

Historia e Letërsisë në Minoritetin Etnik Grek

Prof. Asoc. Panajot Barka

**Historia e Letërsisë në Minoritetin Etnik Grek
Monografi**

Redaktor letrar: **Jani Jani**

Korrektore letrare: **Violeta Çaro**

Gujdestar botimit: **Panajotis M. Lezos**

Shtëpia Botuese **ELIKRANON**

Tel.: 6980 853161, email.: zafiratis@yahoo.gr

www.elikranon.gr, email: elikranon.zafiratis@gmail.com

ISBN: 978-960-652-110-2

Botim i parë: Athinë, Gusht 2022.

All Rights Reserved

© Copyright: Elikranon & Panajot Barka

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Të gjitha pjesët e këtij botimi janë me të drejtën e autorit. Çdo përdorim jashtë kufijve të rreptë të ligjit për të drejtën e autorit, pa lejen e autorit dhe e botuesit, është e ndaluar.

Prof. As. Panajot Barka

Historia e Letërsisë në Minoritetin Etnik Grek

MONOGRAFI

Gjirokastër, Gusht 2022

**Shtëpia Botuese ELIKRANON
Athinë 2022**

*Me mirënjohje të thellë!
Autorëve të shumtë e të shquar të letrave nga MEG
që për shekuj u lanë brezave
një trashëgimi të vyer e të papërseritshme dhe
Fondacionit Elikranon për sakrificat, punën
e pa kursyer e të çmuar për kërkimin, mbledhjen, sistemimin,
risjelljen në dritë dhe vazhdimin e veprës së tyre.*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PARATHËNIE	11
- Objekti dhe disa qasje me rendësi në monografi	17
- Metoda e përdorur	24
- Këndi i vështrimit	27
PJESA E PARË	
KREU I PARË	
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	
- Periodizimi	29
- Emërtimi	34
KREU I DYTË	
TRASHËGIMIA LETRARE NGA FILLESAT DERI NË VENDOSJEN E KUFIJVE	
- Komunikim i drejtpërdrejtë me folklorin, premisa për një individualitet të ri krijues në letërsinë e kultivuar- periodha e parë	39
- Kushtet historike dhe karakteristikat kryesore të letërsisë deri në vendosjen e kufirit - periodha e dytë	46
KREU I TRETË	
LETËRSIA NË MINORITETIN GREK DERI NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE	
-Tiparet e letërsisë në minoritet pas vendosjes së kufirit midis shteteve. Përfaqësuesit: Katina Papa, Tasos Vidhuris, Mihalis Papadhopullos, Athanasios Ikonomidhis, Militiadhis Ikonomidhis, Janis Lilis, Agamemnon Ath. Kommatas, Taqis Mihalis Tsiakos, Alkis Kastritis, Mihalis Manos, Vasilis Ev. Tsatis, Jeorjios Har. Gitzios, Manolis Vitos	55
PJESA E DYTË	
KREU I KATERT	
TIPARET E LETËRSISË NË MINORITETIN ETNIK GREK NË REALITETIN E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE	
- Letërsia gjatë Luftës së Dytë Botërore	83
KREU I PESTË	
PARIMET E METODËS SË REALIZMIT SOCIALIST DHE LETËRSIA E MINORITETIT GREK NË SHQIPËRI	
- Kushtet historike në realitetin politik të pasluftës	93

- Përvetësimi “in extremis” i parimeve të realizmit socialist	94
- Reflektimi i këtij realiteti në jetën dhe veprimtarinë shpirtërore të Minoriteti Grek	96
- Infrastruktura	99
- Elemente të tjera të infrastrukturës –kritika	101
- Kontaktet me letërsinë e kombit amë	102
- Nga një letërsi njëgjydhëshe greke në letërsi dygjydhëshe dhe anasjelltas	105
- Lëvrimi vetëm në gjininë e poezisë	109

KREU I GJASHTË

FAZAT KRYESORE TË LETËRSISË SË PAS LUFTËS, TIPARET DALLUESE, PËRFAQËSUESIT

- Klasifikimi	113
- Letërsia “e burgosur”. Përfaqësuesit: Nikos Filipas Zahos, Fotos Qiriazatis, Andreas Zarballas, Vangjelis Vasiliu, Vasilis Gjizelis, Tilemahos Koças, Athanasios Fidhis, Jorgo Çati	114
- Letërsia e angazhuar	124
- Faza e parë. Përfaqësuesit: Panos Çukas, Spiros Xhas, Janis Panos, Vasilis Koças, Persofoni Gjini	127
- Faza e dytë. Përfaqësuesit: Nikos Kacalidhas, Andreas Zarballas	132
- Përfaqësues të tjerë të kësaj faze: Petros Çerkezis, Thomas Steriopullos, Fotos Malos, Stavros Llajos, Vangjelis Millos, Alekos Papas, Mirela Kallaxhi)	140
- Periudha në vazhdim. Përfaqësuesit: Petros Kurtis, Spiros Hristu, Vasilis Dilos, Jorgos Shukuris, Vasilis Hristu, Stavros Paputsis Minas Lekkas, Vangjelis Zafiratis, Kostas Nushas, Alqis Papas, Mirela Kallaxhi, Elsa Xhumba, Rodhavji Gogoni, Athina Papa, Katerina Karanxha	143
Dy fjalë për infrastrukturën studimore, orientuese dhe kritikën	

PJESA E TRETE

KREU I SHTATË

QASJE TEORIKO-LETRARE E KRIJIMTARISË POETIKE TË P. ÇUKES, N. KACALIDHES DHE A. ZARBALLAS

- Miti dhe ideologjia	153
-----------------------------	-----

KREU I TETË

PANOS ÇUKAS

- Jetëshkrimi	159
---------------------	-----

- Modeli i mitit poetik te vellimi, "Pershëndetje vëllezër, (një zë nga Gjirokastra)"	161
- Vendi i njeriut-(individit) në modelin mitik të poezisë së P. Çukës	162
- Gjëndja e plotmërisë	165
- Natyra e dyzimit poetik tek P. Çuka	169
- Komunikimi me traditën popullore	169

KREU I NËNTË

NIKOS KACALIDHAS

- Jetëshkrimi, vepra	173
- Elementi biografik dhe miti poetik	177
- Kronotoposi i mitologjisë poetike të Kacalidhës	180
- Gjëndja e privimit. Kategoria Natyrë	183
- Kategoria: Shoqëri-njeri	188
- Kategoria: forcat metafizike	190
- Gjëndja e plotmërisë	194
- Çmitizimi i mitologjisë	196
- Marrëdhëniet me traditën popullore	199
Kontradikta	203
- Ndërtimi i poezive- fenomeni i ndikimit	206
- Subjekti poetik, miti dhe surealizmi	209
- Fenomeni i përsëritjes	210

KREU I DHJETË

ANDREAS ZARBALLAS

- Jetëshkrimi dhe veçoritët e poezisë së tij	223
- Kronotoposi i mitologjisë së tij poetike	226
- Topos-i	228
- Hronos-i	239

KONKLUZIONE	249
-------------------	-----

BIBLIOGRAFI	255
-------------------	-----

BIBLIOGRAFI NDIHMËSE (VEPRAT E AUTORËVE)	259
--	-----

INDEKSI I EMRAVE	277
------------------------	-----

PARATHËNIE

Monografia për historinë e letërsisë në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri përbën një angazhim shumëvjeçar kërkimor dhe studimor. Krahas përpjekjes për strukturimin e historisë së saj, monografia synon t'u japë përgjigje problemeve të rrafshit teorik dhe fenomenëve letrare konkrete në lidhje me të.

Në lidhje me pjesën e parë studimi kërkon të arrijë qëllimin duke depërtuar në thellësi, deri në zanafillën e fenomeneve letraro-kulturore të trevës më të gjërë ku bën pjesë ky minoritet, ose me terminologjinë e re juridike Pakicë Kombëtare¹. Thellësia kohore në trajtimin e këtyre fenomeneve angazhohet njëkohësisht me kapërcimin e ngushtësisë territoriale-gjeografike, si një nga dimensionet dimesionët kryesore të vlerave të përgjithshme të kësaj letërsie, e parë si pjesë e kulturës në kuptimin më të përgjithshëm. Niset nga mjedisi-natyra e kësaj hapësire, marrëdhëniet që vendos me të njeriu që banon e jeton në të, për të arritur te produkti kulturor-letrar tradicional apo të kultivuar. Rrjedhimisht, në planin teorik monografia merr përsipër barren e një sprove për të ecur në një terren të virgjër ose pak të trajtuar.

Për të arritur rezultate sa më të qenësishme, krahas vështirësive të karakterit objektiv teorik, u desh të kapërcëhen dhe mentalitete e gjykime tradicionale, konkluzione me devizë ideologjike, politike apo nacionaliste, që kanë mbrujtur në mënyrë të qëndrueshme deri në tabu, opinionin më të gjërë.

Në planin konkret monografia merr përsipër të studjojë dhe analizojë në mënyrë të thelluar dhe krahasuese veprën poetike të përfaqësuesve me në zë të kësaj letërsie të periudhës bashkëkohore, siç janë poetët: Pano Çuka, Andrea Zarballa e Niko Kacalidha. Paralelisht merr përsipër të bëjë periodizime, të konkludojë për terminologji, emërtime dhe vlerësime ezauruese, qëndrime të hapura.

Hapësira territoriale, ose gjeografike për të cilën flasim mbart në rradhë të parë fenomene kulturore – letrare, produkt i një bashkëjetese dhe komunikimi intensiv midis faktorëve të ndryshëm etnokulturorë në të gjitha kohët dhe format, të përcaktuara

¹ Neni 3 i ligjit, nr. 96/2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë.

në hapësirë, ato i përkasin trevës më të gjërë të njohur historikisht me emrin Epir.

Si veçori produkti ato shfaqën si njësim përpjekjesh për mbijetesën e identitetit të kësaj treve. Në realitet përbëjnë kontribute përcaktuese zhvillimi në shumë drejtime për një rajon më të gjërë. Në këtë këndvështrim diakronik historia i rezervoi kësaj treve një rol të veçantë. Me shërbimet e veta luajti rol, madje, hegjemon, në fushën ushtarake, ekonomike e kulturore, në të gjitha momentet që historia kërkoi ndryshime dhe zhvillim, (lashtësi, mesjetë, kohë moderne).

Nëse do të përpiqeshim të përcaktonim elementët thelbësorë të këtij roli do të konkludonim tek raportet që njeriu i kësaj treve ka vendosur diakronikisht me natyrën pasi, siç dihet, harmonia e këtyre marrëdhënieve përcakton kriterin bazë të orientimit të një kulture.

«*Një kulturë është para së të gjithash një mjedis natyror*», (me kuptimin e vendit ose të territorit të banuar), na thotë antropologu i njohur francez Fernand Braudel. Duke e ndryshuar paksa atë, do të mund të thoshim se një mjedis është mbi të gjitha një kulturë, me kuptimin se në të është fiksuar në mënyrë diakronike vet mënyra e organizimit të jetës së komunitetit, dmth vetë kultura e tij. Në këtë kuptim vetë mjedisi fiton një identitet të vetin, i cili buron nga marrëdhënia permanente dialektike midis tij dhe faktorit njeri.

Fiksimi ose lënia gjurmë në një mjedis të caktuar të karakteristikave bazë të një kulture dhe e kundërta, përvetësimi i elementëve natyrorë të këtij mjedisi dhe kthimi i tyre në pjesë të kësaj kulture, çon në identifikimin e grupit, komunitetit me të dhe në formimin e identitetit shoqëror, etnik e kulturor të tij. Kjo dialektikë marrëdhëniesh është korresponduese e kushteve historiko-shoqërore të çdo periudhe zhvillimi. Për pasojë çon në formësimin në nivele të ndryshme të këtij identiteti, por gjithmonë të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me një mjedis gjeografik, madje edhe të përmasave të vogla.

Produkt i qëndrimit dhe i vlerësimit harmonik të raporteve të njeriut me natyrën është fillimisht perceptimi estetik i natyrës nga njeriu.

Te ky raport marrëdhëniesh e kanë origjinën mitet e ndryshme. Po të vemë re raportet e hapësirës për të cilën flasim me mitologjinë do të vemë re se kjo hapësirë është djepi i universit brilant të mitologjisë së lashtë greke, vendi i heronjve mitikë dhe mjedisi ku është vendosur struktura e veprimtarisë së kozmosit

të tyre². Mbi këtë realitet dhe me një komunikim apo mbartje të drejtpërdrejtë artistike e estetike hodhi shtat eposi dhe letërsia e lashtë greke.

Sikur të mos mjaftonte kjo, ndryshe nga hapësirat më të spikatura kulturore, produktet letrare në këtë hapësirë (fjala është për produkte letrare të traditës popullore) ruajtën një linjë zhvillimi të dyfishtë, por me lidhje të pashkëputura nga site kulturor i lashtësisë.

Në periudhën e Mesjetës dhe më vonë, paralelisht me eposin heroik (si karakteristikë e përgjithshme evropiane e frymëzuar, siç thotë Çabej, nga eposi i Dh. Akritës³) dhe baladat (si aktualizim i arketipit të dramave njerëzore të mishëruara në mitologjinë e letërsisë klasike), u mbart gjallë dhe u mbrujt një gjërdan mitesh në formën e legjendave e tregimeve popullore si aktualizim i fragmentarizuar i mitologjisë klasike me elementë që i shërbenin vlerave etike e estetike të kohës **por më shumë shërbenin si kode diakronike përcaktuese të sjelljes kolektive të komunitetit në kushte të caktuara.**

Ky realitet kompleks marrëdhëniesh ka një pasqyrim aktiv në letërsinë e Minoriteti Etnik Grek sidomos para e pas Luftës së Dytë Botërore.

Së dyti harmonia e marrëdhënieve njeri-naturë perceptohet edhe si vlerë etike, si përcaktuese e moralit dhe e sjelljes së gjithëkohshme kolektive.

Së fundmi, njeriu i këtushëm e konsideron natyrën parajsë mbitokësore që i siguron gjithçka i duhet për të jetuar sa më mirë. Si të tillë e konsideron diçka të shënjtë dhe si rregull e hyjnizon. Për të qenë efektiv në respektimin e kësaj risie njeriu shndërron në simbole të identitetit të kulturës së vet elementë natyrorë më të spikatura, të cilat, nëse nuk kanë, ose kanë humbur një funksion të drejtpërdrejtë praktik, zotërojnë në mënyrë të gjithëkohshme vlera apo funksione metafizike.

² Treva kulturore në të cilën u kultivua edhe letërsia e Minoritetit Grek në Shqipëri është padyshim trashëgimtare e asaj kulture të lashtë me të cilën mburet jo vetëm Greqia, por mbarë njerëzimi. Është kjo gjeografia ku shtrihet toponimia e veprimeve të pjesës më të madhe të heronjve mitologjikë të Greqisë së lashtë. Këtu vepruan heronj helenë, trojanë, perëndi e gjysëm perëndi, luftëtarë të lavdishëm, themelues të fiseve epirotase dhe të një serë qytetesh në rajonin më të gjërë. Kjo botë mitologjike që mishëron në një unitet perënditë, idetë, njerëzit dhe natyrën, shërbeu si rezervat i pashtershëm motivesh, arketipesh e temash frymëzimi të përgjithshme për letërsinë dhe artet.

³ Çabej E., 1994, *Shqipëtarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Tiranë fq. 39.

I rëndësishëm mbetet fakti që sa më e fortë dhe më e qëndrueshme është kjo marrëdhënie aq më rezistent mbetet identiteti kulturor i komunitetit-trevës, mbartëse të tij, ndaj çdo lloj presioni të identiteteve të tjera të karakterit etnik-kombëtar, apo shtetëror.

Treva për të cilën flasim i mishëroi këto vlera tek Orakulli i Dodonës që s'është gjë tjetër veçse një pemë.⁴ Mirëpo, ndërgjegjja kulturore botërore nuk ka harruar të nënvizojë se tek Orakulli i Dodonës kanë zanafillën perënditë e Olimpmit në Greqinë e lashtë dhe gjithë kultura e saj që ndriçoi botën.

Pema mbeti për rajonin që flasim, elementi natyror që shënon ende edhe sot pikënisjen e organizimit të strukturës së shoqërive tradicionale në të. (Në fillim është pema, kryesish rrap, prralli, apo edhe valanidhja, më pas është objekti i kultit. Më vonë në kohë u vendosën në qendrën mjedisore të vendbanimit tradicional, objektet e veprimtarive artizanale e në vijim shkollat. Në periudhën komuniste u shtuan edhe qendrat kulturore kolektive).

Elementi tjetër që stigmatizon këtë hapësirë është me origjinë shoqërore, por produkt i po këtyre marrëdhënieve me natyrën. Fjala është për këngën polifonike 3-4 zërëshe⁵. Të gjitha burimet vërtetojnë se kemi të bejmë me elementin shoqëror të një identiteti kulturor diakronik me burim kohor tek mitet e lashta. Kjo karakteristikë shkon paralel me emblemën natyrore të identitetit kulturor të kësaj treve, -pemën,- për të cilën sapo folëm.

Për rastin e këngës polifonike ka rëndësi fakti që marrëdhëniet me mjedisin ndikuan drejtpërdrejt te formëzimi i identitetit të kësaj mënyre të të kënduarit. Ajo është krijuar duke përvetësuar në formë estetike, elementë dhe struktura të mjedisit natyror, ku u mbart, u trashëgua dhe u zhvillua.

Shkalla muzikore pentatonike animitone në të cilën zhvillohet mënyra "a cappelle" (vokale) e interpretimit të këngës polifonike, karakteri retorik i vijës melodike, e kanë burimin te ndikimi i ritmeve animitone të dorikëve ose te frigëve të lashtë. Por, vetë këto ritme janë me prejardhje onomatopesh nga natyra e egër dhe e vrazhdë e këtij rajoni, ku këto fise mbeten për një kohë tepër të gjatë në ëndrrën e tyre drejt jugut e drejt detit.

Por, ndryshe nga pema – Orakull, që, pasi u krijua nga njeriu shërbeu vetëm si dhënës mesazhesh (lidhjet me të sot ruhen

⁴ Barka P., 2016, Ta taksidhja tis Figou (*Τα ταξίδια της Φηγού*), v. I, Elikranon, Athinë, fq. 104-113

⁵ Barka P., 2016, Ta taksidhja tis Figou (*Τα ταξίδια της Φηγού*), v. I, Elikranon, Athinë, fq. 114-127

brënda raporteve të njeriut me mitin dhe funksionit të pemës së zakonshme në organizimin e strukturave shoqërore tradicionale), kënga polifonike, funksionoi dhe vazhdon të funksionojë si një organizëm i gjallë, si një vlerë e gjithëkohëshme estetike, si një biosintezë e njeriut dhe e mjedisit, si një simbiozë dialektike, evolutive dhe diakronike e traditës me realitetin me huazimet, ndikimet dhe antihuazimet, ku në çdo të tashme të kësaj mënyre të të kënduari takon të shkuarën shekullore.

Në formën e sprovës na lejohet të themi që, ashtu si perënditë helene e kanë zanafillën te orakulli i Dodonës, edhe koret e tragjedive helene e kanë origjinën te kjo ngjizje e pavdekshme e polifonisë në fazën foshjore të civilizimit shoqëror.

Një analizë më e gjërë dhe më e thellë shkencore na lejon të themi gjithashtu se këto dy elementë kanë një ndikim diakronik në sjelljen kulturore e rrjedhimisht edhe letrare të trevës për të cilën flasim. Pra, mund të themi që kontributi i gjithëkohshëm i kësaj treve, është produkt i një realiteti të njehsuar në shekuj, jo thjesht nga pikëpamja administrative, por më shumë si rezultat i një nënshtrati të përbashkët kulturor, por me vlera thelbësore në themelet e universit të qytetërimit të tij. Është pikërisht ky realitet që lejoi, si një unitet të kundërtash, bashkëjetesën dhe komunikimin intensiv e pa paragjykime të komuniteteve të diferencuara nga pikëpamja gjuhësore, etnike, apo fetare në këtë hapësirë.

Ky deduksion na jep shkas për të parë se këto raporte gjithëplanëshe krijuan mundësi që kjo trevë të fitojë rol protagonist në lëvizjen iluministe të shek XVIII-XIX të dy komuniteteve më të rëndësishëm në rajon, popullit grek e atij shqiptar, për përcaktimin respektiv të etnogjenezës së tyre dhe ristrukturimit të identitetit kombëtar në kushtet e formimit të shteteve–kombe dhe të çlirimit nga perandoria otomane.

Autorët e lashtë e lidhin Orakullin e Dodonës dhe Perëndinë mëmë të Olimpmit me pellazgët. Rilindasit shqiptarë të shekullit XIX me origjinë pikërisht nga kjo hapësirë gjeografike, në të gjithë prodhimin e tyre ideologjik, intelektual e letrar kërkuan etnogjenezën e kombit shqiptar pikërisht te pellazgët, për të përfunduar te roli dhe simboli i Skenderbeut.

Vetë heroi kombëtar i shqiptarëve, Skenderbeu, krijoi dhe përdori simbole që të çojnë pikërisht te këto fillesa foshnjore të kulturës dhe civilizimit të njerëzimit. Në përkrenaren e tij ai kishte vendosur një kokë dhie, emblema e fiseve të lashta të Epirit, princ i të cilit deklaronte se ishte Skenderbeu. Pelerinën e tij zyrtare e kishte zbukuruar, ndër të tjera me gjethe dhe frytet e va-

lanidhes së Orakullit të Dodonës, duke “imituar” me mënyrën e vet Piron e Epirit dhe Aleksandrin e Madh.

Në kohët tona I. Kadare, nëpërmjet veprës së tij letrare dhe esseistike përpiket të spostojë etnogjenezën shqiptare nga periudha e Skendërbeut tek mitologjia e lashtë greke. Ndërsa P. Zhei, në veprën e tij “*Shqipja dhe Sanskritishtja*”⁶, do të kërkojë vitalitetin e gjuhës shqipe dhe aftësinë e saj për të kuptuar sanskritishten tek marrëdhëniet gjuhësore të shqipes me botën e pellazgëve.

Në Greqi përpunuesit e ideologjisë së Iluminizmit të ri grek, të cilët i përkasin së njëjtës hapësirë, -Epirit, këmbëngulën me të madhe për vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta të popullit grek me lavdinë e grekërve të lashtë për ta paraqitur atë si vazhdues dhe trashëgimtar të këtij qytetërimi.⁷

Gjithsesi, monografia i shmanget qasjes me të njëjtin kujdes dhe impenjim gjithë këtij realiteti shumëplanësh në diakroninë e vet. Siç u tha, i mëshon disa anëve të fenomenëve kulturore pasojë e raportëve njeri natyrë në këtë trevë, për të evidentuar më në gjerësi dhe thellësi fenomenin letrar, që lidhet me Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri⁸, në raport me vendin dhe marrëdhëniet specifike që kjo letërsi krijon me atë shqiptare, por edhe greke, me natyrën dhe elementë të saj, me krijimtarinë popullore etj.

Mografia bën kujdes që të shmangen qëndrime në shërbim të interesave politike e ideologjike që kanë shtrembëruar apo mënjanuar vlerat reale kulturore të kësaj treve. Gjithësesi, në rastin konkret detyrimi për një qasje historike të fenomenëve letrare në këtë trevë, është ndodhur para presionit të realitetëve të krijuara së fundmi.

Realiteti historik i nje letërsisë dhe letrave në gjuhën greke, kufinj shumë më të gjera se realiteti i kufizuar gjeografik dhe etnik i imponuar kryesisht pas krijimit të shtetit shqiptar dhe vëçanërisht në peirudhën e komunizmit. Objektivisht duhet pranuar se terreni paraqet vështirësi që krijojnë për realitetin e sotëm probleme dhe keqinterpretime. Objektivisht duhet thenë se letërsi në gjuhën greke është shkruar nga disa kategori që mbëten jashtë objektit të monografisë. Janë:

⁶ Zhei P., 2005-2006, “*Shqipja dhe Sanskritishtja*” Tiranë vëll. I, II

⁷ Barka P., 2016, *Ta taksidhja tis Figou*, v.II, fq. 101-103

⁸ Përdorimi i termit “*letërsia që lidhet me minoritetin etnik grek në Shqipëri*” bëhet me qëllim që të nënkuptohet edhe letërsia para se ky komunitet të kthehej në minoritet.

Së pari, autoritetet krijuese në kuadrin e levizjës së shqiptarizmit që pranonin kulturën greke si realitet shprehës kulturor dhe për shqiptarët.

Së dyti janë krijuet me origjinë greke që dalëngadalë u asimiluan dhe hoqën dorë prej kësaj origjine.

Së treti, janë krijuet me përkatësi etnike greke në origjinë, por edhe në ndërgjegje, të cilët nuk i përkasin territorit gjeografik të njohur në mënyrë arbitrare si Minoritet Etnik Grek. Fjala është për shëmbull për krijuet nga Voskopoja, Korça, Himara, por edhe nga Gjirokastra, Saranda Delvina, Lunxheria, Zagoria etj.

Ne mund ta shikojmë këtë si mangësi të punës tonë në këtë monografi. Njëkohësisht si nevojë për një trajtesë të veçantë dhe që kërkon shumë punë dhe impenjim studimor më të gjerë.

Objekti dhe disa qasje me rendësi në monografi.

Nga sa u kumtua, objekt i këtij studimi është trajtimi historik i Letërsisë në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri. Ai përbëhet nga tri shtyllat kryesore. Së pari nga qasja e realitetit diakronik kulturor mbi të cilin ngjizet kjo letërsi. Së dyti, nga përpjekja për të organizuar strukturën e një historie të kësaj letërsie në një vështrim të përgjithshëm historiko-letrar dhe së treti, nga një qasje teoriko-letrare e krijimtarisë poetike të P. Çukës, A. Zarballas dhe N. Kacalidhës.

Shtjellimi i objektit lidhet me kapërcimin e një problemi të natyrës teorike. Pyetja që shtrohet është: A duhet pranuar ky prodhim letrar si një letërsi e mëvetësishme, si letërsi e një minoriteti etnik, apo si pjesë integrale e kombit që i përket, apo i shtetit në të cilin jeton, apo i të dyjave njëkohësisht?

Mendoj se argumentat shkencore dhe tradita e trajtimit të saj janë në favor të pjesës së parë të problemit të shtruar. Edhe argumentat kundër kanë peshën dhe logjikën e tyre. Përkrahësit e qendrimit të dytë nisen nga fakti se vlerat estetike të letërsisë kanë natyrë ekumenike, me kuptimin jo thjesht kombëtar, apo etnik. Kanë funksion të gjithëkohshëm⁹, që fillon me momentin e

⁹ Βελοούδης Γ., (Velloudhis J.) 1994 *Γραμματολογία θεωρία της λογοτεχνίας*, (J. Velludhis, Gramatologjia –teoria e letërsisë), fq. 33-39, Athinë (Velludhis. J., është autor grek të cilit për një periudhë kohore 25-vjeçare i përkasin 18 botime mbi teorinë e letërsisë në gjërmanisht, frëngjisht e greqisht).

krijimit duke synuar infinitin e perspektives historike, pavarësisht nga gjuha e përdorur, identiteti i autorit dhe i mitit letrar apo i temës. Kjo është e vërtetë, por nuk duhet harruar se letërsia, ashtu siç është arti i përgjithësisht nëpërmjet individualizimit¹⁰ edhe kontributi i saj në vlera estetike të karakterit ekumenik ka në thelb identitetin e krijuesit që s'është gjë tjetër veçse shprehës i identitetit etnokulturor të komunitetit pjesë e të cilit është.

Në këtë këndvështrim produkti letrar i komunitetit të minoritetit etnik grek, nëse të paktën mund të pretendojë njehsimin me letërsinë helene, ose si një pjesë e letërsisë shqiptare, mund ta fitojë vetëm duke evidentuar individualitetin e vetë si të tillë.

Kjo letërsi lidhet së pari me një trevë kulturore me veçoritë e veta. Ndër faktorët që përcaktojnë këtë status mund të përmendim. Komuniteti i kësaj treve etnikisht i përket kombit grek dhe politikisht shtetit shqiptar.

“Për qëllime studimi të një minoriteti etnik, fetar, ose lingvistik, thuhet në përcaktimin e Komisionit Europian për Demokraci dhe Paqe, përkufizon se minoriteti etnik, është një grup, i cili numërikisht është më i vogël nga pjesa tjetër e popullsisë së shtetit të cilit i përket dhe zotëron karakteristikat kulturore, fizike ose historike, fe ose një gjuhë të ndryshme nga ajo e pjesës tjetër të popullsisë”¹¹.

Në këtë këndvështrim minoriteti etnik grek në Shqipëri, nga njera anë, është trashëgimtar dhe bartës i elementeve përcaktuese të identitetit etnik të një populli (histori të njëjtë, kulturë homogjene, gjuhë dhe konstitucion shpirtëror të përbashkët)¹², nga ana tjetër, është pjesë integrale e një shteti tjetër. Si i tillë identiteti i tij mund të përcaktohet *“në bazë të zhvillimit të tyre konkret në kohë dhe hapësirë, pavarësisht nga gjuha”¹³.*

Vetë realiteti historik na lejon të themi se komuniteti i Minoritetit Grek në Shqipëri në një periudhë të caktuar, pas dhënies së statusit të minoritetit dhe, veçanërisht, në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, e zhvilloi identitetin e vet kulturor me vlera të ndryshme nga ai i kombit amë. Kjo ndodhi si një proces objektiv i reflektimit të realitetit të ri politik në shtetin shqiptar. Këto ndryshime ndodhën duke patur si bazë traditën e vet, që do të

¹⁰ Wellek R., Warren A., 1980, *Θεωρία της Λογοτεχνίας* (Theory of Literature), Athinë, fq. 133.

¹¹ Komisioni Evropian për Demokraci e Paqe, projekti i instrumentit juridik për mbrojtjen e minoriteteve datë 08.02.1991.

¹² Fjalor filozofik, njësia “komb-” dhe përkufizimin në sociologji i “kombit”.

¹³ Βελοούδης Γ., 1994, *Γραμματολογία θεωρία της λογοτεχνίας*, Athinë, fq. 279.

thotë se, edhe pse u reflektuan deri edhe në gjuhë, identiteti kulturor i këtij minoriteti nuk mund të konfondohet me atë të popullit shqiptar.

Kuptohet që edhe produkti letrar i tij u zhvillua në varësi të ngushtë me faktorët socialë, politikë e historikë, që vepruan në identitetin e vet kulturor në periudhën e të qenit minoritet brënda shtetit shqiptar. E parë në këtë rrafsh, ajo përbën një veçori që meriton vëmendje.

Në këtë plan, po të kemi parasysh vlerësimin e Y. Chevrel se nocionet “*letërsi kombëtare*”, “*kulturë kombëtare*” dhe “*gjuhë kombëtare*”, as ishin e as janë të barasvlefshme¹⁴, mund të themi se letërsia e këtij minoriteti nuk mund të vlerësohet apo të klasifikohet duke u nisur nga kriteri i vetëm i gjuhës. Kjo do të na çonte në një konkluzion të gabuar. Ta konsiderojmë atë letërsi greke, përderisa është shkruar në gjuhën greke, apo letërsi shqiptare, përderisa është shkruar në gjuhën shqipe.

Nga këto përsiatje mund të nënvizojmë se vlerat e diferencuara në identitetin kulturor të komunitetit të Minoritetit Grek, të përfutuara nga ndikimi i kushteve sociale-politike – ekonomike e kulturore të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, sollën diferencime midis prodhimit letrar në Greqi dhe prodhimit letrar në komunitetin e Minoritetit Grek në Shqipëri. Këto diferencime i dedikohen më shumë metodës së realizmit socialist që ndoqi letërsia në Shqipëri. Gjuha mbeti elementi i përbashkët midis letërsisë së këtij komuniteti dhe letërsisë greke. Një element tjetër, në dukje i përbashkët, por në fakt diferencues me letërsinë greke, është komunikimi i pandërprerë me traditën letrare popullore të trevës së vet.

Në rastin e marrëdhënieve me letërsinë shqiptare, gjuha mbetet elementi kryesor dallues midis kësaj letërsie dhe asaj të Minoritetit Grek. E vërtetë është se anët e tjera që përcaktojnë dallimin e identitetit letrar të këtij minoriteti me tërësinë e letërsisë shqiptare, marrësinë rëndësi të dorës së dytë, pasi hynë në rrjedha konverguese, por, siç thamë nuk u njehsuan.

Të njëjtin arsyetim, por me sens të kundërt, mund të përdorim edhe për atë pjesë të letërsisë së këtij minoriteti të shkruar në gjuhën shqipe. Madje, ky do të ishte një argument më shumë, që e bën më me interes studimin e kësaj letërsie.

Të veçantën në këtë pikë duhet ta kërkojmë te fakti se nuk kemi: përsëritjen e plotë e të qenësishme të fenomenit “*gjuhë e*

¹⁴ Chevrel Y., 1989, *La littérature comparée*, Paris, fq. 20.

njëjtë, letërsi të ndryshme”, siç vënë re përkrahësit e letërsisë së krahasuar për rastet e letërsive anglofone (të SHBA-së, Anglisë), frankofone (Francës, Kanadasë, apo Afrikës së Jugut) etj, as përsëritjen e plotë e të qenësishme të fenomenit të letërsive të nje-hsuara, edhe pse ato lëvrohën në gjuhë të ndryshme kombëtare në kufijtë e një shteti “etnik”. “*Ekzistenca në rastin e Zvicrës (e letërsive, shën. i autorit) në katër gjuhë (gjermanisht, frengjisht, italisht, retoromanisht), nuk presupozon detyrimisht ekzistencën e katër letërsive “kombëtare”*”¹⁵ thekson J. Velludhis. Së fundi, as përsëritjen e plotë të fenomenit që “disa shkrimtarë të kulturave të ndryshme shprehën në “të njëjtën gjuhë”, -siç thotë Y. Chevrel duke marrë si shembull faktin që “tekat e historisë kanë ndarë me kohë hollandishtfolësit e Vendeve të Ulëta nga ata të Belgjikës, gjërmanofonët e Zvicrës gjërmanike prej atyre të Austrisë.”¹⁶

“Një shkrimtar qëndron më lart se koncepti “atdhe”, -thotë prozatori i njohur nga Minoriteti Grek Telemak Koça,- e as letërsia nuk dallohet vetëm nga gjuha, por edhe nga ato që kumton artistikisht. Në këtë plan unë në Greqi jam shkrimtar “grekofon” dhe jo shkrimtar “grek”. Këtë dallim e kam qoftë nga prejardhja ime si individ, qoftë nga mënyra se si shkruaj letërsi, qoftë nga tematika. Në këtë plan unë ngaj si shkrimtar shqiptar sesa si shkrimtar grek. Megjithë dëshirën time të madhe për t’u integruar në letërsinë greke e ndiej se jam shkrimtar në kufi. Kjo do të thotë se është e vështirë të konfontohet letërsia me gjuhën”¹⁷

Një faktor që e bën akoma më evident përcaktimin se kjo letërsi i përket një treve kulturore dhe jo një treve thjesht gjuhësore, përbën folklori i kësaj treve dhe marrëdhëniet e letërsisë së kësaj treve me të. Folklori dhe në përgjithësi arti popullor, jo vetëm që shërbyen si pikënisje e kësaj letërsie, por edhe e shoqëruan ecjen e saj në të gjitha etapat e zhvillimit. Nga ana tjetër, edhe pse konsiderohet si pjesë e pandarë e folklorit grek, folklori i kësaj treve zotëron karakteristikat e veta dalluese dhe vlera të veçanta dhe të çmueshme.¹⁸ Gjithashtu, brënda këtyre karakteristikave dalluese do të gjejmë elementë të përbashkët të folklorit

¹⁵ Βελοούδης Γ., 1994, *Γραμματολογία θεωρία της λογοτεχνίας*, Athinë 1994, fq. 279.

¹⁶ Chevrel Y., 2002, *Letërsia e krahasuar*, Tiranë, fq. 28.

¹⁷ Koça T., Takim midis shkrimtarëve grek dhe të Minoritetit Grek në Shqipëri, në universitetin e Gjirokastrës, 31.05. 2004.

¹⁸ Një vend me rëndësi zënë legjendat dhe mitet e veçanta të kësaj treve. Ato janë produkt i kushteve social-historike dhe i marrëdhënieve të kësaj treve më rajonin më të gjërë dhe që kanë shërbyer gjithmonë si bazë ideologjike dhe si sitem referimi për sjelljen kolektive të komunitetit të kësaj treve në situata të caktuara.

të një rajoni më të gjërë, që shfaqën herë si elementë të një nënshtrati të përbashkët kulturor të këtij rajoni, e herë si mite e motive shtegtuese.¹⁹

Të gjitha këto argumente nuk mund të mohojnë, përkundrazi, faktin se letërsia e Minoritetit Grek (qoftë edhe pjesa e njohur dhe e lejuar zyrtarisht nga sistemi komunist) ka një ecuri historike brënda se cilës krijoi vlera artistike dhe individualitetet e veta letrare të padiskutueshme.

Si e tillë kjo letërsi përbën një kontribut dhe një vlerë përbërëse për të gjithë letërsinë dhe kulturën shqiptare. (Vetëm në aspektin e kornizës ideologjike, ajo mund të konsiderohet e barasvlefshme me mbarë letërsinë e angazhuar shqiptare me tipar dallues vetëm gjuhën.)

Njëkohësisht, ajo përbën edhe një vlerë e veçori ndryshe për letërsinë greke. Kjo do të thotë se janë të pajustificueshëm konfuzioni dhe ekzistenca e mendimeve dhe e pikëpamjeve të ndryshme, të paargumentuara dhe të pasistemuara, në lidhje me karakterizimin, terminologjinë, periodizimin e saj etj, gjë që bën më të domosdoshëm ndërmarrjen e një studimi të tillë.

Së dyti. Dallimet e mësipërme të letërsisë së Minoritetit Grek në lidhje me fenomene letrare analoge mund t'i kërkojmë te veçoritë e saj si një letërsi kontakti. Në rrjedhat historike kontaktet e saj janë, herë të dyanshme e herë të njëanshme.

Raportet e letërsisë së kësaj treve me letërsinë e kombit amë kaluan nga stadi i një letërsie të njehsuar, para vendosjes së kufijve; në një letërsi pa asnjë kontakt, - në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore; për të kaluar në periudhën e pas viteve 90' të shekullit të kaluar, në stadin e rifitimit të plotë të kontakteve me letërsinë e kombit amë, deri në përpjekje për njehsim me të.

Në raport me letërsinë shqiptare këto kontakte kaluan në stadet e mëposhtme. Nga kontaktet natyrore në periudhën para vendosjes së kufijve, në humbjen pothuaj fare të këtyre kontakteve në periudhën deri në Luftën e Dytë Botërore. Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitet 90 kemi një komunikim intensiv me tendenca njehsuese (pavarësisht nga gjuha) me letërsinë shqiptare. Pas viteve 90 konstatohet tendenca e hapur e letërsisë së Minoritetit Grek për të humbur kontaktet e drejt-

¹⁹ Përkrah mbi këtë realitet nisi të shkruhej, herë vetëm në gjuhën shqipe e herë si bilinge edhe letërsia shqipe që shoqëroi Rilindjen Kombëtare Shqiptare të autorëve shqiptar nga jugu i vendit.

përdrejta me letërsinë shqiptare e për të kaluar sërish në një ekstrem të kundërt, të ngjashëm me atë të periudhës 1912-1939.

Kjo situatë solli një fenomen që rrallë mund të haset në historinë e zhvillimit të fenomeneve kulturore e artistike, veçanërisht, në kushtet e zhvillimeve integruese e globalizuese të shekullit të kaluar dhe në vijim. Kjo për faktin se natyrën e zhvillimit të civilizimit, kulturës, arteve (dhe në këtë kuadër të letërsisë) e përcakton faktori i marrjes dhe i dhënies së informacionit mbi arritjet respektive, **i integritit** (në kuptimin e respektimit të rregullave “*të normës*” krijuese) dhe **i diferencimit** (në kuptimin e devijimit nga norma për krijimin e individualitetit, në rrafsh personal apo kombëtar). I kuptueshëm është në këtë rrafsh zhvillimi i deformuar dhe aspak normal e i natyreshëm i letërsisë së Minoritetit Grek në Shqipëri.

I njëjti argument duhet përdorur për të kuptuar tendencat e viteve të fundit të letërsisë së Minoritetit Grek për një komunikim intensiv me letërsinë panhelene dhe integrimin e saj në këtë letërsi.²⁰ Në takimin midis shkrimtarëve grekë dhe të Minoritetit Grek në Shqipëri, prill, 2004 organizuar nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Greke në Universitetin e Gjirokastrës, kjo tendencë u shtrua si kerkësë e domosdoshme nga shumica e diskutantëve. Bile, siç u theksua atje, u kërkuan mënyra konkrete për arritjen e këtij “*integrimi*” apo “*riintegrimi*”. Në një plan më të gjërë ky fenomen lidhet me realitetin e shpërbërjes së sistemeve politike në vendet e Lindjes Evropiane dhe rifitimit të kontakteve të këtij minoriteti me kombin amë pas hapjes së Shqipërisë ndaj botës.

Tendenca integruese me letërsitë kombëtare analoge vihen re edhe në letërsitë e shumë vendeve të Lindjes, por, edhe në këtë plan, duhet vënë re një dallim esencial. Në vendet e ish-bllokut të Lindjes “*zhvendosjet*” drejt letërsive të tyre kombëtare, si p.sh: në ish-Jugosllavi, ish-B.S, apo procesi i kundërt në ish-Gjermaninë e ndarë, lidhën në përgjithësi me ndryshimin e hartës politike në rajon. Ndërsa tendencat e letërsisë së Minoritetit Grek për integrim ose njehsim në letërsinë panhelene nuk kanë një bazë të tillë. Më shumë kjo tendencë nisët nga fenomeni i emigrimit masiv të komunitetit të këtij minoriteti në kombin amë. Pra dhe të integritit të saj me letërsinë helene në shtetin amë, fenomen që ndodh përmes procesëve të natyreshme.

²⁰ Naço K. 2005, *Ιστορία της Βορειοηπειρωτικής Λογοτεχνίας*, (Historia e Letërsisë Voopriopirote), Gjirokastrë, f. 15.

Nga ana tjetër, letërsia shqiptare kërkon dhe vendos me forma të tjera, përditë e më shumë, kontakte të drejtpërdrejta me letërsinë greke.

Këto tendenca evidentojnë nga një anë tjetër faktin se në periudhën afro 50-vjeçare të diktaturës komuniste, izolimi tërësor i letërsisë së Minoritetit Grek nga pjesa tjetër e letërsisë kombëtare greke, solli atrofizimin e saj. (Krahasuar me rrjedhat letrare koherente ndërkombëtare, të njëjtat pasoja, pavarësisht nga arritjet, pësoi dhe letërsia shqiptare). Një situatë e tillë solli zvogëlimin e mundësive të letërsisë së Minoritetit Grek për të fituar rolin e transmetuesit të dyfishtë midis dy letërsive, asaj greke dhe shqiptare. Ajo nuk arriti ose nuk u lejua që, në bazë të skemës universale të faktorëve që bashkëveprojnë në çdo fenomen komunikimi (dhënës, transmetues, ndërmjetës ose marrës), të luajë rolin e ndërmjetësit midis këtyre dy letërsive si një proces që *“përfshin gjithçka, që kushtëzon dukuritë e kalimit nga një sistem kulturor në tjetrin, që ka të bëjë me mbështetjen materiale ose me veprimtarinë e individit”*²¹. Kështu, ajo humbi aftësinë për të kontribuar si vlerë e veçantë si për tërësinë e letërsisë shqiptare, ashtu edhe për vetë letërsinë greke.

Së treti Juridikisht ky komunitet etno-kulturor është i njohur si Minoritet Etnik Grek në Shqipëri. Rrjedhimisht, në kushtet e këtij statusi dhe produkti i tij letrar do të përcaktohet si Letërsi e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri

Së katërti. Në historiografinë letrare të të dy vendeve me të cilat letërsia e Minoritetit Grek ka kontakte, ngjashmëri apo vazhdimësi, nuk ka ndonjë qëndrim të përcaktuar qartë rreth kësaj letërsie, nuk ka një studim shkencor për natyrën dhe zhvillimin e saj. Në Historinë e Letërsisë Shqiptare, botime reciprokisht të Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1959 dhe i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, 1983, si dhe në botimin shqip të “Historisë së Letërsisë Shqiptare” të Robert Elsie, Tiranë, Pejë, 1997, apo dhe në botime të tjera të ngjashme më të vonshme, letërsia e Minoritetit Grek nuk përmendet as si pjesë e letërsisë shqiptare (si një vlerë e saj) e as si një fenomen letrar që ndodh brënda shtetit shqiptar.

Ndërsa në edicionin e plotë të revistës “Nëntori” nga 1953-1990 dhe të gazetës “Drita” të periudhës 1960-1990, konstatuam

²¹ Chevrel Y., 2002, *Letërsia e krahasuar*, bot. shqip, Tiranë, fq. 71.

se trajtimi i kësaj letërsie, ose nuk ekziston fare, ose është në nivele të përcipta e formale.²²

Në mënyrë konfuze, fragmentare e jashtë kritereve dhe ligjesive estetike të letërsisë dhe arteve, por nën ombrellën e ndikimeve politike e ideologjike, trajtohet kjo letërsi në ato mjete të komunikimit masiv e letrar që dispononte vetë minoriteti në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore.

Heshtje apo konfuzion metodologjik, qëndrime sektare dhe denigruese për letërsinë e këtij komuniteti, të shkruar sipas parimeve të realizmit socialist, hasen në literaturën mbi letërsinë në nivele të ndryshme edhe në Greqi.

Metoda e përdorur

Dihet që për realizimin e një punimi, përveç përcaktimit të objektit-qëllimit, duhen përcaktuar edhe dy elemente të tjerë të qenësishëm që janë **metoda e përdorur** dhe **këndi i vështrimit**. Përcaktimi i këtyre dy elementeve buron nga natyra e objektit. Në rastin tonë mund të konstatohet lehtësisht se dy janë karakteristikat kryesore të kësaj letërsie në studim. Së pari, kjo letërsi na shfaqet me një angazhim diakronik në funksion të kushteve historike, social-politike e ekonomike që lidhën me këtë trevë dhe rajonin më të gjërë. Së dyti, është letërsi e një treve të caktuar kulturore dhe në kontakte të vazhdueshme me faktorë të tjerë kulturorë e letrarë homogjenë dhe heterogjenë. Kjo do të thotë se na ofron realitete “që kanë të bëjnë të paktën me dy seri të ndryshme të dhënash”, përqsja e të cilëve na lejon të realizojmë studimin e objektit tonë.

Rrjedhimisht një nga metodat e përdorura është ajo krahasuese në një plan më shumë sociologjik e antropologjik në përqsjen e letërsisë. “Objekti i letërsisë krahasuese, -thekson Van Tieghem,- janë marrëdhëniet binare (binaires) letrare, janë marrëdhëniet reciproke midis dy letërsive kombëtare”²³. Nuk duam t’u referohemi këtu pikëpyetjeve të shumta teorike lidhur me pavarësinë dhe efektivitetin e kësaj metode (krahasuese) për studimin e

²² Në revistën “Nëntori” problemi i letërsisë së Minoritetit Grek në aspektin teorik trajtohet vetëm dy herë. Një herë në vitin 1955, nga Spiro Xhai, (Revista “Nëntori”, nr. 10, fq. 119-122) dhe një herë nga Pano Çuka në formën e diskutimit në kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të qërshorit të vitit 1984. (Revista “Nëntori”, nr. 6, 1984, fq. 222-227). Në gazetën “Drita” nuk ka trajtime teorike të kësaj natyre.

²³ Tieghem V. 1931, *La littérature comparée*, Paris, fq.174.

letërsisë. Mjaftohemi për këtë me atë që thotë Yves Chevrel se “tani grindjet janë që të suar, në mos janë kapërcyer fare”²⁴ dhe i referohemi përkufizimit të kësaj metode të bërë nga Cl. Pichois dhe A. Rousseau që më 1967: “Letërsia e krahasuar është arti metodik, që, nëpërmjet kërkimit të lidhjeve të analogjisë, të afërsisë dhe të ndikimit, përfaqëson letërsinë ndaj fushave të tjera të shprehjes ose të njohjes, përfaqëson të dhënat dhe tekstet letrare, të largëta ose jo në kohë dhe në hapësirë, mjaft që t’u përkasin shumë gjuhëve ose shumë kulturave, të jenë pjesë e së njëjtës traditë, për t’i përshkruar më mirë, për t’i kuptuar e vlerësuar”²⁵

Metoda krahasuese është ajo që na jep modelin si të përçapemi drejt tjetrit për ta kuptuar atë më mirë dhe paralelisht me të edhe veten. Ajo na jep çelësin për të kuptuar se çfarë ndodh kur një ndërgjegje njerëzore ose kolektive, e përfshirë në kulturën e vet, përballë me një fenomen që është shprehje e një kulture tjetër. Ajo “përfshin të gjithë sektorët e marrëdhënieve kulturore globale dhe të faktorëve–ndërmjetës të tyre, si dhe marrëdhëniet e letërsisë, kombëtare e ndërkombëtare, në një kuadër të gjërë fenomenesh e shfaqjesh jashtëletrare e kulturore”²⁶.

Kuptohet që kjo metodë, e përdorur në shumë fusha të tjera shkencore, në studimin e letërsisë nuk mjaftohet thjesht në grumbullimin e fakteve dhe krahasimin e tyre. Metoda krahasuese në letërsi, zë një gamë tepër të gjërë rrafshesh krahasuese e studimi. Pa i përmendur mund t’i përmbledhim në dy kategori kryesore:

Së pari, veçojmë kategorinë e rrafshesh krahasuese të strukturës apo të shtresimit të brendshëm letrar.

Së dyti, është kategoria e parimeve të përgjithshme të historiografisë krahasuese të letërsisë.

Objekti ynë në këtë studim do të përqëndrohet kryesisht te kategoria e dytë. Qëllimi, siç thamë, është që duke u mbështetur në ligjësitë estetike të funksionit dhe natyrës së letërsisë, të japim një ide sa më të plotë për çështje që lidhën me historiografinë e zhvillimit të letërsisë së Minoritetit Grek; të trajtohen brenda sistemeve të tilla referimi të hapësirës e kohës (hronotoposit), elementë të qenësishëm e përcaktues të kësaj letërsie, siç mund të jenë: kushtet historike, politike e shoqërore që e lindën dhe në të cilat u zhvillua kjo letërsi.

²⁴ Chevrel Y., 2002, *Letërsia e krahasuar*, Tiranë, fq. 12.

²⁵ Pichois Cl. & Rousseau A., 1983, sipas A. Colin, *La littérature comparée*, Paris, fq. 174.

²⁶ Brunel P., 1983, *Qu’ est-ce que la littérature comparée?*, Paris, fq. 67.

Po ashtu, me sistem referimi konceptin e Dewey-it (Djouit) mbi ekzistencën në letërsi të marrëdhënieve të përvojës së krijuesit dhe të atij që e përvetëson atë,²⁷ të përqasen: përkatësia etnike e bartësve dhe krijuesve të saj; raportet e marrëdhënieve me letërsinë panhelene si dhe marrëdhëniet me letërsinë shqiptare dhe popullin shqiptar në përgjithësi etj. Të para brënda sistemit referues të kohës, karakteristikë e shumë prej këtyre faktorëve mbetet ndryshueshmëria në varësi të ndryshimeve gjeopolitike të trevës, në të cilën kjo letërsi u lind dhe u zhvillua.

Për të arritur qëllimin e sapo riideuar të studimit tonë, u mbështetëm njëkohësisht te metodologjia e sociologjisë së letërsisë, e cila pranon se *"ligjësitë estetike nuk mbështeten tek ligjësitë shoqërore; nuk janë, bile, as pjesë e ligjësisve shoqërore. Janë ligjësi shoqërore të një lloji të veçantë, të lidhura ngushtë me ato shoqërore"*²⁸.

Çelësin për të ecur me siguri drejt këtij qëllimi na e jep përfaqësuesi i shkollës së Pragës J. Mukarofsky i cili thotë se historia e letërsisë *"mund të marrë parasysh zhvillimin e strukturës poetike, e cila realizohet nëpërmjet rivendosjes së vazhdueshme të elementeve të saj dhe njëkohësisht në sajë të ndërhyrjeve të jashtme. Faktorët e jashtëm edhe pa qenë vetë bartës zhvillimi, përcaktojnë me saktësi çdo fazë zhvillimi të saj. Nga kjo pikë vështrimi çdo ngjarje letrare shfaqet si rezultante e dy dinamikave: të dinamikës së brëndshme të strukturës dhe të ndërhyrjeve të faktorëve të jashtëm"*²⁹.

Nga ana tjetër, sociologjia e letërsisë si degë e studimit të letërsisë dhe jo e sociologjisë së përgjithshme, na ndihmon për të parë në letërsinë e minoritetit pasojat nga zbatimi i parimeve të realizmit socialist, sipas të cilave, *"vullneti politik (i klasës në pushtet, shën. i autorit) duhet të përcaktojë ecurinë dhe ndarjen e prodhimit artistik"*³⁰. Parimet historiko-shoqërore të kësaj metode, (të realizmit socialist) të ngritura mbi absolutizimin e kategorisë filozofike të shkak-pasojës, sinonin që *"jo vetëm të kuptonin botën, por edhe ta ndryshonin"*³¹

²⁷ Monroe G. Beardsley, 1989, *Aesthetics from Classical Greece to the Present – A short History*, Athinë, fq. 325

²⁸ Welles R., Warren A., 1980, *Theory of literature*, Athinë, fq. 123

²⁹ Revista "Alternative", Nr. 80 (Oktober 1971), Përkth. Greqisht

³⁰ Monroe G. B., 1989, *Aesthetics from Classical Greece to the Present – A short History*, Athinë, fq. 347

³¹ Monroe G. B., 1989, *Aesthetics from Classical Greece to the Present – A short History*, Athinë, fq. 345.

Metoda e sociologjisë së letërsisë mund të fshehi në vetvete gracka të ndryshme. Të tilla mund të jenë, p.sh: parimet e “*sociologjisë empirike*”, të cilat në studimin e letërsisë mjaftohen vetëm me faktorët socialë e jashtëletrarë. Determinizimi i thjeshtuar i veprës letrare te tre faktorët e jashtëm “*race*”, “*milieu*”, “*moment*”, të H. Tain-it, mund të na shpjegjë në pozitat e parimeve pozitiviste të Auguste Comte (1798-1857) në letërsi, sipas të cilave, ajo duhet të mjaftohet me përshkrimin e pastërt të objekteve empirike dhe të mos synojë të kërkojë vlera shpirtërore.

Këto e të tjera gracka metodike jemi munduar t'i kapëcejmë. Nga ana tjetër sistemin referues diakronik–krahasues e konsiderojmë jo thjesht një çlirim nga postulatet ideologjike për studimin e letërsisë së kësaj treve, por edhe një mundësi për evidentimin e vlerave unike e të papërsëritshme në rrafshin e fenomeneve letrare. Kuptohet që kjo çështje del jashtë objektit të kësaj monografie, pavarësisht se është e vështirë dhe e pakuptimtë shmangia totale e saj.

Këndi i vështrimit

Faktori i tretë që ndihmon realizimin e një studimi është këndi i vështrimit. Elementi përcaktues për të përzgjedhur këndin e vështrimit për një studim është, mendoj, nevoja e shmangies së subjektivitetit të studiuesit, sidomos në një studim me karakter shoqëror. Në këtë prizëm dy janë pikëvështrimet kryesore: ajo “intelektuale” dhe ajo “biomatike” (e përvojës personale).

Këndvështrimi i parë deklaron asnjësinë mbi objektin e studimit. Mirëpo, të gjithë janë të ndërgjegjshëm se nuk e siguron asnjësinë e deklaruar, se studiuesi edhe kur e deklaron atë, shpreh, qoftë edhe në mënyrë indirekte, qëndrimin e tij mbi objektin e studiuar.

Këndvështrimi i dytë deklaron se ajo që referohet në një studim është produkt i drejtpërdrejtë i “*uni*” të studiuesit në një moment të dhënë. “*Sa më shumë kalon koha dhe shkruaj,- thotë në një nga librat e tij historiani i njohur John Devy,- gjithnjë e më shumë përdor fjalën “unë”. Këtë nuk e bëj se më pëlqen vetja, por e bëj që të mbroj lexuesin tim, të kuptojë se, atë që them në studimin tim, është ajo që unë besoj në çastin e dhënë dhe këtë e bëj me sinqeritet dhe ndershmëri*”. Kjo mënyrë të arsytuari fiton gjithnjë e më shumë terren në studimet filologjike dhe konsiderohet objektive brënda kuadrit të diversitetit e të pluralizmit të mendimit.

Të studiuarit e fenomeneve nga ky këndvështrim përbën gjithashtu një sprovë për vetënjohje. Dhe, siç thotë Yves Chevrel, *“Kush bën një studim mbi një objekt letrar, cilido qoftë ai, njeh rrënjët e një kulture, të kulturës së bashkësisë së tij (ndonjëherë të kulturave të bashkësive të tij, të njëkohshme ose të njëpasnjëshme), po aq sa ç’njeh rrënjët e kulturës ku është formuar vetë”*³²

Mbështetur, pikërisht mbi këto parime ndoqëm në këtë punim këndvështrimin *“biomatik”*, si një mënyrë më efikase drejt qëllimit tonë. Për këtë zgjedhje ekzistojnë edhe disa arsye, do të thoshnim, objektive.

Arsyeja e parë lidhet me veçoritë e letërsisë së Minoritetit Grek në Shqipëri, sidomos, pas Luftës së Dytë Botërore, veçori që për shkak të ndërprerjes *“hermetike”* të kontakteve me kombin amë, janë të rralla për letërsi analoge minoritetesh etnike. Rrjedhimisht, studimi i kësaj veçorie sigurohet, përpos të tjerash, nga një njohje e përjetuar.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me mungesën e një bibliografie korresponduese me veçoritë e kësaj letërsie. Dhe arsyeja e tretë lidhet me mungesën e studimeve të mirëfillta mbi këtë letërsi ose me ekzistencën e studimeve që preferojnë konfuzionin dhe shtrembërimin e realitetit të saj, në shërbim të qëllimeve politike dhe ideologjive të caktuara.

Nga ana tjetër, për një pjesë të mirë të kësaj letërsie, është ende herët për të bërë konkluzione përfundimtare. Ndaj dhe mënyra biomatike e të studiuarit të saj të siguron epërsinë për të shprehur thjesht një vlerësim apo gjykim nga ky pozicion.

³² Chevrel Y., 2002, *Letërsia e krahasuar*, bot, shqip, Tiranë, fq. 151.

PJESA E PARË

KREU I PARË

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

I.1. *Periodizimi*

Në të gjithë literaturën teorike mbi periodizimin e letërsisë, çështja trajtohet si një nga problemet më delikate apo të ndërlikuara. Problemi bazë mbetet caktimi i parimeve të periodizimit. Mbi ç'kri-tere do të përzgjidhën ato?

Ekziston në radhë të parë rreziku që buron nga trajtimi i historisë së letërsisë nga pozitat e historisë politike. J. Velludhis³³ i referohet për këtë përfaqësuesit më në zë të kësaj teze George Gottfried Gervinus-t, i cili në parathënien e “Historisë së Letërsisë të shekullit XIX”, shkruar prej tij, thotë: “*Nuk kam asnjë lidhje me kritikën estetike të objektit*”.

Të njëjtën rrezikshmëri deformuese për kriteret e periodizimit të letërsisë paraqet edhe pozitivizmi. Në anën e kundërt qëndrojnë formalistët dhe strukturalistët. Parimet e tyre të studimit të veprave letrare së brëndshmi dhe të zhvillimit të letërsisë mbi këtë bazë, i përshtatet më së shumti zhvillimit në teorinë e llojëve të Darvinit³⁴ vëren Wellek. Vet Wellek thotë se kriteret që lejojnë të përvijohën tiparet e periudhave letrare “*mund të përcaktohen... duke u nisur vetëm prej kriteresh të kulluara letrare*”³⁵

Më i pranueshëm është parimi i Mukarovsky-it, i cili pranon trajtimin historik të letërsisë në një ndërthurje të dyfishtë: si “*zhvillim të strukturave*” të brëndshme të saj dhe si “*krijim*”, në raport me realitetin shoqëror “*të jashtëm*”³⁶

“*Në shkallë kombëtare, mbartja e periodizimeve politike edhe në rrafshin e jetës letrare, është një tundim i madh, që duket te shumica e historianëve të letërsisë angleze apo franceze*”, na thotë

³³ Βελοῦδης Γ., 1994, *Γραμματολογία – θεωρία της λογοτεχνίας*, Athinë, fq. 362.

³⁴ Wellek R., 1963, *Concepts of Criticism*, New Haven, London, fq. 121.

³⁵ Wellek R., 1980, *Theory of literature*, Athinë, fq. 67.

³⁶ Βελοῦδης Γ., 1994, *Γραμματολογία – θεωρία της λογοτεχνίας*, Athinë, fq. 365.

Yves Chevrel³⁷. Po ky autor na thotë se në Gjermani, për një orientim periodizimi letrar ose kulturor, parapëlqejnë një ngjarje, siç mund të jetë vdekja e Gëtes. Ndërsa në Greqi, Spanjë dhe Vende të Ulëta, na njofton Chevrel, përdoret dhe termi “breza”.

Në punimin tonë, parapëlqyem parimin e mbartjes së periodizimeve historiko-politike në periodizimin e kësaj letërsie, të gërshetuar me parimin e Mukarovskyt. Njëkohësisht, preferuam edhe termin “breza”, për ato periudha që tiparet dalluese të letërsisë së saj krijohen nga autorë të një moshe ose brezi.

Ndjekja e kësaj rruge lidhet me faktin që, siç theksuam edhe më lart, Letërsia e Minoritetit Grek në Shqipëri u zhvillua si një letërsi e ndikuar nga zhvillimet historike. Nga ana tjetër historiografitë e letërsive shqiptare dhe greke ndoqën pak a shumë të njëjtat parime.

Siç mund të kuptohet, kjo mënyrë fsheh rrezikun e interpretimit të historisë së letërsisë me syrin e historianit ose rrënjën në pozitat e pozitivizmit apo dhe të empirizmit, por në rastin tonë, mendojmë se kjo qasje është më produktive.

Megjithatë, ajo që ka më shumë rëndësi për historiografinë e letërsisë në lidhje me Minoritetin Grek në Shqipëri është fakti që, është vështirë të gjesh një mendim të unifikuar, si për periodizimin, ashtu edhe për emërtimin e saj. Ajo që duhet thënë është se këto mendime mund të grupohen në dy qëndrime relativisht të kundërta.

Qëndrimi i parë i përket periudhës së diktaturës komuniste dhe është pak a shumë i imponuar. Për arsye politikisht të njohura “konkludohej”, pothuaj nga të gjithë studiuesit e atëhershëm, se kjo letërsi lindi gjatë Luftës së Dytë Botërore, emërtohej “*Letërsia minoritare*” dhe konsiderohej pjesë përbërëse e letërsisë shqiptare të realizmit socialist në gjuhën greke.

“*Letërsia e Minoritetit Grek në Shqipëri është e re, - shkruan që më 1953 Spiros Kufos ose, kushtet për lindjen e saj u krijuan atëherë kur Partia Komuniste e Shqipërisë ftonte të gjithë popullin pa dallim feje, krahine e ideje, të bashkohej në Frontin Nacionalçlirimtar për të luftuar kundër okupatorëve të huaj fashistë dhe veglave të tyre në vendin tonë*”³⁸

Spiro Çomora, i pari dhe nga të pakët që trajtoi në letrat shqip problemin e letërsisë së Minoritetit Grek, thotë te revista

³⁷ Chevrel Y, 2002, *Letërsia e krahasuar*, Tiranë, fq. 48.

³⁸ Kufo S., gaz. “Zëri popullit”, 29 korrik, 1953, f. 3.

“Nëntori”: “...në të kaluarën s’kish dhënë shënja jete një letërsi minoritare...kjo lindi pikërisht pas çlirimit të Shqipërisë”³⁹

“Atëherë (në vitet e luftës shën.i autorit) pa mohuar ekzistencën e ndonjë tradite, hodhi rrënjët e veta dhe letërsia e vërtetë minoritare”⁴⁰, - thotë Minellas Dalianis, një nga eksponentët e minoritetit që nga koha e luftës deri në djetëvjeçarin e dytë të shekullit 21^{të}.

“Letërsia e Minoritetit Grek në Shqipëri filloi të zhvillohet pas triumfit të luftës Nacionalçlirimtare dhe vendosjes së pushtetit popullor”, - thotë që më 1955 edhe personaliteti tjetër i luftës, por edhe i letrave në Minoritetin Grek, Spiros Xhas⁴¹. Të njëjtën ide shfaq ai edhe shumë vite më vonë: “Letërsia në gjuhën greke, me ndonjë përjashtim të vogël, filloi të shkruhet pas çlirimit. ... Eshhtë një vllstar që gjeti truall të përshtatshëm dhe klimë të favorshme vetëm në vitet e pushtetit popullor”⁴²

Pa ndonjë vlerë të veçantë artistike dhe pa ndonjë ndikim në opinionin publik dhe traditën më të re letrare, karakterizon letërsinë në lidhje me Minoritetin Grek të periudhës para Luftës së Dytë Botërore edhe Stavros Dajos. “Lufta Nacionalçlirimtare, -thekson,- nuk i solli (minoritetit, shën. yni, P.B) vetëm lirinë, por dhe çlirimin e energjive krijuese...” dhe shton... “.... këto krijime (të luftës, shën. i autorit) shënojnë lindjen e një letërsie të re, asaj të realizmit socialist”⁴³.

Qëndrimi i dytë i përket periudhës pas viteve 90^{të}. Sipas këtyre qëndrimeve letërsia e Minoritetit Etnik Grek ndahet në dy periudha të mëdha me vijë demarkacioni Luftën e Dytë Botërore.

Fillimet e kësaj letërsie, sipas këtyre mendimeve, shkojnë shumë thellë në kohë. Rrënjët i ka te folklori dhe te kënga popullore tradicionale. Nënvizohet ideja se kjo letërsi nuk ka përbërë ndonjë shkollë letrare me vete, por përbën “pjesë të pashkëputur dhe zhvillim natyral të letërsisë panhelene”⁴⁴⁻⁴⁵.

Ndërsa në periudhën e pasluftës, e cila zgjati deri në vitet 90^{të}, kur Minoriteti Grek rivendos kontaktet me kombin amë, le-

³⁹ Çomora S., revista “Nëntori”, 1954 nr. 3, fq. 99.

⁴⁰ Daliani M., Gaz. «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», maj 1989, f. 3.

⁴¹ Xha S., revista “Nëntori”, nr 6, 1955, fq.119.

⁴² Xha S., gaz. «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», prill 1990, f. 5.

⁴³ Dajo S., gaz. «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», shkurt 1989, f. 6.

⁴⁴ Naço K., 2005, “Historia e Letërsisë Vorioepirote” (Ιστορία της Βορειοηπειρωτικής Λογοτεχνίας), Gjirokastër, f. 15.

⁴⁵ Qiriaztis F., “Një vështrim mbi Letërsinë Vorioepirote”, Rev. «Νέα εστία», Athinë, 25.12.1994, f. 125-132

tërsia e Minoritetit Grek, sipas po këtyre mendimeve, krahasimisht me letërsinë panhelene, reflekton “*prapambetje*” përsa u përket vlerave artistike dhe është “*e ndikuar*” nga letërsia shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe letërsia e minoritetit etnik grek zbatoi të njëjtën platformë estetike me letërsinë shqiptare, atë të realizmit socialist. “*Rrjedhimisht, në këtë rast, -thotë prozatori i njohur i periudhës së pas viteve 90, T. Koças,- mund të flasim për letërsi shqiptare në gjuhën greke*”⁴⁶

Duke u bazuar në kriteret rigorozisht historiko-politike, Letërsia e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri, si e tillë, zë fill të momenti i vendosjes së kufijve dhe shndërrimit në minoritet etnik grek të asaj pjese të popullsisë me kombësi greke të përfshirë brenda shtetit shqiptar.

Sigurisht që do të bënim gabim në qoftë se do të studiojmë fenomenet letraro-kulturore duke u nisur nga një datë historike të motivuar politikisht. Aq më tepër që letërsia e kultivuar nga ky komunitet grek brenda shtetit shqiptar, nuk mund të konceptohet si e tillë (në funksion të evidentimit dhe zhvillimit të identitetit etno-kulturor të këtij komuniteti), pa e parë si zhvillim mbi trashëgiminë e vet letrare të periudhës para shndërrimit në minoritet. Vetë realiteti i zhvillimit të kësaj letërsie, qoftë i periudhës 1912-1939, qoftë i asaj 1940-1990, vërtetuan domosdoshmërinë e mbështetjes mbi këtë traditë, sipas parimit që letërsia e çdo momenti të së tashmës, është produkt i arritjeve të traditës mbi të cilat shtohën vlerat e kohës .

Në këtë aspekt, studimi mbi letërsinë që lidhet me trevën kulturore që trashëgohet nga minoriteti i sotëm etnik grek në Shqipëri, merr parasysh faktin se letërsia e këtij minoriteti përbën një vijimësi e ngritur mbi këtë trashëgimi. Nga ana tjetër, duke u nisur nga fakti se kjo trashëgimi letrare është pjesë përbërëse e trashëgimisë letrare kombëtare greke, studimi i prodhimit letrar në komunitetin e Minoritetit Grek fiton rëndësi për ta parë atë si një devijim nga tradita e përbashkët për shkak të kushteve historiko-politike dhe së dyti, për të parë vlerat që sjell si e tillë letërsisë kombëtare greke, por edhe letërsisë shqiptare.

⁴⁶ Koças T., Diskutim në simpoziumin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Greqisë, 14.12.2000.

Duke u bazuar në kriteret e mësipërme dhe duke marrë si pika referimi kontaktet me letërsinë komunikuese me të (greke apo shqiptare), letërsinë në minoritetin etnik grek në Shqipëri mund ta periodizojmë në këtë menyre:

Në një periudhë të parë mund të përfshihet etapa e kontaktit të drejtpërdrejtë me krijimtarinë letrare të traditës popullore.

Periudha e dytë përkon me pushtimin e gjatë otoman deri në lindjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe vendosjen e kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë. Karakteristikë dalluese është se ajo zhvillohet si pjesë e pandarë e lëvizjes së përgjithshme letrare greke.

Periudha e mëpastajme është ajo deri në Luftën e Dytë Botërore. Karakteristikë e kësaj periudhe, është zhvillimi i letërsisë me statusin e të qenit minoritet etnik brënda shtetit shqiptar së bashku me pasojat që e shoqëruan procesin drejt këtij statusi në të gjitha drejtimet. Kjo letërsi vazhdon të ruajë kontaktet me letërsinë e kombit amë. Madje, zhvillohet, më së shumti, jashtë kufijve gjeografikë të shtetit shqiptar. Ndërsa kontaktet me letërsinë shqiptare janë të vakëta, aq sa nuk mund të merren parasysh.

Periudha që pason është ajo e realizmit socialist. Komunikimet me letërsinë kombëtare greke janë inekzistente, me përjashtim të rasteve të rralla dhe atyre të ndërmjetme. Ndikimet nga letërsia shqiptare janë të shumta. Këto ndikime janë më shumë pasojë e metodës krijuese të përshkuar thellësisht nga ideologjia komuniste. Kjo letërsi zhvillohet kryesisht si poezi. Nga një letërsi e shkruar në gjuhën greke në fillimet e saj, kthehet në një letërsi bilingue ku elementi shqip, sidomos në fund të vitëve 70' –fillim të viteve 80-të, bëhet mbisundues.

Si periudhë në zhvillim mund të konsiderojmë atë pas vitëve 90^{te} të shekullit të kaluar. Karakterizohet nga një zhvillim i vrullshëm dhe nga lëvrimi, pothuaj, i të gjitha gjinive e llojeve letrare. Kontaktet me letërsinë panhelene janë të lira, ndërsa rrallohen gjithnjë e më shumë kontaktet me letërsinë shqiptare. Gjithashtu gjithnjë e më shumë rrallohet numri i krijuesve minoritarë të kësaj periudhe që shkruajnë në të dy gjuhët, shqip e greqisht.

1.2. *Emërtimi.*

Mendojmë se është e domosdoshme të hedhim në diskutim dhe mendimet e shfaqura në lidhje me përcaktimin e termit emërtues të kësaj letërsie.

Edhe për sa i përket emërimit, nuk ka një qëndrim të unifikuar. Më shumë vihet re një konfuzion, që e ka burimin, mendojmë te ngarkesat emocionale e politike të shkaktuara nga vetë historia e trevës në të cilën u kultivua kjo letërsi. Të njëjtën gjë duhet ta kërkojmë dhe te mungesa e dëshirës nga ana e autoriteteve përgjegjëse (më shumë se nga vështirësitë) për të qartësuar statusin historiko-politik e etno - kulturor të Minoritetit Grek në Shqipëri.

Ky konstatim lidhet më së shumti me qëllimin e sistemit komunist, i cili në emër të ideologjisë së njeriut të ri socialist, donte të shndërronte identitetin etno-kulturor të Minoritetit Grek në një identitet hibrid.⁴⁷

Ekzistojnë edhe qëndrimet që vijnë nga ana greke, të cilat kërkojnë që, duke ngarkuar me doza emocionale e ideologjike nocionet gjeografike, të mbajnë gjallë situata të tejkaluara dhe ireale për aktualitetin⁴⁸.

Gjithashtu, në gjërësinë e konfuzionit lidhur me termat e përdorura dhe mungesën e një termi të vetëm, me shpjegim të qartë shkencor e përkufizues të kësaj letërsie, mendojmë se duhen marrë në konsideratë edhe një sërë faktorësh të tjerë. Të tillë mund të jenë këndvështrimet e ndryshme për periodizimin e saj, marrëdhëniet e krijuara të kësaj letërsie dhe të bartësve të saj me letërsitë analoge të shtetit ku jeton dhe të kombit amë, kultivimi kryesisht i një gjinie letrare etj.

Si pasojë, për të përkufizuar këtë letërsi përdoren terma të tilla si: "*Letërsia minoritare*", "*Letërsia e Minoritetit Grek në Shqipëri*", "*Letërsia e grekëve të Shqipërisë*", "*Letërsia vorioepirote*", "*Letërsia e burgosur*", "*Letërsia e pasluftës së Minoritetit Grek në Shqipëri*" etj.

⁴⁷ Në aspektin formal këtë tendencë mund ta konstatojmë te përpjekja për të hequr nga togfjalëshi "*minoritet etnik grek*" përcaktuesit e identitetit "*etnik*" e "*grek*", dhe identifikimin e tij thjesht me termin "*minoritar*". Pra, të zëvendësonte emërtimin që shprehte drejtpërdrejt e në mënyrë të plotë identitetin etno-kulturor me termin përgjithësues që e nënkuptonte atë.

⁴⁸ Përdorimi, p.sh, i termit "*vorioepir*" dhe trajtimi i problematikës së Minoritetit Grek edhe në lëmin letrar në bazë të këtij koncepti.

Do të propozonim termin “**Letërsia në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri**” Argumentet lidhur me këtë emërtim do të ishin: Të gjithë pranojmë se letërsia e Minoritetit Grek përbën një vazhdimësi të trashëgimisë letrare që shkon tutje kufirit kohor të krijimit të shtetit shqiptar. Si e tillë, para këtij momenti ajo ishte e njehsuar me letërsinë panhelene. Pas kthimit në minoritet etnik brënda shtetit shqiptar tradita letrare, apo trashëgimia letrare pësoi një devijim ose ndoqi një rrugë tjetër nga ajo e letërsisë kombëtare greke. Këtë produkt letrar që mban vulën e trashëgimisë së trevës së vet (sado të mohuar) dhe të realitetit të ri social-politik në kuadrin e shtetit shqiptar, e njohim si produkt letrar të këtij komuniteti. Këto veçori na çojnë te kërkesat për të shqyrtuar proceset letrare që ndodhin në këtë minoritet si pasojë e ndërveprimit të faktorit traditë në kushtet e reja social-politike. Si i tillë, termi në fjalë na siguron pasqyrimin më të mirë të këtij realiteti si vazhdimësi, apo si fenomene letrare në këtë Minoritet Grek që mbajnë vulën e faktorit trashëgimi dhe ndërveprimit me faktorë të tjerë. Vet ky realitet letrar dallon si nga letërsia panhelene ashtu edhe nga letërsia shqiptare.

Përsa u përket emërtimeve të tjera, do të kishim këto mendime:

Së pari, termi “*Letërsia minoritare*”, e përdorur gjërësisht në literaturën shqiptare, kryesisht nga studiues apo referues me kombësi shqiptare, nuk mund të përkufizojë objektin tonë. Kjo për faktin se fjala “*minoritare*” ka një kuptim të përgjithshëm dhe mund të bëjë fjalë për letërsinë e grupeve minoritare në përgjithësi në vend, pavarësisht nga fakti se në Shqipëri me emrin “*minoritet*” nënkuptohej dhe vazhdon të nënkuptohet vetëm Minoriteti Etnik Grek.

Së dyti, ashtu siç përmendem më lart, përdorimi i termit “*minoritet*” kishte fituar një funksion politik me qëllim ngushtimin dhe zbehjen kuptimore të identitetit etnik e kulturor të Minoritetit Grek. Aq më tepër kur përcaktori “*grek*” nga njëra anë eliminohej, nga ana tjetër kishte fituar ngarkesa kuptimore negative që shkonin nga fyerja deri në sinonim të fjalës “*armik*” dhe vetë anëtarët e komunitetit të Minoritetit Grek në Shqipëri, për të shmangur këto ngarkesa negative, e quanin veten “*minoritarë*”, në vend që ta quanin “*minoritarë grekë*”, ose “*grekë*”.

Po ashtu, dihet se tradita letrare e këtij komuniteti shkon në kohë shumë më larg se momenti historik që e shndërroi atë në minoritet brënda shtetit shqiptar. Kjo bën që termi “*Letërsia minoritare*” nuk mund t’i përgjigjet realiteti historik që lidhet me traditën letrare të këtij minoriteti.

Argumenti i traditës letrare që shkon në kohë më larg se momenti i vendosjes së kufijve, rrëzon dhe përkufizimin “*Letërsia e Minoritetit Grek*”.

Kjo do të thotë se ky term është i përdorshëm në kuptimin e statusit të sotëm të këtij minoriteti, në një kohë kur atij i njihet e drejta dhe autoriteti i trashëguesit të letërsisë së kësaj treve në aspektin diakronik. Ose, për të përcaktuar një periudhë historike të kësaj letërsie, kur ky komunitet njihet si minoritet. Mund të përdoret gjithashtu për një tematikë të veçantë, kur duam të vëmë p.sh. në dukje tiparet apo veçoritë dalluese të kësaj letërsie krahasur me letërsinë shqiptare apo dhe me atë greke në një periudhë kohe të caktuar.

Termi “*Letërsia e grekëve të Shqipërisë*” është përdorur në literaturën përkatëse të Minoritetit Grek në periudhën pas viteve 90të. Kundërshtimi i këtij termi, nga rrethe të ndryshme letrare e jo letrare, lidhet me reagimet negative që ka shkaktuar herë pas here përdorimi i togfjalëshit “*grekët e Shqipërisë*”, për të përcaktuar Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri.⁴⁹ Argumentimi lidhet me faktin se një term i tillë përdoret për grekët e Gjermanisë, të SHBA-së, të Australisë etj, që kanë vajtur aty në një kohë relativisht të re, si diasporë dhe përbëjnë një komunitet përgjithësisht të shpërndarë dhe jo funksional. Si rezultat, thonë se nuk mund të përdoret i njëjti formulim dhe për Minoritetin Grek në Shqipëri, i cili shtrihet në vazhdimësi territoriale me kombin amë dhe nuk ka ardhur në vendbanimet e tij nga ndonjë vend tjetër.

Shumë i përhapur, sidomos në hapësirat greke, është termi “*Letërsia Vorioepirote*”. Termi “*Vorioepirot*” (*Epiri i Veriut*) është më së shumti një nocion gjeografik. Ai lidhet me faktin e ndarjes në dy shtete, në fillim të shekullit XX, të territorit të krahinës së njohur historikisht me emrin “*Epir*”. Në vijim kemi ideologjizimin e politizimin e këtij nocioni gjeografik për të njehsuar në të idenë e “*trojeve greke të shkëputura nga trangu am*”. Ai përbën edhe sot një term me përdorim të gjërë në Greqi edhe në Minoritetin Grek. Përdorimit fillestar të tij i është shtuar tani edhe përdorimi me kuptimin e përcaktimit të origjinës (pra zëvendoson termin “*minoritet etnik grek*”), por edhe përdorimi me kuptimin e ri ideologjik “*të evidentimit*” të patriotizmit individual ose kolektiv. Të njëjtën ecuri kuptimore ka ndjekur dhe termi “*Letërsia Vorioepirote*”.

⁴⁹ Ai është përdorur me qëllimin e përfshirjes në këtë komunitet edhe të anëtarëve të tjerë të Minoritetit Grek që gjendeshin në pjesë të ndryshme të territorit të Shqipërisë, por jashtë zonave homogjene minoritare.

Mendojmë, se për sa i përket letërsisë, edhe ky term nuk mund ta përfaqësojë atë denjësisht. Kjo, jo për faktin se në rrethe të ndryshme në Shqipëri ky term presupozon pretendime “*për bashkimin e Epirit të Veriut me të Jugut*” por, së pari, ky term nuk gëzon një status të njohur juridik e zyrtar, që të mund të përfaqësojë ose të shprehë identitetin e komunitetit grek në Shqipëri. Rrjedhimisht, në aspektin zyrtar nuk mund të përdoret as për letërsinë e këtij komuniteti. Aq më tepër, mund të kryejë këtë funksion në aspektin diakronik, d.m. th për të shprehur letërsinë e periudhës para vendosjes së kufijve. Së dyti, në kufijtë gjeografik të “*Epirit të Veriut*” sado në Jug të Shqipërisë të vendosen ato, do të përfshihet dhe një pjesë popullsie shqiptare.

Duke pasur parasysh arsyetimin e deritanishëm, besojmë se mund të interpretohen lehtë pse nuk i përgjigjen realitetit të kësaj letërsie termat “*Letërsia e pasluftës e Minoritetit Grek*”, “*Letërsia e burgosur*” etj. I pari, i cili haset po aq shpesh sa dhe termi letërsia minoritare, mund të përdoret vetëm për letërsinë e një periudhe të caktuar, atë pas Luftës së Dytë Botërore. Termi i dytë, i cili gjen vend në disa antologji të poezisë së Minoritetit Grek⁵⁰, mund të përdoret (me ngarkesën analoge emocionale), për të karakterizuar atë pjesë të ndaluar ose të censuruar të krijuesve minoritarë grekë gjatë pushtetit komunist. Në Greqi i njëjti term përdoret edhe me kuptimin e gjithë letërsisë së Minoritetit Grek, e cila në periudhën e pasluftës deri në vitet 90të, u zhvillua krejtësisht e izoluar nga pjesa tjetër e letërsisë greke.

Për të gjitha këto arsye, mendojmë se termi “*Letërsia në lidhje me minoritetin etnik grek në Shqipëri*” ose “*Letërsia në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri*” është më afër realitetit si në aspektin diakronik (edhe kur ky komunitet s'ka qenë minoritet), ashtu dhe koherent të kësaj letërsie. Madje, përfshin edhe atë letërsi të shkruar nga të tjerët për këtë minoritet.

⁵⁰ Shih, *Ανθολογία βορειοηπειρώτικης ποίησης, Εξόριστη Ποίηση*, (Antologji e poezisë vorioepirotase, poezi e internuar), Janinë 1996.

KREU I DYTË

TRASHËGIMI LETRARE NGA FILLESAT DERI NË VENDOSJEN E KUFIRIT MIDIS DY SHTETEVE

II.1. *Komunikim i drejtpërdrejtë me folklorin, premisa për një individualitet të ri krijues në letërsinë e kultivuar. Periudha e parë.*

Ndër tiparët kryesore të periudhës së parë, do të dallonim së pari atë të komunikimit të drejtpërdrejtë të letërsisë së kësaj periudhe me krijimtarinë letrare të traditës popullore. Me këtë kuptojmë se në këtë fazë nuk kemi akoma një diferencim të qartë midis letërsisë së kultivuar dhe asaj popullore. E themi këtë se këngët epike, p.sh, që ka trashëguar veçanërisht treva e minoritetit të sotëm grek dhe që janë konsideruar si këngë të ciklit të “*Akri-tëve*”, (epika legjendare historike) nuk lidhën me ngjarje me përmasat e epikës legjendare. Ato më shumë pasqyrojnë drama të jetës së përditshme, si p.sh: tradhëtia bashkëshortore, dashuria e pamundur, drama e ndarjes së bashkëshortëve për shkaqe lufte apo kurbeti etj. Vetëm mjetet shprehëse që përdoren në to janë ato të epikës legjendare dhe të baladave dramatike dhe heroike.

Kjo na lejon të themi se *kufijtë e letërsisë së kultivuar në këtë periudhë nuk janë diferencuar nga folklori dhe se “fillimet e letërsisë që trashëgon sot Minoriteti Grek lidhën me momentet kur folklori letrar fiton trajtat e një letërsie të kultivuar”⁵¹.*

Tipari i dytë lidhet me faktin se të dy këta faktorë së bashku, si letërsia edhe folklori ruajtën një komunikim intensiv me eposin mitologjik. Kjo do të thotë se *kultura dhe civilizimi i periudhës klasike do të ketë një reflektim gjithëplanësh në kulturën dhe krijimtarinë letrare të çdo natyre të kësaj treve. Në aspektin e folklorit do të pasqyrohet në dy linja kryesore: Së pari, në krijimin e një universi*

⁵¹ Naço K., *Përshkrim i shkurtër dhe një trajtim i parë teorik i Letërsisë Vorio-epirote*, gaz. «Τα νέα της ΟΜΟΝΟΙΑΣ» e premte, 2.6.2000, f. 6-8.

të ri mitesh, legendash e gojëdhanash, të **një karakteri të theksuar e të dallueshëm lokal**, si dhe mbartjen e realitetit mitologjik në ciklet e njohura të këngëve popullore, po me natyrë të dyfishtë. Së dyti, në këngë të ngjashme me universin folklorik panhelenik dhe me këngë popullore me identitet lokal.

Tipari tjetër lidhet me faktin se folklori i kësaj treve jo vetëm shërbeu si pikënisje edhe të letërsisë së kultivuar, por edhe e shoqëroi ecjen e saj përpara në të gjitha etapat. Madje, në momente kritike dhe udhëkryqesh historikë shërben si udhërrëfyes, i sjelljes kolektive të komunitetit, ashtu dhe i letërsisë së kultivuar dhe kulturës së këtij Minoriteti në përgjithësi.

Lino Politi, një nga personalitetet më të shquara në lëmin e historiografisë së letërsisë së Greqisë, pohon se, në krahasim me letërsinë e kultivuar⁵² “*kënga popullore përbën një prezencë paralele diakronike*”. Mirëpo, vetë ai zgjedh për fillime të letërsisë së re greke një “ndërprerje” të këtyre paraleleve. Ai i vendos këto fillime tek eposi popullor i “*Akritëve*”, Dhijenit Akritas, që daton në gjysmën e parë të shekullit XI dhe që e pretendojnë njëkohësisht Folklori, Letërsia Bizantine dhe Letërsia e Re Greke. Këtë zgjedhje e pranojnë në mënyrë, pothuaj unanime, të gjithë historiografët e letërsisë greke⁵³. Ndodh kështu ndoshta për arsye se eposi në fjalë përbën monumentin e parë të folklorit në gjëndje të shkruar. Së dyti, ajo përfshihet në të njëjtën klimë epike që përshkon në atë periudhë Perëndimin e Lindjen dhe dëshmon për shkëndijat e para të një ndërgegjeje të re kombëtare.

Bëmë këtë parantezë, për të nënvizuar idenë e domosdoshmërisë së studimit sistematik të fillesave të traditës kulturore nga çdo popull që synon më të vërtetë kërkimin, perceptimin dhe promovimin e karakteristikave dalluese të identitetit të vet. Në strukturat që mundësojnë studimin e sistemit kulturor të një vendi apo komuniteti, letërsia përbën faktorin e privilegjuar. Veçoritë kryesore të këtij sistemi duhen kërkuar tek *dallueshmëria* (pertinence) e fenomeneve në studim, e cila na orienton tek strukturat diakronike, që kompozojnë koordinatat bazë të sistemit të kulturës kombëtare. Kriteri i dytë është *vitaliteti*, i cili lidhet me mundësitë e vlerave të fenomeneve në studim për t’ju përgjigjur dhe zgjidhur në mënyrë të kënaqshme dhe të gjithëkohëshme kërkesat estetike e shpirtërore thelbësore të bartësve të saj, aftësinë

⁵² Πολίτη Λ., 1989, *Εισαγωγή στη νεοελληνική λογοτεχνία*, Athinë, fq. 102.

⁵³ Të njëjtën gjë pranojnë K. U. Dhimaras, (1948), A. Mirambel (1953), Br. Lavagnini (1955), B. Knos (1962), M. Vitti (1971) etj.

për të marrë pjesë në krijimin e vlerave të reja nga ana e tyre dhe për të kontribuar në kuadrin e një dialektike vlerash estetike të një rajoni më të gjërë.

Argumenti i tretë lidhet me *kriteret tipologjike* të studimit, të cilat mundësojnë orientimin e studimit në sektorë strategjik të kulturës e civilizimit.

Ajo që vihet re në Letërsinë në Minoritetin Etnik Grek është veçoria që krijuesit e saj, strukturat krijuese dhe kodet e vlerave estetike në mitet e tyre poetike, burojnë tek natyra, kënga dhe tradita kulturore popullore.

Nëse, psh, në thelb të Orakullit të Dodonës qëndron sipas mitologjisë pema dhe zogu, (sipas një varianti mitologjik Orakullin e themeluan dy pëllumbesha të zeza), këto dy elementë përbëjnë edhe thelbin e mitit poetik të këngës popullore të trevës përreth. Pema është vendi që heroi popullor var armët dhe simbol i rrënjës dhe i qëndresës, i lidhjes me tokën mëmë dhe me natyrën.

Zogu është protagonist i metaforizuar apo i personifikuar që shpalos koshiencën dhe subkoshiencën e dëshirave dhe aspiratave të njeriut të këtushëm. Ndërsa pema ka një funksion statik vertikal në drejtim të tokës dhe qiellit, zogu, me veçori më të theksuara personifikimi, zotëron një dinamikë horizontale dhe vertikale drejt qiellit, për të kontrolluar, apo komunikuar me ato vende, ngjarje apo aspirata që njeriu nuk i arrin dot.

Të njëjtën marrëdhënie me këto elementë ka vendosur edhe letërsia e kultivuar. "*Brezi i çrrënjësor*" është titulli i romanit të J. Lilit, shkruar në vitet 30^{te} të shekullit të kaluar dhe që i dedikohet ikjes së detyruar të brezit të tij (të humbur) nga atdheu i tyre i veçantë.

Tek poeti Niko Kacalidha, pema, herë në kuptimin metaforik e herë të drejtpërdrejtë, herë në funksion fjalëformimi e herë në formë të thjeshtë, na shfaqet 68 herë vetëm te vëllimi poetik "*Pagëzimi i zogjve*", ndërsa "*zogu*" po në këtë vëllim poetik, 167 herë.

Tek Andrea Zarballa pema është kthyer në simbol qëndrese dhe rrënjëzimit të njeriut në atdheun e tij të veçantë, - në tokën e tij, në vendin e tij, në topos-in e tij. (*στην ιδιαίτερη πατρίδα του, τον τόπο του*).

Ky vështrim na mundëson për të përcaktuar kriteret tipologjike të traditës popullore të mbartur në letërsinë e kultivuar. Më të qenësishëm mund t'i gjenim te raportet *individ-shoqëri*, *natyrë-kulturë*, *liri-robëri* dhe *jetë-vdekje*. Sistemi i mësipërm huazohet

nga Claude Lévi-Strauss⁵⁴, i cili e përdori si instrument studimi në fushën e etnologjisë. Sipas tij çiftëzimi në marrëdhënie e këtyre elementeve i korrespondojnë atyre kategorive bazë nëpërmjet të cilave njeriu mund të vëzhgojë e të studiojë përvojën e tij dhe të organizojë sisteme analoge kulturore.

Në çiftet e mësipërme tipologjike i pari dhe i treti u korrespondojnë fushës historiko-shoqërore dhe na adreson tek *izotopi i arsyes*. Njëkohësisht, na jep kriteret e klasifikimit të vlerave shoqërore (dmth të ideologjisë). I dyti dhe i katërti u përkasin thelbit të jetës shoqërore dhe përbëjnë *izotopin kozmologjik*, dmth na sigurojnë kriteret të cilat mundësojnë kodifikimin e marrëdhënieve që mbështesin një botëkuptim. Të dy këto izotope, ose fusha, bashkëegzistojnë në traditën kulturore dhe letrare të popullit, të lidhura me një varësi ose unitet të detyrueshëm, ku raporti *individ-shoqëri* është i barasvlefshëm me raportin *natyrë-kulturë* dhe ra-porti *liri-robëri* i barasvlefshëm me raportin *jetë-vdekje*. Është pikërisht, kjo lidhje që përcakton vlerat estetike thelbësore diakronike dhe mesazhin e aktualizuar të krijimtarisë popullore dhe gjithmonë brenda një strukture të qëndrueshme dhe të transformueshme.

Ta konkretizojmë idenë duke marrë në shqyrtim, një nga variantet e legjendës së ujit në këtë trevë.

Deti, thotë legjenda, - nxorri nga gjiri i tij një gjarpër-kuçedër. Një hinkë stuhie e ngriti në qiell dhe e lëshoi lart mbi faqën perëndimore të malit të Sopotit mbi Delvinë. Ngjarja, dalja e gjarpërit-kuçedër, prishi harmoninë midis natyrës dhe banorëve të atjeshëm (raporti natyrë-kulturë), pasi jeta e gjarpërit-kuçedër ishte lidhur me vdekjen e banorëve dhe të gjesë së gjallë të tyre.

(Edhe në rastin konkret faktori prishës është shoqëria e personifikuar në dashakeqësinë e detit. Në traditën popullore të këntushmë nga deti vijnë vetëm të këqija, sidomos ushtritë e huaja që prishin e shkatërrojnë gjithçka edhe jetën (lufta = kulturë). Bëhet fjalë për një marrëdhënie gjeopolitike dhe antropologjike të njeriut të këntushëm me detin. Deti nuk ishte faktor zhvillimi për Epirin, nuk ishte aleati i tij, prandaj edhe në krijimtarinë tradicionale shndërrohet në burim të së keqës. Ky raport, siç do të shohim më poshtë, ruhet edhe në letërsinë e sotme të kultivuar, por edhe në tipologjinë të një pjese të epikës legjendare shqiptare).

Ky raport përbën edhe konfliktin e mitit që duhet zgjidhur. Zgjidhja përcaktohet si një provë me dy pjesë: ndërmarrja e aksi-

⁵⁴ Claude Lévi-Strauss, *Les structureles élémentaires de la parenté*, fq. 9, Paris 1949.

onit nga njera anë (për të asgjësuar të keqën) dhe fitorja-humbja nga ana tjetër. Pjesa e dytë përbëhet nga dy elemente që kundërshtojnë njera-tjetrën.

Asgjësimi i së keqes, (ndërmarrja e aksionit) nis nga mençuria e një plaku. (Fjala është për heroin që identifikohet me individin dhe natyrën, që na vjen nga veprimi individual primitiv i heroit popullor. Pra, kemi të bëjmë me individ-hero, ose e kundërta, i cili vepron i vetëm në emër të së drejtës natyrore-jetës. Ai do t'i kundërvihet një force të organizuar (në rastin konkret të mishëruar në forcën shkatërruese të hiperbolizuar), që shpreh pushtetin e një shoqërie: kulturën.

Plaku ngarkoi një kafshë (gomar-kafsha karakteristike e zonës) me lëndë lisi dhe brënda ngarkesës kishte vendosur eshkë të ndezur. E çoi ngarkesën në strofkën e kuçedrës. Ajo, e lenë pa ushqimin e preferuar, e gëlltiti kafshën me gjithë ngarkesën. Por, pas pak eshka u ndez dhe kuçedra mori flakë që çoi në asgjësimin e saj. (Tradita popullore nuk e mbaron këtu rrëfimin që nga pikëpamja artistike do të ishte e arsyeshme, por e vazhdon duke u marrë me "hollës" të qenësishme të kundërveprimit të faktorit "shoqëri", i cili eliminohet nga befasia e shkaktuar nga mençuria popullore. (Kjo mbetet një karakteristikë e krijimtarisë së N. Kacalidhës). Vazhdimi i rrëfimit lidhet edhe me përpjekjen që bëhet për t'i dhënë karakteristika bindëse, se ngjarja ndodh pikërisht në këtë trevë-hapësirë, pavarësisht nga koha e rrëfyer që duhet të mbetet e papërcaktuar.

Kuçedra pasi mori flakë ftoi Bisticën dhe detin për ta ndihmuar. Bisticën e thërriti me emrin "nënë" dhe detin me emrin "motër". Deti u zemërua që e quajti "motër". Bistrica nuk mundi të ngjitej më të lartë. Kështu ndihma nuk iu dha. Pas kësaj, kuçedra, me shpresë se do të shpëtonte doli nga strofka e vet dhe mori pllajën e malit mbi Delvinë. Filloi të nxirrte gjithë ç'kishte kapërdirë për të shpëtuar, por nuk shpëtoi. Përpjekjen e saj, thotë legjenda, e tregojnë dhe dy rreshtat me pemë lisi që nuk rriten dhe as shumohën në pllajën e malit mbi Delvinë. Thonë se janë nga lëndët e lisit që vulli atëherë kuçedra.

Komunikimi me mitologjinë klasike konstatohet fare lehtë. Madje bëhet fjalë për vet Iliadën. Pavërisisht nga koha e rrëfimit që në rastin tonë është shumë më e vogël, dramaciteti i epikës me densitet të minimizuar dhe heronj (hero) me trajta thellësisht njerëzore, që s'mund të përdorin shpata e heshta e as të kryejnë veprime mitike elementet komunikuese me mitologjinë e lashtë (Iliadën) janë domethënëse. (Hiperbola dhe konkretizimi i hapësirës së bashku me mprehtësinë e vazhdueshme të problemit-vështirësitë e jetës,

që kërkojnë një zgjidhje, mbajnë gjallë në rastin tonë mitin dhe rrëfimin). Ky komunikim lidhet me mënyrën dhe mjetin e ngjashëm të zgjidhjes së konfliktit.

Në Iliadë, për të pushtuar Trojën, përfundimisht nuk u deshën armët, por mençuria e heroit-individ. Shpikja e Kalit të Drunjtë nga Odiseu. Në rastin tonë kemi përdorimin e kafshës së ngjashme, por të gjallë. Në të dyja rastet lëvizja është e njëjtë. Depërtimi i forcës shkatërruese në brëndësi, në zemër të kundërshtarit. Në rastin e Trojës kjo forcë përbëhet nga ushtarë të armatosur në barkun e kalit të drunjtë. Në rastin tonë nga zjarri i ndodhur në ngarkesën e kafshës. (Ky element na çon në një ngjashmëri tjetër, në mjetin e zjarrit të përdorur nga Herkuli për të asgjësuar kuçedrën me 12 krerë).

Në Iliadë, Troja është një qytet (jo frymor) që i japin jetë banorët e saj (një sistem shoqëror), në rastin tonë kundërshtari është një gjarpër-kuçedër (frymor) “e dërguar” nga deti si personifikim i këtij sistemi. Pra, kemi dy linja veprimi brënda të njëjtit sistem tipologjik, me të vetmin dallim se elementët veprues kanë natyrë të kundërt. (Kur një element është frymor në njerën linjë veprimi, në tjetrën është jo frymor.)

Për individualitetin krijues të kësaj treve, na flet fakti që në periudhën e përhapjes së krishtëritimit, në të njëjtën legjendë popullore hero i (plaku i mençur) zëvendësohet me një përfaqësues, ose të dërguar mbitokësor të perëndisë. Bile, ai ka dhe një emër konkret, Akaqios. Fuqia e tij për të asgjësuar kuçedrën qëndron te kryqi.(!) Në një rast të ndërmjetëm, në fillimet e Krishtëritimit në këtë trevë, merita e asgjësimit të kuçedrës i takon episkopit Dhnatos (person historik), i cili nuk përdor as kryqin e as zjarrin, por i lëshon kuçedrës në strofkë një top të stërmadh prej dylli blete. Kuçedra e gënjyer nga era e mjaltit mundohet ta kapërdijë, por i dalin jashtë luftimit armët e saj më të fuqishme, dhëmbët e ngulura në dyll, me pasojë hero i ta godasë lehtësisht me shqytë dhe ta asgjësojë. Në aspektin e mitologjisë fetare kjo vlerë u identifikua në përgjithësi me shën Gjergjin, i cili konsiderohet dhe shënjti dallues për zonën më të gjërë të Epirit.

Në këtë pikë na mbetet për të sqaruar se ku qëndron vlera etike dhe për pasojë estetike e veprimit të heroit si të tillë, pasi nga sa thamë u duk se në këtë përpjekje triumfi real apo etik i heroit, na shfaqet si triumf i individit përballë shoqërisë dhe një kohësisht, të natyrës përballë kulturës.

Në triumfin e këtij tipi hero i, vlerat natyrore marrin trajtën e vlerave shoqërore, që do të mund të interpretohej si sfidë ndaj

antinomisë, d.m.th si një lloj pajtimi të individit me shoqërinë dhe rivendosje të ekulibrit midis kulturës dhe natyrës. Natyra shprehet nëpërmjet individualitetit të heroit si mbartës i vlerave estetikë të natyrës. Në këtë model në qëndër është vendosur, njeriu në marrëdhënie harmonie me natyrën.

Këtë do të mund ta quanim skemën përcaktuese të “kozmosit ideologjik” të një shoqërie tradicionale periferike, që jeton në marrëdhënie organike me natyrën dhe një raport kundërshtie ndaj shtetit të organizuar dhe pushtetit qëndror. Është pikërisht ky fakt që Epiri konsiderohej nga pushteti qëndror i Bizantit “*në rastin më të keq kryengritës dhe në rastin më të mirë periferik-provincial*”⁵⁵.

“*Periferik në lidhje me qëndrat zyrtare të kulturës, të braktisura ose të shtypura nga klasa në pushtet, këto komunitete zhvilluan kulturën e tyre në kundërshtim me të parat, të mbështetur në motive dhe kërkesa fillestare jetësore të natyrës së butë mesdhetare, por të ekulibruar*”⁵⁶, na thotë E. Kapsomenos, profesor në Teorinë e Letërsisë dhe studiues i marrëdhënieve të letërsisë së kultivuar me folklorin grek.

Në këtë trevë, i njëjti motiv, konflikti me faktorë armiqësorë të huaj, ndaj harmonisë së njeriut të këtushëm me natyrën, si dhe fitoren e heroit me mjete që përmbi guximit, trimërisë dhe shpirtit të sakrificës kanë mençurinë, haset që nga mitet për shkatërrimin e Finiqit deri në kohët moderne. Ky është edhe mesazhi etik për sjelljen kolektive të transmetuar nga ky univers i traditës letrare popullore. Që fitorja në një konflikt permanent kërkon sakrifica, por mbi të gjitha mençuri.

Nga ana tjetër ky realitet përbën kozmogoninë e sjelljes kolektive diakronike të këtij komuniteti dhe është përcaktues edhe në krijimtarinë e kultivuar letrare të ditëve tona, sidomos në poezi, ku natyra dhe personifikimi i saj, apo i elementëve të veçantë të saj, përbëjnë hapësirën dhe mjetet e veprimit estetik.

Ashtu siç u shprehëm edhe në fillim, të njëjtën strukturë tipologjike hasim edhe në këngët popullore. (Një përjasje, por në një plan tjetër, të jetës-vdekjes, do ta bëjmë kur do të flasim për Letërsinë në Minoritet gjatë Luftës së Dytë Botërore) .

⁵⁵ Εκδοτική Αθηνών Α.Ε., *Ήπειρος 4000 χρονια ελληνικής ιστορίας και πολιτισμού*, fq. 219, Athinë 1997.

⁵⁶ Καψωμένος Γ. Ε., 2002, *Αναζητώντας τον χαμένο Ευρωπαϊκό Πολιτισμό*, Α', Athinë, fq. 44.

II.2. Kushtet historike dhe karakteristikat kryesore të letërsisë deri në vendosjen e kufirit - periudha e dytë

Periudha e dytë në kuadrin e kësaj trashëgimie letrare dhe kulturore, përkon me pushtimin e gjatë otoman deri në lindjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe vendosjen e kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë. Sqarojmë se në këtë rast flasim për periudhën kur treva e sotme e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri, ishte e njehsuar me trevën me të gjërë të Epirit. Kjo do të thotë se karakteristikë dalluese e letërsisë së kësaj periudhe, është se ajo zhvillohet si pjesë e pandarë e lëvizjes së përgjithshme letrare greke. Tiparet kryesore të letërsisë së kësaj periudhe, besojmë se janë dy. I pari ka të bëjë me lidhjet e kësaj letërsie me eposin mitologjik dhe i dyti lidhet me kushtet specifike në të cilat ajo u zhvillua.

Fenomeni bietnik - multikulturor e multigjuhësor, përbënte edhe gjatë kësaj periudhe faktorin që i siguronte Epirit, avantazhin për t'u paraprirë zhvillimeve që do të pasonin në rajonin më të gjërë në të gjitha fushat. Dhe kjo lidhet me faktin se "*kudo në botë, atje ku popujt takohen, shikojmë që të shkëlqejnë ata ose ato që rrjedhin nga dy fise (kombe) të ndryshme*".⁵⁷

Zhvillimet politike që shoqëruan periudhën e Dhespotatit të Epirit, me ndryshimet e vazhdueshme të drejtuesve të tij,- grekë, italianë, serbë e shqiptarë, bënë që mbi nënshtratin e përbashkët kulturor, të njehsohej një strukturë popullsie shumëgjuhësore e multietnike⁵⁸. E njëjta strukturë u trashëgua dhe në periudhën e Perandorisë Otomane. Në trevën që ne trajtojmë, N. Vernikos dhe S. Dhaskallopullu, vënë re se banonte dhe lëvizte "*një botë pesëgjuhëshe*"⁵⁹, bashkëjetesa dhe bashkëveprimi i të cilëve do të sjellë medoemos zhvillim e përparim.

Në këtë kuadër njerëzit e letrave të kësaj periudhe do të kërkojnë modele të reja organizimi politik ekonomik, shoqëror e kulturor që do t'u korrespondojnë atyre Perëndimore. Kjo do të thotë, së pari, që ata kuptuan nevojën e njohjes së vetes dhe historisë së tyre dhe së dyti, kuptuan se sistemet perandorake të organizimit shoqëror e politik po perëndonin. Vendin e tyre po e zinin shtetet

⁵⁷ Βερνίκος Ν., Δασκαλαπούλου Σ., 1999, *Στις απαρχές της νεοελληνικής ιδεολογίας*, Αθηνά, fq. 163.

⁵⁸ Εκδοτική Αθηνών, 1997, Α.Ε, *Ήπειρος*, Αθηνά, fq. 219

⁵⁹ Βερνίκος Ν., Δασκαλαπούλου Σ., 1999, *Στις απαρχές της νεοελληνικής ιδεολογίας*, Αθηνά, fq. 22.

kombëtare. Kjo periudhë kulturore iluministësh, arriti kulmin me shtypshkronjën e Voskopojës (1720-1769). Gjatë kësaj periudhe dolën në dritë shumë studime historike, kronika, monografi etj, të shkruara me arsyetim iluminist e qëllimin romantik. Synonin që, duke ndriçuar mendjen, të ndihmonin në njohjen diakronike të vetvetes, me qëllim ngjizjen e identitetit kombëtar.⁶⁰ Këtij spektri i takojnë emra të shquar si Methodhios Anthraqitis, Evjenios Vulgaris, Athanasios Psalidas, Dhaniil Moskopolitis, Nektarios Terpos, Theodoros Kavaliotis, Panajotis Aravantinos, Patriarku Serafim B' nga Delvina, Kosmai i Etolisë etj.

Këta mendimtarë dhe krijues mbështeteshin nga paria ekonomike e vendit dhe që më vonë u njohën si bamirës kombëtarë të Greqisë. Përmendim disa nga emrat që kanë kontribute të shquara si për Greqinë, ashtu dhe për Evropën, Glikis (Γλυκός), Gioumas (Γκιούμας), Sinas (Σίνας), Kazantzis (Καζαντζής), Kiopekas (Κιοπέκας), Kapllanis (Καπλάνης), Zosimas (Ζωσιμάδες), Marucis (Μαρούτσης), Zapas (Ζάππας), Pangas (Πάγκας), Zografos (Ζωγράφος) etj.

Kontributi i tyre është i pazëvendësueshëm në fushën e letrave dhe të dijës. Sistemi i shkollave në Epir, duke filluar që nga shekulli XIII dhe sidomos gjatë e pas shek XVII, kanë vulën dhe kontributin e tyre. Një shkollë e tillë e përmasave evropiane ishte hapur edhe në Gjirokastër që me 1631.

Kësaj lëvizjeje të njerëzve të pasur dhe të ditur nga Epiri i shtohen shtypshkronjat e shumta sidomos në Evropë.

Shtypshkronjen e parë në Venedik themeloi tregëtari janiot N. Glikis (N. Γλυκός) me 1670. Ajo jetoi 184 vjet dhe arriti të botojë 1007 libra. Shtypshkronja e dytë helene po në Venedik u themelua nga N. Saros (N. Σάρος) me 1685. Të së njëjtës periudhë i takon dhe shtypshkronja e Dhimitrit (Δημήτρης) dhe Panos (Πάνος) Theodhosiu (Θεοδοσίου). I katërti që themeloi shtypshkronjë në Venedik në gjysmën e dytë të shek. XVII ishte filologu janiot Andreas Julianos (Ανδρέας Ιουλιανός). Shtypshkronjë në Venedik kishte dhe N. Saros tjetër me origjinë nga Delvina i cili me testament mbështeti hapjen dhe funksionimin e Akademisë së Delvinës.

⁶⁰ Më 1710 Meletios Mitros (Μελέτιος Μήτρος) boton "Gjografinë" «Γεωγραφία», një studim historik edhe mbi Epirin, por që shënon fillimin e periudhës ku nevoja për të njohur veten në realitetin konkret përmes një vështrimi diakronik (me pikënisje kulturore e lashtë greke) që do të përcaktojë të ardhmen. Kronikat e Pogonianisë, e Papingut, e Malçanit. Por mbi të gjitha rëndësi ka kronika mbi themelimin e Dropullit që gjendet në mbi 10 variante dorëshkrimesh që i përkasin viteve 50' të shekullit XVIII. U botua nga Pukevil më 1821.

Në këtë traditë përbën ngjarje me rendësi shtypshkronja e Voskopojës. U themelua nga kleriku Gavriil Konstandinidhi (Γαβριήλ Κωνσταντινίδης) me 1731. Ishte shtypshkronja e dytë në gjeografinë e Perandorisë Otomane dhe e para në pjesën evropiane të saj.⁶¹ Shtypshkronja në Voskopojë lidhet më së shumti me nevojën e krijimit të bazës bibliografike për arsimimin në gjuhët amtare të banorëve me përkatësi të ndryshme kulturore dhe etnike të Voskopojës.

Në këtë plejadë treva që sot lidhet me Minoritetin Grek në Shqipëri ka një kontribut të vyer. Permendim:

Nikollaos Kerameos (Νικόλαος Κεραμέως), nga Janicati i Delvinës. Për të njihet vetëm data e vdekjes, viti 1672. Shkollën bazë e kreu në Janinë. Studjoi për mjekësi dhe teologji në Venecia. Me 1650 u vendos në Konstandinopojë.

Me nxitje të Patriarkut Parthenio C' dhe me vendim të Sinodhit të Shënjtë, mori përsipër veprën kundër Papës titulluar: "Kundër-përgjigje në emër të të cilesuarve padrejtësisht kundërshtarë të një-rës dhe të vetmës Kishë apostolike dhe unike Nimfë të Perëndishme e Krishtit" («Αντέγκλημα κατά των εγκυκαλούντων αδίκως κατά της μιας και μόνης αγίας καθολικής και αποστολικής Θεοτύμου του Χριστού Εκκλησίας»).

Shkrojti dhe vepra të tjera kishtare, teologjike, mjeksore dhe filozofike. Shumë prej tyre si "Reagime ndaj autoritetit të Papës së Romës" («Αντιρρητικά κατά της αρχής του Πάππα της Ρώμης»), "Rreth parimeve teologjike" («Περί αρχών Θεολογικών»), "Rreth miqësisë dhe erosit" («Περί φιλίας και έρωτος») etj. nuk janë botuar.

Me 1754 eruditi Argjyrokastrit **Polizois Spiros (Πολυζώης Σπύρος)** botoi veprën e rendësishme "Përmbledhje mbi logjikën sipas Aristotelit dhe artit të retorikës" («Επιτομήν Λογικής κατ' Αριστοτέλη και Τέχνην Ρητορικήν»).

Evangjellos Meksis (Ευάγγελος Μέξης) (1758-1818), nga Labova e Gjirokastrës, shkollën bazë e kreu në Janinë me mësuat Athanasion Psalidas. Me shpenzime të Ali Pashas u diplomua për mjekësi në Napoli. Shërbeu si mjek në oborrin e Aliut deri me 1810. Ishte ndër anëtarët kryesorë të Filiki Eterias. Ishte shkrimtar dhe përkthyes. Përktheu në shqip, me alfabetin grek Ungjillin sipas loanit dhe shumë libra të tjera për moralin e të krishterëve dhe hebrejve të cilat i boti me 1814.

⁶¹ Adhami S., 1989, *Voskopoja*, Tiranë fq. 66.

Aleksandros Vasiliu (Αλέξανδρος Βασιλείου) (1760 - 1818). Ishte nga Gjirokastra. Njihet si personalitet i rëndësishëm që i takon brezit të Iluminizmit të ri grek, shek XVII-XIX.

Për shkak të biznesit të tij ka jetuar në qytete të ndryshme të Evropës: Trieste, Konstandinopojë, Paris, Lyon, Vjenë etj. Paralelisht u morr dhe me çështjet e arsimit dhe dha kontributin e tij në konsolidimin e iluminizmit neohelen.

Mik i ngjushhtë dhe bashkëpunëtor i çmuar i A. Korais. Mbështetëti idetë e tij dhe botoi mjaft ese në revistën “Llojos Ermis” «*Λόγιος Ερμής*».

Si i tillë, në debatin e gjatë dhe të thellë për çështjen e gjuhës ai njihet si përkrahës i gjuhës popullore dhe kundërshtar i ideve konservatore të përfaqësuara nga N. Dhukas për këtë çështje.

Po ashtu Vasiliu ka një kontribut të pazëvendësueshëm në aspektin e organizimit të rrjetit të qarkullimit të librit nga Evropa në Greqi. Për një periudhë të shkurtër shërbeu si Konsull i Perandorisë Osmane në Trieste.

Nikollaos Dhelvinjotis (Νικόλαος Δελβινιώτης), (1774-1850). Me origjinë nga Delvina. Studjoi në Korfuz dhe Venecia për jurist, profesion që e nderoi me punën e tij. Shkroi poezi në italisht dhe përkthime nga greqishtja në italisht.

Me 1809 botoi një libër me poezi, shumë prej të cilave i kushtoheshin lirisë së kombit grek. Me 1843 botoi të përkthyer në italisht Odhisien e Homerit që u cilësua ndër më të arrirat.

Konstandinos Kondos (Κωνσταντίνος Κοντος), (1834-1909). Me origjinë nga Delvina. Me 1855 regjistrohet për filozofi ne Universitetin e Athinës. Për shkaqe ekonomike u detyrua të ndër-presë studimet të cilat do t'i përfundojë në Hollandë.

Më 1867 u caktua pedagog në Universitetin e Athinës. Përsa i përket botimeve ishte shumë produktiv. Ndërmjet studimeve të tij përmenden: “Komente për letrën time” («*Σχόλια εις την εμήν επιστολήν*»), “Vërrejtje rreth polisit e Athinjotëve të Aristotelit” («*Παρατηρήσεις εις Αριστοτέλους Αθηναίων Πολιτείαν*»), “Vërrejtje gjuhësore” («*Γλωσσικές Παρατηρήσεις*»). Veprat e tij u përkthyen në shumë gjuhë të huaja.

Kur studjonte në Hollandë drejtoi për dy vjet revistën filologjike «*Λόγιον Ερμήν*» dhe bashkëpunoi me shumë revista dhe botime të tjera letrare të kohës. Me 1889 themeloi “Shoqërinë shkencore” të cilës i la 8.000 librat e bibliotekës së tij.

Dhimitrios A. Panajotidhis-Meksis (Δημήτριος Α. Παναγιωτίδης-Μέξης) (1855-1910). U lind në Labovë ku mori dhe arsimin fillëstar në shkollën në gjuhën greke të vendlindjes. Me 1883 u diplomua për mjekësi në Universitetin e Athinës. Fitoi dhe të drejtën e ushtrimit të profesionit në të gjithë territorin e P. Otomane. Shpejt u kthye në Epir dhe u vendos në Thesproti. U muar energjikisht me letërsinë, historinë, arkeologjinë, folklorin.

Botoi letërsi në shtypin letrar të kohës. Veprat e tij studimore përbëjnë bazën bibliografike për historinë e rajonit të Thesprotisë. Përmendim ndër veprat e tij: “Fotikia në Paramithi” (*«Η Φωτική εν Παραμυθιά»*), “Fotikia në Paramithi dhe mbishkrimet në të” (*«Η Φωτική παρά την Παραμυθιάν και επιγραφάί τίνες αυτής»*), “Folkloristika. Doke dhe zakone të rajonit të Paramithisë në Thesproti” (*«Λαογραφικά. Ἦθη και Ἔθιμα του Τμήματος Παραμυθιάς, εν Θεσπρωτία»*), “Arkeologji. Kërkime arkeologjike në thesproti” (*«Αρχαιολογικά. Θεσπρωτικά Αρχαιολογήματα»*), “Shënime kronologjike për monastiret dhe kishat e Thesprotisë” (*«Χρονικά σημειώματα εν Μοναίς και Εκκλησίαις της Θεσπρωτίας»*), “Katalog kronologjik të episkopatave të Thesprotisë me më të vjetrat ato të Evrias, Fotikës dhe Butrintit” (*«Χρονολογικός Κατάλογος των επισκόπων Παραμυθιάς μετά των αρχαιοτέρων της Ευροίας, Φωτικής και Βουθρωτού»*) dhe shumë studime të tjera në këtë fushë.

Margaritis Papas Hristos, (Μαργαρίτης Παππάς Χρήστος) 1810-1857. Ishte nga Dhrovjani. Njihet si erudit, shkrimtar dhe botues. Midis të tjerash me 1851 botoi në Konstandinopojë librin “Gramatika e muzikës dhe përmbledhje muzikore” *«Γραμματική Μουσικής και Συλλογή Μουσικών»*. Vepra e tij u ribotua nga shtëpia botuese dhe fondacioni Elikranon më 2010.

Kosmas Thesprotos (ο Κοσμάς ο Θεσπρωτός) (1780-1852), nga Jeorgucati. Nxënës në shkollën e njohur të Janinës, Kapllanios Skoli me mësues dijetarin e shquar iluminist A. Psalidhas. Shërbeu si mësues në shumë rajone të Greqisë dhe Epirit. Është autori i *«Γεωγραφία της Ηπείρου και Αλβανίας»* “Gjeografia e Epirit dhe Allvanias (Shqipërisë)”. Libri shoqërohet me tetë harta të një rendësie të veçantë. Atij i takon dhe një poemë në varg pesëmbëdhjetërokësh, kushtuar fundit të Ali Pashë Tepelenës.

Vasilios Zotos Mollossos (Βασίλειος Ζώτος Μολοσσός) (1837-1912), nga Dhroviani i Delvinës. Shkroi shumë vëllime me studime, gjithësej 21, me titullin e përgjithshëm “Studime Epirotase”, (*Ηπειρωτικά Μελέτες*), të cilat shërbyen si bazë dhe pikë referimi

për të gjithë studiuesit e mëvonshëm që u morën me Epirin. Midis veprave të pabotuara përmendim "Historia e Epirit" («*Ιστορία της Ηπείρου*»). Ndër to përfshihet dhe një qasje gjuhësore për katër dialektet, sipas tij, të gjuhës shqipe, atij çam, tosk, lab dhe geg. Mollosos i takon edhe një alfabet i shqipës me shkronja greke⁶².

Shkroi gjithashtu një enciklopedi shenjtorësh (ku përshkruhet jeta e të gjithë shenjtorëve orthodox, të Kishës Orthodoxe Lindore). Udhëtoi pothuaj në të gjitha vëndet e Ballkanit dhe shkroi shënime udhëtimi për të gjitha vëndet e vizituara. Shkroi gjithashtu sinaksarë shenjtorësh dhe muzikë kishtarë. Poezia e shkruar prej Mollosos është në frymën e Rigas Fereut dhe u bën thirrje popujve të Ballkanit të ngrënë përbashkësisht krye kundër pushtimit otoman.

Bashkëfshatari i tij **Athanasios Petridhis** (**Αθανάσιος Πετρίδης**) (1830-1914). Shkroi "Studime të hollësishme mbi Dodonën, (*Επιστασίαι κριτικάί περί Δωδώνης*). Botoi variantin e vet të Kronikës së Dropullit, "Kronika e Dhriopidhos" (*Χρονικόν Δρυοπίδος*). Ndër botimet e shumta të kësaj kronike, ai i Petridhit është më interesanti, pasi ai, përveç komenteve dhe shtesave plotësuese të mungurara, bën njëkohësisht krahasime me pesë variante të tjera. Në botimin e Petridhit gjejmë në fillim "Gjeografinë e Epirit" dhe më pas vijon "Kronika e Dhriopidhos".

Petridhis shërbeu edhe si sekretar i Gjolekës. Atij i takon korespondenca e dendur e Gjolekës me kancelaritë perendimore, si edhe korespondenca e Gjolekës me kryeministrin e mbretin grek të kohës. Petridhi është autor i librit "Përshkrimi i shkurtër i Gjeografisë së Epirit". Në revistat "Pandhora" («*Πανδώρα*»), "Apollon" («*Απόλλων*») etj, ka botura shumë artikuj shkencorë me karakter arkeologjik, historik e kulturor me objekt Epirin, Manin, Pelloponison, Attiki dhe Allvaninë.

Petridhis kishte edhe një vëlla, Kostandinin i cili shkruante poezi që i botonte në shtypin periodik të kohës. Vdiq shumë i ri, pa mbushur te tridhjetat. Ndërsa vëllai tjetër Panos (Papa-Panos Petridhis) shërbente si mësues në fshatrat e Himarës dhe Bregdetit dhe shkroi «*Επίγραμμα της Χιμάρας*» të cilin ia dërgoi vëllait të tij Athanasio për ta botuar dhe një liber që u botua pas vdekjes së tij me titullin «*Γεωγραφία της Χαονίας*» ("Gjeografia e Haonisë").

⁶² *Εγκυκλοπαιδικό Λεξικό Ελευθερουδάκη*, (Fjalor enciklopedik Eleftherudhakis), v. 6, fq. 276.

Po nga Dhroviani ishte dhe **Nikollaos J. Mystaqidhis (Νικόλαος Γ. Μυστακίδης)** (1863-1930) të cilit i takojnë 45 studime të ndryshme me objekt arkeologjinë, historinë, kulturën dhe fenë në Epir. Kur shërbente si sekretar në Mitropolinë e Shënjtë të Gjirokastrës shkroi një libër shumëfaqësh për të gjitha fshatrat në varësi të kësaj Mitropolie dhe objektet e kultit të tyre.

Libri konsiderohet i zhdukur. (Migjethëse Beduli kishte kopjuar nga libri disa dokumenta historike për fshatrat e Pogonit. Kështu Beduli vërteton ekzistencën e librit të Mystaqidhit).

Minos Llapas (Μίνως Λάππας), i lindur edhe ai në Dhrovjan të Delvinës, rreth 1834. Studjoi në Berlin, Angli dhe Gjenezë. Profesor në Universitetet e Korfuzit dhe Athinës dhe gazetar. Botues i gazetës «Ανατολικός Αστήρ». (“Ylli i Lindjes”). Shkroi artikuj të shumtë studimor dhe poezi.

Themistoklis Volidhis (Θεμιστοκλής Βολίδης) (1875-1954). I lindur edhe ai në Dhrovjan të Delvinës. Studjoi në Gjermani dhe konsiderohet një nga figurat më të spikatura të bizantologjisë evropiane. Këshilltar i studimeve bizantologjike të universiteteve gjermane dhe drejtor e dorëshkrimeve bizantine në Athinë.

Shërbeu si Drejtor i Bibliotekës së Patriarkanës së Aleksandrisë. Ishte anëtar themelues i Fondacionit të Studimeve Bizantine. Vëpra të botuar të tij janë “Dy sisteme e para qeverise Demokratike të Rigas” «*Τα δύο πρώτα Δημοκρατικά πολιτεύματα του Ρήγα*» 1924 dhe “Shënime lidher me sistemin e përkohshëm politikë të Greqisë të 1822 të Adamantios Korais” «*Σημειώσεις εις το προσωρινόν Πολίτευμα της Ελλάδος του 1822 του Αδαμαντίου Κοραή*» më 1933.

Themistoklis Bamihias (Θεμιστοκλής Μπαμίας) (1875-1930), jurist nga Delvina. Politikan, studiues dhe intelektual me kulturë të gjërë. Deputet në parlamentin e Konstantinopojës si përfaqësues i komunitetit grek të prefekturës së Gjirokastrës. Vazhdoi shkrimin e Kodikut të Delvinës të trashëguar nga Konstandinos Hr. Manaris 1635 e Vasilios Zotos Mollossos⁶³ (Shkrimi i Kodikëve të

⁶³ Kodikë të tjerë më rëndësi të veçantë për krahinë janë: **Kodiku i kishës së Lindjes së Shënmerisë të Labovës** i cili mendohet se filloi të shkruhet në shekullin VI, atëherë që Perandori Justinian ndërteoi kishën. (Sipas Prof. Sh. Sinanit duhet të bëhet fjalë për të njëjtin kodikë që u gjend vonë në Berat.) **Kodiku i kishës së Gjirokastrës** u shkrua shumë vonë nga episkopi metsovit Dhositheo 1760-1799. **Kodiku** tjetër i rëndësishëm është ai i **monastirit të Kamenas** që i përket fillimit të shek XIX.

Delvinës kishte filluar që më 1372, pas sulmit të parë të Turqëve në Delvinë).

Spiros Stratis (Σπύρος Στράτης), Nikollaos Saros (Νικόλαος Σάρος) dhe **Spiros Rizos (Σπύρος Ρίζος)**, njihen si themelues dhe financues të “Akademisë së Delvinës” «*Ακαδημίας του Δελβίνου*» (1737 dhe vijim).

Fillimet e mirëfillta letrare në trevën e sotme të Minoritetit Grek, i hasim në fillim të shekullit XVII. Fjala është për **Stavrinos Dhelvi-*niotis-Vestiaris*** (Σταυρινός Δελβινιώτης-Βεσιτιάρης) (1570 - 1632), nga Malçani i Sarandës, me 1312 vargjet e tij kushtuar bëmave të Mihail Voivodës (1594-1601) në Vllahi. Titulli i poemës është: “*Tregim i bukur për Mihail Voibodën, si sundoi në Vllahi, si preu turqit që u gjenden aty, si bëri dhe shumë heroizma, dhe pastaj si e vranë pa luftuar*”.

Stavrinos na e thotë vetë se ishte nga Malçani i Delvinës. Po vetë pohon se nuk dinte shumë “gramë”. (Kjo deklaratë u bë ndoshta për shkak të modestisë së kohës.) Nuk dihet me saktësi, sa kohë ka qëndruar në vendlindjen e tij, por siç pohon studiuesi i tij Kostas Naços, ai duhet të ketë mësuar shkrim e këndim në shkollën e manastirit të Theollogos, në Cerkovicën e sotme, në rrethin e Sarandës⁶⁴.

Po ashtu nga mënyra e përshkrimit të ngjarjeve dhe “*heroizmeve*” të Mihail Voivodës, rezulton i vërtetë pohimi i Stavrinos se ka qenë ndihmësi i Voivodës. Dihet historikisht, se Mihail Voivoda sundoi në Vllahi nga 1594-1601. Synimi i tij ishte “*çlirimi i Konstandinopojës dhe realizimi i bashkimit të të dy kishave*”.

Poema duhet të jetë shkruar pak pas vdekjes së Voivodës, shkurt 1602. Vetë Stavrinos thotë, se e ka shkruar brënda dy netëve në kështjellën Bistrisa ku e kishin burgosur. Nxitje për të shkruar poemën ose “*romanin*”, siç e karakterizon Naços,⁶⁵ ka të bëjë me kujdesin karakteristik të periudhës bizantine e pas bizantine, se “*ngjarjet e rëndësishme duhën shkruar që të mos humbasin*”.

Është shkruar në gjuhë popullore, por ai përdor edhe fjalë nga greqishtja e vjetër. Vargu i përdorur është pesëmbëdhjetë-*rrokëshi* me rimë.

⁶⁴ Νάτσιος Κ., 1997, *Σταυρινού Βησιτιάρη*, Athinë, fq. 13-14.

⁶⁵ Νάτσιος Κ., 1997, *Σταυρινού Βησιτιάρη*, Athinë, fq. 18.

Poema, edhe pse nuk përmban vlera të spikatura letrare, ka rëndësinë e saj si vepër e parë e mirëfilltë letrare në trashëgiminë e sotme letrare të Minoritetit Grek. Po ashtu, ajo përmban vlerat e veta historike përsa i përket informacionit që sjell. Poema, duke filluar nga 1668, është ribotuar katër herë.

Nga ana tjetër, është i rëndësishëm fakti se virtyti dhe vdekja e një heroi të huaj, si në rastin tonë e M. Voivodës, u bënë burim frymëzimi për një poet që i përket një populli tjetër.

Por, siç vë re, historiografia filologjike, për krijimet e kësaj periudhe nuk mund të flitet për pretendime letrare dhe ajo që ka më shumë rëndësi, është se *“nuk mund të përfshihën në një traditë me rrezatim shpirtëror për rajonin më të gjërë”*. Ndër vlerat që vihën re, p.sh për kronikat, janë karakteri edukativ, informacioni që mbart, si dhe gjuha e përdorur e cila shpesh ka trajtën e gjuhës së folur popullore.

Kësaj periudhe i takon dhe një vepër tjetër letrare. Është konsideruar *“roman”* dhe autori i tij ishte nga Selcka e sotme e Pogonit. Nuk dihet me saktësi titulli dhe autori i veprës.

KREU I TRETË

LETËRSIA NË MINORITETIN GREK DERI NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

III.1. *Tiparet e letërsisë në Minoritetin Etnik Grek pas vendosjes së kufijve midis dy shteteve*

Vendosja e kufirit dhe krijimi i shtetit shqiptar në fillim të shekullit të kaluar krijoi një përvojë të re historike për komunitetin me etni greke, që u përfshi në të me statusin e minoritetit etnik. Përfjetimi prej këtij minoriteti i realitetit të ri historik ndoqi rrugën e vështirë të përpjekjeve të tij për të mos u pajtuar me ndarjen nga pjesa tjetër e kombit të vet; të peripecive nga Luftat Ballkanike e Lufta e Parë Botërore; të ambicjeve të shteteve të fuqishme për të ruajtur supremacinë e tyre në këtë rajon strategjik midis Lindjes dhe Perëndimit; por edhe të peripecive nga përpjekjet për të arritur stabilitetin e brëndshëm politik të shtetit të ri e të brishtë shqiptar.

Në këto situata jeta e këtij komuniteti u fut në amulli e stacionacion të përgjithshëm. Zhvillimi i tij ekonomik e aq më tepër zhvillimi kulturor, u fut në zgrip. Bashkëjetesa ndëretnike si një karakteristikë dalluese dhe faktor stimulues i përparimit të gjithanshëm në histori, u vu në rrezik serioz. Kushtet e krijuara provokuan një emigrim masiv të elementit grek⁶⁶. Ky emigrim prekte kryesisht elementin e shkolluar e intelektual (e njëkohësisht bartës dhe krijues kryesor i vlerave kulturore), i cili është gjithmonë më i ndjeshëm ndaj trazirave, pasigurisë, paqëndrueshmërisë e mungesës së një perspektive të qartë.

Krijuesit letrarë, tanimë përfaqësues të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri, po gjenin strehë në qendrat e mëdha kulturore të Greqisë, siç ishte Athina, Patra, Selaniku etj.

⁶⁶ Në bazë të statistikave të kohës rezulton që 70 përqind e emigracionit nga Dropulli i takon periudhës 1920-1938. Në SHBA emigruan në këtë periudhë 20.000 veta. Nga fshati Bularat më 1939 numëroheshin në kurbet 500 veta, nga Dervicani 410 veta, nga Sopiku 200, nga Poliçani 280, nga Goranxia 110. Më 1936 në fshatin Sotirë kishin mbetur vetëm 20 burra ndërsa 216 të tjerë ishin në mërgim.

Eshtë fakt se në historinë e letrave të Minoritetit Grek në Shqipëri, nuk mund të përmendim pothuaj asnjë emër me peshë që të ketë krijuar në Shqipëri. Por mund të përmendim shumë të tjerë, të cilët kanë ushtruar me shumë sukses veprimtarinë e tyre krijuese në Greqi, apo dhe në vende të tjera jashtë saj.

Këtu përsëri ka vend pyetja: Pse krijimtaria e tyre letrare duhet përfshirë brënda kornizave të letërsisë së Minoritetit Grek? Një përgjigje na jep për këtë prozatori i njohur grek Sotiris Dhimitriu nga fshati Povëll, në kufi me Shqipërinë. *“Eshtë e vërtetë se letërsia jonë në Epir nuk krijoi ndonjë shkollë letrare të vetën në letërsinë e përgjithshme greke, por ajo kishte gjithmonë vullën e vetë epirotase...”*⁶⁷ Duke e parë nga ky këndvështrim krijimtarinë letrare të autorëve nga Minoriteti Grek, që krijuan larg vendlindjes së tyre, do të vëmë re se ata mbartën në këto krijime gjuhën e folur të trevës së tyre, toponomastikën, florën dhe faunën e saj. Tematika e veprave të tyre lidhet drejtpërdrejt me problematikën e vendlindjes. Personazhet dhe heronjtë e tyre kanë mentalitetin, veshjen dhe temperamentin e njerëzve të vendlindjes.

Duhet gjithashtu theksuar se krijimtaria e shumë prej tyre, madje e pjesës më produktive, regjistrohet pas Luftës së Dytë Botërore. Disa herë arrin edhe letërsinë e periudhës në vijim, atë të vitëve të tranzicionit në Shqipëri, pas viteve 1990'. Pra, në aspektin historiografik kjo letërsi i takon pothuaj tri periudhave, sidomos asaj të pas Luftës. Krijimtarinë e tyre në monografi e kemi trajtuar si letërsi të periudhës midis dy luftërave. Kjo për faktin se autorët e kësaj letërsie e nisnin karrierën letrare në këtë periudhë, vazhduan të shkruajnë jashtë vendlindjes ose vendit të origjinës, nuk kanë shkruar, kuptohet, letërsi të realizmit socialist, e as letërsi *“të burgosur”*.

Po përmendim disa nga këta përfaqësues.

Katina Papa⁶⁸ (1903-1959). Zë një vend nderi dhe vlerësim të vëçantë në Greqi dhe në Botë.

Më të drejtë, asaj i takon vendi i Arkondes në letrat në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri.

Si rrallëkush, por si bijë e një familjeje të madhe dhe të nderuar historikisht në jetën kulturore të Greqisë dhe jo vetëm, dallohet për nivelin e studimeve, avanguardën e tyre dhe aftësinë e

⁶⁷ Dhimitriu S., nga diskutimi në takimin midis krijuesve grek nga të dy anët e kufirit në universitetin e Gjrokastrës, 31.05.2004.

⁶⁸ Περάνθης Ν, 1982, *Ελληνική Πεζογραφία, 1453 deri sot*, Vol. IV, Athinë, fq. 513 - 515.

saj për të venë në jetë, në Greqi, ato çka studioi në universitetet më të njohura evropiane të kohës, periudhën midis dy luftrave botërore.

E vetme në hapësirën e Minoritetit Etnik Grek me pretendime kaq të larta në fushën e letrave dhe me aq vlerësime akademike dhe letrare. Lëviz aq natyrshëm dhe me dinjitet në sallonët e personaliteteve të shquara të letrave greke dhe të botës. Arti i saj nuk pretendon gjëra të mëdha që të shkelqejë. Thjesht di të bejë të shndritshme historitë e thjeshta dhe të përditshme njerëzore.

I takon atij rrethi njerëzish që jetuan shumë pak për të prodhuar kaq shumë vlera.

Shkruan letërsi: Prozë (rrëfim), poezi dhe dramë me të njëjtin sukses. Shkruan studime, boton kërkime dhe kritika për veprat e personaliteteve më të shquara të kohës në fushën e letrave.

Harton leksione dhe tekste për zbatimin sa më të mirë në jetë të arritjeve të saj universitare.

Bashkëpunon me gazetatat, revistat dhe shtëpitë botuese me të dëgjura të kohës të cilat e konsiderojnë nder bashkëpunimin me të.

Katina Papa, me veprën letrare, studimore, shkencore ka zënë në kohë një vend të nderuar në panteonin e letrave greke, si një figurë veçanërisht interesante.

Jetëshkrimi.

U lind me 1903 në fshatin Janicat të Delvinës, ku kaloi dhe femininë.

Me 1912 largohet familjarisht për shkak të përmdjekjeve dhe situatës së luftës, për t' u vendosur në Korfuz.

Këtu përfundoi studimet enklrike dhe fitoi medaljen e artë «Ward Douglas», medalje që u akordohej studentëve të shkelqyer në Akademinë Joniane (*Ιόνιος Ακαδημία*).

Pasi përdundoi studimet filozofike në fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Athinës caktohet me detyrë në shkollën e përgjedhur Arsakeion të Korfuzit.

Me 1924-25 përfundon Akademinë Pedagogjike të Athinës.

Me 1930 me bursë të Ministrisë së Arsimit të Greqisë shkoi për studime në Universitetet e Austrisë dhe Gjermanisë, ku studjoi për Psikologji dhe Pedagogji Kuruese.

Në Vjenë për dy vjet ishte studentja e përgjedhur e themeluesit të psikologjisë atomike Alfred Adler.

Në Monako studjoi pranë psikologut të famshëm Seif dhe në Berlin pranë profesorëve Künklel dhe Gohring.

Po në Berlin, bashkëpunoi me profesorin Köhler në Institutin e Psikologjisë në ekseperimentet për kujtesën. Këtu fitoi bursën e Alex von Humboldt.

Në Greqi u caktua me 1933 arsimtare në një gjimnaz femrash në Athinë, ku edhe themeloi të parin dhe për shumë kohë të vetmen në Greqi “Qendrën Këshillmore Pedagogjike” që funksionoi deri me 1954, me rezultate të shkëlqyera.

Me 1955 dha dorëheqjen për t’ ju përkushtuar letërsisë

Vdiq me 1959 në moshën 56 vjeçare.

Shkroi dhe u botuan ose mbetën të pabotuara

«*Στη συκαμιά από κάτω*» / (“Poshtë manit”), Athinë, 1935,

«*Αν άλλαζαν όλα*» / (“Po të ndryshonin të gjitha”) Athinë, 1948.

«*Σ’ ένα Γυμνάσιο Θηλέων*»,

(“Në një gjimnaz femrash) Athinë, 1960.

«*Ποιήματα*» / (“Poezi”), Athinë, 1963.

«*Ο Ξένος*» (“I huaji”) Dramë Athinë, 1967.

«*Η ηθική των αρχαίων Ελλήνων*»,

(“Moral i grekëve të lashtë”), Studim.

«*Τα προς εαυτούς καθήκοντα*»,

(“Detyra për vetën”) Studimi.

«*Κριτικές και αισθητικές μελέτες γύρω από το έργο του Κωνσταντίνου Θεοτόκη, του Γρηγορίου Ξενοπούλου, του Αντώνη Τραυλαντώνη και του Αλέξανδρου Δελμούζου*»,

(“Kritika dhe studime estetike mbi vëpren e K. Theotokit, të Gr. Ksenopullos, Travllantonit dhe Dhelmuzut”).

«*Ο Γρηγόριος Ξενόπουλος ως παιδαγωγός*»,

(“Grigoris Ksenopullos si pedagog”) Monografi.

«*Η αλληλογραφία της με τον Γρηγόρη Ξενόπουλο και τον Δημήτριο Καμπούρογλου*»,

(“Letërkëmbimi me Gr. Ksenopullon dhe Dhimitrio Kaburogllu”).

«*Ο γάμος στο Δέλβινο και τα χωριά του*», μελέτη για ta gamhilia éthima tou Boreíou Tmímatos tis Hpeírou,

(“Traditat e dasmës në Delvinë dhe fshtatrat e saj”) Studim.⁶⁹

«*Η ηθική και το Θέατρο*» / (“Etika dhe Teatri”) Studim.

«*Η φιλοσοφία της Τέχνης στην Ελλάδα*»,

“Filozofia e Artit në Greqi”.

⁶⁹ Studimi u botua si libër me vete nga fondacioni Elikranon në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek në Universitetin e Gjirokastrës, në vitin 2019.

Katina Papa përbën njëkohësisht një nga figurat me rendësi të veçantë përsa i përket bibliografisë studiuëse të veprës së saj, si më poshtë:

- **Άγρας Τέλλος**, Κριτική για το «*Στη Συκαμιά από κάτω*», Νεοελληνικά Γράμματα, 28/7/1935.

- **Αργυρίου Αλεξ.**, Κριτική για το «*Αν άλλαζαν όλα*», Ελεύθερα Γράμματα., 15/3/1948, σ.267.

- **Δαφνής Κώστας**, «*Για την Κατίνα Παπά*», Κερκυραϊκά Χρονικά, 1960.

- **Δαφνής Κώστας**, *Γράμματα Δημ. Καμπούρογλου και Γρηγορίου Ξενόπουλου στην Κατίνα Γ. Παπά, 1920-1937* (προλεγόμενα-επιμέλεια). Κέρκυρα, 1972.

- **Ιακωβίδη Λιλή**, «*Κατίνα Παπά*», Το περιοδικό μας, 10/1959.

- **Ιακωβίδη Λιλή**, «*Η πεζογραφία της Κατίνας Παπά*», Δημιουργίες, 11/1970.

- **Ιακωβίδη Λιλή**, *Κατίνα Παπά· Από τη ζωή και το έργο της*. Αθήνα, 1972.

- **Μελάς Σπύρος**, «*Γράφουσες*», Καθημερινή, 18/7/1944.

- **Μέλμπεργκ Μαργαρίτα**, «*Κατίνα Παπά*», *Η μεσοπολεμική πεζογραφία. Από τον πρώτο ως τον δεύτερο παγκόσμιο πόλεμο (1914-1939)* Ζ', σ. 8-26. Αθήνα, Σοκόλης, 1993.

- **Παπατσώνης Τ.Κ.**, Κριτική για το «*Στη Συκαμιά από κάτω*», Ελληνικά Φύλλα, 3/1935.

- **Σταύρου Τατιάνα**, «*Η δράσις της ελληνίδος στην τέχνη και στα γράμματα: Το καλό βιβλίο*», Νέος Κόσμος, 17/3/1936.

- **Φουριώτης Άγγελος**, Κριτική για το Σ' ένα Γυμνάσιο Θηλέων, Απογευματινή, 17/2/1960.

- **Χάρης Πέτρος**, «*Κατίνας Γ. Παπά: Στη συκαμιά από κάτω και άλλα διηγήματα*», Νέα Εστία 17, ετ. Θ', 1η/5/1935, αρ. 201, σ. 452-453 (τώρα και στον τόμο Σαράντα χρόνια κριτικής ελληνικού πεζού λόγου Α', σ. 164-165. Αθήνα, Ε.Λ.Ι.Α., 1981).

- **Χάρης Πέτρος**, Κριτική για το «*Αν άλλαζαν όλα*», Ελευθερία, 13/3/1948 (τώρα και στον τόμο Σαράντα χρόνια κριτικής ελληνικού πεζού λόγου Β', 1950-1956, σ. 59-61. Αθήνα, Ε.Λ.Ι.Α., 1984).

- **Χάρης Πέτρος**, «*Κατίνα Παπά*», Νέα Εστία", ετ. ΛΓ', 15/11/1959, αρ. 777, σ. 1520-1521.

- **Χατζίνης Γιάννης**, «*Κατίνας Γ. Παπά: Αν άλλαζαν όλα*», Νέα Εστία 43, ετ. ΚΒ', 1η/5/1948, αρ. 500, σ. 598-599. Αφιέρωμα περιοδικών.

- Κερκυραϊκά χρονικά 18.

Katina Papa shquhet për rrethin e saj të gjerë dhe të zgjedhur, miqsh, bashkëpunëtorësh, njerëz të letrave dhe të artit. Mban me ta letërkëmbim të rregullt, kontakte, boton për ta kritikë dhe studime.

Miqtë të Katina Papas:

shkrimtari dhe përkthyesi **Konstandinos Theotokis**, romancieri dhe dramaturgu **Grigoris Ksenopullos**, miqësia dhe bashkëpunimi me të cilin vazhduan deri ne vdekjen e tij, poeti **Angjello Sikelianos**, poeti, prozatori dhe përkthyesi **Nikos Kavadhias**, historiani dhe shkrimtari **Dhimitris Haxhis**, **Nikos Kazantzakis**, **Dhimitrios Kaburoglu** etj

Thanë për Katina Papan:

Kostis Pallamas do të përlozet kur Katina Papa do t'i prezantojë me talentin e saj pasurinë folklorike të vendlindjes së saj.

Nikos Kazantzakis, në një nga letërkëmbimet e shumta midis tyre i shkruan me rastin e botimit të librit të saj të dytë "Nëse ndyshonte gjithçka". *"Shumë u gëzova për librin tuaj. Vërtet, ju kam zili. Çfarë gjallërie! Çfarë ndjeshmeri dhe sa brilant! Çfarë përputhje qëllimi dhe realizimi! Me çfarë thjeshtësie formësoni kompleksitetin e shpirtit! Ju falenderoj për gëzimin që më dhatë."*

Për të plotësuar **Dhimitris Haxhis** *"I takon plejadës së shkrimtarëve grek të periudhës midis dy luftërave që dhuruan një ndjeshmeri tjetër letërsisë greke, e dominuar nga burrat, duke kontribuar në emancipimin e shoqërisë greke"*.

Për profesorët e saj në Perendim: Addler në Austri dhe Seif, Künklel, Gohring e Köhler në Gjermani do të mbetet studentja e përkryer dhe bashkëpunëtorja e denjë.

Profili letrar dhe jetësor i Katina Papas.

Kualifikimi i lartë dhe kultivimi i gjerë i saj e ndihmonin të vezhgonte në thellësi njerëzit dhe të kuptonte më mirë problemet e tyre.

Kur nuk lëjoi lëshime tek vetja për përfitime dhe suksese të çastit.

E rreptë por jo dhe pa e emocionueshme ndaj lavderimeve që i bëheshin shpesh për veprën letrare dhe shkencore. I shkëlqenin sytë nga kënaqësia dhe gëzimi shpirtëror kur konstatonte se vepra e saj kishte jehonë.

Ndër të tjera shquhej për oratorinë e saj. Zëri i saj i qëndrueshëm dhe diktues. Fliste dhe shikonte me shikim të qetë dhe dëpërtues. Dinte jo vetëm të fliste dhe por edhe dëgjonte.

Si shkrimtare Katina Papa i përket rastëve shumë të rralla shkrimtarësh që nga përjetimet e veta të përditshme dhe nga ato që zhvillohen rreth tij, arrin të kompozojë një imazh të spikatur mesazhlesh të jetës njerëzore në përgjithësi.

Në tekstet e saj nuk konstatohet asnjë herë diçka asmatike dhe e dhunshme. Dhe në momentet kur ajo satirizon anët mjera-ne, dallohet mendimi i saj i qartë dhe i qetë që me përkushtim i qaset shpirtit njerëzor. Njëkohësisht kulminacionet dramatike në veprat e saj kanë për bosht historinë personale të heronjve të saj. Katina Papa ka gjithmonë diçka për të thenë pa humbur në detaje pa vlerë. Di shumë mirë të përgjithësojë përmes së veçantës që e gjen tek detaji letrar.

Element tjetër i rëndësishëm përcaktues i cilësisë së letërsisë së saj, është gjuha e cila përbën një nga faktorët me të rëndësishëm të arsenalit të vet shpirtëror. Forca plasmuese e gjuhës së saj udhëhiqet nga fantazia e pasur e shkrimtarës e përqëndruar tek njeriu. Nga kombinimi i aftësisë burimore treguese me njohuritë shkencore rezulton gjuha popullore, e rrjedhshme, e freskët dhe pa skarcitete.

Tregon gjithmonë kujdes që rrëfimi të jetë pjesë organike e veprimit që e lejon atë si rrefyese të distancohet nga ato që ndodhin në veprën letrare.

Katina Papa dhe kontributi i saj në brezin e viteve 30 në Greqi.

Katina Papa i takon brezit letrar të viteve 30' të Greqisë. Dhe kjo jo vetëm për faktin se jetoi në këtë periudhë, por se ka meritën se përçoi dritë në tunelin e kërkimeve letrare për ta shpëtuuar letërsinë nga praktika dhe metoda krijuese moraliste të fundit të shekullit XIX, e lidhur kryesisht me jetën në fshat, Originaliteti i artit të saj dhe pjekuria e vazhdueshme e prodhimtarisë së saj krijuese u shndërruan në vlera të padiskutueshme për këtë brez, duke i lejuar vetës një vend nderi në Letërsinë moderne greke.

Kjo ka vlerë dhe për fatin e sprovave të reja letrare të kohës në qytetet e medha greke, të cilat në përpjekjen për të adoptuar rrymat e reja në pasqyrimin e zhvillimeve të reja socialekonomike, nga njëra anë denonconin te vjetren, nga ana tjetër minonin të ardhmën.

Katina Papa solli përvojën e rrëfimit letrar me qendër njeriun dhe dramën e tij, me rrefyesin të distancuar nga ngjarja dhe nga detyrimet moralizuese e edukuese dhe **me mision të vetëm përzgjedhjen e detajit që krijon emocion estetik dhe vlerë artistike.**

Katina Papa edhe pse e përkushtuar profesionalisht në zhvillimet **kohërente psikoanalitike**, e shpeton artin e vet letrar nga ndikimet artistike që kanë për objekt ndërlikimet e subkoshencës njerëzore të pasqyruara në ndërlikime dhe më të thella artistike. **Pa renë viktimë e rrëfimit psikoanalitik**, ajo adreson me thjeshtësi me një menyrë të drejtpërdrejtë dëportuese dhe kritike tek problemet reale të heronjve të saj dhe reagimeve të tyre të brendshme shpirtërore dhe shoqërore.

Nuk u mor me përshkrimin psikoanalitik të paradokseve të plotfuqishme psikike të individit, por si artiste krijuese u perkushtua me krijimin e personazheve njerëzorë.

Do të qe me vend të theksohet se Katina Papa zotëron padyshim atë avantazh që në thelb përbën vulën e shkrimtarit të vërtet, që edhe kur përdor detaje skolastike nuk harron për asnjë çast së prodhon art.

Elementi tjetër që përcakton letërsinë novatore të Katina Papas është fakti se pavarësisht, se produktivitetit të saj si pjesë e qarqeve psikoanalitike të Vjenës, pavarësisht ndikimit superior që psikanaliza kishte në letërsi, ashtu si edhe në drejtimit e tjera të artit, duke i orientuar në maniera të komplikuar që pasqyrojnë nga ana tjetër subkoshencën gjithashtu të ndërlikuar të njeriut dhe proceset jetësore në labirintet e thella të shpirtit të personazheve të kësaj letërsie, në rastin e Katina Papas, psikanaliza në fjalë nuk ndikoi në letërsinë e saj.

Pa renë në gabimin e zakonshëm të letërsisë së miktuar me psikanalizë, Katina Papa orientohet drejt një mënyre kritike dhe dëpërtuese, në problemet e heronjve të saj dhe në reagimet e tyre, duke arritur në menyrë të drejtpërdrejt fitoren e tyre.

Vellimi i saj i parë me tregime me 1935 “Poshtë manit” u laurua nga akademia e Athinës dhe e promovoi **Katinën si një nga tregimtarët më të mirë të Greqisë së asaj periudhe.**

Libri u përshendet si një ngjarje e një rëndësie të veçantë, si një kujtesë shpresëdhënëse se egziston rrugëdalje nga hija përçmuese e së kaluarës që kishte pushtuar botën e kërkimeve letrare të kohës.

“Kjo përmbledhje tregimesh të zonjës Katina Papa... është plotësisht i një fryme më të lartë, predispozicioni e hiri poetik,

në një gjuhë të përkryer popullore...” u tha në ditën e dekorimit në asamblenë e Akademisë së Athinës.

Vetë ajo do të kujtojë: *“... Janë kujtime fëmijërie nga atdheu im i veçantë. Kur isha 8 vjeç, prindërit e mi, të cilët ishin vendosur në Korfuz, më dërguan të kaloj pushimet e një vere në Epir. Kalova verën dhe erdhi dimri, por unë nuk desha të largohësja nga fshati i vogël me natyrën e tij të egër, me malet e larta, lumenjtë e tij, grykat e thella si shpirtrat e njerëzve dhe sidomos nga gjyshja e ëmbël dhe të shumëditur... Çfarë pash dhe përjetova atë vit të pashlyeshëm të jetës sime, një dimër dhe dy vera do t'i dëgjonin në këtë tregim, parë me sytë e Marinës së vogël që janë vetë sytë e mi...”*

Tregimi, ashtu si gjithë letërsia e K. Papas, është një mrekuilli. Situata, personazhe, problematikë e mprehtë shoqërore, njerëz mbartës të saj, vajza të reja që dashurojnë por nuk e gëzojnë dashurinë, ose që rriten para kohe, të rinj që humbasin rrugëve të kurbetit, plaka të ditura, doke zakone, një botë e tërë në vetëm disa faqe. Gjithëçka është e thjeshtë dhe mahnitëse.

Titulli *“Nën hijen e manit”* dhe përshkrimet lirike, tipizimi i personazhëve dhe veprimet e tyre me një sinqeritet që i shkon përshat natyrës së bukur dhe të egër, të krijojnë idenë se kemi të bëjmë me një histori lirike fshati, por që nuk të kujton tregimet etike të letërsisë greke të fundit të shekullit XIX.

Nëpërmjet rrëfimit të saj, të rritjes së intensitetit lirik në tregim, lexuesi nxitet të mësojë se çfarë do të ndodhë nën hijen e manit. Për të arritur këtë përdorë asimetrinë në hapësirën e rrëfimit. Koha e rrëfimit pas momentit të martesës së shoqes së protagonistes në raport me kohën e deri në këtë moment është i pakët. Matet me disa faqe. Rrëfimi merr trajtën e një kronike. Fjalët përshkruese pakësohen edhe më. Më këtë mënyrë ajo lë lexuesin të prekë *“indel”* më të thella të dramës shpirtërore që shtrihet tutje dy protagonisteve të vogla. Ose e arrin këtë duke lënë të veprojnë tek lexuesi kontrastet me pjesën e parë dhe ballafaqimi i njerëzve me vdekjen e pritshme shkaktuar nga sëmundja ngjithëse pas martesës. Të gjitha këto krijojnë relieve të pashlyeshme ndjenjash, karakteresh, të prekshme vetëm me forcën e shpirtit.

Shoqja e Marinës do të vdesë. Do të vdesë nën man, jo në hijen e manit, por nën shiun e rrëmbyeshëm të vjeshtës, e veshur me një rrobë të bardhë. Marina, e vetmja që nuk kishte frikë nga sëmundja e saj, provonte me kot të hidhte gurin në anën tjetër të bregut të një honi, që, sipas traditës, nëse realizohej, të

plotësohej dëshira. Marinës i ishin gjakosur duart nga përpjekja ...që shoqja e saj të jetonte.

Të njëjtën rrugë do të ndjek Katina Papa dhe në krijimet e veta letrare që do të pasojnë, në prozë, poezi e dramë dhe po me këtë dimension do të jetë jehona për to, brenda dhe jashtë Greqisë.

Aftësia përsa i përket gjetjeve origjinale dallon Katina Papan edhe në letërsinë e saj me temën nga jeta në shkollë, në qytet. Konstatohet dukshëm edhe tek përmbledhjet me tregime si "*Poshtë manit*" dhe ato që e pasojnë "*Nëse ndryshonin të gjitha*" dhe "*Në një gjimnaz femrash*".

Në përgjithësi në tregimet me këtë tematikë haset kundërshtimi i shkrimtarës ndaj konvecionit shoqëror, ndaj shëmtisë së natyrës së shkatërruar, klisheve. Haset sarkazma dashamirëse e saj e mbi të gjitha përkushtimi i saj fanatik, vëçanërisht, në shfaqjen me komplekse të bukurisë që është arti. Dhe në këtë kuadër tema kryesore për shkrimtarën mbetet njeriu. Atje ajo hedh dritën e aftësisë së saj psikopërshkruese me kaq densitet, saqë, mbeten disi në hije problemet shoqërore apo ekzistenciale të njeriut.

Poezia

Figura letrare e Katina Papës, plotësohet vëçanërisht me funksionin e fundit shpirtëror, atë të oazit të poezisë. Nuk duhet harruar këtu se proza e Katinës përbën parathënien më të mirë të artit të saj poetik. Vëllimi i vogël i saj poetik që u botua pas vdekjes së Katinës nga motra e saj piktores, përmban 26 poezi dhe dy përshtatje në greqishtën e re nga poezia e Saphos dhe e Alqeut. Në to zbulohet një energji dhe ndjenjë e pastër e burimore poetike. Konfirmohet një ndërgjegje e formuar letrare që veshtirë mund të marrë frymë nga vasaliteti i kohrave.

Jehona ndërkombëtare e veprës së Katina Papas.

Vëllimi i parë me tregime i Katina Papas "*Poshtë manit*" por edhe ato që pasuan, patën një jehonë vlerësuese të madhe. Botohet nga shtepi botuese në Angli, Zvicër, Gjermani, Hollandë.

Me këtë rast u shkruajtën kritika entusiaste.

Gazeta *Volks Recht* (5.5.1959) e Ziriut shkruante: «... *Katina Papa ka aftësinë të na paraqes personazhë të gjallë, me një menyrë të ngrohtë njerëzore, të ndritshëm dhe me ndjenjë poetike të papërshkruar. Novela qëndron denjësisht përkrah veprave të tregimtarëve të mëdhenj anglezë.*»

Gazeta «Arbectezeitung» (16.5.1959), « *Katina Papa me përshkrimin e të rreptë dhe stilin e saj të thjeshtë, shmang çdo fjalë të të tepërt. Me pak fjalë përshkruan ngjarjet më tronditëse psikike, ose i lë ato të nënkuptohen. Në rrëfimin e saj arrin në thellësi të tilla që do të ishte e kot ta kërkoje në vepra kaq të shkurtëra proze*”

Gazeta «Volksrecht» po me 1959 shkruante se “*në këto tregime Katina Papa tregon se ka një njohje mjeshtërore në artin e tregimit*”

Me 1965 Komisioni e veçantë letrar i shtëpisë botuese Hollandeze “Ferelnd – bibliotek Feraindyoung” zgjodhi për dhuratë për Krishtlindje për 20 mijë abonentët e saj, novelën “*Posht manit*”.

Tasos Vidhuris (Τάσος Βιδούρης) (1888-1967). U lind në Dhrovjan të Delvinës dhe vdiq në Patra ku punoi si pedagog në liceun Arsakeio të Patras. Studioi dhe njohu letërsinë franceze dhe u bë një përkthyes i denjë i saj. Për shumë kohë shërbeu si mësues i kulturës greke në shkollë të ndryshme të Azisë së Vogël. Këtu bashkëpunoi me shumë gazeta dhe revista në gjuhën amtare të Kostandinopojës. Njëkohësisht shkroi tregimet e tij të para që përbëjnë një pasqyrë të gjallë të dramës së shpërnguljës së dhunshme dhe gjenocidit të ushtruar aty mbi popullsinë helene, në dhjetëvjeçarën e parë të shekullit XX.

Pas vendosjes familjarisht në Patra do të vazhdojë të ketë bashkëpunim me revista dhe gazeta panhelene. Botoi në Patra revistën e tij me karakter filologjik dhe vazhdoi të shkruajë letërsi dhe kritikë letrare. Njëkohësisht, përktheu në gjuhën greke letërsi franceze.

Vepra e tij letrare është shkruar në poezi, në prozë e dramë. Poezitë i përmbloodhi nën titullin e përgjithshëm “*Ηλύσια*” (“Ilisia”) dhe prozën nën titullin “*Διηγήματα*” (“Tregime”). Duke u nisur nga tematika tregimet e tij kanë për objekt fatet e popullsisë helene në Azinë e Vogël dhe në Epirin e Veriut.

Nga pikëpamja e metodës krijuese i takon brezit të tregimtarëve moralizues. Përbën rastin pothuaj të vetëm që poezia e tij u mbështet te tradita popullore. Atij i takon edhe një dramë me një akt, titulluar “*Jeniçeri*” «*Ο Γενίσαρος*»⁷⁰.

⁷⁰ E gjithë vëpra e Vidhurit, letrare dhe filologjike, e shpërndarë në gazeta dhe periodikë të kohës, Janinë, Patra, Athinë, Kretë, Hio, Kostandinopojë e gjetkë, është grumbulluar nga fontacioni Elikranon dhe është në proces botimi në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, në Universitetin e Gjrokastërës.

Mihalis Papadhopulos - Botis (Μηχάλης Παπαδόπουλος – Μπότης), nga Bularati i Dropullit (1860 –1937). Përfundoi akademinë pedagogjike Zografeia të Qestoratit dhe prej 1881-1929 shërbeu si mësues në shkolla të Dropullit, si në Bularat, Bodrihtë, Sotirë, Klishari, Jergucat, Koshovicë, në atë të Gjirokastrës, të Kakodhiqit, të Qiparos, Dhrovjanit, Muzinës, etj. Shërbeu si sekretar në Mitropolinë Gjirokastrës.

Paralelisht ai shkruan letërsi. Mund të konsiderohet si një dramaturg shëtites, se kudo që shërbente si mësues, teatrin e kishte si pjesë të veprimtarisë edukative e didaktike. Shkruante sipas rastit vepra dramatike të cilat i vinte në skenë me nxënësit dhe me banorët e fshatrave.

Poezitë u botuan në dy vëllime me të njëjtin titull «*Μερόπη*» (“Meropi”) botuar në Konstantinopojë. Poezitë e tij i bënë jehonë aktualitetit të kohës. I botonte në shtypin periodik të kohës dhe kishin shumë jehonë.

Ndër veprat teatrale përmenden disa komedi të humbura si «*Το πουγκί του Φιλάργγυρου*», (“Qeska e kopracit”), «*Ο ψευτο-γιατρός*» (“Mjeku i rremë”), «*Ο κομιτατζής*» (“Komitaxhiu”).

Eshtë nga të paktët shkrimtarë të kësaj periudhe që jetoi, punoi dhe krijoi gjersa vdiq në vendlindjen e tij.

Athanasios Oikonomidhis (Αθανάσιος Οικονομίδης) (1843-1903). Konsiderohet një ndër më të shquarit midis personaliteteve greke të periudhës që jetoi e veproi. Pinjoll i familjës së shquar të lkonomidhëve nga Sopiku i Pogonit, lerë e rritur në Poliçan. Një intelektual i formuar me gjykim të qëndrueshëm, koncepte të shëndosha dhe kujtesë të jashtëzakonshme.

Intelekti dhe dashuria për letrat u shfaq që në rini. Studjoi në Shkollën e Madhe të Kombit në Konstandinopojë. Drejtoi akademinë pedagogjike Zografeia në Qestorat të Gjirokastrës dhe më pas akademinë e Zapës në Labovë. Shërbeu si kaimekan në Himarë dhe më vonë anëtar i gjykatës së Gjirokastrës. Më pas u tërhoq në Poliçan për t’ju kushtuar letërsisë, por edhe studimeve dhe esseve filozofike, si edhe studimeve dhe përmbledhjeve mbi traditën popullore.

Shkroi në vargje dramën «*Οι δύο οι φίλοι*» (“Dy miqtë”) dhe dramën tragjikomike «*Αρκευθίδες*» (“Arkefthides” – Dëllënjat) ngjarrjet e së cilës i vendos në Epir dramën në vargje me pesë akte me titull «*Μιχαήλ Άγγελος Κομνηνός*» (“Mihail Angjellos Komninos”). Vëllimin e parë në prozë, qe kishte përgatitur, me dhjetë tregime e

titulloi «*Ηπειρωτικές εικόνες*» (Nuk u botua. Disa tregime nga ky vëllim u botuan në revistën e ilustruar «*Εικονογραφημένο Ηπειρωτικό Ημερολόγιο*» - "Ditari i ilustruar epirotas" të M. Oikonomidhit 1911, 1914 dhe 1938), ("Imazhe epirotase" ose "Kujtimet e moshës feminare"). Tregime të tjera të njohura të tij janë: «*Η καστανιά της νύφης*» ("Gështenja e nusës"), «*Ο Βρικόλακας*», ("Vrikollaku") etj.

Shkroi një monografi historike kushtuar Pogonianisë së viteve 1780-1840, si edhe studime të tjera folklorike, një fjalor të dialektit të Epirit etj. Atij i përkasin dhe dy studime të mirëfillta filozofike. Njëri i kushtohet trashëgimisë nga krishtërimi të kulturës së lashtë greke dhe tjetri edukimit të vajzave të kohës për integrimin e tyre në shoqëri nga pozita të emancipuar.

Të gjitha veprat e tij mbeten të pabotuara sa ai ishte gjallë.

Gjithashtu, kur shërbënte në Labovë shkruante rregullisht korespondenca dhe artikuj në gazetat e Konstandinopojës «*Μεταρρύθμισις*» ("Metarithmisis" - Reforma) dhe «*Νέα επτάλοφος*» ("Nea eptallofos).

Miltiadhīs Oikonomidhis (Μιλτιάδης Οικονομίδης), (1883-1964), i biri. Ndërsa i ati u dallua si artikullshkrues, i biri, më 1911 përgatiti në Poliçan të Gjirokastrës dhe botoi në Konstandinopojë revistën e ilustruar «*Εικονογραφημένο Ηπειρωτικό Ημερολόγιο*» ("Ditari i ilustruar epirotas") me 254 faqe dhe më 1914 në Athinë numrin e dytë me 354 faqe. Me 1938 botoi një revistë të re me titull «*Ηπειρωτικά*» ("Ipirotika") me 385 faqe. Në këtë revistë të re përfshiu krijimtari letrare, studime mbi traditën kulturore, kritikë etj. M. Oikonomidhis do ta vazhdojë punën studimore të të atit, por do të lërë edhe një trashëgimi të pasur letrare. Më 1945 botoi në Selanik vëllimin me tregime «*Άνθρωποι από τη Βόρειο Ήπειρο*» ("Njerëz nga Epiri i Veriut"), me 13 tregime dhe pak më vonë vetë ai njoftoi se kishte gati për botim dy vëllime me tregime me tituj: «*Ιστορίες από την Ήπειρο μου*» ("Histori nga Epiri im) dhe «*Αυτά που ομολογώ γινήκανε στην Ήπειρο*» ("Këto që po ju tregoj kanë ndodhur në Epir tim").

Pjesa më e rëndësishme e veprës së tij u mblodh dhe u botua në katër vëllime nga shtëpia botuese dhe fondacioni Elikranon, Athinë 2010. Nuk u përfshinë këtu revistat, të cilat u ribotuan me vete. Elikranon botoi gjithashtu edhe ditarin e vitit 1911.

Εvangjellos Fotiadhis (Ευάγγελος Φωτιάδης) (1909-1973). Me origjinë nga Gjirokastra. Shkollën e mesme e mbaroi në Athinë. Këtu punoi fillimisht si nëpunës dhe në vijim si drejtues i Bibliotekës

Kombëtare të Greqisë. Paralelisht ndoqi studimet për filozofi në Universitetin e Athinës dhe më pas shërbeu si pedagog i Historisë Politike në shumë shkolla ushtarake.

Veprimtaria që e bën më të njohur është kontributi në kërkimin shkencor. Studimi i parë lidhet me Thanas Vajën dhe ka titull, "Mendime rreth studimit të Thanas Vajës" («*Συμβολή εις την περί του Θανάση Βάγια έρευνα*»). Vepra të tjera të tij janë: "Greqisht" («*Ελληνικά*») 1950, "Uniteti i heleneve" («*Η Ενότητας των Ελλήνων*») 1950, "Hyrje në historinë e Greqisë" («*Εισαγωγή εις την Ελληνική Ιστορία*») 1949-1951, "Tradita e dijes si faktor e 1821" («*Η Λογία παράδοσις ως παράγων του Εικοσιένα*») 1953, "Mësimet hyrëse në historinë politike të helenizmit më të ri dhe modern" («*Εισαγωγικά μαθήματα εις την πολιτική Ιστορίαν του νεωτέρου και συγχρόνου ελληνισμού*») 1958, "Mësimet udhëheqjeje" («*Μαθήματα Ηγεσίας*») 1955 etj.

Evangjellos Fotiadhis ishte bashkëpunëtor i rregullt të grupit hartues të "Enciklopedisë së Madhe Greke" («*Μεγάλης Ελληνικής Εγκυκλοπέδιας*»), të "Fjalorit Enciklopedik Eleftherudhaki" («*Εγκυκλοπαιδικού Λεξικού Ελευθερουδάκη*»), të "Fjalorit Enciklopedik Proias" («*Εγκυκλοπαιδικού Λεξικού Πρωίας*»), të "Fjalorit enciklopedik Iliu" («*Εγκυκλοπαιδικού Λεξικού Ηλίου*»), të "Historisë Botërore të Petros Dhimitrakou" («*Παγκόσμιας Γεωγραφίας του Πέτρου Δημητράκου*»), të "Gjeografisë ushtarake të Greqisë" («*Στρατιωτικής Ιστορίας της Ελλάδας*»).

Aleksandros Mamopoulos (Αλέξανδρος Μαρμόπουλος) (1914-1984). U lind në Stegopul të Lunxherisë Gjirokastër. Përfundoi gjimnazin në Pogoniani dhe në vijim degën juridike në universitetin e Athinës. Ishte pjesëtar i shumë shoqatave dhe organizmave të tjera që mirrshin me kulturën tradicionale greke, arsimin traditat, historinë. Me 1974 u zgjodh kryetar i Fondacionit Epirotas të Athinës. Në letërsi u prezantua me tregime të karakterit moralizues që i botoi në shtypin letrar të Athinës.

Disa nga veprat e tij janë: "Epiri: Folkloristikë, doke e etnografi" («*Ήπειρος: Λαογραφικά-Ηθογραφικά- Εθνογραφικά*») me dy vëllime (1961, 1964), "Miti i kontributit shqiptar në pavarësinë e Greqisë" («*Ο μύθος της Αλβανικής συμβολής εις την ανεξαρτησίαν της Ελλάδος*») 1963, "Hristos Hristovasilis, tregimtari, folkloristi, patrioti" («*Χρ. Χρηστοβασίλης, ο διηγηματογράφος, ο λαογράφος, ο πατριώτης*») 1965, "Kurbeti dhe kënga popullore" («*Η ξενιτιά και το δημοτικό τραγούδι*») 1966, "Angjeliqi Hatzimihali dhe arti popullor epirotas" («*Αγγελική Χατζημιχάλη και η Ηπειρωτική Λαϊκή Τέχνη*»)

1967, "Qeraxhintë" («Αγωγιάτες και Κιρατζήδες»), "Kryeplesesia, institucion vetëvendosjeje përgjatë pushtimit Otoman" («Δημογεροντία, θεσμός αυτοδιοικήσεως επί Τουρκοκρατίας»), "Bamirësia epirotase dhe rilindja e re greke" («Ηπειρωτική Ευεργεσία και νέο-ελληνική αναγέννηση») si edhe shumë studime të tjera për Gjergj Kastriotin, për Apostollon Arsaqin, për profesionet artizanale, për arkitekturën popullore etj.

Studimet e tij folklorike dhe të traditës popullore përbëjnë paraqitjen më të gjallë të kulturës popullore epirotase

Nga Mamopullos u trashëgua edhe një vëllim me tregime historike titulluar "Të vendit dhe të kohës time" («Του τόπου μου και του καιρού μου») 1968.

Aleksandros Mamopullos përbën një nga figurat më të spikatura të fushës së letrave të kohës së tij. Mamopullos për tridhjetë vjet ka qënë drejtues dhe botues i revistës së njohur «Ηπειρωτική Εταιρία» ("Ipirotiki Eteria").

Janis Lilis 1916 –1965. U lind në Dervican të Gjirokastrës dhe vdiq në Melburn të Australisë. Jani Lili dhe vepra e tij janë të natyrës së letrave, treguese të modelit të bashkëjetesës dhe të kontributit për të, të kompromisit dhe me errësirën për t'i shërbyer dritës. Rrjedhin nga veçoria e tij e të qenit me origjinë greke. Jetoj vetëm 47 vjet, pak për veprën që la pas.

Fati e pajisi me dhunti të papërsëritshme artistike e letrare. Talentit i dha si dhuratë të çmuar një kulturë të gjerë, të cilën e ktheu në sistem referimi të sjelljes dhe të veprimtarisë së tij civile për të kapërcyer provincializmin, skepticizmin nacionalist dhe urrejtjen pa kufi të kohës së luftës. E vuri në shërbim të letrave për të shkruar një letërsi që e vë në avangardën letrare të kohës. Aq sa pa frikë mund të themi se letërsia e tij jo vetëm që i rezistoi kohës, por koha e letrave duket se nuk mund ta parakalojë atë. Vepra e Lilit na tregon se sa më shumë koha kalon, aq më mirë e kuptojmë rëndësinë dhe vlerat letrare të tij. Shkroi në kohështrirjen para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Jani Lili për asnjë moment nuk e pa vetën shpëtimtar të botës apo të njeriut. Ambicia e tij e vetme, e thjeshtë por e sigurtë, ishte shprehja e shqetësimit të tij të thellë për gjendjen e njerëzimit. Dhe e bënte këtë me shumë mënyra. Me veprime konkrete të njeriut që s'pajtohet me këtë realitet, me udhëtime që i siguronin shpëtimin e përkohshëm dhe thellimin e dhimbjes dhe të protestës njëkohësisht, duke u dhënë pas letërsisë.

Vëpra e tij, për 65 vjet qëndroi në errësirën e baltës që i ho-
dhi koha dhe bashkëkohësit. Arsyeja e vërtetë ishte distanca e
pa shkurtuar që letërsia, arti dhe pretendimet e tij artistike, ruanin
krahasuar me prodhimin artistik të mohuesve të tij. Arsyeja e de-
klaruar lidhet me kompromisin e Lilit “për t’u pajtuar” me meka-
nizmin në shërbim të asaj ideologjie të cilën, në thelb, e dënonte
dhe e urrente deri në asgjësim.

Janis Lilis, mbetet një përfaqësues i denjë i letërsisë greke i
brezit të viteve tridhjetë, periudhë që, sipas vlerësimeve të stu-
diuesve grekë e atyre të huaj, përbën një epokë që ndryshoi gji-
thçka. “Një jylësi vezulluese” e karakterizon atë Rodrig Podrik
Biton-i. *Bëhet fjalë për një letërsi që, sipas studiuesit italian Mario
Vitti, brezat që pasuan e vunë në dyshim por nuk arritën të për-
mbysnin asgjë nga arritjet e saj.* Dhe kjo është e vërtetë po të ke-
mi parasysh se në të përfshihen dy nobelistë grekë, Seferis e
Elitis dhe një plejadë emrash të shquar të letërsisë e të artit grek.

I brumosur në përvojën e klimës së luftës mbeti gjatë gjithë
jetës një shpirt poetik dhe filozofik i shqetësuar për probleme fo-
ndamentale shoqërore, politike e estetike të kohës, për hapësi-
rën dhe kohën, për traditën dhe të ardhmen, për natyrën dhe ma-
rëdhëniet e njeriut me të, si më substancialet. Arrin deri atje sa
t’u kundërvihet mekanizmave të shoqërisë, të cilat, sipas tij, vetë
njeriu i ndërtoi për të skllavëruar vetveten.

Plotësia njerëzore, sipas Lilit, arrihet në respektimin e ligjësi-
ve të natyrës. Pikërisht te kjo natyrë ai kërkon “ashpërsinë e vetë
shpirtit ballkanas”, “predispozicionin nostalgjik dhe dehjen lirike
të botës ballkanase”, “ndryshueshmërinë e çuditshme e shpirtit
të popujve të tij”, për të arritur te konkluzioni se “pasionet këtu
nuk i zbut asnjë civilizim, asnjë kulturë nuk i qetëson”.

Shpreh hapur frikën se shoqëria e lumturisë së imponuar do
të tregohej më e rrezikshme, me tinëzare se barbaritë e shkuara
dhe luftërat. Besoi te komunizmi dhe te internacionalizmi i predi-
kuar prej tij, se e përjetonte atë si materie shoqërore të filozofisë
së Krishterimit. Por aftësia e mendimtarit, që i siguronte rolin e
lajmëtarit për perspektivën e kohëve, e bindi shpejt se rreziku
ishte i pashmangshëm. “Ide të reja lërojnë thellë horizontin e vet
të mjegullt” paracakton të ardhmen komuniste të popullit shqiptar
Jani Lili.

Në këtë këndvështrim Jani Lilit nuk i detyrohemi thjesht he-
qjen e baltës së rëndë të harresës dhe të denigrimit, por edhe
një nderim të veçantë dhe përkushtim për t’u dëgjuar një zë ndje-
shmërie humane, një penë që skanon estetikisht realitetin e ko-

hës së vet, të cilit, me siguri, profesionalizëm dhe aftësi profetike i jep vlera estetike të mbikohëshme.

Jetëshkrimi

“Kur Jani Lili arriti në Australi, në vitin 1948, me ftesë të të vëllait, Spiros, ishte një shkrimtar i sprovuar, njeri me kulturë tepër të gjerë dhe gazetar i njohur”. Kështu shkruan Petros Petranis në librin e tij bibliografik *“Epirotasit e Australisë”*, botuar më 2003, kushtuar personaliteteve me të shquara greke në Australi.

U lind në fshatin Derviçan të Dropullit më 1918.

Mbaroi shkollën fillore të fshatit dhe vazhdoi shkollën fetare për mësuesi në Vella të Pogonit – Greqi deri më 1934.

Që nga viti 1934 deri më 1936 studioi në Akademinë Pedagogjike “Zosimea” të Janinës. Paralelisht me studimet shkruante në gazeta të ndryshme ditore. Që në moshë të re bashkëpunoi me gazetën *“Εστία»* (Vatra) dhe revistën *“Letra të reja greke”*. Përveç greqishtes fliste shqipen dhe italishten.

Pas përfundimit të studimeve në “Zosimea” u kthye në krahinën e tij ku vazhdoi të shkruante në gazeta të ndryshme.

Më 1938 u regjistrua në Universitetin e Romës, në Fakultetin e Filozofisë e të Letërsisë. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore u detyrua të ndërpresë studimet dhe të kthehet në Shqipëri. Jeton dhe njuh veriun e saj. Pa e kuptuar përfundon në shkollën e oficerëve në Tiranë. Me këtë staturë pret me armë në dorë ardhjen e fashizmit në Durrës.

Pason një periudhë e ngjeshur në veprimtarinë publicistike e letrare në gjuhën shqipe. Boton shkrime dhe artikuj që i përkasin letërsisë, kulturës, estetikës dhe artit. Emri i tij rreshtohet denjësisht krahas emrave më të spikatur të kohës si Vangjel Koça, Gjergj Fishta, Haki Stërmilli, Ernest Koliqi, Filip Fishta, Aleksandër Xhuvani, M. S. Frashëri, Pashko Gjeçi, Migjeni etj.

Shkruan në gazetatat më në zë të kohës si “Tomori”, “Shkëndija”, “Drita” etj. Angazhimi i Lilit me letrat shqipe ishte në këtë kohë i gjithanshëm. Në shkrimet dhe artikujt e tij (studimorë, kritikë, estetikë e teoriko-letrarë) bën përpjekje jo thjesht për të trajtuar probleme të ndryshme të karakterit teoriko-letrar e estetik, por edhe për t’i krijuar artit e letërsisë shqiptare terminologjinë, konceptet dhe të gjithë bazën e teorisë së letërsisë së munguar. Kërkon të orientojë letërsinë e kohës në frymën e arritjeve letrare më të spikatura bashkëkohore, e përshtatur kjo në rrethanat e Shqipërisë. Bën përpjekje për të njohur lexuesin shqiptar dhe

sidomos krijuesit me figura të shquara të letërsisë e të artit botëror të kohës.

Lëvron me sukses lloje të ndryshme të publicistikës ku spikat artikulli teorik, ai problemor e polemik dhe intervista. Gazeta "Tomori" e kishte të dërguarin e saj të preferuar në Romë për të marrë intervista nga personalitete të artit italian të kohës.

Nuk mjaftohet kurrësi në aspektin e trajtimit teorik të problemeve letrare dhe artistike. Paralelisht shkruan në shtypin shqiptar letërsi, (skica dhe tregime të vogla), që në fakt përbëjnë mi-shërim të bindjeve të veta teoriko-letrare e ideoestetike.

Më 1944 ai largohet nga Tirana dhe rikthehet në Dropull. Pas një qëndrimi të shkurtër atje vendoset në Athinë ku ushtron mirëfilli gazetarinë.

Më 1945 botoi në Korfuz librin e tij të parë, vëllimin poetik «Πνιγμένοι Καύμοί» (Brenga të mbytura). Po më 1945 botoi në Athinë sprovën esseistike «Η Λιούντζη του Αργυροκάστρου, Ιστορία-Λαογραφία» ("Lunxhëria e Gjirokastrës, histori-folklor").

Më 1946 botoi në Athinë librin «Μεθυσμένα Βαλκάνια» (Ballkan i dehur) dhe më 1947 pasuan dy libra të tjerë të tij, «Περιγραφικές εντυπώσεις» (Përshtypje përshkruese) dhe «Βορειοηπειρωτικές σελίδες» (Faqe nga Epiri i Veriut).

Më 1948 vendoset në Australi. Për një kohë të shkurtër punoi në shoqërinë e automobilave "General Motors". Më pas do t'i rikthehet profesionit të tij të preferuar, gazetarisë. Filloi si drejtues i redaksisë në revistën «Οικογένεια» (Familja) që e botonte bashkatdhetari i tij Zoi Oikonomu dhe bashkëpunonte me gazetën «Αυστραλοέλλην» (Greku i Australisë). Më vonë e zgjeroi gamën e bashkëpunimit edhe me gazetën e tjera greke të Australisë, «Έθνος» (Kombi), «Πανελλήνιος Κήρυκας» (Lajmëtari panhelen) dhe «Πυρσός» (Pishtari).

Nga Australia vazhdoi bashkëpunimin me periodikun e përmuajshëm të Janinës «Ηπειρωτική εστία» (Vatra Epirotase), ku botoi në disa vijime tregimin e njohur «Το καλαμπόκι του αγά» (Misri i agait). Bashkëpunoi gjithashtu me revistën Londineze «Κρίκος» (Hallka).

Për një periudhë kohe botoi gazetën e tij «Σήμερα» (Sot). Përveç gazetarisë u mor shumë me letërsinë kryesisht atë rrëfyese. Gjithashtu, përktheu letërsi nga gjuha shqipe në atë greke dhe anasjelltas

Mbeten të pabotuara veprat e tij: «SS Partizanka – Ξεριζωμένα γενιά» (SS Partizanka- Brezi i shkullur), «Περιγραφικές εντυπώσεις από την Αυστραλία, η άλλη όχθη της γης» (Përshtypje

përshkruese nga Australia, bregu tjetër i tokës), vëllimi me tregime «Οι σκλάβοι του κάμπου» (Sklllevërit e fushës), kushtuar jetës së vështirë të bashkatdhetarëve të tij në Shqipëri, si edhe me dhjetëra poezi, tregime dhe skica.

Vdiq në Melburn në qershor të vitit 1965 në moshën 47 –vjeçare.

Konsiderohet një nga personalitetet më të spikatura të komunitetit grek në Australi ku herë pas here organizohen veprimtari në kujtim të veprës dhe të jetës së tij.

Rendësia e veçantë e librit “Ballkani i Dehur”

Vepra që e bën Lilin më të njohur është ai me tregime udhëtimi nëpër Ballkan, titulluar “Ballkani i dehur”. U shkrua në gjuhën greke, me 1946 me titull «Μεθυσμένα Βαλκανικά». U përkthye në shqip, me 2011. Një letërsi e llojit të veçantë. Është njëkohësisht roman autobiografik, reportazh letrar e filozofik, një manifest social-politik.

Mënyra e kompozimit të rrëfimit e bën Lilin të qëndrojë në krah të Kazantzakit të madhë. Letërsia që shpalos dhe parimet letrare e ideoestetike të cilave u referohet, e vendosin në bashkësinë e korifenjve të letërsisë greke të viteve '30.

Rrëfyeni në vetë të parë i ngjarjeve në udhëtim, herë konfondohet me autorin dhe herë me bindjet e aspiratat e tij, herë me përvojën e jetuar e herë me përjetimet e të tjerëve. Përbën në fakt një skanim deri në indin e fundit të psikosintezës shqiptare kolektive dhe individuale të kohës. I jep rezultat përpjekja për të depërtuar me objektivin e skanerit të tij social filozofik në diakroninë shqiptare në fenomene që shënjojnë mbikohësisht shoqërinë shqiptare.

Jo thjesht për të ndjekur rrugën e krijimit, të kompozimit dhe të formimit të kësaj psiko-sinteze dhe konstitucioni shpirtëror, si edhe shkaqet që e përcaktuan atë, por për t'i dhënë të drejtë vetes për analiza të vlefshme dhe për ditët tona. Në të mishërohet një letërsi ku vlerat artistike gatuhet në estetikën e shpirtit lirik të autorit, ku qëmtimet dhe vëzhgimet gazetareske përbëjnë lëndën e parë për reflektime në pasqyrat e kulturës së tij dhe të ndërgjegjes së tij. Gjithashtu ato ndihmojnë për të fiksuar e dhënë artistikisht dimensionin me të thellë të realitetit shqiptar dhe ballkanik.

Te “Ballkani i dehur” Jani Lili ka marrë përsipër të tregojë e të meditojë për gadishullin e përbashkët, të zbulojë shpirtin ballkanik, vështruar në sfondin historik, por të lidhur dhe me peiza-

zhin natyror. Ai e quan Ballkanin trevë e kontrasteve të mëdha, vend *“që thith gjakun e bijve të vet për idealin e lirisë, tokë vullkan i pasioneve dhe ndjenjave të fuqishme”, “me popuj që u vlon përbrenda urretjtja, armiqësia e gatuar me kalorësinë, fisnikëria me barbarinë.”*

Dhe rrëfimin e tij për Ballkanin e dehur autori e nis pikërisht nga Shqipëria. Është një rastësi fatlume për të që, duke u vënë në rolin e shoqëruesit të kolonelit bjellogardist K. Ullugait, oficer zogist, atij i jepet mundësia të shkelë për afro 6 muaj nëpër viset e Shqipërisë së Veriut, duke filluar nga Shkodra, kryeqendra e saj, e deri në Pukë e në Kukës. Në këtë rrugëtim të gjatë e të vështirë ai do të njihet me realitetin shqiptar, të cilin do ta sodisë dhe vëzhgojë jo me syrin e një turisti, po nga pozita e një intelektualit me horizont, që përpiqet të depërtojë përtej pamjes së jashtme nga pozita sociale të përparuara. Në vështrimin e tij Shkodra paraqitet një qytet piktoresk, me një botë të veçantë krejt origjinale, plot kontraste e mistere. Duke u endur nëpër rrugët e saj, ai heton e dallon vijën ndarëse mes katolikëve dhe myslimanëve, bukurinë evropiane të të parëve dhe kënaqësinë orientale të të dytëve.

Në Kukës ai përballet me jetën e patriarkale të malësorëve, me ligje të rrepta dhe etike puritane.

Udhëtimi shkon më tej, kur zbret në malësinë e Pukës dhe ndeshet pak a shumë me të njëjtin peizazh, me të njëjtin mjedis, po ata burra e ato gra, pothuaj po ajo psikologji e jetë zakonore, po ato ligje të rrepta të maleve dhe po ai fanatizëm. Pa prituri, ai bëhet dëshmitar i një prej këtyre zakoneve, gjakmarrjes. Ai ndjehet keq kur merr vesh që vrasësi është mësuesi, bashkëfshatari i tyre.

Udhëtimi, sa i gjatë e i lodhshëm, po aq mbresëlënës dhe mësimdhënës, mbyllet me kapitullin *“Tirana – kryeqytet – mbret”*. Kontakti me këtë qytet është zhgënjyes, i duket “një mikrobotë e sëmurë” krahasuar me malësinë e pastër dhe fisnike. Në sytë e tij Tirana është një fshat i madh, që ka marrë përsipër nxitimthi detyrat e rënda të kryeqytetit. Sipas autorit, *“këtu jeton mbreti me kopenë e vet mes varfërisë së popullit dhe Lanës së molepsur, që kalon jo larg Pallatit të tij dhe shkarkon plot degëzime tinëzare.”* Tabloja e Tiranës zgjerohet tek hedh dritë në jetën e përditshme të qytetarëve të saj, në peizazhin bardhezi të pazarit oriental dhe të lagjeve me *“kontraste brutale”*.

Libri i Jani Lilit merr vlera të një dëshmie historike në kapitullin kushtuar pushtimit fashist të Shqipërisë. Agresioni ndaj atdheut të tij të dytë e trondit dhe e revoltton. Një natyrë liridashëse

dhe humane si ai nuk mund të pajtohet me skllavërinë e popullit shqiptar. Në këto çaste dramatike e ndien veten pasardhës të heroit ballkanas, Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Vrapon në front dhe merr mitralozin kundër fashisteve që zbarkojnë në breg. Çaste këto madhore që autori nuk është në rolin e soditësit, por të pjesëmarrësit në betejë.

Fillon kështu arratisja drejt kufirit, për të mos iu dorëzuar armikut. I lodhur dhe i çorientuar arrin në Jugosllavi dhe pastaj hidhet në Greqi, ku përballet me mikpritjen dhe solidaritetin ballkanik. Në këtë situatë të vështirë vjen në Shqipëri, ku arrestohet që në kufi dhe burgoset. Edhe kur lirohet nga burgu, ai nuk çlirohet nga brenga e hidhur e pushtimit.

Më në fund, ai kthehet në vendlindje, në Dropullin e tij të dashur, pranë prindërve, i malluar dhe i dëshiruar për t'u çlodhur pas kalvarit që ka kaluar. Por ky është vetëm një interval i shkurtër qetësie iluzive, sepse shpejt ndodh gjëma tjetër: sulmi i pabesë mbi Greqinë që përballet me rezistencën heroike greke, e cila e gëzon atë dhe miqtë shqiptarë. Fashizmi është armiku i tyre i përbashkët. Dhe këtë ai e sheh dhe e ndien kudo ku shkon në këtë kohë nëpër Shqipëri e Greqi, Kosovë e Dalmaci

Libri "Ballkani i dehur" nuk është thjesht vepër dokumentare, por dhe vepër me vlera të çmuara letrare, që dëshmon për një autor të talentuar dhe me përvojë, të cilin e karakterizon sa aftësia prej vëzhguesi të hollë e të mpërthtë të jetës, aq dhe ndjeshmëria e lartë ndaj njeriut dhe botës së tij shpirtërore. Ai është njeri i kulturuar dhe me horizont, psikolog dhe i vërtetë në gjithçka që rrok e përshkruan. Inteligjent dhe realist, shpirt kritik dhe analist, ai depërton në thellësi të jetës, kap thelbin e fenomeneve, priret nga dialektika e proceseve njerëzore dhe shoqërore, vështron gjerë dhe larg, tregohet human dhe karakterizohet nga një filozofi optimiste dhe pozitive. Kështu shpjegohen antifashizmi dhe antimonarkizmi i tij, aspirata për një shoqëri të lirë e të drejtë, reminishencat e ideve socialiste.

Kumtimet e letrave në gjuhën shqipe

*"Kuptohet se kontributi i çmuar i Jani Lilit, thotë prof. Nasho Jorgaqi, i takon letërsisë dhe kulturës së minoritetit grek, por trashëgimia e tij ka të bëjë edhe me Shqipërinë, sepse një pjesë e saj është shkruar dhe në gjuhën shqipe. Nga kjo pikëpamje ai, ndoshta, është ura e parë lidhëse mes dy kulturave tona."*⁷¹

⁷¹ Jorgaqi N. 2012, tek Ballkani i dehur, Tiranë fq. 16.

Kategoria e dytë e krijimtarisë së tij së cilës i referohemi këtu përfshin disa nga seria e pafund e shkrimeve të tij në shtypin më në zë të kohës në Tiranë. Vepra e tij publicistike e artikull-shkruese në gazetat më të mëdha të periudhës së Luftës së Dytë Botërore, ka një qëllim të lartë. Ajo synon të krijojë bazat e teorisë së letërsisë shqiptare, të japë njohuri letrare, të bëjë analiza e kritika, t'i ofrojë dhe të sistemojë terminologjinë dhe vetë letërsinë shqiptare. Arti për të ishte *“këshilltar i pagabueshëm i jetës, prijësi shpirtëror, shtytësi drejt një lartësie jashtë materialiste”*.

Në mendimet e tij për letërsinë kërkon një komunikim me traditën dhe të vendosë një ekuilibër midis asaj dhe artit modern. Pretendon me bindje një marrëdhënie të barabartë në këmbimet letrare me Evropën. Por, nuk pranon imitimim e verbër të saj, nuk qetësohet me klasicizmin e vjetër. Përqafon, me siguri, frymën e re në kulturën botërore, duke propozuar një letërsi shqiptare, që mbart vulën e popullit të vet, që qëmton mbi realitetin shqiptar dhe djepin e traditës së vet letrare të kultivuar e popullore. I sjell realitetit letrar në Shqipëri personalitete të shquara letrare e artistike nga Greqia e Italia apo vende të tjera Evropiane, me këmbënguljen e vetme lartësimin cilësor të letërsisë shqiptare.

“Jani Lilin e gjejmë në shoqëri me emra të njohur të kulturës shqiptare si kritikun Vangjel Koça apo shkrimtarin Ernest Koliqi, të cilët, ndonëse qenë figura të hierarkisë fashiste, nuk arritën ta komprometonin atë politikisht. Asnjë shkrim i tij nuk është i infiltuar nga ideologjia e ditës, përkundrazi, ai tregohet i distancuar, madje, siç do ta vërejmë në veprën e tij “Ballkani i dehur”, autori qëndron në pozita antifashiste. Një qëndrim i tillë s’ka si të mos i bëjë nder emrit dhe kujtimit të shkrimtarit minoritar.”⁷²

Kategoria tjetër krijuese që është në funksion të së dytës, lidhet me skicat dhe tregimet e shkurtra letrare të botuara gjithashtu në shtypin e kohës në periudhën 1940-194, në Tiranë

Në koncizitetin e tyre ai tregon se letërsinë e njeh më mirë kur e shkruan se sa kur e vlerëson. Mbi fabula e subjekte të thjeshta të marra nga jeta e përditshme ai shpalos kulturën e tij të gjerë letrare, filozofike, shoqërore. E ndihmon, me sa duket, dhuntia e të qenit gazetar ku aftësia vëzhguese e detajeve përbëjnë materien për mishërimin në artin e tij letrar të kulturës së tij dhe të njohurive të veta filozofike.

⁷² Jorgaqi N. 2012, tek *Ballkani i dehur*, Tiranë fq. 17.

Arti i fjalës së tij është përherë në funksion të qëllimit më të lartë. Herë përshkruan, herë psikologjis, herë filozofon e herë ëndërron. Rrëfimi rrjedh me thjeshtësi në ngjarje dhe situata, të cilat, shpesh, edhe pse qendrojnë mbi detaje, na çojnë te thelbi i qëllimit të autorit. Karakteret e tij, herë të vërteta e herë plazmatike, nuk janë heronj, por dëshmitarë, nuk janë fajtorë, por viktime në kërkim të një rruge shpëtimtare. Ai i fton në rrëfimin e tij për t'i dhënë jetë, për të dramatizuar dhe për ta bërë më tërheqëse analizën e vet politiko-shoqërore.

Gjuha e Lilit është krijuese, e përshtatur me mjeshtëri në stilin e rrëfimit të tij karakteristik. Në përdorimin e saj është i dukshëm interesimi për të qëmtuar edhe fjalën e fundit.

Lili nuk është se ndërton sistemin e vet figurativ nëpërmjet gjuhës, por më shumë vë simbolikën gjuhësore në shërbim të parimeve të tij estetike e filozofike, sidomos përsa i përket raportëve të njeriut me natyrën, me traditën e tij kulturore, filozofike e shoqërore etj.

E gjithë vepra e tij i është nënshruar kohët e fundit procesit të botimit.

Agamemnon Ath. Kommatas. U lind më 1903 në Bularat të rrethit të Gjirokastrës. Në moshën 18-vjeçare emigroi në Shtetet e Bashkuara. Autor shumë poezive dhe i romanit historik me titull «*Χασάν Οδυσσέας ο Αργυροκαστριτης*» (“Hasan Odhisea Gjirokastriti”), i botuar më 1972 në Athinë. Nëpërmjet romanit të tij ai kërkon të tregojë, siç thotë edhe vetë në parathënien, “*afinitetin midis dy popujve fqinj, grek e shqiptar dhe të kontribuojë në mirëkuptimin dhe forcimin e marrëdhënieve midis tyre*”.

Taqis Mihalís Tsiakos. U lind në qytetin e Gjirokastrës me 1909 nga ku u largua me 1914 për t’u vendosur në Parga. Pas liceut në Kurfuz filloi studimet universitare në Athinë për farmacist. Studimet i ndërpreu për t’ju kushtuar letërsisë. Poezitë dhe tregimet e para i botoi në gazetatat dhe revistat letrare të Janinës. Botoi gjithashtu shënime udhëtimi dhe kritika letrare.

Tsiakos i përkasin vëllimet me poezi: «*Σβησμένοι αντίλαλοι*» (“Jehona të shuara”) 1936; «*Αμμουδιές και Ξέρες*» (“Rranishte dhe thatësira”) 1945; «*Πεταλίδες*» (“Petalidhe” = midhje të mëdha) 1949; «*Μεσημέρια*» (“Mesdite”) 1956; «*Περίπατοι και επιστροφές*» (“Shëtitje dhe prapakthime”) 1970. Me vëllimet e tij poetike Tsiakos zinte një vend nderi midis krijuesve tradicionalë të Greqisë së kohës.

Alkis Kastritis (1912-1989), (është emri letrar i **Jeorjio B. Papadhopoulos – Γεώργιος Παπαδόπουλος**). U lind në fshatin Selio të Dropullit të Sipërm. Mes vuajtjeve të një femije jetime nga babai, me 1938 u diplomua për shkencë filologjike nga universiteti i Athinës. Shërbeu si arsimtar në Korfuz dhe nga 1939 deri me 1975 shërbeu si mësues i filologjisë greke në një shkollë greke të Rumanisë. Me 1977 u kthye në Athinë.

Që në fëmijeri shkroi poezi në shtypin letrar të kohës. Ka botuar vëllimet poetike të mëposhtme: «*Θλιμμένα τραγούδια*» (“Këngë të dëshpëruara”) 1930 (Janinë)· «*Αύρες και θύελλες*» (“Fllade dhe stuhi”) Athinë 1936· «*Τραγούδια της σιωπής*» (“Këngë të heshtjës”) Athinë 1937· romanët për femijë «*Το παράξενο παιδί*» (“Femijë e çuditshme”) Bukuresht 1943 dhe (“Stuhia”), Athinë 1979. Në Bukuresht shkroi gjithashtu pjesë teatrale për femijë dhe të rinj, si edhe shumë tekste shkollore ndihmëse.

Mihalis Manos (Μιχάλης Μάνος) (1910-1973). U lind në Dervician dhe vdiq në New York. Filloi shkollën në fshatin e lindjes dhe vazhdoi studimet në Patra dhe Zosimea Skoli. Ishte nëpunës në institucionin bankar të Vasil Shahinit në Gjirokastër dhe bashkëpunëtor i tij në mbrojtjen e të drejtave arsimore të Minoritetit Etnik Grek (1933-35), që u bë shkak për internimin e tij në Lushnjë.

Me 1943 u vendos në Janinë ku me 1952 botoi revistën famshme «*Ηπειρωτική εστία*» (“Vatër epirotase”).

Shkroi shumë poezi dhe prozë, por edhe shumë artikuj studimorë, të cilat mbëten të shpërndara. Me 1955 kishte botuar në Janinë veprën «*Ηπειρωτική Ανθολογία*» (“Antologji Epirotase”) me poezi dhe tregime të autorëve epirotas. Po këtë vit emigroi në New York. Më 1959, themeloi në New York “Qendrën Kulturore Helene”. Për 6 vjet ishte drejtor i Hellenic Radio News. Më 1957 boton në SHBA, librin «*Νοεροί περίπατοι στην Ελλάδα*» (“Shëtitje imagjinare në Greqi”). Vepra të tjera të tij janë: “Çeshtja e arsimit dhe qëndrimi i 1934” «*Το Σχολικόν και η στάσις του 1934*», “Dashuria e Dranos” «*Η αγάπη του Ντράνος*», “Folklori I Dervicianit” («*Λαογραφικά Δερβισάνης*»), “Revolucioni i bardhë” («*Λευκή Επανάστασις*»), “Biografia e V. Shahinit” («*Βιογραφία Β. Σαχίνης*»), “Për lirinë 1915-1972” («*Για την Λευτεριά 1915-1972*»).

Vasilis Ev. Tsatis (Βασίλης Τσάτης) (1920 -1999). U lind në Sotirë të Dropullit të Sipërm. Në moshën 16 vjeçe emigroi në

Pirea që provoi punë të renda krahu. Paralelisht ndiqte edhe shkollën gjersa mori diplomën universitare për shkencë humane në Athinë.

Në letërsi debutoi me tregimin «*Τα κάλαντα του Λαζάρου*» (“Këngët e Llazarit”) 1957. Në vijim botoi shumë poezi dhe tregime në shtypin periodikë letrar të kohës. Më 1969 botoi vëllimin me tregime «*Πεζογραφήματα*» (“Rrëfime”) që u prit jashtëzakonisht shumë mirë nga publiku i lexuesve. Më 1973 botoi vëllimin e dytë me tregime me tiull, «*Σαν γιατροί*» (“Si mjekë”) dhe me 1979 «*Της Παναγιάς στου Μακρυαλέξη*» (“Shën Mërisë në Makrialeksi”).

Jeorjios Har. Gitzios (Γεώργιος Χαρ. Γκίτζιος) (1925-1993). U lind në Koshovicë dhe fëmijë 6 vjet u vendos në Athinë. Studioi në liceun muzikor të Athinës dhe përfundoi studimet larta në teori për vegla të ndryshme muzikore. Në letërsi debutoi me vëllimin poetik «*Ξεχασμένες αρμονίες*» (“Harmoni të harruara”) 1972 dhe më 1973 botoi romanin «*Περπατώντας στη Γη*» (“Duke ecur në tokë”).

Manolis Vitos (Μανόλης Βήτος). Nga Sminetsi i rrethit të Sarandës dhe me banim në Athinë. Zë një vend shumë të rëndësishëm në prozën rrëfyese të letërsisë në Minoritetin Etnik Grek.

Në një periudhë kohore 32 vjeçare ka shkruar plot nëntë vëllime me tregime: «*Στα δίχτυα του έρωτα*» (“Në rrjetën e dashurisë”), tregime, 1946, «*Ο γαμος του φτωχου*» (“Dasma e fukarait”), tregime, 1951, «*Ο πόλεμος*» (“Lufta”), tregime, 1953, «*Ο αρωστημένος*» (“I semuri”), tregime, 1957 «*Εφήμερη ευτυχία*» (“Dasuri e përkohshme”), tregime, 1961 «*Ματιες στη ζωή μου*» (“Vështrime në jetën time”), tregime, 1965 «*Το σπίτι*» (“Shtëpia”), 1971 «*Διηγήματα*» (“Tregime”), 1975 «*Ο Βιοπαλεσής*» (“Në luftë për jetën”), tregime, 1978.

Përmendim gjithashtu, romacieren **Marika Nathanail-Manthu (Μαρία Ναθαναήλ-Μάνθου)** nga Dhroviani. Po nga ky fshat ishte dhe **Qiriako Ikonomu (Κυριάκος Οικονόμου)**, i diplomuar për filologji në Paris dhe novelën e tij “Tsillo- ja” («Η Τσίλω»).

Mund të përmendim akoma **Jani Kalin (Ιωάννης Κάλλης)** nga Lesinica e Sarandës, me një libër në poezi «*Ανάλεκτα*» (“Përzgjedhje”) dhe librin me dy tregime të gjata, «*Η Ελευθερία*» (“Liria”). Po nga Lesinica ishin akoma edhe **Evangjellos Kasiaras (Ευάγγελος Κασσιάρας)** me librin «*Στη γη των πατέρων μας*»

(“Në tokën prindërore”) dhe shumë poezi e tregime të botuara në shtypin e kohës. **Vasilios Zarballas (Βασίλειος Ζαρβαλάς)** me përmbledhjen me tregime «Αμίλητο νερό» (“Uji i pafolur”). Në këtë grupim përfshihen edhe **Hristos Njarkaris (Χρήστος Νιάκαρης)** nga Koshovitsa, **Petros Kavuris (Πέτρος Καβούρης)**, **Odh. Qirushis Οδυσσέας Κυρούσης**) etj.

Paraqet interes edhe një kategori tjetër autorësh krijues, kryesisht rrëfimtarrësh, të kësaj periudhe. Fjala është për autorë nga treva e sotme e Minoritetit Etnik Grek dhe botimet e tyre pas vitit 1945. Janë të arratisur nga Shqipëria komuniste dhe shkruajnë dhe botojnë me pseudonime. Përmendim p.sh **M. Dhivriotin, Gr. Zagoritin, Akrokeravnion** etj.

Do të përmendim së fundmi fshatin Dhrovjan për një risi të veçantë në fushën e artit, atë të muzikës.

Me 1851 **Margaritis Papahristos Dhrovjanitis**, botoi në Konstandinopojë, librin “Muzikë kishtare, teori dhe praktikë”. Libri u shkrua me konvencione muzikore të vjetra dhe përbën një nga përpjekjet e rralla për t’u ardhur në ndihmë njërëzve të fesë së besimit ortodoks të cilët në shërbësat fetare kishtare interpretonin ritet muzikore bizantine me ligjesitë e traditës popullore, të transmetimit gojë me gojë dhe brez pas brezi.

Odhiseas Llappas, nga Dhrovjani. U lind në Aleksandri me 1890 në familje të pasur. Që i vogël u angazhua me teatrin dhe muzikën. Kënga u bë pasioni i tij i jetës. Studioi në këtë drejtim në Milano dhe këndoi më shumë sukses në lëmin e operas. Interpretoi në skenat më të mëdha të botës dhe para shumë personaliteteve botërorë të artit, të kulturës, të politikës.

Me 1936 u vendos në Greqi ku vdiq me 1960.

Po nga Dhrovjani ishte dhe **Jeramos Mikrajannanitis (Anastasios Grekas)** (1904-1993). Konsiderohet si një nga hymnografët më të shquar të Kishës Ortodokse post bizantine. Dallohej gjithashtu për aftësinë për të shkruar vargje, për kulturën e gjerë dhe përdorimin përfekt të gjuhës greke. Për vëprën e tij u dekorua nga Akademia e Shkencave të Athinës. Që më 1959 Patriarkana e Konstandinopojës i akordoi status të veçantë.

Ndërkohë, po nga ky fshat na vjen në këtë periudhë edhe një kontribut i veçantë, kësaj radhe në fushën e botimeve.

Stefanos Pargas, është emri filologjik i botuesit, përkthyesit dhe kritikut Niko Zelita nga Dhrovjani. U lind në fshatin e tij me

1888 dhe vdiq me 1938. Emigroi në Aleksandri të Egjyptit ku u shqua si eksponent i lëvizjës kulturore helene këtu.

Ndër themeluesit e revistës *Γράμματα*, (Grammata), botimin e së cilës e vazhdoi vetë. Me të njëjtin emër themeloi me sukses një shtëpi botuese. Ishte njëkohësisht drejtor i një reviste tjetër, tip Magazine dhe themelues i shoqatave filologjike e letrare helene, (Shoqëria Muzikore Helene, Grupi Arsimor i Egjyptit etj)

Nga shtëpia e tij botuese panë dritën e botimit veprat e Varnalis, Palamas, Voutiras, Theotokis, Janopoulos, Ksenopullos etj., si edhe një seri librash të autorëve të njohur të letërsisë botërore, të përkthyer prej tij. Pargas ishte mik i ngushtë i Kavafis.

Një kategori me vete dhe me vend të veçantë zënë kontributet në letrat greko-shqiptare. Përmendim rastin e **Branko Merxhanit (Aleksandros Mertzanopullos)** me origjinë nga Sopiku i Pogonit, i familjës **Dilo** si edhe shumë të tjerëve.

Ndërkohë, siç edhe gjetkë u përmend, për të shmangur çdo keqintërpretim dhe paragjykim në këtë monografi nuk përfshihen shumë emra të tjerë, të cilët jo vetëm botuan në gjuhën greke, por në kohën e tyre e konsideronin vetën të përkatësisë etnike helene. Rasti më ekstrem paraqet ai i Fan Nolit. Kuptohet që kjo trajtesë përbën një objekt me vete dhe me interes për antropologjinë shoqërore, multikulturën, bietninë etj

Pra, siç shihet edhe nga bibliografia e shkurtër e autorëve me në zë të kësaj periudhe letërsia e saj zhvillohet në të gjitha gjinitë dhe llojet. Ajo vazhdon të ruajë të njëjta trajta dhe nivele si dhe letërsia panhelene. Madje, ashtu si vë re edhe T. Koças, vazhdon të ushqejë letërsinë greke si e barabartë, pavarësisht nga tematika e veçantë që trajton në shumicën e krijimeve.

PJESA E DYTË

KREU I KATERT

TIPARET E LETËRSISË NË MINORITETIN ETNIK GREK NË REALITETIN E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

IV. 1. Letërsia gjatë Luftës së Dytë Botërore

Lufta e Dytë Botërore krijoi një realitet të ri për Minoritetin Grek në Shqipëri. Pas peripecive të brëndshme dhe nën ndikimin e Frontit Nacionalçlirimtar të popullit grek, pjesa dërrmuese e këtij Minoriteti, mori pjesë në mënyrë të organizuar në luftën e përbashkët me popullin shqiptar, të drejtuar nga Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar Shqiptar.

Pas disa dekadash marrëdhëniesh që kishin vënë përherë e më shumë në dyshim mundësinë e bashkëjetesës paqësore, po ndodhte bashkëpjesëmarrja në të njëjtën luftë. Kjo kthesë me përmasa vërtet historike për marrëdhëniet e mëtejshme midis elementit grek e shqiptar në Shqipëri, kishte si faktorë përcaktues armikun e përbashkët dhe aspiratën që ushqueu për minoritetet Karta e Atlantikut, për të drejtën e vetëvendosjes pas luftës të atyre minoriteteve, që do të luftonin kundër fashizmit përkrah popujve në shtetet që jetonin.

Nga ana tjetër, ky realitet i ri marrëdhëniesh po konturohej nga një ideologji e re, - atë komuniste. Kjo do të thotë se, për minoritetin etnik grek në Shqipëri lufta në vetvete, ashtu si ideologjia udhëheqëse e saj, përcaktonin jo thjesht një situatë të re, por vetë thelbin e momentit të ri historik që buronte nga këto marrëdhënie. Rrjedhimisht, atij i duhej të përpunonte e të krijonte sisteme të reja vlerash referuese. Kjo presupozonte krijimin e modeleve të reja mitesh, heronjsh e ideologjish, të aftë për të shërbyer jo vetëm si ushqim shpirtëror, por dhe si nevojë, që nëpërmjet riprodhimit shpirtëror të këtyre vlerave apo sistemit të ri të referimit, të krijohej besueshmëria optimiste në lidhje me perspektivën e këtij realitet të ri.

Në plan të parë doli roli i letërsisë dhe jo i një letërsie të çfarëdoshme, por të një letërsie me një angazhim historik të diktuar më shumë nga aspirata entuziaste sesa nga qëllime qartësisht të përcaktuara

Kësaj letërsie i duhej të çante shtigje të reja. Se pari, i duhej t'i përgjigjej nivelit të vlerave që krijonte realiteti i luftës dhe nivelit të marrëdhënieve të reja shoqërore e ndëretnike. Së dyti, nuk mund të shmangte as filozofinë e ideologjisë komuniste, e cila, e ndihmuar nga realiteti i luftës, e kishte më të lehtë për t'u bërë sunduese. Së treti, misionin e vet kjo letërsi duhej ta kryente në kushtet e mungesës së një tradite letrare koherente me këtë realitetit të ri.

Në këtë drejtim kjo letërsi nuk mund të mbështetej as në letërsinë shqipe. Për këtë nuk pengonte vetëm mungësa e marrëdhënieve tradicionale e as mundësia e pakët e komunikimit. Vetë letërsia shqiptare nga njera anë nuk dispononte ndonjë traditë të pasur letrare dhe nga ana tjetër edhe vetë ajo duhej të përballonte problematikën e luftës, e ndikuar nga filozofia e ideologjisë komuniste dhe nga synimet e përfaqësuesve të kësaj ideologjie për marrjen e pushtetit.

Megjithatë, edhe në këto kushte letërsia në Minoritetin Grek gjeti forma për një rrugë të natyrshme zhvillimi. Dihet që në çdo moment kalimtar historik, çdo grup apo komunitet i formuar etnikisht kërkon si dodmosdoshmëri objektive një sistem të ri kolektiv sjelljeje që t'i përgjigjet dinamikës së re të zhvillimit. Në sferën shpirtërore kjo realizohet nga subkoshienca kolektive, e cila i referohet atij sistemi vlerash të qëndrueshme që përbëjnë nënshtratin shpirtëror e kulturor të komunitetit.

Kështu shpjegohet pse realiteti i ri i luftës, i bëri krijuesit minoritarë t'i drejtoheshin pasurisë së pafundme të universit të krijimtarisë popullore dhe të përzgjidhnin pjesët më domethënëse për kushtet e reja që po krijoheshin. Si të tilla shërbyen ciklet e këngëve popullore historike të kaçakëve në Greqinë e fundit të shekullit XVIII edhe fillimet e shekullit XIX. Në këtë rast nuk është se kemi thjesht një përngjashmëri, sado të pakët, të kushteve historike. Më evidente bëhet nevoja e modeleve të gatshme dhe të njohura heroizmi për t'i mishëruar ato te heronjtë dhe te luftëtarët e rinj, për një të ardhme jo fort të ditur e të përcaktuar. Kjo mbështetje te universi i pasur i vlerave të krijimtarisë popullore të trevës së tyre, u siguronte krijuesve minoritarë epërsinë që të bëheshin farkëtuesit dhe shprehësit bindës të këtij sistemi të ri vlerash politike e shoqërore, pavarësisht nga fakti se sa u shërbenin aspiratave të bartësve të tyre. Kësisoj, huazimi i modeleve

të sprovuara në të kaluarën përbënte një garanci për të krijuar besimin e duhur ndaj parimeve të ideologjisë së re. Në këtë pikë, zhvillimi natyror i letërsisë vihet në dyshim serioz. Angazhimi i saj si funksion diakronik e permanent shoqëror do të shënojë fillimin e angazhimit në funksion të ideologjisë e të politikës (komuniste).

Rimarrja e modeleve të gatshme dhe të sprovuara i shërbënte realisht edhe ruajtjes pa shkëputje të vazhdimësisë vertikale të parametrave etnik. Kjo për faktin se këngët e kaçakëve përbëjnë në tërësinë e tyre një zhvillim të natyrshëm të këngëve të akritëve dhe baladave popullore, të cilat nga ana e tyre kanë lidhje të drejtpërdrejta me korpusin e madh të miteve dhe të letërsisë klasike të Greqisë së lashtë

Mirëpo, siç e thamë, kjo luftë nuk mund të krahasohet me historinë e luftës së kaçakëve në Greqi, pavarësisht se ajo shërbeu si fillim i revolucionit grek të 1821. Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare kishte parametra e konvencione të reja krejt të ndryshme. Ajo zhvillohej në kuadrin e luftës së popullit shqiptar. Në këto rrethana marrëdhëniet e Minoritetit Grek me kombin amikshin më shumë konvencionin e luftës globale kundër fashizmit dhe të ideologjisë komuniste dhe fare pak ato shfaqeshin si marrëdhënie të drejtpërdrejta etnike.

Megjithatë, fakt është se në këtë krijimtari gjejmë të gjitha tiparet dhe veçoritë e këngës popullore tradicionale greke, veçanërisht, të ciklit historik të kaçakëve. Dallohën në to mishërimi në një unitet poetik ose pjesëmarrje e përbashkët në veprimin poetik (kryesisht nëpërmjet personifikimit dhe hiperbolës) të njerëzve, të natyrës, të ideve dhe të perëndive. Dialogu midis heroit, të cilit i kushtohet kënga (poezia) dhe mjedisit, cilido qoftë ai, si karakteristikë dalluese e eposit të lashtë, këngëve të akritëve dhe baladave, mbetet një karakteristikë përgjithësuese e krijimeve poetike të kësaj periudhe. Ashtu si në traditën e krijimtarisë popullore edhe në krijimtarinë e kësaj periudhe, natyra, në aspektin e konotacionit figurativ, përbën një parajsë të mbitokë që i garanton tërësinë dhe siguron fatbardhësinë e qënies së gjallë-njeriut. Në nivelin e veprimit rrëfyes poetik marrëdhënia e njeriut me natyrën, (peripecitë njerëzore në natyrën e personifikuar), shpaloset si një komunikim pafund që tenton një identifikim të lumnueshëm me të. Në aspektin e sistemit të vlerave kjo lidhje shfaqet si marrëdhënie identiteti midis vlerave të natyrës dhe të njeriut.

Po ashtu, përballimi i vdekjes, si vazhdim i jetës, ndodh si të këngët tradicionale të kaçakëve. Kjo vijimësi, si realitet dhe si vlerë estetike në poezi, arrihet nëpërmjet harmonizimit dhe nje-

hësimit të vetive të natyrës me ato të njeriut, pavarësisht se raportet caktohen sipas kategorive të kundërta, *liri-robëri, jetë-vdekje*. Sipas kësaj skeme robëria është e njëvlefshme me vdekjen (dhe përbëjnë polin negativ) dhe liria me jetën (përbëjnë polin pozitiv). Çelësi i këtij modeli qëndron te identifikimi absolut i jetës me lirinë dhe te ndarja eventuale e saj nga gjendja e robërisë. Te këngët popullore kjo hierarki vlerash zë fill te parimi se jeta vet nuk ka vlerë, ose nuk ia vlen ta jetosh, nëse nuk i korrespondon cilësisë reale të njeriut (e përcaktuar në raportin e tij me natyrën). Këtu buron koncepti i sakrificës së jetës personale në emër të dinjitetit dhe pavarësisë njerëzore. Në këtë mënyrë, njeriu i këngës popullore, ose hero i popullor, duke parapëlqyer vdekjen përballë robërisë dhe përdhosjes, mohon në mënyrë më të dukshme shkëputjen e jetës nga liria dhe nga dinjiteti i tij. Në fakt duke sakrifikuar jetën, hero i pohon në mënyrë evidente integritetin e saj që identifikohet, ose njehsohet me plotërinë e ekzistencës si kategori filozofike. Vargjet e mëposhtme na paraqesin më së miri këto raporte:

*Οι παρτιζάνοι βγήκανε
στις πιο ψηλές κορφούλες
γιατί 'χαν σκλάβους αδερφούς
και σκλάβες αδερφούλες...*

*Partizanet seç dolën
në majat më të larta
se kishin skllëvër vëllëzërit
se kishin skllave motrat...*

ose:

*Ήταν όλα παλικάρια
του λαού μας τα παιδιά,
ένας ήταν ο σκοπός τους:
Θάνατος η λευτεριά!...*

*Ishin të gjithë trima
djemtë e popullit rini,
një qëllim ata kishin
ja vdekje ja liri!*

Në asnjë nga poezitë e kësaj periudhe nuk përmendet fjala “vdekje” si veti mohuese e jetës. Në vend të saj përdoret fjala “fjetje” si moment qetësie dhe rigjenerimi të jetës ose plotësisht në harmoni me të.

Interesante mbetet mbartja në letërsinë e Luftës së Dytë Botërore të Minoritetit Grek të tipologjisë së aksionit mbrojtës të këngës popullore greke. Kjo do të thotë se aksioni, ose motivi nxitës për veprim, te këto këngë përcaktohet nga kundërshtimi i heroit për të lejuar kundërshtarin t'i rrëmbëjë diçka të vyer që ai zotëron. (E njëjta situatë shfaqet edhe te epika për Gjergj Elez Alinë). Krejt e kundërta nga tipologjia e aksionit në përfundim që hero i vepron në emër të rrëmbimit nga ai të një vlere që e zo-

tëron dikush tjetër. Pra, ky hero i yni na shpalos vlerën e plotmërisë që buron në vetvete nga jetesa me drejtësi dhe në harmoni të plotë me mjedisin natyror dhe shoqëror.

Këtë filozofi vlerash të këngës tradicionale popullore e gjejmë të mishëruar edhe në letërsinë e Luftës së Minoritetit Grek. Bile, duke mbartur të njëjtat mjete shprehëse që janë përdorur dhe në ciklin, të cilit i referohemi, por edhe në baladat dhe në këngët akritase. Marrim si shembull këngën për dëshmorin Spiro Partali. Thotë në një moment kënga:

«...Σύντροφοι μη μ' αφήνετε στα έρημα τα δάση
για πάρτε με και σύρτε με, ψηλά σε 'κείν' τη ράχη
καμείτε και τον τάφο μου, το μαύρο μου κιβούρι,
να 'ναι βαθύ, να 'ναι πλατύ, να 'χει και παραθύρι,
να βλέπω τα συντρόφια μου, να χαίρετε η καρδιά μου....»

(Shokë mos më lini mes pyjeve të shkreta
merrmëni dhe çomëni në majë t'asaj kodre
bëmëni dhe varrin të ziun varrin tim
të jet' i thellë, të jet' i gjërë, të ketë edhe dritare
të shoh unë shokët e mi, zemra të më gëzohet...).

Ashtu siç ndodh në shumë këngë kaçakësh, edhe këtu kemi motivin e partizanit të plagosur (në greqisht përdoret emri αντάρτης - andart) në mes të një pylli që pret vdekjen. Ai, si te kaçakët, nuk i trembet vdekjes më shumë se idesë se do të jetë vetëm. Ndaj dhe kërkon që dhe pas vdekjes të ketë mundësi komunikimi (pasiv) me shokët (jetën). Dritaren që kërkon te varri i tij na kujton gjithashtu variante të ndryshme të baladës së murimit (Ura e Artës) apo dhe vetë varrin e Dhijeni Akritës.

Por shpesh natyra përdoret edhe për të shprehur dramacitetin që krijon ikja nga jeta e mbi tokë. Në këtë rast veprimi zhvillohet sipas parimit marrëdhënie pozitive - funksion negativ.

Για δεσ καιρό που διάλεξες ο Χάρος να σε πάρει,
Τώρα π' ανθίζουν τα κλαρια και βγαζ' η γής χορτάρι
(Pa shiko kohë që zgjodhe Vdekja të të marrë,
Tani që dega lulëzon dhe bari tej e mban ...)

Heroi-njeri nuk e përballon tundimin se ai po ikën në kohën që pranvera vjen.

Në krijimet e kësaj periudhe, përveç rimarrjes së motiveve nga këngët popullore të traditës, të vargjeve, fragmenteve nga ato, apo dhe këngëve të tëra ku ndryshohet vetëm emri dhe koha e ngjarjes (fenomene këto tipike të krijimtarisë popullore) gjejmë përshtatjen në të njëjtën këngë të motiveve nga këngë të ndryshme:- të kurbetit, të nizamëve, të baladave etj. (Edhe këto

fenomene tipike të krijimtarisë popullore). Në to gjejmë shpesh dhe armët që përdomin kaçakët (shpatën) dhe në të njëjta vargje formacionin luftarak partizan, madje, në gjuhën shqipe “*brigadë*”. (Kënga për dëshmorin Llambi Llambraqi).

Elementët e rinj që hasen në krijimet e periudhës së luftës partizane, karakterizohen më shumë nga ngjyrimet ideologjike dhe ndikime nga himnet e marshet revolucionare të kohës, qofshin këto shqiptare, greke apo ndërkombëtare. E veçanta është se ato interpretohen në gjuhën greke. Kemi, p.sh rimarrjen në masë të gjërë të fjalës “*shokë*”. E njëjta fjalë gjendet e përdorur rrallë edhe në këngët e kaçakëve. Në to ajo përdoret me kuptimin intim të mikut. Në këngët partizane përdorimi i saj bëhet në një kontekst ideologjik.

Po ashtu, dihet që te këngët popullore të kaçakëve, (njësoj si në mitologji apo në këngët epike të akritëve) ndërgjegja dhe veprimi i individit vazhdon të luajë rol kryesor në përcaktimin e fatit e të rrjedhës së ngjarjeve. Amanetet, si pjesë integrale e kozmosit të eposit të kaçakëve, kanë si objekt anën personale dhe private. Në kuadrin e kësaj antropologjie qëndrimi karakteristik i heroit është një qëndrim rezistence dhe kundërshtimi ndaj faktorëve që venë në rrezik plotmërinë dhe integritetin e tij natyror ose shfaqet si një përpjekje për ta venë atë në vend pas një padrejtësie. Pra, mishëron modelin e heroit kundër shoqërisë apo formave të pushtetit që vënë në rrezik komunitetin e tij të vogël. Ky raport është e vërtetë se vë në dukje modelin e heroit që është gati të sakrifkohet ai dhe të shpëtojë të tjerët duke na shpalosur modelin e heroit mbrojtës.

Përkundrazi, në krijimet e luftës partizane ato zëvendësohen me veprime kolektive (të shokëve, popullit). Edhe amanetet u përkasin elementëve të logjikës kolektive, lirisë, demokracisë, përparimit etj. Pra kemi një raport të ri forcash të mishëruar në idealin e ri, të cilit i përkushtohet heroit kolektiv që mbetet i njehsuar dhe në harmoni me natyrën. Në anën tjetër është sistemi shoqëror që kërkon t’i kundërvihet atij.

Së fundi duhet me forcë nënvizuar se në krijimtarinë e kësaj periudhe, përveç ruajtjes së linjës së riprodhimit të motiveve tradicionale, kemi edhe ndikime të parametrave të këtyre marrëdhënieve. Vihën re motive, apo dhe këngë të plota të ndikuara nga fryma e përgjithshme e aleancës së popujve kundër forcave të boshtit, e udhëhequr kjo alencë nga ish-Bashkimi Sovjetik. Po ashtu në gamën e gjërë të këtyre krijimeve, kemi këngë të ndikuara apo të përkthyer nga shqipja.

Më mirë këto ndikime vihën re tek ana muzikore e interpretimit. Marshet dhe meloditë e tjera që u përdorën kishin një linjë të përbashkët të konveccionit global të luftës,-ideologjinë komuniste, pavarësisht nga ndonjë veçori. Karakteristikë është fakti që ky ndikim, në aspektin muzikor, u shtri edhe në ato krijime apo këngë të Minoritetit Grek të kësaj periudhe, të cilat u mbështetën fuqimisht te trashëgimia e poezisë popullore greke.

Që në këtë periudhë kemi shfaqjen e elementit deklamativ, panigjirik e retorik të poezisë. Këto karakteristika, të kuptueshme dhe të lejueshme deri diku për shkak të situatës, në të cilën krijohën dhe reflektojnë, dalngadalë shndërrohën në tregues të angazhimit ideologjik e politik të krijimtarisë së kësaj periudhe. Bile arrijnë deri në shfaqjen hapur të luftës së klasave. Këto elemente në të ardhmen do të bëhën mbisunduese dhe do të përbëjnë treguesin themelor të letërsisë së realizmit socialist.

Nëqoftëse “*lufta*” në këngët e traditës na jepet në realitetin e vet të vrazhdë dhe heroik, por pa një qëllim të përcaktuar, në krijimet e periudhës së luftës jepet nën prizmin e një qëllimi të qartë ideologjik. Lufta tani bëhet për

“... Για μια λαοκρατία, για ένα μέλλον λαμπρό
ελευτεριά ειρήνη, δουλειά, πολιτισμός»
(Për një demokraci, të ardhme të ndritur
paqe, punë liri, civilizim...) .

Ose

“...Ποιος είδατε το Γιώργαρο
το Γιώργαρο το Ζώτο
τον κλέφταρο τον πρώτο
μερόνυχτα τον βλέπαμε
το Ζώτο τη φαγάνα
την παλιοκαραβάνα.....»

(Kush pa Jorgaron
Jorgaron Zoton
Të parin hajdut
Natë e ditë e shihnim
Zoto llupësin
çanakprishurin...) ⁷³

Janë pikërisht këto trajtesa që zbehin në maksimum vlerën letrare të këtyre poezive.

Nga ana stilistike në to ruhet vargu 15-rrokësh apo dhe 13-rrokësh, klasik apo i thyer, me ritëm jambik. Këto janë karakteristika kryesore të poezisë tradicionale popullore greke, por edhe të poezisë së kultivuar të autorëve të Minoritetit Grek për këtë

⁷³ Fjala është për një figurë intelektualit nga minoriteti që nuk u pajtua me idetë komuniste dhe për këtë u përdoq. Të njëjtin qëndrim mban ndaj tij dhe pro-dhimi letrar i kohës.

periudhë dhe për dekada të tëra të periudhës së pasluftës. Për-pjekjet për të futur në to rimën nuk janë dhe aq të suksesshme.

Po ashtu, dëshmtitarë të letërsisë së kësaj periudhe tregojnë se gjatë Luftës janë lëvruar dhe skica e tregime si dhe pjesë të vogla teatrale. Ato janë mënjanuar dhe në emër të “harresës” sot nuk disponohën (Të vetme krijime që u ruajtën janë disa skica dhe tregime të vogla të Lefter Talos, të cilat faktikisht nuk lidhën me luftën, por me periudhën para saj).

Për zhvillimin e kësaj letërsie u përdorën dy “gazeta” shaptilografji, njera me emrin «*Ο Αγώνας μας*» (“Lufta jonë”) dhe tjetra «*Η φωνή του αντάρτη*» (“Zëri i andartit”), që qarkullonin në krahi-nat “minoritare” të Gjirokastrës (Dropull – Pogon – Zagori – Lu-nxheri) në vitet 1943 – 1944 (fundi i vitit 1943 dhe në vazhdim në vitin 1944). Pasardhësja e këtyre gazetave të kohës së luftës së II Botërore është gazeta «*Λαϊκό Βήμα*» (“Llaiko Vima”) e Gjiroka-strës që u themelua menjëherë pas luftës (Janar 1945) nga të njejtët element të lëvizjes partizane të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri.

Siç shihet, natyra dhe fizionomia e kësaj letërsie, e mbështetur kryesisht te krijimtaria e traditës popullore, krijuan përshtypjen se letërsia e Luftës së Minoritetit Grek shënon dhe fillimet e letërsisë në Minoritetin Grek në Shqipëri. Kjo përshtypje u kthye në një të vërtetë të paverifikueshme dhe ndihmoi shumë nevojat e politikës komuniste për të mohuar traditën ekzistuese letrare që trashëgoi Minoriteti Grek në Shqipëri. U shfrytëzua për këtë pari-mi i njohur se fillesat e çdo letërsie të kultivuar e kanë zanafillën te krijimtaria popullore.

Nga ana tjetër letërsia e Minoritetit Grek (lexo poezia) e kësaj periudhe, ashtu siç ndodhi edhe me letërsinë shqiptare, u trajtua me termat e folklorit, si krijime popullore (këngë) të Luftës Partizane. (Kjo ndodh edhe për arsyt e thjeshtë se ato krijoheshin për t’u kënduar, pra për t’i shërbyer moralit të luftës) Kështu, për këto poezi përdoret termi “*këngë partizane*” në shqip, ndërsa në gre-qisht edhe “*Këngë andartësh*” (*Αντάρτικα τραγούδια*).

Duhet thënë se, pavarësisht nga shkalla e mbështetjes në traditën popullore, në krijimtarinë në shqip apo greqisht, identi-fikimi me krijimtarinë popullore ose me një formë të përafërt me të (Këngë partizane – e të gjithë popullit që luftoi për liri nën drejtimin komunist) bëhet edhe me një qëllim tjetër. Për të vërtetuar se fryma komuniste dhe pasqyrimi i saj në art përbënte shkallën më të lartë “*të natyrës apo të frymës popullore*”, kara-teristikë që do ta hasim në vijim në gjithë letërsinë e pasluftës

së popullit shqiptar edhe në krijimtarinë e kultivuar të Minoritetit Grek.

Në shërbim të së njëjtës ide, që letërsia e Luftës së Minoritetit Grek shënon dhe fillimet e letërsisë në lidhje me Minoritetin Grek në Shqipëri, përdoret edhe fakti se letërsia e pasluftës në minoritet, krahasimisht me letërsinë e krijuar nga autorë minoritarë grekë brënda territorit shqiptar në periudhën para Luftës, pati një zhvillim të vullshëm.

Këto dhe arsyet e tjera i bënë ata pak studiues të periudhës së diktaturës komuniste të letërsisë në minoritet, të trajtonin krijimtarinë e periudhës së luftës si fillime të një letërsie të re, "*të letërsisë minoritare*".

Në kritikën e kohës, krijuesit e periudhës së Luftës u quajtën "*njerëz të cilët ose nuk kishin asnjë lidhje me poezinë e kultivuar, ose kishin ndonjë njohuri lidhur me kërkesat e poezisë*"⁷⁴. Bile, këtyre marrëdhënieve të krijuesve të kësaj periudhe me letërsinë, u dedikohën edhe elementët e poezisë së kultivuar që hasen, sipas mendimit kritik në fjalë, në krijimtarinë e periudhës së Luftës. Madje, përpjekja e Pano Çukës në librin e tij "*Një buqetë me këngë popullore*" dhe të të tjerëve pas tij, që flasin për emra konkret krijuesish të këtyre këngëve, konsiderohet e gabuar⁷⁵. Ndodh kështu kur dihet që një pjesë e mirë e këtyre krijuesve si vetë Panos Çukas apo Spiros Xhas, Janis Panos, Vagjelis Vasiliu etj, u bënë krijuesit me në zë në letërsinë e mëvonshme në Minoritetin Grek në Shqipëri.

⁷⁴ Jani J., gaz «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», nëntor, 1989, fq. 6.

⁷⁵ Jani J., gaz «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», nëntor, 1989, fq. 6.

KREU I PESTË

PARIMET E REALIZMIT SOCIALIST DHE LETËRSIA E MINORITETIT GREK NË SHQIPËRI

V.1. Kushtet historike në realitetin politik të pasluftës

Përvetësimi i fitores kundër fashizmit në fund të nëntorit 1944 nga komunistët shqiptarë, u shoqërua me vendosjen de jure të pushtetit të tyre me në krye Enver Hoxhën, në fund të 1945-ës dhe fillim të 1946-ës. Bazat logjike të politikës që do të ndiqej ishin hedhur që gjatë luftës dhe bazoheshin në dy akse kryesore.

Së pari, logjika e eliminimit të kundërshtarëve politik dhe individëve që zotëronin një potencial intelektual perëndimor të manifestuar, si mendim ndryshe nga ai i Hoxhës.

Së dyti, për të siguruar një *“unitet”* të brëndshëm që nuk do të vinte në dyshim sundimin e vet, Enver Hoxha aplikoi me sukses teorinë e patriotizmit nacional-socialist. Shqiptarët, sipas kësaj teorie, duhet të harxhonin gjysmat e energjive, për ta kthyer në ndërgjegje *“mbrojtjen”* nga *“armiqtë shekullorë, që donin të coptonin Shqipërinë”* dhe nga ata *“që e kishin halë në sy”*, por që ajo, *“nën udhëheqjen e partisë, dinte të hidhte valle në gojë të ujkut”*.

Pra, sistemi komunist ndoqi në Shqipëri për të gjithë qytetarët e vet, politikën homogjenizuese nacional-socialiste. Kjo politikë vepronte negativisht te vetë populli shqiptar në dy drejtime kryesore. Drejtimi i parë çonte në shpërfytyrimin e dinjitetit personal të individit, në emër të krijimit të një dinjiteti kolektiv të përshtatur ideologjisë së partisë dhe të udhëhequr prej saj, sipas slloganit të *“njeriut të ri socialist”*. Drejtimi tjetër lidhet me rritjen, mbi këtë bazë, të ndjenjës nacional-socialiste. Kuptohën pasojat e rënda të kësaj politike në aspektin e respektimit të lirisë së individit dhe të të drejtave të tij.

Kuptohet, gjithashtu, se të dy këta faktorë, kishin veprim negativ të dyfishtë mbi Minoritetin Grek, edhe si qytetarë shqiptarë, edhe si anëtarë të një komuniteti etnik.

V. 2. Përvetësimi “in extremis” i parimeve të realizmit socialist

Pasojat ishin më të dukshme në fushën shpirtërore dhe veçanërisht në atë të letërsisë. Udhëheqja komuniste, shpalli marksizëm-leninizmin si ideologji udhëheqëse të politikës së saj, në fushën e letërsisë dhe të arteve. Ndërkohë, ose zbatoi parimet estetike më ekstreme të saj (ato të konfondimit të letërsisë me ideologjinë), ose i deformoi ato në favor të qëllimit, që letërsia dhe artet të jenë në shërbim absolut të sigurimit të rolit të saj udhëheqës.

Kështu, duke qenë e vetëdijshme për rolin e letërsisë dhe të arteve në përpunimin e ndërgjegjes kolektive, udhëheqja komuniste shqiptare në emër të zhvillimit të tezave të marksizëm-leninizmit, adaptoi si parim të estetikës marksiste-leniniste një thënie të Stalinin. Sipas saj, “shkrimtarët janë arkitektët e shpirtit të popullit”⁷⁶.

Po ashtu, për të imponuar pranimin e parimeve të Proletkul’t të artit të realizmit socialist në ish-Bashkimin Sovjetik, u deshën rreth tridhjetë vjet. Debati i filluar në mesin e dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XX u mbyll në kongresin e parë të Shkrimtarëve Sovjetik më 1934⁷⁷. (Bile, më shumë ishte një marrëveshje vullnetare midis grupeve të angazhuara politikisht dhe atyre të paangazhuara)⁷⁸.

Komunistëve shqiptarë iu deshën vetëm disa vjet për ta bërë këtë. Konferenca e tretë e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, tetor 1949, përcaktoi drejtimin e letërsisë shqiptare si letërsi e realizmit socialist⁷⁹, drejtim që nuk ndryshoi deri më 1990.

Në Shqipëri u abuzua me tezën e Leninit mbi të drejtën e Partisë, për të ushtruar kontroll mbi botimet partiake në përgjithësi⁸⁰. E drejta e kontrollit mbi krijimtarinë letrare u kthye në pa-

⁷⁶ Fokkema D. - Ibsch E., 1998, *Theories of Literature in the Twenty Century*, Athinë, fq. 162.

⁷⁷ Në statutin e Lidhjes së Shkrimtarëve ky parim përshkruhej si “pasqyrim konkret i realitetit në zhvillimin e tij revolucionar e kombinuar me domosdoshmërinë e edukimit ideologjik të masave punonjëse me idealet e socializmit”

⁷⁸ Fokkema D. - Ibsch E., 1998, *Theories of Literature in the Twenty Century*, Athinë, fq. 162.

⁷⁹ Elsie R., 1997, *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë – Pejë, fq.380.

⁸⁰ Në artikullin “Organizata e partisë dhe letërsia e partisë”, dhjetor, 1905, Lenini hodhi tezën për të drejtën e Partisë për të ushtruar kontroll mbi botimet partiake në përgjithësi (jo mbi botimet letrare dhe mbi ato botime që nuk kanë lidhje me partinë).

rim bazë. Kjo çoi në ngritjen dhe veprimin në ekstrem të makinës së censurës deri në autocensurë.

Po ashtu, në ish B.Sovjetik ekstremiteti i censurës veproi për një kohë të shkurtër⁸¹. Në Shqipëri karakteristikë dalluese mbeti forcimi dinamik, në raport me kohën, i kontrollit të Partisë mbi letërsinë deri në 1990.

Eshtë gjithashtu, i njohur fakti që Enver Hoxha e mbështeti veprimtarinë e vet politike, duke manifestuar dukshëm një kompleks inferioriteti ndaj epërsisë intelektuale të njerezve të letrave në përgjithësi, veçanërisht ndaj atyre që kishin studiuar në Perëndim. Në këto rrethana, ai e absolutizoi mohimin e së drejtës së krijuesve letrarë, për të provuar forma të reja dhe të panjohura në letërsi dhe arte. Kështu shkrimtarët lejoheshin të bënin sprova letrare brënda kuadrit logjik e ideologjik të Partisë dhe krijimtaria e tyre duhej të përbënte një propagandë letrare të kuptueshme nga masat dhe, rrjedhimisht, më efektive se propaganda politike.

Gjithashtu në Shqipëri nuk u pranua kriteri i dyfishtë për trajtimin e veprave të traditës, (- i historizmit për vlerësimin e veprës letrare në lidhje me kohën kur u shkrua dhe kriteri politik, për të gjykuar një vepër nga këndvështrimi politik i kohës)⁸². Në Shqipëri kriteri politik i vlerësimit të trashëgimisë letrare vendase, u bë mbisundues dhe absolut. Ky këndvështrim i traditës letrare, së bashku me parimet e realizmit socialist të letërsisë, të gërshtuara me parimin sipas të cilit Partia përbënte shkallën më të lartë të frymës popullore, i dhanë një goditje të rëndë vazhdimësisë së prodhimit letrar në Shqipëri. *“Përndjekja e intelektualëve, sidomos e atyre që kishin qenë jashtë vendit para vitit 1944 dhe shkëputja faktike nga të gjitha traditat kulturore, thotë Robert Elsie,- krijuan në Shqipëri një zbrazëti letrare e kulturore e cila, zgjati deri në vitet gjashtëdhjetë. Pasojat e saj mund të ndihën edhe sot.”*⁸³

Në këto rrethana kuptohet sa mund të pajtohej sistemi i Enver Hoxhës me një liri letrare dhe me ndikime të pakontro-

⁸¹ U shfaq me 1946 me censurën që Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste i B. Sovjetik ushtroi mbi Mihail Zosçenko dhe Anna Achmatova dhe u zbut pas vdekjes së Stalinit 1953. Kongresi i dytë i Shkrimtarëve të B.Sovjetik 1954 sanksionoi heqjen nga parimet e realizmit socialist të parimit për edukimin revolucionar të masave.

⁸² Mao Ce Duni shkon akoma me tej kur pranon kriterin estetik për vlerësimin e një veprë letrare edhe kur ekziston rreziku *“të tërhiqet vëmendja e lexuesve nga veprimi revolucionar”*.

⁸³ Elsie R., 1997, *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë – Pejë, fq. 378.

lluara, si në aspektin e trashëgimisë ashtu dhe në atë aktual, siç mund të ndodhte me letërsinë e Minoritetit Grek në Shqipëri. Një situatë e tillë provokoi për letërsinë e pasluftës në Minoritetin Grek, një realitet zhvillimi nën presionin e censurës dhe të auto-censurës dhe kultivimin e një letërsie thellësisht të angazhuar në favcor të ideologjisë sunduese.

Duhet thënë, gjithashtu, se në krijimtarinë letrare në gjuhën shqipe zbatimi i parimeve të realizmit socialist nën ndikimin e linjës së Sejfualla Maleshovës⁸⁴, pati përkohësisht mëdyshje. Kjo mëdyshje lidhej me vetë fatin e thelbit të letërsisë si të tillë. Mëdyshjet dhe rezervat lidhur me zbatimin e këtyre parimeve, të shfaqura nga një pjesë e krijuesve minoritarë, përveç shqëtësimit të mësipërm, kishin parasysh edhe rrezikun në lidhje me identitetin etnik.

V.3. Reflektimi i këtij realiteti në jetën Shpirtërore të Minoriteti Grek

Le të shikojmë rëndësinë e këtyre veçorive në fizionominë e re të letërsisë në lidhje me Minoritetin Grek të kësaj periudhe.

Pushteti komunist, që në fillimet e tij, krijoi për minoritetin një situatë presioni deri në paranojë. Bllokoi menjëherë, çdo kontakt njerëzor me kombin am e çdo lidhje shpirtërore me të jashtë kontrollit të partisë. Bile, në kuadrin e ideologjisë komuniste dhe në emër të luftës kundër shfaqjeve dhe ndikimeve të huaja, arriti të bllokojë deri edhe depërtimin e valëve radiotelevizive.

Në vijim, trumbëtoi në çdo nivel dhe për një kohë të gjatë parullën e “*Synimeve grabitqare të monarkofashistëve ndaj Shqipërisë*”. Kjo propagandë çonte në forcimin e unitetit të brendshëm duke nxitur armiqësinë ndaj Greqisë. Mirëpo, njëkohësisht, kultivonte midis komunitetit të Minoritetit Grek, ndjenjën e fajit për përkatësinë e vet etnike.

Në emër të mbijetesës ata, ose duhej ta shmangnin publikimin e këtij identiteti etnik, ose duhej ta përdornin me formalitetin “*minoritar*” që “*jeton e punon i lumtur në Shqipërinë socialiste*”, ose duhej ta mohonin totalisht. Pra, të gjitha format e referimit ndaj këtij identiteti nuk kishin në thelb asnjë vlerë në evdntimin real të tij.

⁸⁴ Elsie R., 1997, *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë – Pejë, fq. 379.

Gjithçka mbështetej te frika e hapur dhe e pamasë që E. Ho-xha e kishte “*edukuar*” që në kohë të Luftës dhe, me kalimin e kohës, vetëushqente një terror të shumëfishtë dhe tepër të veçantë. Aplikimi i këtyre makinacioneve kishte krijuar përshtypjen, se bëhej fjalë për një zhvillim të brëndshëm natyral. Si rezultat edhe humbja e identitetit bëhej në mënyrë të pandjeshme dhe pa shkaktuar reagimet e natyrshme.

Sjellja alogjike e Minoritetit Grek ndaj identitetit të vetë deri tek distancimi (qoftë edhe i detyruar) nga kombi am, lidhet edhe me faktin se për 25 vjet (1946 -1971), Greqia dhe Shqipëria nuk kishin as marrëdhënie diplomatike midis tyre.

Nga ana tjetër, duke qenë se Shqipëria ishte një shtet hermetikisht i mbyllur ndaj botës, monitorimi i të drejtave të njeriut dhe të minoritetit bëhej nëpërmjet pasqyrës ideologjike të partisë - shtet.

Po ashtu, nën preteksin e eliminimit të kundërshtarëve të pushtetit popullor, sistemi komunist asgjësoi atë potencial njerëzor e intelektual të Minoritetit Grek, që nuk mund të pajtohej me këtë politikë. Këta ishin njerëz që kishin studiuar jashtë Shqipërisë, kryesisht në Greqi, të cilët jo vetëm që zotëronin një kulturë ndryshe, por zotëronin lidhjet më të gjalla dhe më të qenësishme me kombin am.

Goditje pësuan edhe pena të tilla si Vangjelis Vasiliu, Nikos Filipa Zahu, Mihalis Hr. Manos, Athanasios Fidhis, Aristidhis Qirushis etj, të cilët u burgosen dhe u internuan nga disa vjet deri gjithë periudhën deri në vitin 1990.

Kaq e madhe dhe e rëndë ishte goditja në drejtimin e letrave, saqë për të hedhur hapat e para në rrugën e letërsisë u deshën të kalonin disa vite. Kështu, vëllimi i parë poetik në gjuhën greke mban vulën e viti 1953, të autorit Pano Çuka me titull “Jetë e lirë” («*Ελεύθερη ζωή*»). Po këtë vit del në qarkullim edhe libri i parë në prozë në greqisht e shqip i Spiro Xhait me titull: “Përkundruell Murganës” (*Μπροστά στα μάτια της Μουργκάνας*).

Për t’i mbajtur nën kontrollin e vet, por edhe për të nxitur devotshmërinë në shërbim të ideologjisë komuniste, “Partia” dënohte herë pas here shkrimtarët rebelë për t’u treguar të tjerëve se të jesh i bindur do të thotë, të jetosh me dinjitetin që të siguronte pushteti popullor. Përmendim këtu shkrimtarin dhe poetin e njohur Foto Qiriazatin.

Po ashtu, krijuesit minoritarë grekë kishin shpesh të njëjtin fat me shumë kolegë të tyre shqiptarë. Ata bëheshin objekt spa-

strimi i ciklonëve që “ndërmerre Partia, për revolucionarizimin e jetës së vendit”.

Në plejadën e gjërë të shkrimtarëve dhe artistëve që u denuan pas plenumit të famshëm të Partisë së Punës të 1974-ës, u përfshi edhe prozatori i njohur i Minoritetit Grek Spiros Xhas. Ai u përjashtua nga partia, programin e së cilës, siç thotë vetë, e kishte pranuar që më 1942. U denua me punë në prodhim në moshë pensioni. Veprat e tij u demaskuan publikisht nga organizata e frontit dhe u ndalua të shkruajë për vite të tëra.

Citojmë më poshtë pjesë nga autobiografia në dorëshkrimin e vetë Spiro Xhait:

“Më 1974 fare pa pandehur dhe pa pasur asnjë vërejtje më përjashtuan nga Partia e Punës. Akuza bazë ishte: “Nuk isha dakort me vijën e partisë dhe ushtrija opozitë në politikën e qeverisë”. Kjo ishte ana e dukshme e medaljes, sepasi për të më përjashtuar nga partia. Arsyeya e vërtetë qëndronte në faktin se, kisha ruajtur të paprekur identitetin tim i të qenit grek”.

Nga ana tjetër Partia kultivonte midis krijuesve minoritarë, ashtu si midis krijuesve shqiptarë, simbole devotshmërie. Makina propangaduese e partisë, përzgjidhte elementin më të devotshëm, mundësisht edhe të aftë e të talentuar dhe i shndërronte në figura që duheshin respektuar, madje edhe imituar nga të tjerët në krijimtarinë e tyre. “Partia” u kishte besuar një barrë të rëndë monopolizuese, në të gjitha fushat e veprimtarisë letrare e artistike të minoritetit.

Nga ana tjetër, me ta komunikonte vetë “udhëheqësi komunist”, flisnin me konsiderata maksimale kritika më autoritare e kohës dhe shkrimtarët me në zë në vend. Ata përfaqësonin Minoritetin Grek në të gjitha veprimtaritë e sferës kulturore e artistike. Madje, edhe talentet e reja duhej të kishin deri në një farë mase bekimin e këtyre poetëve simbole.

Janë pikërisht këto mekanizma që kultivuan në mënyrë dia-kronike, diferencimin e prodhimit letrar në Minoritetin Grek. Nga njera anë, kultivuan letërsinë e angazhuar, e cila njohu shpesh shkallën më të lartë të angazhimit atë të devotshmërisë. Nga ana tjetër çuan në instalimin e censurës dhe shkallës më të lartë të saj autocensurën. Kjo e dyta çoi në prodhimin e asaj që u quajt “letërsia e burgosur”.

V. 4. *Infrastruktura*

Akti i shkrimit të letërsisë nuk lidhet thjesht me momentin historiko-kulturor që përcakton pikënisjen e kufirit ndarës midis letërsisë së kultivuar nga ajo orale – folklorike⁸⁵. Njëkohësisht përbën një element me rëndësi në kompleksin e procesit të realizimit të letërsisë⁸⁶ si e tillë. Ky element fiton një rëndësi përherë më të madhe në kushtet e sotme të prodhimit letrar ku faktorët industrial ose jashtë krijuesit të vërtetë të një veprë letrare, luajnë gjithnjë e më shumë rol të dorës së parë. Kjo do të thotë që zhvillimi i një letërsie, presupozon mbi të gjitha ekzistencën e një infrastrukture të zhvilluar mbështetëse, që përfshin jo thjesht anën teknike botuese, por edhe promovuese e reklamuese të letërsisë.

Në këtë kuadër, mendojmë se është me vend të shënojmë se përderisa Enver Hoxha adoptoi parimet staliniste edhe në trajtimin e minoriteteve, me siguri, që këto parime do të gjenin pasqyrim edhe në trajtimin e letërsisë dhe të arteve në Minoritetin Grek, si elemente të rëndësishme që do të vërtetonin “parimet humane të shtetit socialist”⁸⁷.

Në këtë këndvështrim, dhe në kushtet e mungesës totale të një infrastrukture të trashëguar, është e vërtetë se sistemi komunist u kujdes të ngrinte një infrastrukturë të veçantë, në shërbim të zhvillimit të letërsisë së Minoritetit Grek në Shqipëri. Vonesat e vëna re në fillimin e instalimit të kësaj infrastrukture, lidhën me vështirësitë objektive të viteve të para të pasçlirimit. Ndikoi, gjithashtu, fakti që adoptimi i tezave të Stalinit për trajtimin e minoriteteve u bë me vonesë.

I vërtetë mbetet fakti që kjo infrastrukturë u zhvillua ngadalë, ishte formale dhe stimulonte atë lloj letërsie, kryesisht poezi, që i interesonte sistemit komunist.

Në radhë të parë u stimulua në mënyrë të kontrolluar zhvillimi i letërsisë së realizmit socialist i minoretit grek në Shqipëri. Ky zhvillim, qoftë si qëllim në vetvete, por më shumë si pasyrim në art nga vetë krijuesit e minoritetit të trajtimit shembullor të tij nga pushteti

⁸⁵ R. Wellek – A. Warren, 1976, *Teory of Literature*, Athinë, fq. 142.

⁸⁶ Βελλουδης Γ., 1994, *Γραμματολογία, Θεωρία της λογοτεχνίας*, Athinë, fq. 56.

⁸⁷ Kjo do të thotë se masat e marra nuk synonin një realitet të qenësishëm, por ishin pjesë të përpjekjeve të sistemit për të siguruar një vitrinë. Kështu sistemi zgjodhi Minoritetin Grek si vitrinë përfaqësuese për të gjitha minoritetet e tjera në vend. Në kuadrin e Minoritetit Grek zgjodhi krahinë e Dropullit për ta fokusuar si model mirëqënieje dhe frymëzimi. Dhe brënda në këtë krahinë disa fshatra e midis tyre familje të veçanta.

socialist, përbënte për këtë pushtet një element bazë për të kompletuar vitrinën e kujdesit dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve në Shqipëri.

Nga ana tjetër, siguronte, nëpërmjet ndikimit efektiv të letërsisë, përkushtimin e këtij minoriteti ndaj pushtetit. Ky mision, në fakt, kërkohet nga letërsia e Minoritetit Grek si pjesë e pandarë e letërsisë shqiptare në përgjithësi, ashtu siç ndodhi edhe me të gjitha proceset e tjera.

Për shumë vjet mjeti i vetëm që i shërbeu këtij qëllimi, ishte gazeta "Llaiko Vima" («Λαϊκό Βήμα»), e cila dilte një herë në javë që nga 1945-a. Në të botoheshin herë pas herë krijime letrare në prozë e poezi. Më 1956 u themelua në këtë gazetë faqja letrare, e cila jo gjithmonë funksionoi si e tillë. Ajo kurrë nuk shërbeu si tribunë e vërtetë e fjalës letrare. Madje, këtë rol nuk arriti ta kryente as gazeta 8 faqëshe me titull "Llaiko Vima Letrare" («Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα»), që filloi të botohej më 1988 si supliment i përmuajshëm dhe përdyjavshëm i "Llaiko Vimes".

Emisioni në gjuhën greke pranë Radio Gjirokastrës, i themeluar edhe ai që më 1945-ën, nuk mund të pretendojë për një rol efektiv në këtë drejtim. Emisionet kulturore të së dielës, të drejtuar për një kohë shumë të gjatë nga Pano Çuka, kishin më shumë karakter propagandistik. Megjithatë nuk mund të mohohet se, në terrin ekzistues edhe ato ishin një dritarëz tjetër në shërbim të zhvillimit të letërsisë së Minoritetit Grek, të ruajtjes së gjuhës dhe kulturës së tij.

Në vitin 1952, në shtëpinë botuese "Naim Frashëri" në Tiranë, funksionoi për herë të parë sektori i botimeve në gjuhën greke me një redaktor. Vetëm në fillim të viteve 80' ky sektor mori një fizionomi më të plotë. Ai u zgjërua me njerëz të tjerë e të rinj, disa prej të cilëve kishin studiuar në Greqi. Të gjitha botimet në gjuhën greke realizoheshin në shtypshkronjën "21 Janari" (më parë "Miqësia") në Gjirokastrë.

Më 1958 Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë në një takim me krijuesit minoritarë, "*mori në analizë zhvillimin e letërsisë në Minoritetin Grek*". Konsideroi sukses botimin deri atëherë të 8 librave me letërsi në gjuhën greke dhe theksoi "*nevojën e edukimit ideoestetik të krijuesve minoritarë grekë, për kuptimin më të mirë të parimeve të realizmit socialist*"⁸⁸.

Më 1968 u krijua në Gjirokastrë dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë për Gjirokastrën, që u pasua

⁸⁸ gaz. Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα, fq. 6, shkurt, 1989.

me vonë me atë të Sarandës. Krijuesit minoritarë u përfshinë në këto struktura krijuese.

V.5. Elemente të tjera të infrastrukturës – kritika

Kritika letrare, si një institucion ndihmës për përparimin dhe rritjen cilësore të letërsisë së Minoritetit Grek, nuk arriti të luante këtë rol. Përkundrazi, ajo u përdor për të thelluar me tej angazhimin e letërsisë pas ideologjisë komuniste. E vërteta është se ajo nuk trashëgoi ndonjë traditë. Po ashtu, kritika në letërsinë e Minoritetit Grek vërteton më së miri parimin stalinist. Me të u morrën njerëz që përfaqësonin në një mënyrë apo një tjetër ideologjinë e partisë. Kritika ishte tejet skematike dhe synonte të evidentonte thjesht mënyrën e mishërimit në përmbajtjen e veprës letrare të kërkesave të partishmërisë. Madje për vepra në greqisht, shkruhej kritikë letrare edhe në gjuhën shqipe.

Vetëm aty nga fundi i vitëve 80, një pjesë e njerëzve që kishin studiuar në Greqi, duket se sollën një frymë të re në këtë drejtim. Ata ishin njerëz të specializuar për letërsi. Zotëronin në mënyrë perfekte gjuhën amtare dhe një kulturë më të gjërë. Megjithatë edhe ata e panë këtë letërsi dhe kulturën e Minoritetit Grek nga këndvështrimi ideologjik i partisë në pushtet. Vënia e autoritetit të tyre kulturor në shërbim të evidentimit të partishmërisë në letërsinë e Minoritetit Grek, ishte me pasoja jo të thjeshta, aq më shumë, po të mendohet se ata nuk patën guximin të kontribuonin në krijimin e kontakteve me letërsinë e kombit am.

Nga ana tjetër, siç e thamë edhe kur folëm për objektin e studimit tonë, në bibliografinë e specializuar të të dy vendeve me të cilat ka lidhje letërsia e Minoritetit Grek, vendi që zë ajo është e pakët. Jo vetëm që nuk ka një studim shkencor për natyrën dhe zhvillimin e saj, por artikuj e studime për probleme e vepra të veçanta janë shumë të rralla e skematike. Po ripërsërisim këtu të dhënat e përmendura në kapitullin e parë.

Në Historinë e Letërsisë Shqiptare, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 1983 dhe në botimin shqip të "Historisë së Letërsisë Shqiptare" të Robert Elsie, Tiranë – Pejë, 1997, Letërsia e Minoritetit Grek nuk përmendet as si pjesë e letërsisë shqiptare (si një vlerë e saj) e as si një fenomen letrar që ndodh brënda shtetit shqiptar.

Ndërsa në edicionin e plotë të revistës “Nëntori” nga 1953-1990 dhe të gazetës “Drita” të së njëjtës periudhe, konstatuam se trajtimi i kësaj letërsie ose nuk ekziston fare, ose është në nivele të recesioneve, lajmeve apo deklaratave politike⁸⁹.

Po ashtu ajo që vihet re është se edhe këto botime të rralla vijjnë duke u rralluar me kalimin e viteve deri në mungesën e tyre të plotë. Kjo ndodh në një kohë që autorë nga Minoriteti Grek si Foto Malo, Spiro Xha, Vasili Melo etj, trajtojnë në shtypin letrar shqiptar probleme teorike dhe konkrete të letërsisë shqiptare⁹⁰.

E kufizuar dhe vazhdimisht duke u zvogëluar është dhe vendi i letërsisë së Minoritetit Grek në tekstet letrare të shkollave të Minoritetit Grek. “*Veprat e shkrimtarëve minoritarë që botohën në totalin e leximeve letrare të pasluftës në shkollat e Minoritetit Grek, deri në vitin 1994 përfaqësojnë vetëm 2.2 përqind të numrit të përgjithshëm të teksteve letrare në këto libra*”, -thotë studiuesi i këtyre teksteve shkollore, Athanasios Paskalis⁹¹

Vetë kjo infrastrukturë e pakët në botime, mjete dhe njerëz në dispozicion të Minoritetit Grek, nuk krijonin një bazë reale për të përkrahur e stimuluar këtë letërsi. Nga ana tjetër, prizmi ideologjik, fragmentarizmi, spontaniteti dhe vlerësimet përgjithësisht jashtë parimeve estetike, janë karakteristikat kryesore të trajtimit të kësaj letërsie në mjetet e komunikimit masiv e letrar të minoritetit në periudhën e pasluftës.

V. 6. Kontaktet me letërsinë e kombit amë

Siç e theksuam edhe gjatë, kontaktet e letërsisë së Minoritetit Grek me letërsinë greke ishin aq të pakta, sa më saktë është të thuash se ishin inekzistente. Dihet se një libër në gjuhën greke i pakontrolluar dhe i palejuar nga sistemi përbënte akt penal –politik.

⁸⁹ Në revistën “Nëntori” problemi i letërsisë së minoritetit grek në aspektin teorik trajtohet vetëm dy herë. Një herë në vitin 1955, nga Spiro Xhai, (Revista “Nëntori”, nr. 10, fq. 119-122) dhe një herë nga Pano Çuka në formën e diskutimit në kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të qërshorit të vitit 1984. (Revista “Nëntori”, nr. 6, 1984, fq. 222-227). Në gazetën “Drita” nuk ka trajtime të kësaj natyre.

⁹⁰ Malo F., “Pasqyrim i fenomeneve të reja që në lindje”, revista “Nëntori”, nr. 1, 1968, “*Toka, ndërgjegjja dhe lëvruesit e tyre*”, revista “Nëntori”, nr. 6. 1969, “*Zhvillimi i vrullshëm i poezisë tonë*”, revista “Nëntori”.

⁹¹ Πασχαλης Σ. Α., 1998, *Τα μεταπολεμικά αναγνωστικά της ελληνικής μειονότητας της Αλβανίας*, (Librat e këndimit të minoritetit grek) Athinë, fq. 297.

Ajo pak letërsi që hynte në Shqipëri, ishte kryesisht letërsi që konsiderohej nga Tirana zyrtare e majtë dhe si e tillë “*përparimtare*”. Ato pak libra vinin kryesisht nga emigrantët politikë grekë në Rumani të cilët kishin themeluar atje shtëpinë botuese «*Νέα Ελλάδα*» (“Greqia e Re”). Nga mesi i viteve 60^{te}, pas prishjes së marrëdhënieve me ish - Bashkimin Sovjetik dhe bllokun tjetër të Lindjes edhe librat e atjeshëm u ndaluan.

Nga ana tjetër, duhet thënë se edhe këto libra ishin shumë të pakët në numër dhe ishin në përdorim të brëndshëm vetëm nga disa veta të besuar të sistemit. Për publikun më të gjërë të Minoritetit Grek, madje, dhe për masën e madhe të krijuesve të tij letrarë, kontaktet me letërsinë greke siguroheshin nëpërmjet përkthimeve në shqip të autorëve grekë nga një gjuhë e tretë, siç ishte në shumicën e rasteve frëngjishtja. Po ashtu në redaksinë e gazetës “*Liaiko Vima*” arrinin nga Greqia disa gazeta të majta, por edhe ato “*për përdorim të brëndshëm*”.

Vonë, aty nga vitet 80^{te}, pas politikës së hapjes që filloi të ndiqte Tirana me Greqinë, u lejuan disa libra shkrimtarësh grekë, por edhe këta duhet të ishin miq të sistemit komunist në Shqipëri, si p.sh: libra të Menellaos Ludemis, të Eli Aleksit, të Llambro Mallamas etj. Një tregues i këtyre marrëdhënieve përbën edhe realiteti i kësaj letërsie në tekstet shkollore letrare. Në leximin letrar të klasës së gjashtë në vitin 1950 numri i pjesëve nga letërsia greke ishte 40, më 1969 ishin vetëm 2 dhe më 1984 ishin 5.

Po ashtu në vetë krijimtarinë letrare në lidhje me Minoritetin Grek ekziston një funksion i dyfishtë. Nga njera anë, nuk ka asnjë referim të lidhjeve midis Minoritetit Grek dhe Greqisë, nga ana tjetër, synohet promovimi dhe kultivimi i marrëdhënieve midis Minoritetit Grek dhe popullit shqiptar.

Duhet theksuar gjithashtu se letërsisë së Minoritetit Grek në Shqipëri, iu imponua ndërprerja e kontakteve me traditën e vet paraardhëse. Në këto rrethana ajo komunikonte me kulturën kombëtare greke dhe traditën e vet nëpërmjet gjuhës, nga njera anë dhe traditës së krijimtarisë popullore, nga ana tjetër. Të dy këta faktorë ishin më shumë rezistentë se përpjekjet ndërhyrëse dhe eliminuese të sistemit komunist ndaj tyre. “*Tradita popullore ishte shumë e fortë, saqë nuk mund ta asnjësonin ndërhyrjet*”, - thotë filologu dhe shkrimtari i njohur grek Hristoforos Milonis⁹². Ato përbënin, njëkohësisht, burimet e vetme për të mbështetur

⁹² Μηλιώνης Χρ., *Η Λογοτεχνία στη Β. Ήπειρο*, (Letërsia në Epirin e Veriut) gaz. “*Kathimerini*”, 6.3.1994, fq. 30.

zhvillimin dhe krijimin e individualitetit të kësaj letërsie. Nga ky fond, kjo letërsi i dha ç'mundte letërsisë shqiptare. Mirëpo, duke qenë se kjo e fundit u kthye në sistem referimi, letërsia e Minoritetit Grek mori prej saj çka i duhej, qoftë për t'u bërë letërsi e kornizave të realizmit socialist, qoftë për t'i shërbyer si e tillë ideologjisë komuniste.

Për të kuptuar se si kjo letërsi u shkëput nga tradita dhe u bë mjet efektiv që edhe receptuesit e saj të bënin të njëjtën gjë, marrim si shembull tregimin e Spiro Xhait, "Rrojet e Republikës"⁹³. Qëndrojmë shkurtimisht te fillimi i tregimit...

... Ishte 11 Jenar 1954, festa e Republikës. Fshatarët e Zervatit ishin mbledhur në shkollë. Dhe mbas pak u nisën të gjithë për në varrezat e fshatit. Përpara shkonin vajzat duke mbajtur një kurorë të madhe prej degësh dafine dhe trandafila dimri. Pak më prapa ecte i zhytur në mendime, Ndini, kryetari i kooperativës bujqësore të Zervatit. Në krah të tij oficeri Luka, që kishte ardhur me leje në fshat nga një repart i kufirit që shërbente..."

Siç mund të konstatohet lehtë, tregimi përngjason më shumë me një reportazh. Nga informacioni që na sjell mund të ndërtojmë strukturën e një komuniteti në një moment ceremoniali - feste: Një festë e re, politike. Festimet fillojnë nga shkolla. Do të nderohet i vrari në varrezat në kishë. Turmës i prin simboli i ri, -kurora. Pastaj protokollin e përbëjnë dy emra që përfaqësojnë institucione të reja, -kryetari i kooperativës që përfaqëson hallkën e re ekonomike dhe një oficer nga fshati që shërben në kufi e na tregon shkallën e devotshmërisë ndaj sistemit. Emrat e personazheve dhe vendi i shpalosjes së ngjarjeve, (fshati ku u themelua kooperativa e dytë bujqësore në Shqipëri), e lejon autorin të tregojë shkallën e lartë të integritimit politik të Minoritetit Grek.

Po të bëjmë një krahasim me traditën do të vëmë re: Festa ose do të jetë popullore, ose fetare. Vendi i organizimit është kisha. Simbolet janë të përcaktuara në varësi të festës. Në krye qëndrojnë zakonisht prifti, mësuesi ose çdo person tjetër i lidhur funksionalisht me festën.

Pra, shikohet qartë se si autori distancohet (nuk e sheh) nga tradita popullore, për të hymnizuar realitetin e ri politik. Vetë forma e përdorur - të treguarit në formën e reportazhit - i shkon më shumë për shtat largimit nga realiteti tradicional dhe angazhimit politik të veprës letrare. Përzgjedhja e rrëfyesit në vet të tretë, i

⁹³ Xha S., 1954, *Rrojet e Republikës*, tregim, revista "Nëntori" nr. 6.

siguron autorit një objektiv për të ditur dhe kontrolluar gjithçka. Dhe të mos harrojmë se jemi në vitin 1954.

V. 7. Nga një letërsi njëgjuhëshe greke në letërsi dygjuhëshe dhe anasjelltas

“*Statusi i greqishtës dhe i shqipes në këtë minoritet (Minoritetin Grek, shën. i autorit) është i barabartë*”, - thekson sociolinguisti i njohur Gjovalin Shkurtaj⁹⁴. Sipas të njëjtit autor, kjo do të thotë... “*përdorimin e njëhershëm dhe konkurent të dy gjuhëve në të njëjtën hapësirë gjeografike, ekonomike ose politike....*”⁹⁵ Në këtë pikë flasim për gjuhën si element i rëndësishëm i një kulture dhe akoma më i rëndësishëm për dallimin e një letërsie të caktuar.

Gjithashtu, realiteti të cilit i referohemi i përket planit aktual kohor. Kjo do të thotë se kemi një evolucion nga një situatë tjetër. Siç e thamë edhe më lart, në periudhën kohore të paraluftës, ku ky komunitet përjetonte statusin e ri të minoritetit etnik, pra, jetonte “*në të njëjtën hapësirë gjeografike, ekonomike ose politike*” me popullin shqiptar, gjuha, aq më tepër letërsia, kishin kontakte të rralla me ato “*të bashkësisë shoqërore*” në mazhorancë.

Në dhjetëvjeçarin e ri të pasluftës fenomenet kishin filluar të ndryshonin dhe realiteti kishte fituar një shpejtësi tjetër nga ajo e aspiratave. Më 1955-ën Spiro Xhai duke folur për zhvillimin e letërsisë në Minoritetin Grek, thekson: “*Fillimi i zhvillimit të letërsisë në minoritetin grek është diçka e re dhe inkurajuese. Por, po të krahasojmë prodhimin letrar të deritanishëm me nevojat dhe kërkesat e masave, do të shohim se akoma është shumë i pakët dhe nuk i kënaq aspak këto kërkesa. Duhet të kemi parasysh, se për arsye të gjuhës popullore e minoritetit në përgjithësi, nuk ka mundësi të përfitojë nga letërsia shqiptare dhe ta shijojë atë...*” - dhe shton si nevojë “*përkthimin e disa veprave të mira të letërsisë shqiptare në gjuhën greke...*”⁹⁶

Konstatimi i Xhait pohon se në përgjithësi minoriteti vazhdon të jetonte në një status monoling dhe orientimi i tij është që ky minoritet të zgjidhë nevojat e tij estetiko – letrare me letërsi të realizmit socialist, por në kuadrin e gjuhës amtare.

⁹⁴ Shkurtaj Gj., 1999, *Sociolinguistika*, Shblu, Tiranë, fq. 195.

⁹⁵ Shkurtaj Gj., 1999, *Sociolinguistika*, Shblu, Tiranë, fq. 173

⁹⁶ Xha S., 1955, *Letërsia e Minoritetit Grek në Shqipëri*, revista “Nëntori”, nr. 10, fq. 121.

Në realitet po ndodhte ndryshe dhe vetë Xhai nga pozicioni i krijuesit kundërshton vetveten. Që në fillimet e letërsisë së Minoritetit Grek krijuesit minoritarë promovuan veten si krijues dygjuhësh. Sinjifikativ është fakti që novela e parë me autor Spiro Xhain "*Kënga e paqes*", 1949, është shkruar në dy gjuhë, greqisht edhe shqip. Ndodh, gjithashtu, që shumë nga veprat e tyre krijuesit me në zë në Minoritetin Grek si Panos Çukas ose Spiros Xhas t'i kenë shkruar fillimisht në shqip e pastaj në greqisht. Kështu Panos Çukas librin "*Ujqër me rasa*" e shkruan në shqip më 1970 dhe në greqisht më 1973. Monografinë "*Thodhoris Mastoras*" e shkruan në shqip më 1976 dhe greqisht më 1977.

Spiros Xhas, historinë prekëse të novelës "*Pesë letra*", 1956, e botoi njëkohësisht dhe në shqip dhe në greqisht. Romani "*Spitali partizan*", 1966, u shkrua fillimisht në shqip e pastaj në greqisht. (Vëmë re këtu faktin që gjuha që paraprin në prozë është shqipja.)

Por, si këta dy autorë, ka edhe të tjerë, si: Nikos Kacalidhas, Fotos Qiriazatis, Thomas Sterios (Sterjopullos) e shumë të tjerë që shkruanin me po të njëjtin sukses libra (poezi) si në shqip ashtu edhe në greqisht.

Nikos Kacalidhas ashtu si Spiros Xhas janë lauruar për botimet në gjuhën shqipe. Ismail Kadareja thotë për Kacalidhën se: "*padyshim hyn në plejadën e poetëve më të talentuar të vendit*". Ndërsa Dritero Agolli thotë: "*Nuk është vetëm poet i Shqipërisë, nuk është vetëm poet i Greqisë, është poet ballkanas dhe me gjërë, evropian...*"⁹⁷

Por, ana tjetër, ndërsa nuk mund të gjesh krijues minoritarë grekë që të ketë shkruar vetëm në shqip, mund të gjesh krijues minoritarë grekë që kanë shkruar vetëm në greqisht. Një nga këta është Andreas Zarballas.

Arsyet e një fenomeni të tillë duhet t'i kërkojmë:

Së pari. Siç na pohon Gj. Shkurtaç, situatat bilingve krijojnë "*konflikte e kontraste të gjuhëve e të kulturave*", të cilat "*politikanët dhe në përgjithësi klasat në pushtet, synojnë t'i zgjidhin duke kërkuar të zbatojnë ose të imponojnë njësim gjuhësor e kulturor, qoftë për motive praktike, qoftë për arsye të mëjtimeve politike apo ideologjike të caktuara. ... ose bëhet njësim që s' është gjë tjetër veçse një përshtatje e pastër dhe e thjeshtë e njerës nga kulturat konkurente që zgjidhet si më eprorja dhe më unikja.*"⁹⁸

⁹⁷ Gazeta. "2000", Prill 2000, fq. 2.

⁹⁸ Shkurtaç Gj, 1999, *Sociolinguistika*, Shblu, Tiranë, fq. 161

Në kushtet e krijuara nga pushteti komunist, pjesëtarët e Minoritetit Grek shikonin mundësinë e mbijetesës dhe të perspektivës duke u përfshirë në shoqërinë shqiptare, por duke zbehur deri në fshehje identitetin e vet ose duke e manifestuar atë formalisht. Pra, kemi më shumë një proces përshtatjeje ndaj faktorëve imponues para se ata të veprojnë. Rrjedhimisht, lëvrimi i letërsisë në dy gjuhë nga ana e krijuesve minoritarë grekë përbënte edhe një tregues më shumë devotshmërie i një forme të veçantë nga ana e tyre.

Së dyti. Faktori i mësipërm orientoi sjelljen e përgjithshme të minoritarëve grekë në Shqipëri. Nga statusi, pothuaj monoling, dalngadalë kaluan në një status:

a. biling, gjeopolitik, (të dy gjuhët greqishtja e shqipja kanë status të barabartë me tendencë për epërsi të theksuar të shqipës. Po ashtu, të gjitha marrëdhëniet me shtetin zhvilloheshin në gjuhën zyrtare).

b. familjar (martesa të përziera).

c. tekniko-ekonomike, (të gjitha format e zhvillimit në ekonomi, kulturë, arsim, depërtonin në veprimtarinë e përgjithshme e të përditshme të anëtarëve të komunitetit grek vetëm në gjuhën zyrtare. Raportet zyrtare kulturore përçoheshin në masën 70 me 30 për qind në favor të gjuhës shqipe. Arsimi i mesëm e i lartë bëhej në gjuhën zyrtare)⁹⁹.

Së treti. Një arsye tjetër përbënte nevoja për sa më shumë lexues, aq e domosdoshme për njerëzit e letrave. Në kushtet e Shqipërisë së izoluar publiku i vetëm e i gjërë ishte lexuesi shqiptar. Pastaj edhe jeta letrare me konkurrencën, dekorimet dhe laurimet e saj bëhej në gjuhën shqipe. Sipas N. Kacalidhës, *“duke qenë se letërsia dhe artet nuk njohin kufij shtetërorë e kufizime gjuhësore, për një shkrimtar është nevojë e brëndshme kontakti me sa më shumë lexues dhe ky auditor i gjërë ishte lexuesi shqiptar”*¹⁰⁰.

Kjo nevojë rritej edhe për faktin se kishim një zvogëlim relativ të lexuesve minoritarë grekë. Ndodhte kështu për shkak se njohja dhe përdorimi i gjuhës amtare greke pakësohej me kalimin e kohës. Pakësimi ishte pasojë e ngushtimit të mësimin në shkolla

⁹⁹ Barkas P., 2001, *Kërkime universitare* 5, Gjirokastër 2001, fq. 121-127

¹⁰⁰ Kacalidhas N., nga diskutimi në takimin midis krijuesve grekë nga të dyja anët e kufirit në universitetin e Gjirokastrës, 31.05.2004.

dhe i perceptimit të zhvillimeve ekonomike në vend, sidomos, në fushën e bujqësisë, nëpërmjet gjuhës shqipe.

Kjo ka vlerë edhe për krijuesit, të cilët në shumicën dërrmuese të rasteve arsimoheshin në gjuhën shqipe.

Nga ana tjetër lexuesi minoritar, e kishte praktikisht të pamundur të gjente në gjuhën amtare korpusin e madh të letërsisë botërore. Bile, askush nga përkthyesit minoritarë nuk mori përsipër të përkthente një vepër të letërsisë botërore në gjuhën greke. Madje, siç thamë, edhe atë pak letërsi greke lexuesi minoritar e gjente në greqisht të përkthyer nga shqipja dhe vetë përkthimi shqip ishte bërë nga një gjuhë e tretë.

Një situatë e tillë kishte bërë që në fund të viteve 70^{te} fillim i viteve 80^{te}, raporti i letërsisë dygjuhëshe të shkruar nga minoritarët grekë të ishte në mënyrë absolute në favor të letërsisë së shkruar në gjuhën shqipe.

Nuk mund të mos vëmë re gjithashtu se largësia gjeografike nga treva homogjene e Minoritetit Grek, çonte jo vetëm në stimulimin e prodhimit të letrare në gjuhën shqipe, por edhe në zbehjen gjithnjë e më shumë të elementeve stilistike, leksiko-frazeologjike e tematike që kishin lidhje me origjinën e tyre. Shembull tipik përbën Spiro Xhai kur shkruan në gjuhën shqipe.

Nevoja e hapjes me Greqinë, e konstatuar pas vizitës së Enver Hoxhës në Gjirokastrë dhe Grapsh mars 1978, i dha fund këtij fenomeni. Inkurajimi i politikës për të shkruar në gjuhën greke gjeti përkrahjen dhe mbështetjen e vet krijuesve minoritarë. Momenti përkon, gjithashtu, me periudhën kur brezi i ri i krijuesve minoritarë po arrinte pjekurinë e vet letrare.

Këto luhataj përbëjnë edhe një nga karakteristikat dalluese të kalimit nga faza e parë në fazën e dytë të letërsisë së Minoritetit Grek. Ndërsa në fazën që do të pasojë, atë pas viteve 90^{te} do vihet re fenomeni i kundërt, i distancimit nga krijimtaria letrare në gjuhën shqipe.

Kuptohet që në kushtet e globalizmit të përgjithshëm që jetojmë, lëvrimi i një letërsie dygjuhëshe nga ana e një minoriteti, përbën një vlerë të padiskutueshme letrare. Por kjo nuk mund të thuhet për rastin konkret, se letërsia e këtij minoriteti nuk kishte asnjë kontakt me letërsinë tradicionale e bashkëkohore greke. Si rezultat, nuk mund të luante rolin e ndërmjetësit dhe ndikimit reciprok midis letërsisë shqiptare dhe asaj greke.

Negativisht ndikon në këtë drejtim dhe fenomeni i ri që karakterizon fazën në vijim të viteve 90^{te} të Letërsisë së Minoritetit Grek. Krijimtaria letrare e autorëve minoritarë grekë, shkruhet

kryesisht në gjuhën amtare dhe fare pak nga ata, si Nikos Kacalidhas, këmbëngulin të shkruajnë akoma në të dyja gjuhët. Ndërsa Jorgos Çatis, edhe pse shfaqet në letërsi pas viteve 90të, shkruan vetëm në gjuhën shqipe. Në gjashtëmbëdhjetë librat e tij të botuara pas 1995-ës, pjesa më e madhe në poezi, Çati manifeston një tendencë të hapur përfshirëse në letërsinë shqiptare.

V. 8. Lëvrimi vetëm në gjininë e poezisë

Në prill të 1990^{ës} gazeta “Llaiko Vima Letrare”, nisur nga shqetësimi se lëvrimi i prozës nga autorët minoritarë në gjuhën greke kishte mangësi të theksuara, organizoi një debat në të cilin kërkoheshin ndër të tjera shkaqet e moslëvimit të prozës. As që bëhet fjalë për dramaturgjinë.

Po sjell në vijim disa nga përgjigjet.

Spiros Xhas: *“Letërsia në gjuhën greke në vendin tonë, me ndonjë përjashtim të vogël, filloi të shkruhet pas çlirimit ... dhe normale është të fillonte me poezinë.”*

(Shënojmë se 14 vjet me vonë në një intervistë të bërë për këtë problem nga unë iu përgjigj së njëjtës pyetje: *“Eshtë e vërtetë se sistemi komunist bëri ç’ është e mundur që letërsia jonë në gjuhën amtare të zhvillohej vetëm si poezi. Ne prozatorët u orientuam të shkruanim prozë vetëm në gjuhën shqipe.”*)

Andreas Zarballas, në diskutimin e çelur nga gazeta, pranon vetëm se nuk mund të flasim për arritje në fushën e prozës në gjuhën greke.

(Shënojmë se 14 vjet më vonë në një bisedë po për këtë problem jep këtë shpjegim: *“Proza ka të bëjë me një problematikë më komplekse dhe kërkon forca krijuese të afta për ta trajtuar atë.”*)

Thomas Sterjos (është fjala për Thomas Sterjopullos, i cili në gjithë periudhën e veprimtarisë së tij letrare në Shqipëri firmoste me emrin Thoma Sterjo, ndërsa pas vitit 1990 nderoi mbiemrin në Sterjopullos, mbiemër që familja e tij mbante para vitit 1950 në Shqipëri): *“Do të desha t’i referohesha mungesës së traditës si dhe mungesës së përvojës së duhur të forcave krijuese për këtë gjini.”*

Fotos Malos: *“Shkaqet e dobësive duhën kërkuar brënda dhe jashtë tregimit. Përvoja e pakët në krahasim me poezinë.”*

Eshtë fakt se Letërsia e Minoritetit Grek nisi paralelisht në poezi e në prozë.

Prozën në gjuhën amtare e inaguron më 1949^{en} Spiros Xhas me novelën “*Kënga e paqes*” në dy gjuhë, shqip edhe greqisht dhe siç e thamë më 1953 u botua si libër me vete nën titullin “*Përkundruell Murganës*”. Një vit më vonë i njëjti autor boton vëllimin me tregime “*Rojet e demokracisë*”.

Ky autor jo vetëm që e inaguroi, por e mbajti gjallë këtë krijimtari për një dekadë e gjysmë, pavarësisht se boton paralelisht edhe shqip. Boton në vijimësi, madje, me suksesin e kohës, disa novela, (“*Dashuria cingane*”, “*Pesë letra, -një histori e vërtetë*” bile edhe romane si “*Spitali partizan*” i lauruar më 1966 dhe i përkthyer në disa gjuhë.)

Po ashtu proza në letërsinë e Minoritetit Grek në llojin e tregimit u rishfaq dukshëm pas mesit të vitëve 80^{te}, që është një periudhë kur shtrëngesat e izolimit totalitar kishin filluar të liroheshin.

Kjo tregon se nuk ishte pengesë për lëvrimin e saj as mungesa e përvojës letrare dhe as kompleksiteti i problematikës. Këtë e vërteton edhe realiteti i viteve pas rënies së diktaturës në Shqipëri. Proza bëhet pothuaj mbisunduese dhe në të gjitha llojet. Vëllimet me tregime, novelat dhe romanet e autorëve minoritarë në gjuhën amtare konkurojnë me sukses edhe në letërsinë greke.

Pra, edhe mendimi ynë përkon me mendimin e shfaqur se arsyeja pse nuk u lëvrua proza duhet kërkuar te drejtimi politik. Përvoja jonë personale na jep të drejtën të themi, gjithashtu, se stimulli vetëm i poezisë në krijimtarinë letrare në Minoritetin Grek, lidhet me argumentin politik se ky minoritet si “*i vogël në numër*”, nuk duhet të manifestonte aftësi dhe vlera të qenësishme të një komuniteti me pretendime të tjera në krijimtarinë letrare.

Ky qëndrim ka vlerë vetëm për letërsinë e shkruar në gjuhën amtare dhe jo atë të shkruar në shqip nga krijuesit minoritarë (si në rastin e Xhait). Po ashtu në lloje të tjera arti, përceptimi i të cilave kërkon një nivel të specializuar kulturor, si: piktura, skulptura etj, nuk u vu re e njëjta taktikë. Fakt është që piktorët, skulptorët, aktorët e kësaj përkatësie etnike nuk kishin kufizime për të krijuar në lloje të caktuara arti.

Problemi doli në fushën e muzikës. Aty nga mesi i viteve 80, kur një grup muzikantësh dhe letrarësh të Minoritetit Grek në Gjirokastër, tentuan të kompozonin e interpretonin këngë në gjuhën amtare jashtë kuadrit folklorik, u ndërhy me metoda të buta për të hequr dorë nga kjo përpjekje me preteksin se Minoriteti Grek ka për traditë vetëm folklorin.

Në fakt, ekziston një lidhje e qëndrueshme midis poezisë së kultivuar të poetëve minoritarë me folklorin, të cilën mund ta vemë

re po të krahasojmë stilistikën e figuracionin në krijimtarinë popullore me poezinë, sidomos, të fazës së parë. Në përgjithësi, rima-rrja e elementeve nga realiteti letrar i traditës popullore shfrytëzohet nga krijuesit minoritarë, ashtu si dhe shqiptarë, jo thjesht për t'i dhënë letërsisë frymë popullore apo vlera të veçanta. Më shumë është kërkesë e orientuar për të ndihmuar që, fenomenet shoqërore që impononte politika sociale e pushtetit, të pranoheshin si produkt popullor. Gjithashtu, kjo poezi po përdorej me të njëjta funksione si tek folklori. Përbënte një mjet efikas për të mitizuar udhëheqjen komuniste.

Forma folklorike e poezisë në letërsinë e minoritetit zgjidhte, njëkohësisht edhe dy funksione të tjera. Ishte mjeti më i mirë për t'i krijuar këtij minoriteti përshtypjen se mbante lidhje me traditën e vet dhe për pasojë, i krijonte përshtypjen se kjo ishte mënyra më e mirë, për të plotësuar dhe shprehur kënaqësinë dhe emocionin e vet.

Për të njëjtat arsye kjo përbënte tendencën e përgjithshme të letërsisë së kësaj periudhe në Shqipëri. Këtë e tregojnë më së miri edhe të dhënat statistikore. 40% e botimeve në Shqipëri në periudhën 1944-90 ishin poezi. Në Perëndim këto raporte janë diçka krejt të papërfytyrueshme. Por ka edhe më keq. Në Kosovë deri në 70 % e krijimtarisë letrare e përbënte poezia.¹⁰¹ Raportet e kësaj natyre në Kosovë kanë një shpjegim. Përderisa letërsia këtu ka një angazhim të theksuar kombëtar, kuptohet që do të përdoret edhe mjeti më i mirë për kultivimin dhe promovimin e kësaj ndjenje dhe ky mjet është poezia.

Në letërsinë e minoritetit grek gjërat janë akoma më të rënda. Poezia e kalon masën 90% të krijimtarisë letrare në përgjithësi dhe kuptohet se nuk ka asnjë arsye objektive për të pasur raporte të tilla.

¹⁰¹ Elsie R., 1997, *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë – Pejë, fq. 417

KREU I GJASHTË

FAZAT KRYESORE TË LETËRSISË SË PAS LUFTËS, TIPARET DALLUESE, PËRFAQËSUESIT

VI.1. *Klasifikimi*

Duke u nisur nga pozicioni apo marrëdhëniët e letërsisë së Minoritetit Grek me pushtetin komunist do të mund ta ndanim në: Letërsi “të burgosur”¹⁰² ose “të ndaluar” dhe letërsi “të lirë”.

Letërsia “e burgosur” përbëhet nga krijimtaria e njerëzve, të cilët, për shkak të kundërshtimit të regjimit komunist fizikisht ose shpirtërisht ishin të burgosur, të internuar, me biografi të prishur dmth, nuk gëzonin qoftë edhe ato liri dhe ato të drejta qytetare që pushteti komunist u lejonte njerëzve të tjerë. Si rezultat kjo letërsi nuk i shërbeu regjimit dhe ishte kundërshtarë e tij. Njëkohësisht, ajo ishte thellësisht e angazhuar me fatin e lirisë së individit dhe identitetit etnik të vëna në rrezik. Lëvrohet në kushte të vështira. Mban komunikim me letërsinë e kombit am të një periudhe të caktuar dhe shkruhet kryesisht në gjuhën amtare greke. Kjo letërsi nuk kishte parë dritën e botimit deri në rënien e regjimit komunist.

Letërsia “e lirë”. Do të mund ta ndanim në dy grupe. Në grupin e parë mund të përfshijm letërsinë që ka si karakteristikë krijimtarinë me autocensurë, dmth krijuesit të ndodhur midis ndërjegjes së plotë për rolin e letërsisë dhe pamundësisë, për t’iu përkushtuar letërsisë së vërtetë ose përdorën sisteme metaforiko-alegorike në krijimtarinë e tyre, ose shkruanin paralelisht dhe letërsi të realizmit socialist dhe një letërsi tjetër, për një kohë tjetër.

Grupi i dytë përmbledh krijimtarinë thellësisht të angazhuar. Kjo letërsi përshkohet nga parimet e realizmit socialist të diktuar nga pushteti komunist në Shqipëri. Karakteristikë tjetër e rëndësishme e saj është humbja e komunikimit me letërsinë kombëta-

¹⁰² Ne do të përdorim këtu termin “letërsi e burgosur”. Nisemi nga arsye thjesht emotive, duke qenë se ky term është përdorur deri tani në qarqet letrare të minoritetit për letërsinë e periudhës së pasluftës që nuk kishte lidhje me pushtetin.

re greke. Lidhjet me të dhe me krijimtarinë letrare të krijuesve me origjinë nga Minoriteti Grek janë inekzistente, me përjashtim të rasteve të rralla. Po ashtu, kësaj letërsie iu mohua çdo lloj trashëgimie duke konsideruar si fillime të veta letërsinë e periudhës së Luftës së Dytë Botërore.

Si në aspektin e parimeve, ashtu edhe përsa u përket ligjë-sive të tjera të zhvillimit, ajo ndikohet fuqishëm nga letërsia shqiptare **dhe përbën një pjesë të letërsisë shqiptare të realizmit socialist e shkruar në gjuhën greke.** Si pasojë, kjo letërsi shfaq interes për identitetin dhe kulturën e Minoritetit Etnik Grek, ose në mënyrë indirekte, ose për ta vënë në shërbim të ideologjisë komuniste. Ajo ndjek zhvillimin e letërsisë shqiptare të periudhës së pasluftës dhe kalon nëpër dy faza. Faza e parë shkon si kohë deri në vitet 70 dhe faza e dytë deri në vitet 90. Zhvillohet kryesisht si poezi. Në aspektin e gjuhës që lëvrohet vihet re kalimi nga letërsia kryesisht në gjuhën amtare, në letërsi bilinge, ku letërsia e shkruar në gjuhën shqipe deri nga mesi i viteve 80, kishte fituar epersi ndaj asaj në gjuhën amtare.

VI.2. Letërsia “e burgosur”

Karakteristikë e kësaj letërsie është fakti se ambienti mbytës dhe përndjekjet nga regjimi komunist identifikohen me fatin e të qenit “*minoritar*”, gjë që krijon ngarkesën e rëndë emocionale të shkëputjes nga kombi am dhe nostalgjinë e lirisë së humbur. Te kjo letërsi dhimbja dhe protesta janë mbisunduese, pavarësisht nga dukja. Ajo komunikon drejtpërdrejt me këtë dhimbje që është sa e njerëzve, aq edhe e ambientit që rrethon krijuesit e saj. Ndërsa revolta i ngjan një vullkani që e di se nuk mund të shpërthejë. Duhet vënë re këtu një fakt shumë domethënës.

Revolta në këtë letërsi nuk ka lidhje me njerëzit e thjeshtë të popullsisë shqiptare. Përkundrazi, ata konsiderohen “*bashkëvuajtës*”. Revolta nuk drejtohet as kundër “*ambientit*” shqiptar në përgjithësi. Disa nga autorët e letërsisë së burgosur të Minoritetit Grek shkruajnë, madje edhe në gjuhën shqipe. E vërteta është se krijuesit e letërsisë së burgosur të Minoritetit Grek, ashtu si gjithë të përndjekurit e tjerë, ndihën shumë pranë me bashkëvuajtësit shqiptarë. Ata i afron kundërshatari i përbashkët politik, produkt i ideologjisë komuniste dhe i veçon, pa i armiqësuar, fakti se liria për krijuesit minoritarë ka dhe një vlerë tjetër. Është e lidhur me mohimin e kombit amë.

Kjo letërsi u shkrua nga tre kategori krijuesish.

a. **Kategoria e parë** përbëhet nga krijues që vuajtën denimin nëpër burgje, kampe internimi apo që provuan privimin e lirive civile. Përfaqësues kryesorë të kësaj kategorie mund të përmendim Niko Filipa Zahon, Foto Qiriazatin etj.

Nikos Filipa Zahu. U lind më 1929 në fshatin Lugar. Pas çlirimit familja e tij u shpall “kulake”. Vëllai i tij i madh vdiq në burgun e Spaçit, ndërsa tjetri në internim. Më 1948 vetë ai tentoi të arratisesh me not. U arrestua dhe u dënua me 18 vjet burg. Në burg mësoi edhe dy gjuhë të huaja. Shkroi përveç poezive edhe një ditar, të cilin nuk e gjeti, pasi vendi ku e kishte propozur ishte transformuar. Të njëjtin fat kishin edhe poezitë për tre vëllime poetike. Kur u lirua nga burgu 1966 dhe u bë e njohur se shkruante letërsi e riarrestuan. Fitoi lirinë më 1990.

Poezitë që shpëtuan i përmbloodhi në një vëllim poetik të botuar në Korfuz më 1992. Poezia e parë mban datën 1957 dhe e fundit u shkrua më 1990. Ato kanë shtrirjen gjeografike të burgjeve, kampeve të përqëndrimit dhe internimeve të të gjithë Shqipërisë. Fillojnë me burgun e Gjirokastrës dhe të Tiranës, dhe përfundojnë me kampet e përqëndrimit në Laç dhe në Mamuras. Pjesa më e madhe e poezive u shkrua në Llakatund. Vetëm një poezi është shkruar në liri në vitin 1957. Vdiq “i varfër, por i nderuar” dhe pa familje më 2003 në Korfuz.

Në parathënien e përgatitur nga botuesi i vëllimit të tij poetik thuhet ndër të tjera “Zahua ka për ne flakën që nuk shuhet kurrë, është njeriu mendimtar që ka vizione, është njeriu i thjeshtë që ngjitet në ndërgjegjen tonë. Është poet i vërtetë përderisa nuk u shërben regjimeve, por sakrifkohet në emër të muzës dhe i shërben ndjenjës”¹⁰³.

Ah! Do të desha me këngë
Të prisja ardhjen e agimit
Pranverës t'i hiqja çdo brengë
Dritë t'i shtija lulëzimit

Αχ! Ήθελα με τραγούδια
να τραγουδήσω την αυγή
την Άνοιξη με τα λουλούδια
που ομορφαίνουνε τη γη

Por unë s'mundem të këndo
Zëri më mbytet në fyt
Lërmë, zemra ime, të lotoj
Diçka më sëmbon, më ndrydh

Μα δεν μπορώ να τραγουδήσω
με πολυβόητη φωνή
άσε, καρδιά μου, να δακρύσω
κάτι με σφάζει με πονεί.....

¹⁰³ Νικό Φίλιππου Ζάχου, *Ποίηματα* (poezi), Korfuz, 1992, fq. 9.

Kështu shkruan poeti në një nga poezitë e tij në burgun e Gjirokastrës më 1958. Vargu i tij është i thjeshtë. Përdor strofën me numër të ndryshëm vargjesh, me rimë dhe pa rimë. Gjuha është popullore. Nuk shprehet me figuracion të zgjedhur apo të ndërlikuar. Interesohet më shumë për shprehjen e drejtpërdrejtë të ndjenjave. Në poezitë e tij nuk kemi një duel të vazhdueshëm të poetit me pushtetin në emër të lirisë, por edhe njeriun të mbushur me mallin e dashurisë për ajrin e pastër, për shaminë dhe emrin e një vajze, për të afërmit. Të gjitha këto edhe pse trajtohen si elementë jetësorë që i mungojnë, nuk e bëjnë pesimist.

Fotos Qiriazatis. U lind më 1942 në fshatin Llazat të Sarandës. Më 1968 u diplomua në fakultetin filologjik të Universitetit të Tiranës. Një vit më vonë u dënua me një vit riedukim nëpërmjet punës dhe më 1987 u dënua me 15 burg si organizator i një grupi nacionalist grek.

Më 1961 kishte botuar vëllimin poetik *“Fluturimet e para”*, më 1969 *“Hapat”*, dhe më 1979 *“Rruga drejt burimeve”*. Para periudhës së burgimit tre herë kishte paraqitur për botim një vëllim me tregime që më pas e titulloi *“Bërtitje në mesnatë”* («*Κραυγή στη νύχτα*») dhe të tri herët i ishte kthyer mbrapsht *“për gabime ideologjike”*. *“Më 1970, -thotë në kujtimet e veta autori,- libri u varros për herë të parë me shënimin: “I dashur mik, kushdo qofsh, bëj pak durim që të lexosh këto rreshta. Këtu do të gjesh rrekat e një jete që pikon gjak”*.

Do ta ripunojë dhe do ta botojë si libër të periudhës komuniste më 1992 me titullin e lartpërmendur («*Κραυγή στη νύχτα*»). Vlerësimet në Greqi të letërsisë së Qiriazatit janë nga më pozitive. Ai cilësohet si një shkrimtar që *“kërkon bindshëm një vend në letërsinë moderne greke”* dhe vazhdon më poshtë: *“Kjo poezi dhe kjo prozë kaluan mes për mes errësirën e natës dhe nuk u nxinë, nuk u vyshkën”*¹⁰⁴.

“Qiriazatin mund ta karakterizojmë si një mjeshtër të vërtetë të fjalës që ka shkruar disa nga faqet më të mira të prozës së re greke”.¹⁰⁵

Të po kësaj periudhe janë edhe poezitë e vëllimit «*Φωτολούλουδα*» (*“Luledrite”*). Bile, ai mban mend se këto poezi janë shkruar në dimrin e vitit 1987 deri në korrikun e po atij viti në hetimesinë e Tiranës, midis seancave të hetimit dhe të torturës. *“Na-*

¹⁰⁴ Shtëpia botuese “Akritas” Athinë, 1992

¹⁰⁵ gaz. Κυριακατική Ελευθεροτυπία, 31. 01.1993

tyrisht nuk bëhej fjalë për bojë dhe penë. M'u desh përseritje e përditshme për t'i mbajtur në kujtesë,"- thotë poeti. Dy vjet me vonë, më 1989, ai i futi poezitë e tij në tubeta boshe pastë dhëmbësh dhe me ndihmën e bashkshortës i nxorri nga rrethimi i burgut.

Në fakt, prodhimtaria letrare e Foto Qiriazatit shpalolet pas viteve 90^{të} në Greqi, e cila i jep një vend nderi në letërsinë moderne greke dhe me siguri e rrjeshton atë edhe në kategorinë e dytë të letërsisë së burgosur të Minoritetit Grek në Shqipëri. Dallohet si prozator me romanet e tij dhe si poet. Karakteristikë mbetet fakti se Fotos Qiriazatis, edhe pse pas vitit 1990 banon në Greqi, tematika e krijimtarisë së tij letrare mbetet e lidhur ngusht me vendlindjen, njerëzit e saj dhe problemet e tyre. Kjo e bën atë të ndryshojë nga shumë njerëz të letrave nga minoritetit grek me banim në Greqi, të cilët pas hapave të para letrare me burim frymëzimi atdheun e veçantë, rrokën një tematikë të përgjithshme letrare. Po ashtu Fotos Qiriazatis i dublon titujt e veprave të tij, ose në ribotimet e tyre u ndryshon titullin.

Nga proza e Qiriazatit përmendim romanin me dy vëllime «*Άκου τι σου σφυρίζει ο άνεμος, Κυνηγώντας την ομορφιά*», (“*Dëgjo ç’të thotë era, Duke ndjekur bukurinë*”), 1998, i cili mund të gjendet dhe me titullin «*Η κόρη του ποιητή*» (“*Vajza e poetit*”), si dhe dy romanet e tjera «*Το μυθικό ανάκτορο*» (“*Pallati mitik*”) 2018 dhe «*Όταν βούιζε η Μπίστρισα*» (“*Kur buçiste Bistrica*”).

Nga poezia përmendim: «*Ποίηση*» (“*Poezi*”) 2007, një përmbledhje të poezive më të mira të periudhës 1966-1991, «*Φύλλο ζωής*» (“*Gjethë jete*”) 2017.

Po ashtu Fotos Qiriazatis është marrë me studime të ndryshme me objekt kryesisht letrat dhe kultura në Minoritetin Etnik Grek.

Sido që të jetë, Fotos Qiriazatis njihet si njeri rebel i letrave dhe i jetës shoqërore, të cilin e përçon tej e mban dëshira e zjarrtë për liri, dashuria e madhe për njerëzit dhe vendlindjen e tij. Shquhet për një stil energjik e patetik, por që di të përdorë edhe tone të ulëta. Ndjenja e dëshpërimit është e pranishme, por kurrë ai nuk di të qajë. Edhe në momentët e dëshpërimit më të madh, di vetëm të nderzë një pishtar shprese në zjarrin e dashurisë për vendin e tij, për lirinë, në kuptimin më të gjërë të fjalës.

b. Kategorinë e dytë e përbëjnë krijues minoritarë të cilët ose nuk mund të botonin letërsi për shkak të “*biografisë*”, ose përmbajtja e krijimtarisë së tyre artistike ishte “*antikushtetuese*”, pra nuk mund të botohej. Dallojmë dy grupime.

Në grupimin e parë hyjnë ata krijues që shkruanin letërsi dhe e mbanin të fshehur “*në dhe*”, duke pritur një ditë më të mirë për botimin e saj. Përmendim Vangjeli Vasiliun, Aristidhi Qirushin, Foto Qiriazatin dhe, sipas pohimeve të tyre, Niko Litin, Andrea Zarballanë etj.

Kishte nga ata krijues që, njëkohësisht mund të shkruanin edhe për llogari të parimeve të realizmit socialist. Kjo letërsi ishte produkt i autocensurës. Ndodhte shpesh që shkrimtari apo poeti, i ndodhur midis nevojës për t’u autocensuruar dhe ndërgjegjes për misionin e vërtetë të letërsisë të kërkonte forma të tilla shprehjeje e komunikimi që u jepnin veprave të tyre vlera të veçanta artistike.

Burim mjetesh të tilla shprehëse ishte krijimtaria popullore, e cila fitonte automatikisht disa funksione. Shërbente, siç thamë, si ushqim për këtë letërsi dhe njëkohësisht si mjet komunikimi me traditën e mohuar në emër të “*realitetit të ri të partisë*”. Shërbente njëkohësisht edhe si një mënyrë për ta mbajtur gjallë dhe në veprim vetë traditën. Një shembull të tillë përbën poeti dhe publicisti Andreas Zarballas.

Andreas Zarballas,

Në shënimet e veta lidhur me vëllimin e tretë poetik të tij, “*101 ποιήματα για μια χούφτα χώμα*” (101 poezi për një grusht tokë), botuar më 1992, ai thotë se “*101 poezitë e këtij vëllimi, janë shkruar në vitet 1970 deri më 1990. Lexuesi i vetëm ishte e shoqja, e cila dinte edhe vendin që ato groposeshin*”. Ajo nuk rrojti për t’i parë ato të botuara dhe Zarballas ia dedikoi asaj librin me shënimin: “*Merit të dashur. Kur ato ishin nën dhe ajo ishte midis nesh. Tani që këto poezi dolën në dritë të diellit, ajo nuk është më.*” Numri 101 në titull lidhet me shprehjen aq shpesh të degjuar në minoritet për dënimet e rënda, deri kapitale, të gjykatave komuniste në dëm të minoritarëve grek. Atëherë doli nevoja e një tabuje. Tabuja ishte “*U dënua më 101*”, dmth, u dënua me 101 vjet burg. Pra, nuk kishte më shpëtim për të dhe liri për familjen e tij. Kjo skenë vizatohet drithëruese në poezinë me titull “*Automjeti me Nr.11*”. Fjala është për numrin (targën) e “*gazit të degës së punëve të brëndshme*” të rrethit të Sarandës. Në atë kohë të gjithë e dinin se kudo që kjo makinë shfaqej, do të ndodhte arrestimi i radhës. Poeti për ta bërë më të frikshme këtë gjëmë e vlerëson atë nga këndvështrimi i fëmijëve, të cilët në vend që të gëzoheshin se shikonin një makinë, siç do të qe e natyrshme për kohën, ata shprehën bashkë me poetin.

<i>Makina me Nr. 11 lëron fshatrat tona</i>	<i>Το αυτοκίνητο Αριθ.11 αλωνίζει τα χωριά μας</i>
<i>Nga pas</i>	<i>Πίσω του</i>
<i>Lë dy vragë paralele</i>	<i>αφήνει δύο παράλληλες γραμμές</i>
<i>Plot hieroglifë</i>	<i>γεμάτες ιερογλυφικά</i>
<i>Këtë shkrim e njohim.</i>	<i>Αυτή τη γραφή τη γνωρίζουμε.</i>
<i>Eshtë i vdekjës</i>	<i>Είναι του θανάτου</i>

Poezitë e kësaj përmbledhjeje, përbëjnë një mohim rebelues të realitetit ku jetonte poeti. Ato mbajnë të shpalosur gjithë ndërgjegjen e tij, njerëzore e poetike. Poeti është i ndërgjegjshëm se, po të diktohej forca shpërthyesë që zotërojnë vargjet e tij, do të provokonin zemërimin “e Perëndisë së Tmerrit” ndaj tij. Ndaj edhe ai ua besoi ato baltës së vendlindjës së tij dhe Merit që, në fakt, përbëjnë në një kuptim më të gjërë dhe pikënisjen për simbolikën e veçantë të tij. Zarballai nuk na shfaqet as si “dehero” e as si hero. Na shfaqet thjesht si poet dhe si njeri në një pozicion të dyzuar, që e kupton se ishte më mirë të jetoje në atë skëterrë, me qëllim të ndizje qoftë edhe fshehuarazi një qiri, se të kërkoje vdekjen qoftë edhe si hero.

Duhet thënë, gjithashtu, se edhe tek këto poezi Zarballai operon me të njëjta mjete shprehëse: simbolin, metaforën, paralelizmin. Ai riaktivizon me një dinamikë dhe filozofi të re mesazhet e krijimtarisë popullore tradicionale, për të krijuar kozmosin e atdheut të tij të veçantë si në aspektin diakronik, ashtu dhe aktual. Ai niset nga momenti i realitetit dhe zhytet në ndërgjegjen e koduar të identitetit kolektiv të dhënë me simbolikën, mitet dhe metaforat e vetat. Në vijim rikthehet te realiteti i tij me mesazhet poetike të siguruara nga kjo trashëgimi kolektive, por duke shtuar elemente poetike të tij.

Vangjelis Vasiliu. U lind në Kalcat të Sarandës, më 1918. Që në moshë fare të re, ai botoi poezitë e para të tij në shtypin letrar të kohës në Greqi dhe u konsiderua një penë me pretendime të mëdha poetike. Si shumë të tjerë nga Minoriteti Grek, gjatë Luftës së Dytë Botërore iu bashkua lëvizjës partizane ku vazhdoi të shkruajë poezi, tani në shërbim të luftës. Është autori i baladës së famshme për heroin Lefteri Talo. Më 1946-1949 burgoset dhe akuzës së prokurorit si filogrek, ai i përgjigjet: “*Gabim, zoti prokuror! Jam grek safi. Filogrek mund të jetë një italian ose ndo një tjetër.*” Pas burgut, kur miqtë e tij i kërkuan të shkruajë sërish poezi, ai iu përgjigj: “*Zemra e poetit nuk i ngjan ziles që tringëllin kurdoherë që dikush i bie.*”

Vdiq më 1991 duke lënë një pasuri poetike të pabotuar dhe ditarin e tij të gjatë. Në vitin 1996 vajza e tij botoi në Qipro një libër të vogël me poezi të tij me titull «*Τραγούδια για τη Κατερίνα Κατερίνα*» (Këngë për Katerinën), Nikosia (Qipros).

Në grupimin e dytë, përfshihen ata krijues që krijimtaria e tyre e vërtetë shpërtheu pas rënies së pushtetit komunist. Përmendim këtu Vasili Gjizelin, Tilemaho Koçën, Jorgo Çatin, Grigor Jovanin etj. Krijimtaria e tyre dallohet për një prodhimtari të lartë. Gjithashtu, edhe pse ata janë vuajtës të sistemit komunist, edhe pse tematika e veprave të tyre është e lidhur shpesh me realitetin e periudhës komuniste, krijimtaria e tyre letrare është e çliuar nga mllfet personale. Ata shpalosin hapur filozofinë e paqes dhe të faljes, nën devizën se privimet e tyre nuk duhet t'i provojnë dhe të tjerë. Por, megjithatë, sado “*froidiste*” të duket kjo, këta krijues nuk mund të fshehin në krijimet e tyre dëshirat të paplotësuara në kohën e duhur.

Vasilis Gjizelis. U lind më 1938 në fshatin Plakë të Sarandës. Studimet e larta për filologji në Universitetin e Tiranës i filloi më 1959, por nuk i mbaroi. I arrestuan të atin me akuzën për “*shovinizëm*”. Gjyqi vendosi që i ati të ekzekutohet dhe vetë Vasilis dhe familja e tij të internohën në Krujë. Në internim ai dhe familja e tij mbëten deri me 1990.

Në gusht të 1990^{ës} largohet nga Shqipëria dhe vendoset në Greqi. Për një periudhë shtatëvjeçare, nga 1991-1997, boton shtatë libra, shumica me poezi: «*Δύσκολη πορεία*» (“Rrugë e vështirë”), Athinë, 1991; «*Ελευθεριάδα*», (“Iliriada”) Athinë, 1993; “Puthja Blu” Elbasan, 1993; «*Υπάρχω*» (“Ekzistoj”), Athinë, 1994; «*Πάψε να μου το λες*» (“Pusho se thëni”), Athinë, 1994; «*Σε ματωμένο κύκλο*» (“Në rreth të gjakosur”), Athinë, 1997; «*Βαλκανιάδα*» (“Balkanjada”), Athinë, 1997.

Ajo që duhet thënë për poezinë e Gjizelit është fakti që mllafi i tij poetik shpërthën pas kaq vitesh ndrydhjeje. Ai merr me vete përjetimet e një jete plot mohime, frenime dhe zvetënime, për t'i bashkuar me shqetësimet e përgjithshme të kohës së brezit të tij dhe të së ardhmës. Duket se vuajtjet e tij e bindën më shumë poetin që të përvetësojë deri në përkushtim dashurinë, lirinë, bashkëjetesën, paqën. Gjithashtu, ai nuk ka ngurrim të tregojë se këto nuk janë gjëra kaq të thjeshta. Aq me tepër ato mund të varen nga ai. Kjo, megjithatë nuk lëkund tek ai bindjen e misionit të poetit për këto ideale. Gjizelis shkruan:

*Dhe unë, në udhët e botës,
kalorës i zi vite në udhëtim,
fatin e "zotave" duke trazuar.*

*Κι εγώ, στ' ανάγναντα του κόσμου
μαύρος καβαλάρης χρόνια στέκω,
ανασκαλεύοντας τη μοίρα των «θεών».*

Ndryshe nga N. F. Zahos poezia e Gjizelis, zotërohet nga një figuracion i zhdërvjellët. Duket se i beson formës, për të përcjellë më mirë mesazhet e veta që, gjithsesi, kanë një funksion të qartë civil.

Siç edhe u tha, është nga të paktit që krijimtaria e tij u zhvillua në të dy gjuhët, greqisht dhe shqip.

Tilemahos Koças. U lind më 1951 në fshatin Vrisera të Gjirokastrës. Ai që në lindje, provoi fatin e "*biografisë së keqe*" të shumë femijëve minoritarë grek e shqiptarë. Mbaroi vetëm shkollën e mesme në Gjirokastrë, sepse kaq i lejonte biografia e prishur. Sprovat e para letrare i fillon shumë vonë, në prag të rënies së sistemit, me tregimet e botuara në gazetën "Llaiko Vima Letrare".

Me 1991 është nga të parët që "*arratiset*" në Greqi dhe fillon punë në ndërtim. Ndërkohë vllaga krijuese e kthën nga rruga e llaçit dhe e betonit në atë të letërsisë dhe realiteti i ri i jep mundësi të punësohet si përkthyes zyrtar në Ministrinë e Jashtme greke. Kështu, po më 1991, boton vëllimin e parë me tregime «*Συμβάν στη νύχτα*» ("Ngjarje në mesnatë"). Më vonë pasoi libri tjetër me novelën «*Το τελευταίο καναρίνι*», 1995, i përkthyer edhe në gjuhën shqipe me të njëjtin titull "Kananini i fundit". Më 1998 Koça boton vëllimin e tretë me tregime me titull «*Το τραγούδι εκείνης της νύκτας*» ("Kënga e asaj nate") dhe po atë vit novelën «*Βροχή στον τάφο*» ("Shi mbi varr").

Me 2004 boton librin e fundit me tregime, «*Τρεις γενιές Αμερικάνοι*» ("Tri breza amerikanë"). Këtu zë fill vargu i gjatë i romanëve të T. Koçës që e bënë atë shumë të njohur në Greqi. «*Τα επτά παραθύρια*» ("Të shtatë dritarët") 2003. «*Τεκμήριο Αθωότητας*» ("Argument pafajësie") 2007. «*Στην απέναντι όχθη*» ("Në bregun matanë") 2011, «*Ο χορός της νύφης*» ("Vallja e nusës") 2012, «*Κώδικας τιμής*» ("Kod nderi") 2013, «*Οι δεινόσαυροι των Αθηνών, ταξίδι σε λάθος χώρα*» ("Dinosaurët e Athinës, udhëtim në vend të gabuar") 2015, «*Σινική μελάνη*» ("Bojë Kine") 1918. «*Στη δίνη του ψυχρού πολέμου*» ("Në merinë e luftës së ftohtë") 2022.

Po ashtu, Koças është pjesëmarrës në disa vëllime të përbashkëta me autorë të tjerë ballkanas dhe evropianë. Ndërkohë që

disa libra të tij përkthehen në gjuhën shqipe ai vet ka përkthyer në greqisht, vepra të I. Kadaresë, M. Ahmetit dhe B. Mustafait.

Tilemahos Koças është një nga krijuesit minoritarë që, siç shprehet kritika greke, *“hapi i pari perden për të na treguar përditshmërinë e një populli, që rronte i harruar pranë nesh”*¹⁰⁶

Koças është një rrëfimtari me stil të thjeshtë. Hapi i tij i mbështetur në rrëfimin popullor, por pa rënë në folklorizma, është i sigurt. Ka një komunikim të drejtpërdrejtë me lexuesit e tij, të cilëve u tregon me gjuhën e përditshme gjëra aq të zakonshme e njëkohësisht kaq të rëndësishme nga jeta e tyre në sistemin komunist, të cilat ata nuk kishin mundur t'i vinin re. Përshtkrimet dallohen nga qartësia dhe dialogu nga vrulli. Drama personale e kolektive, dëshira të paplotësuara, ëndrra të vrara nga regjimi komunist, përbëjnë kuadrin e tematikës së Koçës. Nuk pretendon të na shfaqet si një hero i paqenë, por si vlerë më pozitive kumton faljën dhe pendimin. Rrëfyesit e Koçës janë vazhdimisht personazhë pjesëmarrës ose jo në rrëfim. Sido që të jetë, janë produkt i përvojës së tij të gjatë, përvojë që autori e përjetoi si vuajtje dhe tani ua përcjell lexuesve në art.

Ai vet tregon se 90 % e materialit letrar i takon përjetimeve personale të drejtpërdrejta nga sistemi komunist dhe 10 % përjetimeve të te tjerëve.¹⁰⁷

Në mënyrë indirekte pranon se është pikërisht kjo marrëdhënie e plasmuar në studjon e tij krijuese që i siguroi suksesin në Greqi. Ndërkohë ai kurrë nuk hoqi dorë nga qëllimi që *“pasi të mbaroja punë me tematikën e atdheut të veçantë, të bëhesha shkrimtar grek për t'u marrë me problemet e shoqërisë greke”*¹⁰⁸. Përpjekja e bërë disa herë i provoi se në raste të tilla ai bëhej i padukshëm, i parendësishëm.

Interes paraqet në këtë grup rasti i **Athanasio Fidhit**, i lindur në Gjirokastër më 1909 dhe i diplomuar në Universitetin Juridik të Milanos. Ai shkroi poezi, tregime, romane dhe drama. Por veprat e tij mbeten të pabotuara. Studimet e tij jashtë shtetit si dhe burgosja dhe internimi i vëllait për 38 vjet, nuk krijuan asnjë mundësi për botimin e tyre.

Një rast krejt të veçantë paraqet poeti **Jorgo Çati**. U lind në Qesarat të Sarandës më 1953. Ndoshta, nuk ishin arsye të politike

¹⁰⁶ Gaz «Καθημερινή», fq. 31, dt. 06.03.1994.

¹⁰⁷ Intervistë në faqen kulturore elektronike LIFO, 5 maj 2021.

¹⁰⁸ Intervistë në faqen kulturore elektronike LIFO, 5 maj 2021.

ato që e penguan të shkruajë. Por liria e pas viteve 90 zbuloi në nënndërgjegjen e tij poezinë. Ky metabolizëm, na paraqitet si një kërkesë e “*unit*” të tij, për të provuar ekzistencën e vet si njeri dhe si poet. Kjo realizohet duke shtyrë apo larguar nga vetja çdo gjë që përbën thelbin e identitetit të vet kolektiv, përkatësisë etnike dhe që i siguron vetminë në grupin shoqëror që e rrethon. “... *poet i çuditshëm. Një njeri krejt i veçantë..... I pashpjegueshëm për kërkesat e veta*”, - thotë për të Nikos Kacalidhas¹⁰⁹. Në këtë kontekst, gjithë krijimtaria e tij është shkruar në gjuhën shqipe. I çuditshëm është gjithashtu edhe fakti se, nga gjithë elementët e tjerë përbërës të përkatësisë etnike, ai mbart pothuaj vetëm gjeografinë e toponimisë. Kozmosin e miteve dhe të mjeteve të tjera shprehëse për krijimtarinë e tij i kërkon dhe i gjen në botën shqiptare.

“*Një ditë pranvere unë mora lahutën*

E nisa këngë për Mujë dhe Doruntinë...” - thotë poeti. Pra ai nuk merr, ta zëmë “*lirën*”, as u drejtohet Dhijenit Akritës që është homologu i Mujit, as Aretis që është e motra e Konstandinit tek balada greke e vëllait të vdekur. Po ashtu, ai për të kënduar zgjedh “... *Dyjarën, gajden, çiftelinë / E isos labe i qepem pak më vonë*”¹¹⁰, që janë vegla muzikore karakteristike shqiptare.

Ndër vprat e J. Çatit përmendim: “*Zëra nga skëterra*”, poezi, 1995; “*Përralla me mbret*”, fabula, 1995; “*Mes dashurisë e dhimbjes*”, lirika, 1996; “*Mimozat e zemrës*”, vjersha, 1997; “*Në skaj të ëndrrës pret një vajzë*”, lirika, 1998; “*Mbjell mes jush një sekuó*”, poezi, 1999; “*Mërmërimë mes gurgullimash*”, poezi 2000; “*Ëndërrvrasësit*”, poemë, 2000; “*Alter ego*”, roman, 2001; “*Puhi pas duhisë*”, poezi, 2003.

c. Në kategorinë e fundit përfshihen ata krijues të letërsisë në Minoritetin Etnik Grek, veprimtaria letrare e të cilëve u zhvillua jashtë kufijve të Shqipërisë, por që krijimtaria e tyre nuk shkëputet nga realiteti i këtushëm. Për shkak të regjimit, ajo ishte e ndaluar për lexuesin minoritar (por jo e burgosur).

Përmendim këtu krijuesit më të vjetër dhe më të dëgjuar si Katina Papa (1903-1959), nga Janicati i Sarandës, Minos Zotos (1905-1932) nga Dhrovjani, Taso Vidhurin (1888-1967) nga Dhrovjani i Delvinës, Jani Lilin (1916-1965) nga Derviciani i Gjiro-

¹⁰⁹ Kacalidhas N., 2000, Marrëzia, jeta dhe vdekja, parathënia e vëll. “*Mërmërimë mes gurgullimash*”, Sarandë.

¹¹⁰ Kacalidhas N., 2002, Poezia “*Kalorësi i këngës*”, vëll. “*Kalorësi i ëndrrës*”, Tiranë.

kastrës¹¹¹. Ata janë larguar shumë kohë para Luftës, ose gjatë saj nga vendlindja e tyre, por siç thamë, krijimtaria e tyre letrare mbeti e lidhur me vendlindjen.

Ndër ta mund të rreshtohën edhe përfaqësues të tjerë, të cilët janë larguar nga vendlindja kur e kuptuan se komunizmi përbënte për ta një rrezik eventual. Përmendim këtu Mihali Hristo Manon (1910-1973), nga Derviciani i Gjirokastrës. Manos u largua nga vendlindja, pasi lufta po mbaronte dhe diferencimi i qendrimeve nga pushtetmarrësit komunistë po bëhej evident.

VI.3. Letërsia e angazhuar

Përballë këtij realiteti letrar ekziston ai i letërsisë së angazhuar ose të partishme. Stadet deri në kthim në ndërgjegje të kësaj letërsie, kalojnë nga frika te nevoja e mbijetesës, nga nevoja për mbijetesë te bindja deri në devotshmëri, në shërbim të politikës së pushtetit.

Era e barutit politik përbënte frymëzimin e tyre, “*si një përzierje frike e patosi revolucionar*”. Këndvështrimi letrar është peng i fenomenëve bardhë e zi, në një tematikë të mbërthyer kryesisht në jehonën “*e lirisë së fituar nga lufta, në vrullin revolucionar për ndërtimin e jetës së re dhe në vazhdimin e luftës kundër armiqve*”. Kjo tematikë i siguronte letërsisë rolin që i caktonte partia në shërbim të proceseve “*të ndërtimit socialist të vendit*”. Dalian Shaplo e përcaktonte misionin e poezise, “*mjet qe u shërbën masave, t’u jap atyre ushqim shpirtëror dhe kënaqësi emocionale*”¹¹². Pra, siç shihet, gjendemi në realitetin e zbatimit rigoroz të parimeve të letërsisë së proletkultit të përpunuar si teori e letërsisë së klasës në pushtet në ish- B. Sovjetik.

Megjithatë nuk mund të mos vihet re se, parimet e letërsisë së realizmit socialist në letërsinë e Minoritetit Grek, u zbatuan në formën e ndikimit, madje jo të natyrshëm, nga letërsia shqipe. Po ashtu modelet letrare të shkollës ruse, ishin një përshtatje abuzive në realitetin e këtushëm. Kjo ndodhi për faktin se u imponua shkëputja e dhunshme nga tradita dhe nga zhvillimet letrare të kohës e në mënyrë të veçantë nga letërsia e kombit am. Po ashtu përndjekjet dhe dhuna provokuan një djerrinë krijuesish.

¹¹¹ Shih kreun “*Tiparet e letërsisë në Minoritetin Grek pas vendosjes së kufive shterorë*”.

¹¹² R. Elsie, 1997, *Histori e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë-Pejë, f. 417.

Mishërimi artistik në këtë letërsi, bëhej shpesh me një gjuhë panigjirike, deklamative e propaganduese. Ndërsa, duke qenë se përvoja e vetme letrare në gjuhën amtare mbeti krijimtaria popullore, mbështetja në këtë përvojë me synim realizimin e detyrimeve ndaj politikës, siguronte shpesh një skematizëm folklorik.

Këtë e tregojnë më së miri titujt dhe përmbajtja e librave të parë në gjuhën greke. *“Jetë e lirë”* 1953 dhe *“Traktoristja”* 1957 janë titujt e dy vëllimeve poetike të Pano Çukës. *“Lirisë dhe paqes”* i drejtohet në vëllimin e tij të parë poetik, Janis Panos. Nëpërmjet vëllimit poetik *“Fyelli im”*, shprehte të njëjtat qëndrime, ndjenja dhe mendime poeti i talentuar Pavlos Shutis.

Duke shfletuar 43 poezitë e vëllimit të parë të P. Çukës të cilat u shkruajtën në gjërësinë kohore 10 -vjeçare, por dhe veprat e tjera në vijim, do të hasim titujt të tillë, si: *“Lavdi Partisë”*, *“Një mijë vjet Enverit”*, *“Çezmave të reja të Dropullit”*, *“Dritë e re”*, *“Rinia e punës”*, *“Miq të e mëdhën”* (kushtuar vizitës së delegacionit të kolkozianëve sovjetikë, në kooperativën bujqësore të Vrionit –Vurg) etj.

Kritika e kohës e përcjell kështu vëllimin e parë poetik të Çukës dhe të gjithë letërsisë së pasluftës së Minoritetit Grek:

*“Fryma e Partisë është e gjallë në të gjitha poezitë, në daç për problemet e transformimit të jetës në vendin tonë, në daç për frymën internacionaliste të një letërsie militante, si e jona, të realizmit sicialist”*¹¹³, - do të shkruante S. Çomora.

“Burim frymëzimi për poetin janë njerëzit e lirë, pa zotër dhe afendër mbi kokë. Ata ndërtojnë me duart e tyre jetën e re, jetën që nga dita në ditë bëhet më e mirë.... Vjershat e Pano Çukës edukojnë lexuesin me frymën e re, me frymën e partisë dhe janë thurur bukur nga ana artistike... karakteristikë dalluese e poezisë së tij është forma kombëtare dhe përmbajtja socialiste.”, - thotë për të njëjtin vëllim poetik Spiro Kufo.¹¹⁴

Në të njëjtën shkrim autori S. Kufos nuk ka si të mos vëjë re se vargjet prozaike, deklarative të cilat *“Përveç se prishin bukurinë artistike të vjershës, shtrembërojnë edhe realitetin tonë, pse e paraqitin ndërtimin si një punë të lehtë dhe rrugën që të shpie tek objektivi i caktuar si të shtruar me lule, pa pengesa e vështirësi”*¹¹⁵ Megjithatë, siç shihet, këto dobësi nuk vihen re se dëmtojnë cilësinë artistike të poezisë, por se nuk i japin mundësi asaj të kryejë mirë funksionin si mjet ndihmës i propagandës së parti-

¹¹³ Çomora, S., revista “Nëntori”, nr. 3, 1954, fq. 99.

¹¹⁴ Kufo, S. gaz. “Zëri i popullit”, dt. 29.07.1953, f. 3

¹¹⁵ Kufo, S. gaz. “Zëri i popullit”, dt. 29.07.1953, f. 3

së. Po ashtu, që në këtë vëllim të parë poetik shohim si vershojnë fjalë dhe shprehje stereotipe, si: shkëlqim, dritë, ferr, lavdi, lumturi, thesar, vullkan, djersë, çelnikos, jeta, gjak etj. Fjala “*gjak*” përsëritet 15 herë.

Këto karakteristika janë dominante gjatë gjithë fazës së parë të letërsisë së pasluftës së Minoritetit e cila, si në letërsinë shqiptare, zgjat deri në vitet 70^{të}.

Pothuaj, në të gjithë fazën e saj të parë të periudhës së pas luftës edhe poetët minoritarë grekë nuk arritën të zgjidhnin dilemën midis poetit si i tillë dhe misonit të tij propagandistik të paracaktuar. Kjo do të thotë se gjithkohshmëria e vlerave artistike “*si harmonizim i momentit artistik të krijimit me momentet e reja të perceptimit artistik*”¹¹⁶ në perspektivën e kohës, nuk funksionoi në këtë lloj letërsie. Këtë e tregoi dhe fati i shumë veprave letrare, të cilat, me ndryshimin e sistemit, humbën mundësinë për të ekzistuar.

Megjithatë edhe në këtë periudhë dallohet qartë se poezia, ndryshe nga proza, mbetet individuale në kuptimin e qëndrimit artistik ndaj realitetit dhe unit poetik. Si e tillë nuk mund ta pranojë tërësisht peshën e kornizave strikte. Nga ana tjetër, sado i angazhuar të jetë një poet, nuk mund të flijojë gjithë lirinë e tij në emër të devocionit politik. Vetë ndjenja estetike e gjuhës poetike, liria relative e shprehjes që ofron poezia, prania e fantazisë në të dhe nevoja për gjetjen e konvencioneve të reja shprehëse, qoftë edhe për të shrehur në mënyrë artistike ide politike e sociale, përbëjnë elementët dalluese estetike të një letërsie sado që mban vulën e epokës politike që e prodhoi.

Kjo do të thotë se, pavarësisht nga nevoja jonë sot për t’u distancuar nga kjo periudhë politike, prapëseprapë një vështrim objektiv arrin të komunikojë me vlerat e kësaj letërsie. Vetë fakti që shumë nga krijuesit minoritarë arrijnë që, pavarësisht nga ngarkesat emocionale antikomuniste, t’i risjellin publikut përmbledhje me krijime letrare të cilat mundën t’i rezistojnë edhe kohës tonë pa diktaturë dhe censurë, është shumë domethënëse. Përmendim këtu përmbledhjen poetike të Pano Çukës «*Γεια σας αδέρφια. (Μια φωνή από το Αργυρόκαστρο)*» (“*Përshëndetje vëllezër, Një zë nga Gjirokastra*”), botuar më 1993 apo dhe përmbledhjet poetike të Niko Kacalidhës etj.

¹¹⁶ Βελοούδης Γ., 1994, *Γραμματολογία – Θεωρία της λογοτεχνίας*, Athinë, fq. 367.

VI.4. Faza e parë

Si karakteristika bazë të fazës së parë mbeten mënjanimi i shpejtë i medyshjeve për një letërsi të lirë dhe konsolidimi i parimeve të realizmit socialist. Procesi i kthimit në një letërsi të angazhuar shoqërohet me shkëputjen e çdo komunikimi me letërsinë bashkëkohore greke.

Ruajtja e mjeteve shprehëse të krijimtarisë popullore dhe zhvillimi i tyre drejt një letërsie të kultivuar, pavarësisht nga ato që kumtojnë, përbën një veçori tjetër dalluese.

Starton si letërsi e shkruar në poezi e prozë dhe zhvillohet kryesisht si poezi ose si letërsi poetiko-folklorike. Fillimet e saj janë kryesisht në gjuhën amtare, por, me kalimin e kohës, krijuesit minoritarë të kësaj faze do të preferojnë të shkruajnë më shumë në shqip.

Proza letrare zbehet. Ajo merr formën e monografive për heronjtë nga minoriteti që u sakrifikuan në luftë. Po ashtu, u kthye në formën e traktatëve politike e publicistike, me një funksion të qartë politik për pasqyrimin e ndërtimit socialist, të luftës së klasave dhe të luftës kundër ndikimeve fetare e zakoneve prapanike.

Tematika do të mbetet e njëtrajtshme dhe do të lidhet me luftën e bërë për liri, me ndërtimin e socializmit dhe luftën kundër armiqve të rinj.

Në finishin e kësaj faze, bashkë me ardhjen e vullshme të elementit të ri letrar, kemi dhe shënja të dukshme të kërkesave, në rritje, për të thyer konservatorizmin letrar që kishte diktuar angazhimi i skajshëm politik i letërsisë. Këto kërkesa përfshinë si strukturat letrare ashtu edhe tematikën.

Përfaqësues të kësaj periudhe janë Panos Çukas, Spiros Xhas, Janis Panos, Pavllos Shutis, dhe pas tyre, në vitet 60' Fotis Qiriazatis, Vasilis Koças, etj

Panos Çukas (1925 – 1995)

U lind më 1925 në fshatin Sopik të Pogonit të rrethit të Gjirokastrës. Studioi në shkollën e mesme për mësues në Vellas të rrethit të Janinës. Pa mbushur të 20^{të} ishte një nga penat që shkroi poezi në formacionet luftarake të Minoritetit Grek në luftën e përbashkët me popullin shqiptar. Është një nga themeluesit e emisionit greqisht në radion lokale të Gjirokastrës, (1945) dhe bashkëpunëtor i rregullt me publicistikë e pjesë letrare në gazetën "Llaido Vima", që me themelimin e saj (1945) e deri sa zemra e tij pushoi së rrahuri në një nga spitalet e Greqisë më 1995.

Shumë nga shkrimet e tij i botoi me pseudonimin letrar “*Alqis Anthulis*”.

Për shumë vjet ishte redaktori kryesor e teksteve shkollore për nxënësit e shkollave të Minoritetit Grek. Shërbeu si mësues në degën “*mësuesi në gjuhën greke*” në shkollën e mesme pedagogjike të Gjirokastrës.

Ka botuar në gjuhën amtare greke 12 vëllime me poezi.

Në prozë në gjuhën amtare ka shkruar tre libra.

Ka shkruar në gjuhën shqip nëntë libra në poezi e prozë.

Përktheu nga shqipja në greqisht 30 vepra të autorëve më të njohur të traditës dhe realizmit socialist. Këto përkthime në prozë, poezi e dramaturgjii, edhe pse u drejtoheshin moshave të ndryshme lexuesish, plotësonin një boshllëk shumë të madh për lexuesit minoritarë në gjuhën amtare.

Përkthime ka edhe nga greqishtja në shqip.

Përveç teksteve shkollore ka realizuar vet gjashtë antologji për nxënësit e shkollave dhe në pesë të tjera është bashkautor.

Në këtë kuadër do të ishte shumë e vështirë t'i hynim përpjekjes për verifikimin e artikujve të ndryshëm me karakter politik, shoqëror e letrar të botuar në shtypin e kohës në të dyja gjuhët.

Krijimtaria letrare e Pano Çukës, siç është e kuptueshme, përshkoi gjithë periudhën e realizmit socialist dhe përbën një nga përfaqësuesit kryesor të letërsisë së Minoritetit Grek, i njohur gjithashtu edhe ndër lexuesit shqiptarë.

E vërtetë është se Çuka është një nga krijuesit më të angazhuar nga Minoriteti Grek në kauzën ideologjike të komunizmit. Veprat e tij në shumicën e rasteve, u ngajnë reportazheve letrare të shkruara në vargje a në prozë për ngjarje dhe data që lidhën drejtpërdrejt me nevojat e konsumit ideologjik të pushtetit. Shpesh merr përsipër “*shqetësimet politiko-ideologjike të partisë*”, që i kapërcëjnë caqet e Minoritetit Grek, bile, dhe të Shqipërisë. E rëndë dhe kompromentuese mbetet për të pozicioni i flamurtarit në luftën kundër fesë.

Megjithatë, Panos Çukas diti t'i kapërcente pengesat dhe kufizimet ideologjike e të shkruante poezi. Ai dinte të bënte letërsi duke aplikuar një gjuhë burimore. Duke u mbështetur fuqishëm në traditën e poezisë popullore gjuha amtare bëhet më plastike dhe më shprehëse. Këto veti marrin më shumë vlera kur poeti i largohet tematikës së ideologjizuar dhe depërton në jetën e përditshme. Atëherë di të përjetësojë traditën, të sjellë më afër njerëzit e thjeshtë, të filozofojë për jetën dhe vdekjen. Di të përkëdhelë me dashuri, të ngrejë në art marrëdhëniet e njeriut me ve-

nd lindjen. Me një fjalë është një poet lirik i spikatur, megjithëse nuk guxon të dalë jashtë raporteve të përcaktuara ideologjike.

Vargu i përdorur prej tij është 11,13 dhe 15-rrokëshi klasik i traditës popullore. Atë e gjejmë dhe të thyer duke përdorur, madje, dhe rimën. Përpkjekjet e tij për të shkruar varg të lirë nuk ishin të suksesshme.

Është i padiskutueshëm kontributi i tij në fushën e përkthimit të letërsisë në gjuhët analoge, veçanërisht, nga shqipja në greqisht. Kontributi nuk qëndron vetëm në faktin se krijoi mundësi që lexuesit minoritarë të lexonin në gjuhën amtare letërsinë shqipe, por se cilësia e përkthimit ishte e tillë, saqë, pa frikë, mund të themi se Panos Çukas bëri Naimin, Dritëroin, Kadarënë etj të flasin greqisht dhe arti i tyre të fitojë finesën e greqishtes. Njëkohësisht ai solli një kontribut të çmuar në komunikimin e dy letërsive dhe në këmbimin e vlerave reciproke.

Spiros Xhas. (1918-2012)

Është, padyshim, përfaqësuesi më dinjitoz i letërsisë së Minoritetit Grek të pasluftës në lëvrimin e gjinisë së prozës. 50 vitet e punës krijuese duket se nuk arritën që t'i shterroj në frymëzimin dhe idetë për të shkruar edhe në moshën 86-vjeçare.

U lind në fshatin Sofratikë të Dropullit të Poshtëm. Studioi edhe ai në shkollën e mësuesisë në Vella të Janinës. Më pas punoi si mësues në fshatrat e Minoritetit Grek në Shqipëri. U lidh me lëvizjen antifashiste dhe mori poste të rëndësishme në formacionet luftarake të Minoritetit Grek. Këtu bën edhe sprovat e para letrare.

Më 1949 boton në gazetën “Llaiko Vima” novelën e parë të tij «*Το τραγούδι της ειρήνης*» (“Kënga e paqës”). Më 1953 kjo novelë me pak ndryshime botohet në greqisht e shqip me titull “Përkundruell Murganës” («*Μπροστά στα μάτια της Μουργκάνας*»), 1953, më 1954 shkroi përmbledhjen me tregime “Rojet e demokracisë” («*Οι φρουροί της Δημοκρατίας*»), më 1956 novelën «*Πέντε γράμματα- μια πραγματική ιστορία*» (“Pesë letra – një histori e vërtetë”), më 1962 «*Τσιγγάνικη αγάπη*» (“Dashuri cigane”), më 1966 romanin “Spitali partizan” («*Το παρτιζάνικο νοσοκομείο*»). Deri më 1966 do të shkruajë romanin e dytë “Qyteti i ri” («*Η νέα πόλη*») si dhe novelat për fëmijë, “Kur ndërtonim hidrocentralin” («*Όταν οικοδομούσαμε τον υδροηλεκτρικό σταθμό*») dhe “Llampa e minatorit ndrit” («*Η λάμπα του μινადόρου φωτίζει*»).

Më 1970 shkroi dy monografi për Heroin e Popullit Lefter Tallo dhe për Thanas Zikon.

Spiro Xhait i përket dhe njera nga dy-tre dramat e shkruara nga autorë minoritarë. Fjala është për dramën me katër akte: “*Akti i fundit*”, botuar në revistën “Nëntori”, nr. 1, 1958.

Pas rifitimit të së drejtës për të botuar, fillim i vitëve 80, botoi në shqip romanin “*Kronikë Dropullite*” 1989. Në planet e tij krijuese ishte rishkrimi i këtij romani në greqisht, si dhe botimi i romanëve: “*Misioni i largët*”, “*Trëndafilat e majit të kuq*”. Nuk i botoi për shkak të ndryshimeve politike në vend.

Do t'i rikthehet krijimtarisë letrare kur, pas vitit 1991, u vendos në Greqi. Por me sa duket, është pak si vonë për të sjellë diçka të re në prozën e Minoritetit Grek, megjithëse mbetet babai i saj për periudhën e pasluftës.

Duhet thënë se proza e Spiro Xhait pavarësisht nga prodhimtaria e lartë, nuk i shpëtoi dot skematizmit që impononte metoda e realizmit socialist. Personazhet e tij, pavarësisht se mund të flasin greqisht, janë karaktere e tipe që i gjen me bollëk në prozën shqiptare të viteve 50. (Kjo vlen, bile, edhe për romanin e tij “*Kronikë Dropullite*”). Përjashtim bëjnë këtu personazhet dhe situatat te “*Pesë letra – një histori e vërtetë*” («*Πέντε γράμματα- μια πραγματική ιστορία*»), “*Dashuri cigane*” («*Τσιγγάνικη αγάπη*»).

Konfliktet dhe antagonizmi në veprat e tij kanë një ngrym të partishëm bardhë e zi, ndërsa tematika, deri vonë, mbetet pothuaj e njëjtë: “*Lufta që na dhuroi lirinë*”, “*përpyekjet për ndërtimin e jetës së re*”, “*drejtësia e vijës së partisë*”, e kaluara e zezë, të cilën duhet ta kemi parasysh në çdo hap të jetës etj. Edhe shumë nga tregimet e tij të fundit manifestojnë një nostalgji për bukuritë e një jete të pajtuar në periudhën socialiste.

Janis Panos (1917- 1989)

Filloi veprimtarinë letrare që në periudhën e luftës me balladën tjetër të njohur për Lefteri Talon si dhe poezi të tjera ku dallon, veçanërisht, elegjia për masakrën e Glinës të shkaktuar nga ballistët më gusht të vitit 1943.

Më 1960 botoi vëllimin poetik për fëmijë “*Kënga e Vurgu*”, më 1962 “*Lirisë dhe paqes*”, si dhe vëllimin “*Në kudhrën e përgjakur*”. Frymëzimi i tij mbetet ai i luftës dhe i punës për socializmin. Është një nga të paktit që tentoi të shkruajë dramaturgji. Botoi në shqip dramën “*Në zjarrin e luftës*”, por pa ndonjë sukses dhe pa mundur t'i rezistojë kohës.

Janis Panos u mor edhe me përkthime nga shqipja në greqisht. Përktheu poezi të Mjedës, Agollit, Siliqit etj

Vasilis Koças (1940-2013)

U lind në fshatin Krioneri të Dropullit të Sipërm në rrethin e Gjirokastrës.

Mosha relativisht e re të jep përshtypjen se do t'i krijonte mundësinë vetës të përfshihej në brezin e krijuesve të rinj të minoritetit grek, të ndiqte shembullin e bashkëmoshatarëve të tij Zarballait, Qiriazatit, Kacalidhës etj. Por Koças mbetet një poet tipik i fazës së parë të letërsisë së pasluftës. Vargu i tij është ai tradicional popullor. Madje, përpjekja për të qenë sa më i partishtëm e dëmton shpesh finesën e thjeshtësisë dhe elegancën e mendimeve të holla të vargut popullor. Edhe përpjekja e tij për të aplikuar rimën apo vargun e lirë është e pasuksesshme.

Vasilis Koças, edhe në poezinë e shkruar pas rreniës së komunizmit, kërkon dhe gjen udhëheqës për t'i kushtuar të njëjtit vargje deklamative e panigjirike të ngrituara mbi një gjuhë të përpunuar popullore. Ka shkruar poezi dhe kryesisht në greqisht. Vepra e tij më e mirë konsiderohet poema «*Ήσουν ποτέ στη Δρόπολη*» ("Ishe ndonjëherë në Dropull"), 1977.

Veprat të tjera të tij janë «*Τραγούδια του καιρού*» ("Këngët e stinës"), 1965· «*Σατυρικοί στίχοι*» ("Vargje satirike"), 1968· «*Κομμουνιστικά φώτα*» ("Drita komuniste"), 1969· «*Απρίλη καλωσόρισες*» και «*Συζήτηση με τη γυναίκα μου*», ("Mirë se erdhe prill" dhe "Bisedë me gruan time"), 1973· «*Ταξιδιάρικα μοτίβα*», ("Motive shtegtare"), 1974· «*Ποιήματα*» ("Poezi"), 1986.

Shkroi edhe poezi për femijë. U mor, gjithashtu, me përkthime autorësh grekë e shqiptarë.

Pavlos Shutis (1922-2009)

I pazëshëm, por poet i kultivuar, lirik. Befasues në vargun dhe figuracionin e tij dhe me individualitet të spikatur. Nuk u bindej shumë kornizave ideologjike, por as i shkelte ato që të penalizohej. Në kohë të ndryshme shkroi tre vëllime me poezi.

Më 1955 botoi vëllimin «*Η φλογέρα μου*» ("Fyelli im"). Ishte i dyti në gjuhën amtare në periudhën e pasluftës, por u cilësua më i arriri artistikisht. Me 1965 botoi vëllimin e dytë, «*Με τη λύρα και το κεντρι*» ("Me lirën dhe thumbin") dhe me 1983 «*Προσφορές*» ("Kontribute"), në të cilën përmbloodhi pezitë e zgjedhura të dy vëllimeve të para dhe poezi të pabotuara ose të botuara në shtypin e kohës. Shutis është poet që ka shkruar vetëm në gjuhën greke, por u shqua shumë për elegancën e përkthimeve nga shqipja tek greqishtja. Po ashtu Shutis ishte i njohur për ndihmesën që u jpte të rinjve të talentuar.

Persefoni Gjini (1931-2007)

Pothuaj e vetme poete që shoqëroi letërsinë në Minoritetin Grek në të gjithë periudhën e pasluftës. Vargu i saj burimor, i mbështetur në vargun tradicional popullor, rimat e thjeshta dhe përdorimi i krahasimeve, paralelizmave e metaforave aq të njohura dhe të suksesshme në krijimtarinë popullore janë karakteristikë, që i japin jetë poezisë së saj.

Persefoni Gjini me poezinë e saj përpiqet dhe është kudo, në çdo problem të kohës. Shpesh ajo konsiderohet poete popullore dhe mirret si shembull se si rapsodi popullor mund të ndjekë dhe të pasqyrojë realitetin socialist. Në këtë kuptim ajo ka qëndruar midis poezisë së kultivuar dhe rapsodit popullor. Edhe vëllimi i saj poetik mban të njëjtin titull «*Ραψωδικοί Στίχοι*» (“Vargje rapsodike”). Madje, shumë nga krijimet e saj janë kthyer në këngë popullore, pavarësisht se sa ato i rezistuan kohës. Me 2002 botoi në Athinë vëllimin poetik, «*Πατρίδα μου Πολύτσανη*» (Atdheu im Poliçani).

Megjithatë, Persefoni Gjini mbeti gruaja poete e Minoritetit Grek që gëzoi respektin e të gjithëve.

U lind më 1931 në Poliçan të Gjirokastrës dhe vdiq me 2007 në Gjirokastrë.

VI.5. Faza e dytë

Karakteristikat kryesore.

- Në aspektin e pozicionit ideologjik (marrëdhëniet me pushtetin), pësha e letërsisë së burgosur bie mjaft. Paralelisht me kërkesat për letërsinë e angazhuar evidentohen tendenca në rritje për një letërsi të çliruar nga angazhimi ideologjik. Ndërkohë shfaqet edhe një lloj tjetër angazhimi letrar që lidhet me përpjekjet për të evidentuar identitetin etnik.

Edhe në këtë fazë vazhdon të mbetet evidente autocensura dhe censura.

- Në aspektin letrar vihet re një përpjekje për një ngritje cilësore artistike si në drejtim të gjetjeve, të formave e të mjeteve shprehëse, ashtu dhe në atë tematike

- Në aspektin e llojeve letrare mbetet mbisunduese poezia, kryesisht, liriko-politike e ideologjike. Por kemi një presion në rritje dhe të prozës, kryesisht, të tregimit dhe novelës, sidomos aty nga fundi i viteve 80.

- Karakteristikë mbetet, gjithashtu, përkthimi i një numri gjithnjë në rritje të veprave letrare në gjuhë analoge dhe krijimtaria në dy gjuhë. Krijimtaria në gjuhën greke dalëngadalë fiton epërsi mbi krijimtarinë në gjuhën shqipe të vet krijuesve minoritarë.

- Kërkesat cilësore lidhën me ardhjen në skenë të një numri shumë të madh krijuesish të rinj

Mendimi i pakët kritik i asaj periudhe vlereson pjekurinë letrare, që përcakton natyrën e fazës së dytë në letërsinë e Minoritetit Grek, si produkt i *“ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit dhe i kalimit të vendit në fazën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste”*¹¹⁷.

Mendimi në fjalë, aq i njohur dhe në kritikën letrare shqiptare, nuk ka bazë reale edhe po të nisemi nga parimet e historio-grafisë së realizmit socialist. Kjo për faktin se në periudhën që u njoftua *“ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit”*, fryma liberale, hapja dhe përafrimi me Perëndimin që u vunë re në letërsinë dhe në artet shqiptare, provokuan mërinë e udhëheqjes komuniste për t'i rikthyer ato në linjën e *“tabanit kombëtar dhe frymës popullore”*. Plenumi i katërt i PPSH-së i 1974^{es} ishte një akt brutal kundër përpjekjeve për një frymëmarrje të re cilësore të artit e të letërsisë.

Fryma e re, në rinovimin e letërsisë edhe në Minoritetin Grek lidhet me presionin e brëndshëm të ardhur nga brezi i ri i krijuesve, por edhe nga kontaktet e shtuara me botën e jashtme, sidomos i kontaktëve të drejtpërdrejta të realitetit shqiptar (Minoriteti Grek) me Greqinë.

Brezi i krijuesve të kësaj faze në Minoritetin Grek shpalosi shqetësime të tjera për letërsinë. Nuk pajtohet me ruajtjen e strukturave tradicionale letrare. Në poezi përdoret me efikasitet vargu i lirë. Dilemën midis lirisë së poetit dhe lirisë së kushtëzuar nga roli i paracaktuar i poetit e zgjidh dalëngadalë në favor të lirisë së poetit, kuptohet aq sa nuk mund të cënohen dhunshëm komizat ideologjike. Madje, brezi i ri i krijuesve shmang dukshëm edhe tematikën e imponuar nga ideologjia komuniste.

Në krijimtarinë e krijuesve të rinj shfaqet vullshëm një tematikë shoqërore e çliruar nga ideologjia. Lirizmi në përgjithësi fiton një frymëmarrje më të gjërë. Dukshëm vihen re dhe kërkesat për një trajtim ndryshe të traditës dhe përkatësisë etnike.

Krijimi i një simbolike të veçantë, alegoria, metafora të marra nga krijimtaria popullore dhe të ridimensionuara në aktualitetin e

¹¹⁷ Dajo S., 1989, gaz. *Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα*, Shkurt, fq. 6.

kohës bëhën mjete kryesore shprehëse të poezisë së kësaj periudhe, sidomos, të asaj pas viteve 80.

Në këtë prizëm lëvrimi i letërsisë në gjuhën amtare shënon një kthesë serioze. Pothuaj të gjithë autorët e rinj që kishin filluar krijimtarinë e tyre në gjuhën shqipe, tani shkruajnë ose vetëm greqisht, ose në të dy gjuhët.

Paralelisht me krijuesit e vjetër, shfaqën dhe emra të rinj. Përfaqësuesit kryesorë janë Nikos Kacalidhas, Andreas Zarballas, Petros e Odhiseas Çerkezis, Hristos Vidhuris, Thomas Sterios, Fotos Qiriazatis, Fotos Malos, Spiros e Stavros Llajos, Vasilis Bariabas, Vasilis Qeramas, Minas Lekkas e akoma më të rinj si Stavros Dajos, Spiros Kallos, Alqis Papas, Alekos Papas, Vangjelis Millos, Mirela Kallanxhi, Kostas Nushas, Spiros Hristos, Tilemahos Koças, Vangjelis Zafiratis, Amalia Qendru etj, të cilët do të konsolidojnë individualitetin e tyre krijues pas viteve 90^{të}.

Në vitet 80' të shekullit të kaluar u shtua shumë letërsia për fëmijë, sidomos poezia

Ndërkohë, rriten kërkesat për lëvrimin e prozës sidomos nga krijuesit e rinj. Në vitin 1985 kemi edhe vëllimin e parë me tregime të autorit të ri Stavros Dajos. Në shtypin periodik në gjuhën greke të asaj periudhe shkruajnë tregimet e tyre të para Thomas Sterios (Sterjopullos), Spiros Hristos, Tilemahos Koças, Petros Çerkezis, Spiros Llajos, Panajotis Barkas etj.

Disa prej tyre, si P. Çerkezis, S. Llajos, do t'i rikthehën totalisht poezisë, për të kaluar më vonë prozës. Tilemahos Koças, Spiros Hristos etj, do të t'i përkushtohën prozës për t'u bërë përfaqësues me në zë në letërsinë e Minoritetit Grek. Ka emra të tjerë të cilët, siç ndodh rëndom, me kalimin e kohës hoqën dorë nga letërsia.

Lloji i prozës është kryesisht tregimi i shturtër. Karakteristikë është se tematika nuk ka lidhje shumë me aktualitetin. Proza-torët e rinj ndihën më të sigurt kur shkelin në monopate të njohura tematike. Ato i përkasin së kaluarës ose luftës, por interes të veçantë paraqesin tregimet me fabula – ide.

Në këtë periudhë, 1981, shkruhet edhe drama e parë në gjuhën amtare. Titulli i saj është “*Χειμωνιασμένη αγάπη*” (Dashuri e dimerëzuar). Është e vetmja që u vu në skenë në periudhën komuniste. Aktorë dhe gjithë stafi drejtues ishin nga fshati Skore i Pogonit. Autori i dramës, Panajot Barka, ishte njëkohësisht dhe regjisor, dhe skenarist dhe aktor.

Nikos Kacalidhas.

Poet, prozator, esseist, përkthyes. Për krijimtarinë e tij letrare është nderuar me shumë tituj e medalje. Ministër pa portofol për problemet e minoriteteve në qeverinë shqiptare, atashe kulturor në ambasadën e Shqipërisë në Athinë

U lind në Leshinicën e Sipërme të rrethit të Sarandës më 1949. U diplomua për letërsi në Universitetin e Tiranës. Në fushën e letrave u shfaq shumë shpejt. Vazhdon të jetë poet, megjithëse, nga dora e tij kanë dalë edhe mbi 30 ese (sprova) për autorë e probleme të ndryshme të letërsisë në Minoritetin Grek, si dhe një numër i madh përkthimesh, sidomos, poezi nga greqishtja në shqip. Tani provon forcat e tij në prozën e gjatë të romanit. Shkruan vargje me të njëjtën lehtësi si në shqip edhe në greqisht.

Ai nisi krijimtarinë e vet poetike si një përfaqësues i brezit të ri të poetëve në Shqipëri. Shumica e vëllimeve poetike të dhjetëvjeçarit të parë krijues, vitet 70-80', janë të shkruara në shqip. Madje, është nga të paktit poetë minoritarë grekë që vazhdon të ketë një komunikim shumë të mirë me publikun shqiptar. Ai edhe tani shkruan me të njëjtën lehtësi e ngrohtësi poezi në gjuhën shqipe. (*“Profecia e drurëve”* 1998, *“Fati i Amarandos”* 2003 e *“Pagëzimi i zogjve”* 2006.)

Është njëkohësisht poeti nga më produktivët i Minoritetit Grek dhe një nga më produktivët në letërsinë shqiptare. Ka shkruar mbi 30 vëllime poetike të ndara në dy kategori, vjersha dhe poema.

Prodhimtaria e tij letrare rritet së tepërmi në dy dhjetëvjeçarët e fundit. Në këtë periudhë, Kacalidhas bën hapa të qëndrueshme në lëvrimin e poezisë në gjuhën amtare, pa harruar edhe lexuesin shqiptar. Ndërkohë pjekuria e tij si njeri krijues konfirmohet edhe nga fakti se i kushton rendësi të madhe prozes. Ndër veprat e kësaj periudhe përmendim: *«Η σέλα της σελήνης»* (“Shala e Henës”) 2007 poezi, *«Τα εραλδικά της Κίχλης»* (“Heraldikët e Kihlit”) 2008 poezi, *«Οφεις οικουρός»* “Gjarpëri i shtëpisë” 2013 poezi, *«Ο παρακλητικός του ηλιοβασιλέματος»* (“Lutja e perëndimit të diellit”) 2014 poezi, *«Δαφνοπόταμο»* (“Lumë prej dafine”) 2015, poezi, *«Το ξύπνημα των κοιμωμένων οφθαλμών»* (“Zgjimi i syve të fjetur”) 2020 poezi, *«Το άροτρο του φεγγαριού»* (“Parmenda e henës”) 2004 romani i parë, *«Νύχτας ανομήματα»* (“Mekate nate”) 2006 tregime e novela *«Περί Ομονοίας και άλλων δαιμονίων»* (“Rreth Omonias dhe demonëve të tjerë”) 2018 roman, *«Ο Νυχτοπαρωρίτης»* (“Niktoparoriti”) 2019 roman, *«Η επέλαση των χιονιάδων»* (“Marshimi i borës”) 2021 prozë.

Përsa i përket prozës vlen të rimarim pohimin e shkrimtarit grek Menis Kumandareas thenë në prezantimin e romanit “Niktoparoriti”: *“Edhe pse proza e Kacalidhës shkruhet në ditët e shekullit tonë, - thotë për të shkrimtari grek Menis Kumandareas,- përsa i përket strukturës, estetikës, artit të kujton Kafkën, Kuderan, Andrits, Mirivilin dhe Kadarenë. Dhe të gjitha këto të mbështjella dhe të strukturara me një gjuhë të pasur, me shumë virtyte të fshehta që të çon në një botë sa të lashtë aq dhe moderne që buron nga kryqëzimi i të folmës epirotase me gjuhën e kultivuar”*¹¹⁸.

Kacalidhas, që në fillimet e veta krijuese tregoi vendosmerinë për të shkruar poezi dhe në çdo hap të hedhur synon një majë të re. Vepra poetike e Niko Kacalidhës njohu disa çmime e vlerësime. Që me vëllimin e parë “Fjalët e thëna në pranverë” 1971 merr “Çmimin e Republikës”. Me vëllimin e tretë “Shtëpitë tona në Jug”, merr “Çmimin e dytë kombëtar” në poezi. Pasojnë disa çmime të dhëna nga gazetat “Drita” e “Zëri i rinisë” si dhe revista “Nëntori”. Më 1989 dekorohet nga Presidenti i Republikës me titullin “Naim Frashëri” për shërbime të shquara në letërsi. Në 2003 merr çmimin “Pena e argjendë”, për përkthimin e vitit, të akorduar nga Ministria e Kulturës, për përkthimin në shqip të nobelistit grek Odhiseas Elitis.

Një numër nderimesh, çmimesh e dekorimesh i janë akorduar edhe në Greqi. Vlen të përmendet “Çmimi i Parë Panhelenik” për poezinë “Asqitis”, 2003 dhe po këtë vit “Çmimi i Parë Ballkanik” “AIMOS” dhënë nga Komisioni Ballkanik i Sofies për vëllimin “Një qind, 100 gjetheshat e Plejadës”.

Eshtë poeti me njohje me shumë personalitete të njohura si me nobelistin Odhisea Elitis, me Melina Merkurin, me poetin kombëtar të Qipros, Kosta Montin. Gëzonte simpatinë e veçantë të Dritëro Agollit dhe sot të I. Kadaresë etj

Madje, do të thoshnim se kjo është pjesë e egocentrizmit të tij që në procesin krijues shfaqet me një individualitet aq sa të lexueshëm, aq dhe të koklavitur, por që në përgjithësi është parë si vlerë. Shprehje e këtij egocentrizmi poetik është shpjegimi i tij për “kozmosin” e vet poetik. Kjo botë niset nga ai vetë, familja dhe vendlindja e tij.

Në këtë kuadër poeti përpiket të krijojë filozofinë e vet, arqetipat e tij që ngrihen në lirizmin dhe epizmin e njëkohshëm të poezisë së tij, të cilat në fakt frymëzohen nga perceptimet poetike shpesh të të tjerëve, por që ai u jep frymëmarrjen e botës së tij.

¹¹⁸ Kumandareas M. 2019, prezantimi i romanit “Niktoparoriti”, Athinë.

“Kur lexon poezinë e Niko Kacalidhës, nxitesh për të gjetur burimet dhe ecurinë e vizionit të tij poetik”, -thotë për të Flutarak Germeji duke folur për vëllimin poetik “Profecia e Drurëve”¹¹⁹.

Dhe është e vërtetë që kur lexon poezi të Kacalidhës në gjuhën shqipe të kujtohen motive të Elitis, Seferis, Ricosit etj.

E njëjta gjë ndodh edhe kur lexon poezi greqisht të Niko Kacalidhës. Të kujtohet mënjëherë Kadareja, Arapi, Podrimja.

Ai e merr këtë ngacmim, ose diçka tjetër që e impresionoi tej mase, e fut në botën e tij poetike të metaforave, simboleve e personifikimeve aq ngushtësisht të lidhura me pemët, zogjtë, ujërat, shkëmbinjët e vendlindjës së tij, për t'i formësuar në një diçka poetike që i përket egocentrizmit të tij. Madje, duket ndjeshëm pjesëmarrja në këtë proces edhe i yjve, rrufeve, reve, hënës e gjithçkaje tjetër qiellore që duket nga pikëvështrimi i vendlindjes së tij.

Gjithashtu duke qenë se Kacalidhas shkruan aq lirshëm në të dyja gjuhët, me të njëjtën mënyrë poetike, në krijimtarinë e tij krijon shpesh një sintaksë poetike të vetën, e cila rrjedh nga komunikimi brenda vetes i gjuhëve analoge. Në këtë kuadër ai përbën një shembull për letërsinë krahasuese. Duke qenë një ndërmjetës poetik midis dy gjuhëve arrin të krijojë jo vetëm individualitetin e tij krijues por edhe të ndikojë te letërsitë analoge. Si tregues për këtë mund të mirret edhe vlerësimi që i bëhet në të dy vendet.

Andreas Zarballas

U lind më 1942 në fshatin Llazar të Sarandës. Pas studimeve punoi për pak kohë si mësues dhe pastaj gazetar në gazetën “Llaiko Vima”. Më 1981 botoi vëllimin e parë poetik, «*Επιμένουμε*» (“Këmbëngulim”). Më 1985 librin me publicistikë, «*Ταξίδι στον τοπο μου*» (“Udhëtim në vendin tim”) dhe më 1989 vëllimin e dytë poetik «*Τα παιδιά του Ήλιου*» (“Djemtë e Diellit”). Më 1992 botoi vëllimi e tretë poetik, «*101 ποιήματα για μια χούφτα γη*» (“101 poezi për një grusht tokë”). Me 2004 studimin «*Ο άλλος χάρτης*» (“Harta tjetër”). Më 2006 dhe 2007, përgatiti dy antologji, e para me poezi të poetëve minoritarë grek e përkthyer dhe shqip dhe e dyta me tregimin e zgjedhur të prozatorëve nga Minoriteti Grek. Me 2008 botoi vëllimin me tregimet e tij më të mira «*Η μοίρα του Αλκίνοου*» (“Fati i Alkinout”) dhe po këtë vit një vëllim me esse rreth këngëve popullore me titull, «*Το αιμα της αγάπης*» (“Gjaku i së dashurës”). Më 2009 botoi vëllimin e ri me poezi «*Ραβδο-*

¹¹⁹ Germeji F., *Diskutim letrar*, Tiranë, 15.01 2001.

μάντης” (“Fallhedhësi me shkop”) dhe më 2016 vëllimin poetik “Η μπαλάντα της στάμνας” (“Balada e shtamnës”).

Si njeri i letrave Zarballas i kushtoi rendësi dhe përkthimit analog, - nga greqishtja në shqip, siç janë poezitë e zgjedhura në antologjinë e poezisë Ballkanike Aimos, por dhe anasjalltas nga shqipja në greqisht.

Pavarësisht nga prodhimtaria jo e shumtë, konsiderohet një nga poetët me në zë dhe një nga penat më të fuqishme në letërsinë e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri. Në vetvete ai përbën një shkollë poetike. I ndërgjegjshëm për misionin e tij si poet e gazetar ai ka meritën se është nga të parët që thyen kornizat e brezit të vjetër. Zarballas është, gjithashtu, i rreptë në kërkesat për cilësi në letërsi. Ndikimi i tij ishte i drejtpërdrejtë për hapin cilësor që bëri poezia e krijuesve të Minoritetit Grek në këtë fazë. Ndhimoi shumë edhe pozicioni i tij në gazetën “Llaiko Vima”, si i vetmi mjet periodik që botonte letërsi në gjuhën greke.

Andreas Zarballas është kaq i lidhur me fatet e vendit që i përket, saqë poezia e tij, edhe kur botohej nën “inspektimin” rigoroz të diktaturës, gjente mjete komunikimi me pulsën e përkatësisë etnike dhe këtë ndjesi e përçon me guxim që e pajis arti i metaforave, paralelizmave dhe i simbolikës së tij të veçantë. Kur shkruante poezi që do t’i fuste diku nën dhe, evidentohet më qartë pezmi i fatit të të qenit dyfish i përbuzur dhe i harruar. Siç e thamë, është poeti i krijimit të simbolikës së tij të veçantë që i shërbën misionit të poezisë së tij, por i shërbejnë dhe komunitetit të tij për t’u vetorientuar e vetëpërcaktuar.

Filologu dhe tregimtari i njohur grek Hristoforos Milonis, shkruan për Zarballan: “Në poezinë e tij, gjuha arrin të realizojë funksionin e saj më fin dhe të shprehë jo thjesht fatin e keq në sipërfaqën e tij të së përditshmes, por dhe “lëvizjet më të thella të shpirtit”, ëndrrat, dinjitetin e plagosur dhe marrazinë e një populli që e kanë harruar. Bota e tij është një botë e mbyllur, por në unitet me fatin dhe kujtesën historike, me kohezionin gjeografik dhe veçoritë dalluese të identitetit kulturor dhe jetës së brëndshme të komunitetit të vet. Tek ai është i shkrirë organikisht poeti që, përfundimisht bëhet ndërgjegjja dhe zëri i tij...”¹²⁰

Vargu i tij është i kursyer dhe i thjeshtë. Përmes një sintaksi të goditur, arrin të përcjellë pa vështirësi emocion te lexuesi i tij. Di dhe përdor me saktësi fjalën kur do të krijojë ngjyime poetike, apo të përcjellë meditime filozofike. Është poet me shumë i

¹²⁰ Μιλίωνης Χρ. Gaz. Καθημερινή, dt. 6 mars, 1994. f. 30,

arsyes se i ndjenjës. Natyra, ngjyrat, tingujt kanë vlerë për Zarballan kur e ndihmojnë të depërtojë më mirë te shpirti i popullit.

Motivet e traditës popullore, ashtu si dhe vargu klasik popullor trembëdhjetë apo pesëmbëdhjetërokësh, marrin një vlerë të re artistike, gjithmonë, duke u aktualizuar në përmbajtje. Me të njëjtën mënyrë dhe qëllim ai trajton edhe mitologjinë e lashtë greke. Zarballai kërkon të “*fshihet*” pas këtyre formave për të qenë sa më alegorik në kumtimet e tij të ndaluara për kohën.

Andreas Zarballas nuk kujdeset vetëm për vargun. Kujdesi i tij më i madh është te mesazhi që do të transmetojë. Do që të jetë sa më i saktë, më i plotë dhe më i gjërë. Krijimi i uniteteve poetike me një tematikë të caktuar, por dhe me një mesazh sa më të gjërë, jo me poema të gjata, por me poezi sa më të shkurtra, mbetet një karakteristikë tjetër e poetit. Brënda këtij kuadri, ai krijon simbolikën e vet, e cila jo në pak raste është shndërruar në simbolikën e poezisë së krijuesve të tjerë minoritarë. Marrim këtu si shembull ngarkesën emocionale dhe simbolike që fitoi në krijimtarinë e tij fjala “*vendi ynë*”. Në kushtet kur përdorimi i fjalës Greqi dhe emrat apo mbiemrat e prodhuara prej saj ishin të ndaluara, duhej krijuar një nocion i ri për të përcaktuar përkatësinë etnike. Dhe u gjet togfjalëshi “*o τόπος μας*” (“*vendi ynë*”) për të përcaktuar si atdheun e veçantë të poetit dhe në vijim të të gjithë të tjerëve, ashtu edhe marrëdhëniet me Greqinë. Po ashtu përmendin simbolet e shamive dropullite, të pemës dhe të rrënjëve etj, gjë për të cilën ia vlen t’i kushtohet vëmendje më e gjërë.

Të bën përshtypje sensibiliteti i treguar nga poeti ndaj çdo gjëje. Veçanërisht, me dyshim, shikon poeti “*transformimet e socializmit*”. Është ndoshta nga të rrallët poetë që u shqetësua, p.sh, për ndërhyrjen e njeriut socialist në mjedisin natyror në emër të përfitimit të tokës së bukës. (Poezia “*Kënga për prallin e madh*”, vëllimi poetik “*Djemtë e Diellit*”.) Poeti nuk bëhet Don Kishot të dalë e të ndalojë këtë katastrofë, por shkruan një poezi që qan për shkulljen, në emër të këtij qëllimi, të një pralli shekullor. Për poetin nuk është vetëm se një pllajë mali mbeti pa pemën e vjetër, por se bashku me këtë boshllëk poeti shikon humbjen e këngëve që ishin lidhur më këtë prall. Ndërgjegjja e poetit shkon, pra më larg. Objektet mjedisore përbëjnë për të, pjesë të kulturës së një populli dhe shkatërrimi i tyre, përpos se vrasin natyrën dhe mjedisin, shkatërronjë edhe këtë kulturë.

“Zarballas”, -thotë për të Fotos Qiriazatis, “*është poet i kuresyer dhe i thjeshtë, me vargje që kanë si epiqëndër më shumë arsyen se zemrën, por lirik dhe i dashur, i dhembshur dhe i hi-*

*dhëruar, me mërzitje të dukshme për braktisjen e madhe në mëshirën e njerëzngrenësve, gjithë stres dhe ankth, por edhe besim e shpresë shtrënguar mes dhëmbëve*¹²¹.

Si fjalë e fundit për këtë shënim për A. Zarballan do të përmendim atë kërkesë të vazhdueshme ndaj tij për më shumë prodhimtari. Por me sa duket poeti i zhgënjyer nga zhvillimet që pasuan pas vitit 1990, duket se po i lë gjithnjë e më pak vend letërsisë dhe merret me evidentimin ndryshe, të paktën të historisë së “vendit të tij” në të gjitha drejtimet.

VI.6. Përfaqësues të tjerë të kësaj faze

Siç u tha edhe kur i fol për periodizimin e letërsisë në Minoritetin Etnik Grek, dhjetëvjeçari i fundit para shëmbjës së komunitetit, vitet 80’, karakterizohen nga një shpërthim krijuesish të rinj. Karakteristikë tjetër me rendësi e kësaj periudhe është se krijimtaria e tyre përshkohet nga braktisja e partishmerisë dhe angazhimit të tepruar ideologjik drejt një letërsie, sidomos poezie, sa më lirike, njerëzore dhe me kërkesa të larta artistike dhe estetike, saqë mund të thuhet se përbën një mohim të skematizmit të deriatëhershëm.

Karakteristikë tjetër është se vihet re një kthim i vullshëm tek krijimet në guhën amtare. Gjithashtu, gjinia e poezisë e humbet monopolin para presionit të prozës, vëçanërisht tregimit dhe novelës.

Bëhet fjalë për kategorinë e krijuesve të cilët do t’i japin tempin dhe diapozonin së letërsisë në Minoritetin Etnik Grek të periudhës në vazhdim, asaj pas rrezimit të sistemit komunist.

Ndër ta ka krijues që zotëronin një afirmim paraprak, por pasoheshin nga shumë krijues deputues që do të afirmohen në vijim. Paralelisht, ishte i ndjeshëm seleksionimi i cilësive letrare.

Ndër ta përmendim:

Petros Çerkezis

U lind më 1946 në Poliçan të Pogonit, rrethi i Gjirokastrës. Studioi për Letërsi në Universitetin e Tiranës. Për shumë kohë punoi si mësues e më pas libretist në estradën e Gjirokastrës. Botoi për herë të parë poezi në moshën 20-vjeçare. Fillon krijimtarinë e tij në gjuhën shqipe në poezi e prozë. Në greqisht

¹²¹ Qiriazatis F., gaz. «*Νέα εστία*», 25.12.1994.

shkruan në fillim të viteve 80. Poezitë i përmbodhi në gjashtë vëllime për fëmijë e për të rritur. Përmendim:

“Në tokën e stërgjyshërve”, poezi, 1977· “Duarshtrëngime”, poezi, 1984· “Dridhet pala e fustanellës”, 1987· «Οι ληστές του Ηλίου» (“Grabitesit e Diellit”), poezi, 1998· «Στην όχθη του σκοτωμένου χρόνου» (“Në bregun e kohës së vrarë”), poezi, 1999. Deri në këtë periudhë proza e tij, kryesisht tregime në gjuhën greke dhe shqipe, ishte e shpërndarë në shtypin periodik. Viti 2003 shënon dhe botimin e fundit në gjuhën shqipe nga ana e tij. Fjala është për vëllimin me proza poetike titulluar, “*Panteoni i dashurive të flijuara*”.

Në fillimet e dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të ri i kushtohet tërësisht prozës, veçanërisht asaj të gjatë. Më 2005 boton romanin e tij të parë titulluar «*Η έκτρωση*» (“Abordi”). Më 2017 boton vëllimin tjetër në prozë me rrëfime titulluar, «*Τα δέντρα και ο θάνατος*» (“Pemët dhe vdekja”). Pas një viti do të vijë romani i dytë, «*Η μεγάλη έξοδος*» (“Dalja e madhe”) dhe me 2019 romani i tretë «*Πύρινος αρραβώνας*» (“Fejesë e zjarrtë”).

Karakteristikë mbetet fakti se shkalla e jehonës së atdheut të veçantë në krijimtarinë e tij nuk është kaq intensive sa tek krijues të tjerë bashkëkohës dhe me peshë në letrat e Minoritetit Etnik Grek. Po ashtu, vepra e tij tregon se ai është një krijues në kërkim, por më shumë në kërkim të vendit që do të zëjë ai në letërsi. Kjo përcakton edhe llojin e letërsisë që shkruan.

Petros Çerkezis merr pjesë në disa botime në prozë e poezi nga grup autorësh. Nën kujdesin e tij panë dritën e botimit dy antologji me poezi me autorë nga Minoriteti Etnik Grek, reciprokisht më 1996 dhe 2019. Gjithashtu shquhet për përkthime cilësore në gjuhët respektive, greqisht dhe shqip. Merret edhe me studime e esse që lidhën me trashëgiminë letrare të Minoritetit Grek.

Në Qipro që banon prej vitit 1994, letërsia e prodhuar prej tij është pritur shumë mirë, veçanërisht proza e cila shquhet për një naracion poetik.

Thomas Sterjopoulos

Poet, prozator dhe studiues. Studioi për mjekësi në Universitetin e Tiranës. Dashuria e tij me letërsinë shfaqet shumë herët. Shkruan fillimisht në gjuhën shqipe. Ndër katër libra të botuara para vitëve 90’ vetëm njeri, ai me titull «*Οι άνθρωποι που αγάπησα*» (“Njerëzit që dashurova”), 1984 është shkruar në gjuhën amtare. Në vijim do të shkruajë vetëm në greqisht.

Në raportin poezi, prozë vihet re një ekuilibër. Veprat e shkruara prej tij në periudhën 1997-2022, janë si me posht:

«*Η άγνωστη Ρωμισούνη*» (“Helenizmi i panjohur”) qasje mbi traditën popullore, 1997: «*Άνθρωποι στα σύνορα*» (“Njerëz në kufi”) tregime, 2004: «*Ο θάνατος του Κώστα Ταμπάνη*» (“Vdekja e Kosta Tabanit”) tregime, 2010: «*Γραμμένα στο χρώμα*» (“Të shkruara në tokë”) tregime, 2012: «*Νυχτερινή επίσκεψη και άλλα διηγήματα*» (“Vizitë nate dhe tregime të tjera”), 2014: «*Ενθύμιον Χίου*» (“Kujtime nga Hio”) poezi, 2017: «*Άνθρωποι*» (“Njerëz”) portrete, 2019: «*Στις Δερόπολης τον κάμπο*» (“Në fushën e Dropullit”). Përmbledhje artikujsh dhe komente, 2021: «*Η αντιπολεμική και κοινωνική σάτιρα του Βασίλη Μανή-Καζινιέρη*» (“Satira kundër luftës së Vasil Mavi-Kazinieri”, shënime biografike, 2022.

I ardhur nga fusha e mjekësisë, ai sjell një ndjesi tjetër në letërsinë e Minoritetit Grek. Tematika e poezive të tij u largohet ideologjizmeve. Në të mbizotëron konvecioni i paqes dhe i dashurisë. Ai di të përcjellë te lexuesi ndjenja të holla. Aplikon vargun me rimë dhe vargun e lirë. Dhe figuracioni i zgjedhur është burimor dhe mbështet kryesisht tek metafora.

Sterjopullos dallohet gjithashtu për lirizmin e tij edhe kur shkruan prozë. Personazhet e tij shquhen për vizatimin e saktë, që arrihet më shumë përmes dhënies së botës së tyre, veprimet e mendimit, se sa duke i përshkruar. Lirizmi shquhet që në fabulat e tregimeve, që rrjedh nga kompozicioni i rrëfimit.

Personazhet dhe heronjtë e prozës së Sterjopullos janë njerëz të terrenit. Hapësira që ata veprojnë përbën atdheun e veçantë të Sterjopullos. Kryesisht behet fjalë për njerëz që besuan në drejtësi dhe në fjalët “*e apostujve të barazisë dhe të lirisë*”, njerëz që falën gjakun e tyre se besuan te shoqëria e komunitit, por në emër të luftës së klasave u gjenden përballë brutalitetit, të mohimit të fjalës së lirë dhe të drejtës së ideve. Në përpjekjen e tyre për të reaguar ata shkatërrohen.

Vend me rëndësi në veprimtarinë e tij në fushën e letrave, zë edhe studimi i historisë dhe traditave të vendit të vet. Studimet e ndryshme në këtë drejtim frymëzojnë edhe letërsinë e shkruar prej tij.

Fotos Malos

Pavarësisht nga origjina dhe pozicioni që ka si pedagog letërsie në univeristet, kontributi i tij në letërsinë e minoritetit nuk është ai që pritej. Në përgjithësi, shënjat premtuese të fillimit, nuk

u justifikuan dhe ai nuk mund të ngrihej në nivelin e krijuesve të tjerë me zë në minoritet.

Stavros Llajos

Edhe pse me një moshë relativisht të re, kërkon të zëjë një vend në letërsinë e Minoritetit Grek. Vëllimi i tij i parë poetik «*Μια χούφτα θάλασσα*» “*Një grusht det*”, 1985, në gjuhën amtare, i këndon detit, peshkatarëve, diellit, zogjve dhe dritës. Poezia e tij ka çuditërisht, një tej pamje që nuk ndotet nga angazhimi i detyrueshëm.

Vangjelis Milos

Pesha e rëndë e “*biografisë së keqe*”, nuk e pengon atë që të shkruajë poezi të vërtetë me ëmbëlsinë dhe thjeshtësinë e këngës popullore, larg zhurmave e panigjirizmit bosh.

Alekos Papas

Është një përfaqësues i brezit më të ri me pretendime krejt të reja, të cilat ngrihën mbi shqetësimet që vënë në dyshim raportet e pushtetit politik me individin në përgjithësi.

Poezitë e tij të kësaj faze, edhe pse ndonjëherë jo fort të arrira, kanë brënda një filozofi të indinjatës që buron nga pamundësia, për të ndryshuar këto raporte të ndërtuara së prapthi. Ai është një poet që kërkon lirinë dhe kërkesa e tij precizohet në lirinë politike.

Mirela Kallaxhi

Do të sjellë në faqet e gazetës “Llaiko Vima letrare” poezi me një lirizëm origjinal, meditav dhe sensual.

Po ashtu poezi me një frymë të re do të sjellin dhe Vangjelis Zafiratis, Zisos Llucis, Kostas Nushas, Jorgos Mitilis, Amalia Qendro, Panajotis Barkas, Athina Papa etj.

Lëvrimi i prozës, kryesisht tregimi dhe novela, bëhet nga autorë që konfirmohen shpejt në këtë lloj, si Tilemahos Koças, Andreas Zarballas, Thomas Sterjopullos, Spiros Hristos etj.

VI.7. Periudha në vazhdim

Fjala është për letërsinë e shkruar pas viteve 90. Në fakt nuk është e thjeshtë për ta përcaktuar termin e periodizimit të letërsisë së kësaj periudhe. I shkon për shtat termi fazë apo periudhë. Po të marrim si pikë referimi Luftën e Dytë Botërore duhet

përdorur termi fazë. Po të marrim si pikë referimi marrëdhëniet me letërsitë analoge duhet përdorur termi “*periudhë*”.

Duke qenë se kriteri i dytë është më i qenësishëm, mendojmë, se bëhet fjalë për një periudhë në vijim dhe jo për fazë të një periudhe tjetër.

Kjo periudhë e re, sëcilës i dimë pikënisjen në aspektin kohor, karakterizohet nga një zhvillim i vullshëm dhe nga lëvrimi, pothuaj, i të gjitha gjinive e llojeve letrare. Karakterizohet gjithashtu, nga përpjekjet për të fiksuar në art fatin individual e kolektiv të Minoritetit Grek gjatë periudhës komuniste. Pra, vazhdon të mbetet në përgjithësi një letërsi e angazhuar, por në një kah tjetër, që lidhet me fatin e Minoritetit Grek në Shqipëri dhe sot, si edhe fatin e individit, anëtar i këtij minoriteti, në Greqi dhe Shqipëri. Kjo përbën edhe identitetin e kësaj letërsie. Shkruhet kryesisht në Greqi. Si e tillë, ajo lëviz në të njëjtin shtrat me Letërsinë e Minoritetit Etnik Grek që shkruhej jashtë Shqipërisë që pas vendosjes së kufijve.

Siç fare thjesht mund të konstatohet autorët e kësaj periudhe janë së pari dhe krijues të fazës së dytë madje edhe të fazës së parë të periudhës së pas Luftës.

Midis tyre konkurojnë me shumë sukses dhe autorë të rinj që debutojnë pas rënies së komunizmit në Shqipëri.

Është gjithashtu e vërtet se në këtë periudhë mund të flitet për një supërpodhim letrar. Poezia, për shumë arsye, madje objektive, ruan ende epërsinë. Proza shfaqet si me tregime, novela, romane, por edhe me monografi, ditare, kujtime. Ndryshe nga poezia, proza nuk e fsheh angazhimin tematik ndaj atdheut të vëçantë. Në këtë sofër të madhe nuk mungojnë as prodhime letrare që shpesh u ngjajnë përpjekjeve për të shplarë ndërgjegjen nga një faj edhe kur ai është kryer nga halli, nga moskuptimi apo nga nevoja e mbijetesës.

Kostas Nushas dhe **Fotos Papas** i mëshojnë krijimit të fondit muzikor të kultivuar, bazuar në poezitë e poetëve minoritarë.

Panajotis Barkas sjell dhe vë në skenë dramën e dytë të tij në gjuhën amtare (“*Kundër Rymës*”) 2009 si edhe një seri dokumentarësh që i bëjnë jehonë kulturës diakronike në Minoritetin Etnik Grek dhe ngjarjeve të rëndësishme historike.

Petros Kurtis vjen në këtë periudhë, prej vitin 2009 deri më 2021, me një supërpodhim letrar me vëllime poetike dhe në pro-

zë me tregime, romane, monografi e biografi. Rendisim pjesën më të madhe të tyre:

- «*Η Μαιανδρία*» (“Meandhria”)
- «*Η Λουίζα, το κορίτσι που δεν ξέρει να γελά*» (“Luiza, vajza qe s’di të qesh”) μυθιστόρημα 2009
- «*Η μούσα του χωριού μου*» (“Muza e fshatit tim”) μυθιστόρημα
- «*Το εισιτήριο της κόλασης*» (Bileta nga sketera”) μυθιστορημα
- «*Ο Μαύρος Καβαλάρης*» (“Kalorës i zi”)
- «*Μάρθα μη φύγεις*» (“Martha mos ik!”)
- «*Στα φτερά του Πήγασου*» (“Në krahët e Pegasos”) Poezi
- «*Θα είναι αργά*» (“Do të jetë vonë”)
- «*Το ματωμένο δαχτυλίδι*», (“Unaza e gjakosur”) roman 2011
- «*Αγάπη και δάκρυα*», (“Dashuri dhe lot”) roman 2012
- «*Κραυγές μέσα από το φίμωτρο*» (“Klithma pas gojës së mbyllur”)
- «*Ωμότητες*», (“Brutalitete”)
- «*Μια πένα φωνάζει*», (“Një penë bërtet”)
- «*Μετρώντας τα κύματα*» (“Duke numëruar valet”) ποιήματα
- «*Εγώ με την κομμένη γλώσσα*» (“Unë me gjuhë të prerë”)
- «*Σφυριές*» (“Goditje çekiçi”) poezi 2019

Përmendim akoma:

Spiros Hristu me poezinë, sprovat, kritikën letrare dhe veçanërisht me vëllimet me tregime dhe tre romane, si: «*Ο άλλος άνθρωπος*» (“Njeriu tjetër”) 1999· «*Ο Γλάρος ήταν στην ώρα*» (“Pulëbardha ishte në kohë”) 2009· «*Στην άλλη στροφή*» (“Në kthesën tjetër”) 2015· «*Τα σημεία των καιρών*» (“Gjëmat e kohrave”) 2016· «*Δεν έχω λόγια μόνο λουλούδια*» (“Nuk kam fjalë veç lule”) 2018.

Pas këtyre vëllimeve me tregime dhe poezi ka botuar romanet: «*Με θέα τη λίμνη*» (“Me pamje nga deti”) 2018· «*Το κορίτσι με τα τριαντάφυλλα*» (“Vajza me trendafil”), 2019· «*Βρεθήκαμε να μη χαθούμε*» (“U gjetem për të mos humbur”) 2020.

Vasilis Dilos me romanin «*Ο παράδεισος είναι δίπλα*» (“Parajsa është në krah”).

Jorgos Shukuris me vëllimin me tregime «*Η θλιμμένη νεράιδα*» (“Neraidha e trishtuar”).

Vasilis Hristu me vëllimin me tregime «*Μάνα... καημένη μάνα*» (“Nënë ... e shkreta nenë”) dhe romanin «*Τα τραγούδια της Ελένης*» (“Këngët e Elenit”) 2020.

Stavros Paputsis vjen me vëlimet me tregime «*Εναγώνιες προσδοκίες*» (“Prishmeri në ankth”): «*Στη χωρισμένη γη της Ηπείρου*» (“Në tokën e ndarë të Epirit”): «*Το κομπολόι της ελπίδας*» (“Tespihët e shpresë”): «*Να κλαις και να γελάς*» (“Të qash e të qeshësh”) 2020· me vëllimet me poezi «*Αναπόφευκτη μέθεξη*» (“Dehje e pashmangshme”), «*Πάνω από έναν αιώνα*» (“Përmbi një shekull”): si edhe me dy biografi «*Το πρόπον του Ανδρέα Μαρτίνου*» (Ajo që i shkon Andrea Martini) 2015· «*Δημήτρης Στέφος, ο άνθρωπος, ο επιστήμονας, ο καταδιωκόμενος, ο Έλληνας*» (“Dhimitris Stefos, njeriu, shkencëtari, i përndjekuri heleni”) 2018.

Minas Lekkas Një poet që në letërsinë e periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore ishte pak i njohur për faktin se jetonte larg zonave me popullsi kombakte të Minoritetit Grek. Pas viteve 90’ është i pranishëm në shtypin letrar të kohës. Botoi vëllimet poetike «*Φυλακισμένα τραγούδια*» (“Këngë të burgosura”), «*Της Αθήνας τα παράξενα*» (“Gjërat e çuditshme të Athinës”), «*Μαργαριτάρια*» (“Margaritarët”), «*Γέφυρες*» (“Urat”).

Poezia e tij, shpesh me varg klasik, shquhet për racionalitet mendimi dhe tregon vlerën e tij për të kthyer në art filozofik aftësinë e vëzhgimit dhe të përjetimit intensiv të realitetit. Lekkas gjithashtu, shquhet dhe për poezinë e problematikës aktuale, sidomos asaj politike.

Vangjelis Zafiratis. Ka një rrugëtim të gjatë në fushën e poezisë ku shquhet për përpjekjen për të krijuar individualitetin e tij poetik. Poezia etij edhe kur është lirike dhe shquhet për finesën tregon se është produkt i “*laborarit*” poetik. Ka aftësinë që të ushqejë poezinë e tij me frytet e punës studimore dhe krijimtarinë popullore.

Botoi vëllimet poetike «*Ποιήματα*» (“Poezi”), «*Εμένα οι κάμποι με γνωρίζουν*», (“Mua fushat më njohin”), «*Δάκρυ της πέτρας*» (“Loti i gurit”) 2002, «*Πέτρες και θάλασσα*» (“Gurë dhe det”), «*Σγουρός βασιλικός*» (“Borzilok gjethedredhur”), dhe në gjuhën shqipe “Qyteti i larë në diell”, «E zeza është e bardhë». Botoi gjithashtu sprovat «*Η μοναξιά της πέτρας*» (“Vetmia e gurit”) dhe, «*Άγιοι Σαράντα*» (“Shën Saranda”) 2021.

Kostas Nushas vjen me vëllimin poetik, «*Θρυλική συμφωνία*» (“Simfoni legjendare”) me poemat për Bisticën, Himarën, Dropullin dhe çëllimin e dytë poetik «*Κόκκινος κύκλος*» (“Rrethi i kuq”). Nusha tregoi një angazhim të veçantë për melodozimin dhe kthimin në këngë të shumë poezive të krijuesve minoritarë grekë.

Alekos Papas me vëllimin poetik «*Το σύγχρονο ταξίδι του Οδυσσέα*» (“Udhëtimi modern i Odiseut”). Poezia e tij e shkruar në varg të lirë shquhet për figuracion të guximshëm, huazon motive nga mitologjia greke për ta përdorur si Kavafi, në qasjet tematike të ditës sidomos ato kushtuar identitetit etnik dhe politikës së ditës. Punon shumë me vergun edhe kur ai ka trajta narrative.

Alqis Papas me vëllimin poetik «*Γεφύρια*» (“Urat”).

Një zë të vëçantë, premtues dhe me jehonë në publikun grek dhe shqiptar është ai i **Kristo Armando Gjezos** me origjinë nga Himara. Edhe pse realitivist shumë i ri në moshë, i datëlindjes 1988, ka një prodhimtari të konsiderueshme letrare dhe në gjini e lloje të ndryshme. Me 2012 botoi vëllimin e parë poetik “Frikë e parealizuar”, («*Ανεκπλήρωτοι φόβοι*»), që u laurua me çmimin e parë si deputues në letërsi. Do të pasojnë, romani “Balta” («*Η λάσπη*»), vëllimi me tregime “Traballa” («*Τραμπάλα*») dhe libri për femijë “Pema që kishte për kokë një top” («*Το δέντρο που είχε μια μπάλα για κεφάλι*»).

Me rrënjë nga Himara dhe Dropulli është dhe poeti **Dhimiter Kokaveshi**. Ka një prodhimtari të dukshme letrare. Shkruante në të dy gjuhët dhe për krijimtarinë e tij letrare ka njohje dhe vlerësim ndërkombëtare. Tre nga vëllimet e tij poetike janë: “Stalakmitet” 2004, “Fati i dritës”, 2009, dhe “Meteoritet”.

Më e pranishme dhe më e konsoliduar vjen në këtë periudhë zëri i grave të dhëna pas letërsisë. Përmendim:

Mirela Kallaxhi, «*Ίχνη και περάσματα*» (“Gjurmë dhe shtigje”) 2020 Athinë. Një zë në letrat greke që premtonte që kur ishte në bankat e shkollës së mesme. Shquhet për një lirizëm autentik, meditativ që lëviz në sferën e metafizikës dhe sensual.

Elsa Xhumba, “Sa mban një ëndër” («*Όσο κρατάει ένα όνειρο*») 2016 Gjirokastër. Titulli i vëllimit është shprehje e qartë e poezive të saj. Me varg të shkurtër, me mendime befasuese dhe figuracion të bëftë. Lirizmi i saj ka të bëjë me jetën dhe dëshirën për ta jetuar atë edhe për momentet dhe dëshirat e perealizuara.

Rodhavi Gogoni, «*Ερωτικές φεγγοβολές*» (“Dashuri dritëhene”) 2019. Pavarësisht se poezia e saj është përmbledhur nga

ajo vetë në një vëllim poetik, konsiderohet një poete e konsoliduar dhe me identitet të plotë lirik. Çmimet e marra e vërtetojnë këtë.

Athina Papa, «*Αμάραντα ταξίδια*» “Udhetime të pa fishkura”) 2020, «*Αβυσσος ψυχής*» (Pafundësi shpirti) 2021. Publikimi i poezive të saj është pak i vonë. Lirizmi i vargut të saj shpreh ndjenja dhe mendime së bashku. Pëlqen vargun klasik me rimë. Ruan tone të qeta për të shprehur përjetimet e veta të cilave u jep vlera përgjithësuese, ose që mundëson lexuesin të gjejë vetvetën.

Katerina Karaxha, «*Νήματα και αισθήματα*» (“Fije dhe ndjenja”) 2018: «*Το βάλς της πέννας*» (“Valsi i penës”) 2021. Një poete me pretendime dhe ambicje.

Mirela Mitro, e përmendim jo aq për prodhimtarinë e gjerë letrare. Shkruan poezi, kryesisht medative. Por për faktin se është e vetmja që mban titullin akademik të profesorit të asociuar. Po ashtu dallohet për kontributin e saj në fushën e përkthimit. Ka botuar librin me poezi «*Ξεχασμένες ματιές*» (“Shikime të harruara”).

Kuptohet që autorët dhe veprat e tyre të cilëve u referohemi më lart përbëjnë një pjesë të vogël të asaj prodhimtarie të madhe letrare të po kësaj periudhe dhe të atyre të mëparshme. Një pjesë tjetër e madhe dhe e rëndësishme u përmend kur u fol për shkrimtarët dhe poetët e periudhave të mëparshme.

Por mund të përmendim akoma, romancierin e dëgjuar Ilija Fuqin dhe bashkëfshatarin e tij po romancier Thanasi Mejdi. Shtojmë këtu Anastasia Katsalidhën, Marko Zianën, Dhimosteni Paskon, Panajota Isarin, Niko Ballkonin, Vasil Mukën, Spiro Pekon, Thanasi Pappan, Emilio Pandon, Mihali Qosen, Mimi Kostën, Vasili Piralin, Irini Rafti -Andrucon, Theodhos Mantziarin. Kosta Mishon, Aristidhi Iasonidhin, Aristoteli Spiron, Harallambi Foton, Zisi Karvellan, Thoma Pilio, Foti Menikon Melina Papa, Foto Papathanasin, Florentina Millon, Amalia Qendro-Llukani etj.

Në këtë periudhë kontaktet me letërsinë panhelene janë të lira, ndërsa rrallohën gjithnjë e më shumë kontaktet me letërsinë shqiptare. Gjithnjë e më të rrallë janë krijuesit minoritarë të kësaj periudhe që shkruajnë në të dy gjuhët, shqip e greqisht. Përveç Jorgo Çatit, Vasili Gjizelit, apo edhe Niko Katsalidhas autorë të tjerë nga Minoriteti Grek që shkruajnë letërsi dhe në gjuhën shqipe përmendim Panajoti Bolin, Sotiri Thanon, Dhimitri Tsagan, Thoma Thimjon, Thanasi J. Pilafan etj.

Ndër ta P. Boli jeton dhe punon si mësues e gazetar në vendlindjen e tij. Bota e femijëve dhe shqetësimet njerëzve që e rrethojnë janë temat e tij të preferuara. Ka shkruar poezi në gjuhën shqipe që në vitet 1980. Prozën e filloi shumë më vonë. Përvëç botimeve të mirëfillta vazhdon ende të botojë poezi dhe tregime në shtypin letrar dhe periodik shqiptar Ndër botimet e tij përmendim, vëllimin me skica “Sy të trishtuar” («*Θλιμένα Μάτια*») 2016, “Nostalgjia çapitet në rrugët me kalldrem” 2019, poezi, “Sonte Hëna” 2022, me tregime dhe skica, ndërkohë që ka gati për botim disa libra të tjerë me poezi, prozë, gazetari.

Një veçori me vete përbën rasti i Grigor Jovanit. Lindur në Dropull dhe rritur në Laç. Studjoi filologji dhe u specializua për gazetari. Edhe pas vitit 1991 që u shpërngul familjarisht në Athinë, Jovani vazhdoi të shkruajë letërsi dhe të jetë i angazhuar me letrat në gjuhën shqipe. Shquhet për kontributin në medjat në gjuhën shqipe në Greqi, që botojnë emigrantët. Ndërkohë letërsia mbetet pasioni i tij i jetës. Ka shkruar vëllimet poetike “Botë pa dashuri” (1977), “Punishtja e ëndrrave” (2004), “Udhëtoj brenda vetes” (2008), “Blu e thellë” (2012), “Vreshtat e Dionisit” – gjashtë libra në një (2015), “Taverna e të marrëve” (2022). Për botim ka romanin “Ura e mbretit” dhe librin me proza të shkurtëra “Klinika”. Jovani nuk e fsheh ngjizjen tek vetja të identitetit shqiptar, pavarësisht origjinës së tij greke.

Dy fjalë për infrastrukturën studimore, orientuese dhe kritikën

Nuk mund të mos vihet re se kjo letërsi zhvillohet e shpërndarë në realitetin helenë. Mungesa e një strukture për ta ndjekur, grumbulluar, studiuar e promovuar mbetet një problem serioz. Ky problem lidhet me fatin e ruajtjes së identitetit të saj në të ardhmen si letërsi e Minoriteti Grek dhe nuk ka si të ndodh ndryshe përderisa ky Minoritet ndodhet në Shqipëri.

Evidente është gjithashtu, mungesa e kritikës dhe e infrastrukturës së kritikës. Prodhimtaria letrare nuk i nënshtrohet procesit të kritikës letrare Autoriteti i specializuar mungon, ashtu siç mungon edhe infrastruktura, - gazetatat revistat etj. Organizimi i veprimtarive promovuese janë të shumta por nuk mund të zëvendësojnë aktin e kritikës letrare. Ndërkohë, vetëm disa nga penat e fuqishme kanë fatin t’i nënshtrohen kritikës së specializuar, por në kuadrin e gjithë letërsisë helene. Po ashtu, mungojnë studi-

met e mirëfillta për natyrën e saj të tashme dhe për të ardhmën e saj. Në këtë kuptim letërsia e Minoritetit Etnik Grek vërtet është e lirë, vërtet që kjo liri e saj vazhdon të ruajë një angazhim të caktuar tradicional, por në përgjithësi, është e paorientuar dhe pa impaktin e duhur kulturor në një shoqëri të dalë nga një sistem diktatorial.

Mëgjithatë, asgjë nuk mund të shikohet e të shumëzohet me zero. Egziston një traditë e hershme me kontribute të vyera. Bëhet fjalë për shoqata, grupime të cilësuar letrare, shtëpi botuese. I njohur është p.sh, kontributi për letrat helene dhe veçanërisht ato të vendlindjes së tij, i bamiresit Kristaq Zografos në Konstandinopojë.

U përmend në një moment të mëparshëm në monografi rasti i Niko Zelitas¹²² nga Dhrovjani. Ai themeloi në Aleksandri një shtëpi botuese me rrezatim dhe kontribut me shumë vlera. Po ashtu njihet si themelues i shoqatave filologjike e letrare helene, Shoqëria Muzikore Helene, Grupi Arsimor i Egjyptit. Po në Aleksandri të Egjyptit, bashkëfshatari tjetër i Zelistës, Odhiseas Llapas themeloi shoqërinë letrare “Eskili” etj.

Kjo traditë ruhet ende në ditët e sotme. Përmendim shoqatën EKABH në Athinë, shoqatën letrare dhe të letrave të Poliçanit dhe Pogonit. Po ashtu me shumë interes është kontributi i shtëpisë botuese «*Εκδόσεις Σύγχρονης Λογοτεχνίας*» (“Botime të letërsisë moderne”) të Nikolla Nikës nga Bodrishta e Gjirokastrës, shtëpia botuese “Jovani” e Kristo Jovanit nga Jergucati i Dropullit, në Athinë, Instituti IBE dhe Ipirotiki Estia në Janninë etj.

Kontributi i Fondacionit Elikranon

Në këtë kuadër duhet theksuar roli dhe kontributi i shtëpisë botuese dhe i fondacionit Elikranon në Athinë dhe Sarandë. Ky institucion i dyfishtë, është i angazhuar në disa veprimtari të lidhura drejtpërdrejtë me letrat në Minoritetin Etnik Grek.

Merr përsipër botimin e pjesës më të madhe të prodhimit letrar të krijuesve nga Minoriteti Etnik Grek. Statistika tregojnë se ka botuar mbi 120 libra të natyrës letrare të mbi 45 autorëve.

Nga ana tjetër grumbullon dhe riboton trashëgiminë letrare të dhjeveçarëve dhe shekujve të kaluar. Në arkivin e vet numëron

¹²² Shih, kreu i tretë. Tiparet e letërsisë në Minoritetin Etnik Grek pas vendosjes së kufirit midis dy shteteve.

deri tani mbi 150 vepra letrare të gjinive dhe lojeve të ndryshme si edhe me dhjetra gazeta dhe revista të natyrës letrare.

Po ashtu Elikranon është shndërruar në një qendër takimesh, shkëmbimi mendimesh, qarkullimi librash, bibliografie, idesh e mendimesh.

Elikranon ka marrë përsipër edhe grumbullimin, sistemimin dhe ruajtjen e kësaj prodimitarie letrare qëndravëllimeshe.

Fondacioni kontribuoi edhe në bibliografinë e kësaj monografie dhe ka falendërimet tona.

PJESA E TRETË

KREU I SHTATË

QASJE TEORIKO-LETRARE E KRIJIMTARISË POETIKE TË PANO ÇUKËS, NIKO KACALIDHES DHE ANDREA ZARBALLAS

VII. 1. *Miti dhe ideologjia*

Ndryshe nga dy pjesët e para të monografisë që kishin karakter konstatues dhe përshkruar, pjesa tretë e kësaj monografie ka për objekt analizën e plotë dhe të thelluar të veprës letrare të tre poetëve, P. Çukës, A. Zarballas dhe N. Kacalidhës. Qëllimi është që të vihen në pah konkretisht vlerat artistike dhe estetike të letërsisë në Minoritetin Etnik Grek nëpërmjet analizës së veprave konkrete të këtyre tri përfaqësuesve të kësaj letërsie. Përzgjedhja është bërë mbi disa kritere. Së pari i përkasin fazave të ndryshme brenda periudhës së realizmit socialist. Së dyti, megjithëse i përkasin së njëjtës metodë krijuese angazhimi i tyre poetik, gjuha e përdorur dhe teknika poetike është e ndryshme. Së treti kjo presupozon vështirësi në mënyrën e organizimit të strukturës së studimit dhe në vijimësi të paraqitjes së materialit.

Realiteti i mësipërm e bën gjithsesi, të vështirë realizimin e plotë të qëllimit të venë. Mënyra më e thjeshtë ishte të mireshim me çështje dhe kritere të formës dhe strukturës poetike. Por kjo, nga ana e vet do të binte ndesh me parimet dhe orientimin bazë të punimit të përcaktuar që në parathënie dhe në disa kapituj në vijim, atë të mesazhit poetik të kodifikuar në mite dhe të mbartur në krijimin dhe rikrijimin e tyre në konceptin real dhe filozofik të kohës dhe hapësirës.

Nga ana tjetër, vet këta poetë u përpoqën të heqin nga krijimtaria e tyre atë letërsi, funksioni estetik i së cilës skadoi bashkë me mbylljen e ciklit të pushtetit komunist dhe promovuan atë pjesë të traditës së tyre me vlera të qëndrueshme përtej këtij angazhimi, si dhe atë prodhim të krijuar rishtazi. Kjo e bën të arsyeshme që ne të përqëndrohemi pikërisht në këtë prodhimtari le-

trare dhe në përputhje me metodën e zgjedhur, menduam të operojmë në bazë të disa kriterëve përgjithësues.

Vëllimet poetike të marra në shqyrtim janë:

P. Çuka «Γεια σας αδέρφια (μια φωνή απ' το Αργυρόκαστρο)» (“Përshëndetje vëllezër, (një zë nga Gjirokastra)”), Athinë 1993.

N. Kacalidha: “*Pagëzimi i Zogjve*”, Tiranë 2006. Përfshihën poezi të zgjedhura nga vëllimet poetike “*Pagëzimi i zogjve*”, “*Eliksiri i Gurit*”, “*Shtëpia e erërave*”, “*Hiri i hidhërimit*”. Vëllimi “*Profecitë e drurëve*” Tiranë 1988 dhe «*Η μοίρα του αμάραντου*» (Fati i amarandos), Athinë, 2003, ku përfshihën vëllimet poetike “*Bashi i yjeve*”, “*Natësira e lulenatës*”, “*Vaji i malit të vrenjtur*”, “*Limonë të hidhur*”, “*Loti i ciklaminës*” “*Ambrozia e gurit*”, “*Njëmijë guacka deti*”, “*Dhe sfinks i foli*”.

Andrea Zarballas: “*Njëqind e një poezi për një grusht dhe*”, Athinë 1992.

Detajimi i tematikës dhe i motiveve, të cilat kërkuan një punë voluminoze, na lejuan të konkludojmë në kategoritë e mëposhtme.

1. Kategoria e natyrës
2. Kategoria e njeriut (shoqërisë)
3. Kategoria e forcave metafizike, (perënditë, fati, shënjtoret etj)

Për të mundësuar një analizë në bazë të këtyre kategorive është e domosdoshme të kuptojmë disa nocione teorike në lidhje me to dhe që do të na ndihmojnë të vendosim një marrëdhënie sa më të qenësishme dhe të natyrshme me parashtrimet e mëparshme.

Së pari parashtrojmë idenë e mitit dhe të ideologjisë si një marrëdhënie organike midis tyre. E nisim arsyetimin nga ndryshimi midis gjuhës dhe letërsisë si dy mjete komunikimi që përdorin të njëjtin kod. Veçoria dalluese e gjuhës duhet kërkuar te “*funkzioni referues*” i shënjes. Në letërsi dhe veçanërisht në poezi “*qëllim dhe objekt i komunikimit është mesazhi në formën e vet konkrete*”¹²³, është “*funkzioni poetik*”.

Në lidhje me këtë funksion të gjuhës poetike Niçe thoshte se “*Sa më abstrakte është e vërteta që do të kumtosh, aq më afër ndjenjave duhet ta sjellësh*”¹²⁴. Dhe N. Kazantzakis shton: “*Por tani nxitoj të shpreh ndjenjat me fjalë, në shkrimet e ardhshme*

¹²³ Jakobson R., 1975, *Γλωσσολογία και ποιητική* (përkthim, greqisht Glosologjia dhe poetika), Athinë, fq. 34, 5.

¹²⁴ Βουγιουκα, Α. 1999, *Η ποίηση της πραγματικότητας και η πραγματικότητα της ποίησης*, (Poezia e realitetit dhe realiteti i poezisë), Athinë fq. 101.

do t'i kushtoj gjithë kujdesin vargut dhe një çeshtjeje akoma më të vështirë: të lehtësoj çdo fjalë dhe shprehje nga përmbajtja "kuptimore", vetëm emocion, esencë, muzikë. Thjeshtësi absolute me figurë të thjeshtë, të pastër, me vizion"¹²⁵. Sipas Elitisit arti i tij poetik përbën "një metodë të kuptimit të botës nëpërmjet ndjenjave"

Ky ndryshim konsiston në atë që poezia i përket sistemeve gjuhësore polisemantike dhe shfaqet si mënyrë subjektive referimi, ndërsa gjuha si mënyrë objektive. Mirëpo, ndërsa ky funksion shfaqet si vlerë subjektive, në realitet, në një masë të madhe përcaktohet nga kode që funksionojnë në nivel të subkoshencës individuale dhe kolektive dhe lidhën apo bashkohën me ideologjinë e një shoqërie (në aspektin historik). Fenomeni përbën, sipas Barthes një pjesë ideologjike.

Çdo poezi strukturohet në bazë të dy boshteve, atë sintagmatik dhe atë paradigmatic që bashkohën i pari me nivelin gjuhësor dhe i dyti me funksionin poetik. Të dy konfondohen në mënyrë organike midis tyre. Në rafshin ose boshtin sintagmatik zenë vend nëpërmjet hapësirës, kohës, karaktereve dhe veprimeve mesazhet ideologjike të krijuesit që mishërohen në boshtin paradigmatic. Për pasojë, "kozmosi ideologjik" i një vepre është modeli ose sistemi akronik në të cilin kodifikohet botëkuptimi dhe antropologjia e poetit, ndërsa "kozmosi mitik"-miti, është shndërrimi i këtij konceptimi të botës reale në mite konkrete, dmth, në histori me subjekte vepruese, hapësirë dhe kohë, të krijuara nga poeti, në mënyrë të tillë që përbëjnë një izotop me kozmosin ideologjik.

Pra miti, është ligjërimit-tekst, i një niveli tjetër semantik struktura e të cilit, raporti midis *shënuesit* dhe të *shënuarit*, shënjesobjektit, nuk është një strukturë arbitrare, siç ndodh me shënjen gjuhësore, por në mënyrë të skajshme i arsyetuar dhe gjithmonë i ngritur mbi sistemin semantik gjuhësor. Gjithmonë sipas Barthes-it, ajo që në sistemin gjuhësor është *shënjë* në sistemin e mitit shndërrohet në *shënues të thjeshtë* dhe kuptimi semantik në sistemin gjuhësor shndërrohet në formë. Si i tillë miti është një ligjërimit gjuhësor "*i huazuar*" nga gjuha si sistem komunikimi dhe që "*rikthehet*" në këtë funksion, por i pasuruar me aftësinë polisemantike që siguron (në planin letrar) metafora dhe sistemi tjetër figurativ. Mund të thuhet që është një realitet i krijuar, i plasuar, që i serviret lexuesit si i vërtetë nëpërmjet një sistemi se-

¹²⁵ Βουγιουκα, Α. 1999, *Η ποίηση της πραγματικότητας και η πραγματικότητα της ποίησης*, (Poezia e realitetit dhe realiteti i poezisë), Athfq 103.

mantik gjuhësor të ngarkuar me emocion që mbart një ideologji të caktuar. Kjo do të thotë se kur poeti arrin të mënjanojë kondradiktën midis mitit dhe realitetit, që arrihet nga shkrimi midis tyre, atëherë ai garanton sukses poetik të papërseritshëm dhe ekuilibër të admiruar.

Në këtë kontekst besoj se është me rëndësi të theksohen akoma dhe disa pikëpamje të tjera lidhur me mitin, të cilat na japim mundësinë për të kuptuar se miti është produkt shoqëror, i krijuar prej shoqërisë për t'i shërbyer asaj dhe për të kryer këtë funksion ai mbartet diakronikisht duke iu përshtatur nivelit të arritur prej saj.

Sipas Frojdit, miti përbën shfaqje të jashtme të fenomeneve të brëndshme psikoanalitike të njeriut me pikënisje në subkoshiençë. *"Përbëjnë mbetje dëshirash dhe fantazish të kombëve të tera me fillesa të endrrat prehistorike të foshnjërisë së njerëzimit"*¹²⁶.

Nxënësi i tij K. Jung ia dedikon mitin subkoshiençës kolektive si një predispozicion psikik i formësuar nga forca e trashëgimisë, nga ku buron në përgjithësi vepra e artit nëpërmjet artistit, si *"individ kolektiv"* (shoqëror).

Ideologjia nuk është gjë tjetër veçse të gjitha shfaqjet e dijes dhe të kuptimit të botës, (Figura, mite, ide, kuptime), qofshin ato të drejta apo të gabuara, aprovohën si veprimtari përbërëse nga cilado shoqëri njerëzore dhe përdoren prej tyre si mjet rehabilitimi i së drejtës dhe mbrojtjes së interesave të tyre. Ajo mund të ndahet në dy kategori në ideologji të përhershme dhe të pjesëshme. E para përbën pjesë organike të shoqërisë njerëzore në aspektin diakronik dhe ideologjia e pjesëshme ka karakter historik dhe shpreh qëndrimet koresponduese të çdo shoqërie në një kohë të caktuar.

Elitis në polisiminë e tij për mitin, midis të tjerash e trajton atë si një vizion të paraparë në kuadër të një funksioni *"politik"* të poezisë që dëndëson të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Duke folur për Greqinë ai beson se ky mit vizionar ekziston në mënyrë të ngahërshme, thjesht *"kërkon pak zemër të pastër"* që të shfaqet.

Në këtë pikë duhet theksuar rëndësia që merr ekzistenca e *"një besimi"*, -në formën e ideologjisë, në krijimin e një miti, gjë që presupozon se bota e mitit është një botë dramatike, botë veprimesh, forcash, pushtetesh që përplasen. Në këtë kuadër model veprimi në mit nuk është natyra, por shoqëria. Natyra reflekton në mit shoqërinë unike, njerëzore të vet jetës.

¹²⁶ Frojd S., 1956, *Ο ποιητής και οι φαντασιώσεις*, Athinë, fq. 772,

Pas kësaj përqaasjeje le t'u kthehemi poetëve konkretë dhe analizës së veprës së tyre me instrument kryesor, kategoritë e përcaktuara më lart. Kriteri i përzgjedhjes së tyre janë kategoritë kryesore të karakterizimit të letërsisë si art i kohës. Fjala është për kategoritë e hapësirës (lart-posht, brënda-jasht) dhe të kohës (tani-atëherë -pastaj). Në këto raporte nëndarja *lart* përfshin *qiellin, perëndinë, hapësirën kozmike, "botën tjetër"* në përgjithësi *metafizikën*. Nëndarja *poshtë* përfshin, *tokën dhe natyrën* nga njera anë dhe *shoqërinë* nga ana tjetër (realiteti shoqëror dhe natyror).

Në kategorinë e kohës nëndarja *tani* lidhet me të tashmen "*realtitetin*", ndërsa nëndarja *atëherë* me të shkuarën mitin. Nëndarja *pastaj* është e lidhur me të ardhmen e cila tek të tre poetet përbën krahasimisht një dimension të vagët dhe të papërcaktuar, të modeluar në formën e dëshirës, apo dhe të pyetjes retorike.

Për të operuar sa më mirë, brënda këtyre kategorive mund të vendosen në mënyrë organike raportet që zgjodhëm në kreun e dytë *individ-shoqëri, natyrë-kulturë, liri-robëri dhe jetë-vdekje* si kritere tipologjike të traditës popullore të mbartur në letërsinë e kultivuar.

KREU I TETË

PANOS ÇUKAS

VIII. 1. *Jetëshkrimi.*

80 vitet e jetës së tij mund të konsiderohen pa frikë se përbëjnë jetën e një punëtori të palodhur të gjuhës greke në oazin e izoluar nga shteti amë të Minoritetit Grek në Shqipëri. Këtë titull ia jep atij veprimtaria në fushën e letrave si poet, prozator, publicist, përkthyes, redaktor, folklorist, orator.

Ai, konsiderohet "*poet minoritar i Shqipërisë*". Për të janë shkruar mbi 150 artikuj e shënime vlerësuese në të gjithë shtypin shqiptar e minoritar, por edhe në Greqi.

Për Pano Çukën janë shprehur autoritetet më të njohur letrare nga vendi, por edhe nga Greqia.

Dritëro Agolli, "*Pano Çuka është poet me shije të hollë artistike. Vargjet e tij kanë pathos, figura romantike dhe simbole që i hasim në traditat e letërsisë klasike...*"¹²⁷.

Adriatik Kallulli, "*...një individualitet poetik i formuar që mundohet të reflektojë realitetin tonë në mënyrë origjinale, me mjete e figura të përpunuara.*"¹²⁸.

Andrea Varfi, "*Poezia e tij komunikon, është e ngrohtë, e kapshme, origjinale...*"¹²⁹.

Janë shprehur gjithashtu, Ismail Kadare, Aleks Çaçi, Llazar Siliqi, Spiro Çomora, Dhimiter Shuteriqi, Petrit Ruka, Zija Çela, Jorgo Bulo, Dalan Shaplllo etj

U lind më 1925 në fshatin Sopik të Pogonit të rrethit të Gjirokastrës. Studioi në shkollën e mesme për mësues në Vellas të rrethit të Janinës. Pa mbushur të 20^t ishte një nga penat që shkroi poezi në formacionet luftarake të Minoritetit Grek në luftën e përbashkët me popullin shqiptar.

Është një nga themeluesit e emisionit greqisht në radion lokale të Gjirokastrës, (1945) dhe bashkëpunëtor i rregullt me publicistikë e pjesë letrare në gazetën "Llaiko Vima", që me theme-

¹²⁷ Agolli D., gaz. "Drita", 1. 3.1964.

¹²⁸ Kallulli A., gaz. Drita, 16.10.1966.

¹²⁹ Varfi A., gaz. Drita, 2.2.1975.

limin e saj (1945) e deri sa zemra e tij pushoi së rrahuri në një nga spitalet e Greqisë më 1995.

Shumë nga shkrimet e tij i botoi me pseudonimin letrar "Alqis Anthulis".

Për shumë vite ishte redaktori kryesor i teksteve shkollore për nxënësit e shkollave të Minoritetit Grek. Shërbeu si mësues në degën "mësuesi në gjuhën greke" në shkollën e mesme pedagogjike të Gjirokastres.

Ka botuar në gjuhën amtare greke 12 vëllime me poezi. Përmendim: «*Ελεύθερη ζωή*» ("Jetë e lirë") 1953· «*Ποιήματα*» ("Poezi") 1955· «*Η Τρακτορίστια*» ("Traktoristja") 1957· «*Ανατολές και δύσεις*» ("Lindje Perëndime") 1964· «*Το νέο τέλος ενός παλιού θρύλου*» ("Fundi i ri i një legjende të vjetër") 1977, (po atë vit në shqip)· «*Κορυφές και ορίζοντες*» ("Maja dhe horizonte") 1977 etj.

Në prozë në gjuhën amtare ka shkruar tre libra. «*Τα ξαραβωιάσματα*» ("Prishja e fejesës") 1970· «*Λύκοι με ράσα*» ("Ujq me rasa") 1973· (në shqip më 1970)· «*Θοδωρής Μάστορας*» ("Thodoris Mastoras") 1977· (në shqip më 1976).

Ka shkruar në gjuhën shqipe nëntë libra në poezi e prozë. "Çelësat e lumturisë" 1967· "Urdhëroni në vendlindjen time"· "Koka e gjarpërit" 1973· "Kështu nisën të vinin pranvera të reja" 1981· "Solditje nga bedenat" 1982· "Në lulëzim të përbashkët" 1985.

Përktheu nga shqipja në greqisht 30 vepra të autorëve më të njohur të traditës dhe realizmit socialist. Përmendim: "Afërdita përsëri në fshat" 1957· "Atdheu", i Çajupit 1959· "Kohë lufte" 1974· "Princesha Argjiro" 1977· "Nënë Shqipëri" 1980· "Antologji e poezisë shqiptare" 1981· "Komisari Memo" 1981· "Shqiptonjat fluturojnë lart" 1982· "Familja e peshkatari" 1983· "Njeriu me top" 1984 etj. Këto përkthime në prozë, poezi e dramaturgjia edhe pse u drejtoheshin moshave të ndryshme lexuesish, plotësonin një boshllëk shumë të madh për lexuesit minoritarë në gjuhën amtare.

Përkthime ka edhe nga greqishtja në shqip, p.sh. "Dëshira e vërtetë e shqiptarëve" të Naimi Frashërit, poezi nga Asdreni, nga Livadhitis, Kristalis, Kalvos etj

Përveç teksteve shkollore ka realizuar vet gjashtë antologji për nxënësit e shkollave dhe në pesë të tjera është bashkautor.

Në këtë kuadër do të ishte shumë e vështirë t'i hynim përplekjes për verifikimin e artikujve të ndryshëm me karakter politik, shoqëror e letrar të botuar në shtypin e kohës në të dyja gjuhët.

Krijimtaria letrare e Pano Çukës, siç është e kuptueshme, përshkoi gjithë periudhën e realizmit socialist dhe përbën një nga

përfaqësuesit kryesor të letërsisë së Minoritetit Grek, i njohur gjithashtu edhe ndër lexuesit shqiptarë.

Konsiderohet si “*djalë i përkëdhelur i sistemit*”. E vërteta është se Çuka është një nga krijuesit më të angazhuar nga Minoriteti Grek në kauzën ideologjike të komunizmit. Veprat e tij në shumicën e rasteve u ngjajnë reportazheve letrare të shkruara në vargje a në prozë për ngjarje dhe data që lidhën drejtpërdrejt me nevojat e konsumit ideologjik të pushtetit. Shpesh merr përsipër “*shqetësimet politiko-ideologjike të partisë*” që i kapërcejnë caqet e Minoritetit Grek, bile, dhe të Shqipërisë. E rëndë dhe kompromentuese mbetet për të pozicioni i flamurtarit në luftën kundër fesë.

Megjithatë, Panos Çukas diti t’i kapërcente pengesat dhe kufizimet ideologjike e të shkruante poezi. Këto veti marrin më shumë vlera kur poeti i largohet tematikës së ideologjizuar dhe depërton në jetën e përditshme. Atëherë di të përjetësojë traditën, të sjellë më afër njerëzit e thjeshtë, të filozofojë për jetën dhe vdekjen. Di të përkëdhelë me dashuri, të ngrejë në art marrëdhëniet e njeriut me vendlindjen. Me një fjalë është një poet lirik i spikatur, megjithëse nuk guxon të dalë jashtë raporteve të përcaktuara ideologjike.

Siç e theksuam, është i padiskutueshëm kontributi i tij në fushën e përkthimit të letërsisë në gjuhët analoge, veçanërisht, nga shqipja në greqisht. Kontributi nuk qëndron vetëm në faktin se krijoi mundësi që lexuesit minoritarë të etnisë greke të lexonin në gjuhën amtare letërsinë shqipe, por se cilësia e përkthimit ishte e tillë, saqë, pa frikë, mund të themi se Panos Çukas bëri Naimin, Nolin, Dritëroin, Kadarënë, Migjenin etj të flasin greqisht dhe arti i tyre të fitojë finesën e greqishtes. Njëkohësisht ai solli një kontribut të çmuar në komunikimin e dy letërsive dhe në këmbimin e vlerave reciproke.

VIII.2. Modeli i mitit poetik te vellimi,

«Γεια σας αδέρφια (μια φωνή απ’ το Αργυρόκαστρο)» (“Pershëndetje vëllezër, (një zë nga Gjirokastra)”, Athinë 1993.

Në veprimtarinë e tij të gjatë krijuese, Panos Çukas është karakterizuar si poet dhe shkrimtar thellësisht i angazhuar. Pas rrënjes së diktaturës ai, në emër të gjithëkohshmerisë së vlerave estetike, i bëri veprës së tij poetike disa vëllimshme një “*katha-*

rsis". Dhe duket se u kënaq me propozimin që u bëri lexuesve, propozim që përfshin 45 poezi në vëllimin në fjalë në gjuhën greke. Megjithatë, përpjekja për "*katharsis*" nuk arriti të fshijë totalisht gjurmën e thellë të raportit të poetit me përvojën e kohës. E rëndësishme është se kjo përvojë na vjen jo thjesht e natyrës shoqërore por si botëkuptim, madje i qëndrueshëm. Siç do të shohim, botëkuptimi poetik, pavarësisht nga ndryshimi në natyrën e mitit poetik, është po ashtu i qëndrueshëm edhe tek A. Zarballa, por jo tek N. Kacalidha.

Për Pano Çukën hapësira reale e veprimit të unit poetik, ndryshe nga Kacalidha dhe Zarballa, mund të përcaktohet vetëm në mënyrë indirekte. Kjo arrihet duke ndjekur në poezitë e tij rimarrjen e disa traditave nga cikli i jetës, emra personazhesh apo heronjsh që lidhën me një trevë të caktuar, fenomene shoqërore stigmatizuese, si kurbeti etj. "*Hapësira*" e mitit poetik ka një shtrirje horizontale të pamatë. Vertikalisht nis me Diellin, yjet dhe perëndinë për të vendosur kufi të poshtëm tokën dhe natyrën e shpalosur në të, malet, detin, lumenjtë, arat, lulet, rrapin, ngjyrat, tingujt.

Përsa i përket kategorisë "*kohë*", duhet thënë se poeti zgjedh nga kategoria e kohës historike (e cila lidhet me kulturën dhe jo më natyrën) "*kohën individuale*"¹³⁰ dhe e vendos në kohën natyrore si marrëdhënie, natyrë-kulturë. Mban ndaj saj qëndrimin e bindjes mashtruese, që përfundon në zhgënjim, se nëse nuk do të ekzistonte koha do të ishte një krijesë shekullore me identitet të panjohur lumturie. Zhgënjimin nuk e pohon, por mund të dallohet si një ndjenjë privimi.

VIII.3. Vendi i njeriut-(individit) në modelin mitik të poezisë së P. Çukës

Midis njeriut dhe mitit dhe në qëndër të tyre poeti vendos njeriun, i cili funksionon sipas raporteve *individ-natyrë, natyrë-kulturë, individ-shoqëri*. Që në fillim theksojmë se njeriu i mitit poetik të Çukës, është njeri shoqëror. Dmth, ndryshe nga njeriu apo

¹³⁰ Studiuesit e kohës historike kanë propozuar tre dimensione historikë: Kohën individuale, ose koha e shkurtër e subjekteve (njeriut) në jetën e përditshme, kohën shoqërore, ose të ciklive ekonomike që rregullojnë ecjen e shoqërisë dhe kohën gjeografike, ose kohën e stërgjatë të lëvizjeve të ngadalshme të strukturave shoqërore

heroi tradicional, i cili, siç e pamë, i kundërvihet shoqërisë apo sistemeve të caktuara shoqërore që vinin në rrezik ekuilibrin dhe harmoninë e tij me natyrën, marrëdhënie e cila, thamë, përcaktonte raportin *natyrë –kulturë*, njeriu i mitit poetik i Çukës është në harmoni me natyrën dhe shoqërinë.

*Μεγάλος είναι ο ΑΝΘΡΩΠΟΣ, που στα ύψη
με πλατιά κλαπατάρια φτερουγά,
στα αιθέρια μυστικά ν' ανακαλύψει,
τη φωνή των άστρων ν' αγρικά...*

*(“I madh është njeriu, që hapësirat e qiellit zotëron
tek eterët sekrete zbulon
zërin e yjeve prekë...”)*


Është e vërtetë se “njeriu” i poetit vendos raporte “kulture” me natyrën. Ato nuk janë raportet tradicionale. Dallohen nga ato për arsye se njeriu i poetit nuk i imponohet natyrës, veçse i përshatet. (Zbulon sekrete-prek zërin e yjeve). E lartëson në nivelet e pamata të natyrës që të përfshihet, të bëhet pjesë e saj jo si nënshtrim dhe natyra t’i lejojë atij pasuri më të shumta dijesh e kulture. Po aty poeti nxiton të na japë edhe dy dimensione të tjera të njeriut të tij. Ekzistenca e tij si i tillë është e lidhur me aftësinë për të ndjerë në thellësitë e shpirtit “*pulsin, gëzimet, vuajtjet/...*” e popullit të tij. Dhe brënda këtij kuadri të jetë në gjëndje për të marrë përsipër kontribute në emër të tij, sado të vogla qofshin ato. E rëndësishmja është të mos epet para vështirësive.

*“Supet e tij të fuqishme të ul
endrra të ndritura mbi to të hedh
dhe të ngjitet drejt lart, qoftë nga pak
vetëm pengesat t’i lë pas.”*

“Ο άνθρωπος” (“Njeriu”), fq. 42.

Në sistemin poetik të Çukës funksionon logjika e parimeve marksiste. Sipas saj kemi zbulimin e një uniteti më të thellë të instiktit të jetës (erosit) me strukturën shoqërore bazuar te koncepti i shokut dhe i shoqërizimit dhe promovimit të tij si parim bazë i marrëdhënieve ndërpersonale dhe i organizimit të shoqërisë. Ky parim harmonizon njeriun, shoqërinë, natyrën dhe kulturën. Zëvendëson unitetin fillestar të njeriut me natyrën dhe botën dhe ligjëron si rregull bazë të organizimit shoqëror aktivizimin vullnetar të individit dhe kontributin reciprok, pa ndërhyrje nga lart dhe imponim të jashtëm. Siguron barazi të të gjithë anëtarëve, duke mohuar çdo shprehje individualiste-egoiste që do të mund të trazonte harmoninë shoqërore në raport me natyrën. Sipas këtij

parimi, nocioni i “*individualizmit*” nënkupton humbjen tek ai të cilësishë njerëzore. Grafikisht do të mund ta paraqisim me katrorin semasiologjik të Greimas¹³¹



Në këtë figurë nocionet “*njeri*”- “*jonjeri*”, janë pozitive dhe nocionet “*kolektiv*” “*individ*” negative. Në akset vertikale nocionet janë komplementare, ndërsa sipas diagonaleve kundërshtuese.

Thotë poeti:

*....Si dy zogj të gëzuar e të brishtë
një fole të thurrur me ëndrra të krijojmë
folenë e ngrohtë të familjes sonë
larë në dritën e shënjtë të harmonisë
atje të luajnë femijtë tanë
femijë të denjë të familjës tonë shoqërisë....*

*....Σα δυο χαρούμενα, φιλόπινα πουλιά,
μια ονειρόπλεχτη να πλέξουμε φωλιά,
-τη θαλπερή φωλιά της φαμιλιάς μας
λουσμένη στ'άξιο φως της αρμονίας
κι εκει να κελαηδούνε τα παιδιά μας,
άξια παιδιά της φαμιλιάς μας κοινωνίας...*

Endrra e të pamartuarit. fq. 30.

Në vëllimin e tij poeti Çuka ka shmangur tipin e njeriut të vendeve lindore marksiste. (Sipas këtij modeli kemi në një fazë të parë spostimin, përvetësimin dhe zhdukjen e “*unit*” individual nga një autoritet më i lartë (perëndi, natyrë, pushtet politik), në një fazë të dytë nënshtrimin e “*unit*” dhe në fund mungesën e vlerave individuale.) Brënda parimeve marksiste, ai zgjedh modelin komunitar-kolektiv, i cili në fakt është një shprehje e modelit tradicional të organizimit shoqëror. (Sipas këtij modeli kemi një fazë të parë që mirret me persosjen e “*Unit*” brënda një komuniteti më të gjërë njerëzor, në një fazë të dytë kemi shoqërizimin e tij dhe në finale promovim të vlerave shoqërore).

¹³¹ Graimas A.J., Dysens. 1970, *Essais semiotiques*, Paris, fq. 135-155.

Po ashtu modeli i tij (komunitar-kolektiv) dallon nga modeli perëndimor.

(modeli perëndimor)

Përparësi të individit

Barazi formale të individit

Përpyetje personale

Konkurrencë për mbijetësë

(modeli komunitar-kolektiv)

përparësi të kolektivit

barazi esenciale shokësh

përpyetje kolektive

veprim shoqëror & kontribut reciprok

VIII.4. Gjëndja e plotmërisë

Ndoshta është pikërisht adoptimi i këtyre modeleve poetike që kanë lejuar P. Çukën të ushqejë subjektin e vet poetik me optimizëm dhe mbi këtë bazë të ngrëjë modelin e mitit të tij. Po ta karektirizonim ndryshe do të thoshnim se përshkohet **nga gjëndja e plotmërisë**. Plotmëria buron edhe nga një fakt tjetër se në poezitë e Çukës mungojnë dyzimet sidomos në lidhje me unin e tij poetik. Këtë gjëndje plotmërie e plotëson akoma më shumë pjesëmarrja e natyrës si një element që garanton vërtetësinë e optimizmit dhe pohimeve të tij aspak të dyzuara.

Natyra dhe njeriu te Çuka përbëjnë një harmoni plotmërie ku natyra fare thjesht mund të diktohet dhe të ndjehet si një parajsë për njeriun kur ai është në harmoni me shoqërinë.

*“...Si buzëqeshje e turpshme në buzëshegën e vashës
majëmavele agimi u hedh dritë
... Dita lyen me lejla të pamatë qiellin
saqë dhe yjtë lejla e bënë floririn.”*

*“Σα ντροπαλό χαμόγελο σε κόρης ροδοχείλια
στις απηλες βουνοκορυφές η χαραυγή ροδίζει
...Η μέρα βάφει μ'αυτονο τον ουρανό λουλάκι,
ώσπου και τ'άστρα τα χρυσά λουλάκιασαν κι εκείνα.”*

Agimi (Αυγινό) fq. 26.

*“Në më do mos më kërko
diku veçmas zhurmës së jetës
larg shpërthimit të natyrës...”*

*“Αν μ'αγαπάς, ποιητή, μη με ζητήσεις
καπου παράμερα απ' τη βοή της ζήσης
αλάργ' απ' το ξεφάντωμα της φύσης....”*

Këto janë fjalët që poeti vë në gojë të muzës në një monolog të saj me unin e tij, që në fakt nuk është gjë tjetër veçse ndërgjegja e tij e brëndshme në lidhje me realitetin e kërkuar të mitit të tij poetik, si shprehje e plotmërisë së tij. Dhe shton:

*“Unë jam një çapkëne e çlirët
Te jeta dhe zhurma e botës
Gjej forcën dhe dritën ngahera
... Vetëm aty do të më gjesh
Me verën time do të të deh
Jetën me gjallëri ta joshësh
Dhe me vargjet e tua
Zemrat t'i ndezësh me mendime”*

*“Εγώ είμαι μ’ ανυπόταχτη τσαχπίνα
κι είναι η ζωή, κι είναι η βοή του κόσμου
η δύναμη βυζάστρα μου, το φως μου.
Μονάχα εκεί θα μ’ αποζητήσεις
με το γλυκό κρασί μου να μεθύσεις
σα ζωντανός μες τη ζωή να ζήσεις
άλλες καρδιές και σκέψεις να ποτίσεις”*

Takim me Muzën, (Pαντεβού με τη Μούσα) fq. 43

Vemë re këtu se si natyra (drita) dhe jeta (njeriu-shoqëria) përbëjnë një unitet force krijuese për mitin poetik. Është, gjithashtu një shembull i goditur se si poeti shmanng kondradiktën midis realitetit dhe mitit, ose të paktën është i ndërgjegjshëm për këtë, si një garanci për suksesin estetik të poezisë së tij.

Tek poezia “*Λαλούμενα*” (vegla muzikore popullore), fq. 48, natyra dhe tinguj e saj janë “*përkthyer*” në muzikë që përbën një “*gjuhë të pavdekshme dhe triumfale*” për njeriun. (Herë përkthën “*të fshehtat e thella të shpirtit të detit*”/... Herë ngjan ... “*me kataraktin dhe trokun e kalit*”/... Herë “*bilbilin konkuron*”/... Ajo, muzika popullore, mund të ngjajë me “*opera sirenash*” dhe “*simfoni circesh*” duke na nxjerrë kështu në një breg tjetër, atë të produktit kulturor si metamorfozë të natyrës në trajta njeriu. Madhështinë e saj poeti e shikon tek fakti se me mjet muzikën u arrit, sipas mitologjisë, “*pushtimi i këshqjellës së Hadit*” dhe është po ajo që, nëse është hiperbolë, kur “*bilbilat e violinës mund të ngjallin dhe të vdekurit*”, është realitet kur “*...rinojnë dhe bëjnë më të gjallë të gjallët.*”....

Tek poezia në vijim “*Plasmim*” fq. 49, janë ngjyrat e natyrës që kanë vendosur ritmin, koloritin dhe kompozimin e kostumëve popullore.

Tek Çuka rëndja te kujtimet nuk përbën një risi për të justifikuar zhgënjimin dhe për të rregulluar “*nëpërmjet aktit letrar*” atë që bëri edhe vet ai keq në jetën reale, por i shikon kujtimet si rrugëdalje dhe forcim të shpresës. Këtë shpresë ai e gjen te thelbi i natyrës, te drita dhe të vet natyra. Tek ajo natyrë që njeriu u mbështet për të evidentuar evinimentet e jetës së tij. (Dega e ullirit-simbol i paqes dhe tregues i lavdisë.) Mjaft që të dish ta interpretosh atë.

*“Te deg’ e ullirit shoh heroin në krah të lavdisë së virgjër
Një pemë më flet për bilbila, aromë freskie nëpër pyje.
Dhe çdo agim më thotë të presim vite lumturie.”*

*“Στην αγριλιά βλέπω τον ήρωα δίπλα στη δόξα την παρθένα
Ένα δεντρι μου λέει για αηδόνια, για δροσαγέρια μες τα δάση.
Και κάθε αυγή μου λέει για χρόνια που θα ‘ρθούνε πιο
ευτυχημένα.”*

“Shoh dritën në një rreze dielli”.

(*Θωρώ το φως σε μια ηλιαχτίδα*) fq. 60

Ose thotë poeti për hardhinë e tharë dhe të harruar nga të gjithë.

*“...Dhe vetëm e lulëzuar
në kujtesën time do mbesi
se dashuria ime e parë ndër gjeth’ të saj lulëzoi
dhe ajo çdo gjë që me të rron të pavdekshëm e bën.”*

*“...Και μόνο φουντομένη
στη θυμησή μου, ολόχρονη, παντοτινά θα μένει
τι η πρωταγάπη μου άνθισε, στα φύλλα της κρυμμένη,
κι πρωταγάπη αθάνατο κάνει ο,τι ζει μαζί της...”*

Pjergulla (H κληματαριά) fq. 27.

Njësi korresponduese me raportin natyrë-shoqëri është raporti Dielli-dashuri. Dashuria e përcaktuar nga komponenti funksional prania e dritës tek Pano Çuka na shfaqet tridimensionale. Fjala është për dashurinë si premisë për vazhdimin e jetës, jeta si produkt i dashurisë (dashuria e nënës) dhe dashuria për atdheun, abstrakte por tepër e qenësishme. Në këtë gamë dashurie Dielli është i pranishëm, si i tërë, ose me elementë të tij siç janë drita apo ngrohtësia. Dielli, po t'i referohemi Elitis-it është një element natyror me vlera shoqërore dhe si i tillë përbën majën e kozmosit poetik. Dielli përbën fillësën e krijimit, burim i jetës dhe i dritës. Drita e Diellit zbut gjithçka, heq çdo kufi ndarës dhe sjell pranë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe intim gjithë gjallesat. Këto veti të Diellit të vëna re nga Eliti, Seferi, Kalvo, Sikeliano, në aspektin shoqëror kanë homologe dashurinë edhe te poezia e Çukës.

«Dritën shoh në një rreze diellore, pranverën në një lule
me një puthje një mijë fjalë ndej se shpreh dashuria e shënjtë»,
na thotë poeti P. Çuka në poezinë “Shoh dritën në një reze die-
lli”. (Θωρώ το φως σε μια ηλιαχτίδα) fq. 60.

Po të vemë re kumtimi “shoh dritën” përbën një moment ko-
mpleks me një ngarkesë polisemantike që përmban jo thjeshtë
tablonë e shkëlqimit të dritës dhe identifikimin me natyrën por
edhe komunikimin burimor dhe identifikim me dashurinë si the-
mel i jetës dhe i vazhdimësisë së saj. Nuk mund të mos vemë re
këtu faktin që ndërsa drita përjetohet nga një rreze diellore, (mi-
nimum) dashuria shpallet e perëndishme.(maksimum)

Në poezinë “Martesë” fq. 31, fillimi i veprimit në dasëm (si një
nga tre dimensionet e ciklit të jetës), e ka zanafillën te veprimi i Die-
llit. Me dy metafora personifikuese të huazuara nga krijimtaria po-
pulllore, poeti na përcakton ndërvarësinë midis Diellit që “ndriçon,
ndriçon” në dritaren e nuses dhe veprimeve që duhet të pasojnë.
 (“ndriçon, ndriçon” një përseritje funksionale në favor të intensitetit
të energjisë dhe bukurisë diellore). Për nusen kjo është shënjë se
duhet të stoliset dhe “vë për fytyrë të saj diellin ndriçues”, thotë
poeti. Humbja e dashurisë është e barabartë me humbjen e dri-
tës, arsyes dhe vetë jetës.

“Vdiq dashuria ime.....

dhe mori zemrën time, arsyen dhe dritën time”,

Poezia “E çmendur”, (Τρελή), fq.66.

Në këtë rast raporti Diell (dritë) - dashuri merr një përmasë të
re, ose më saktë evidentohet më mirë nëpërmjet raportësh të ve-
na re në katrorin semantik të Gramais. Dritë-dashuri (jetë), errë-
sirë-vdekje. Mungesa e dritës kur dashuria “vdes” transformohet
automatikisht në një mjedis të ftohtë dhe të errët. Këtë fakt e vë-
më re më mirë te poezia “Buzëqeshja sarkastike e vdekjes”, fq.
40, ku kjo buzëqeshje na shfaqet “e padiell” dhe e “akulltë”.

Për poetin është e qartë se kur bukuria është e barasvle-
fshme me dashurinë atëherë ngjizja e tyre arrihet me Diellin. Atje
ku bukuria kërkon ta nëpërkëmbë dhe ta injorojë dashurinë, apo
ta nënshtrojë atë, Dielli “heq” praninë e tij, ose zhvlerësohet.

“E çfarë nëse Diellin gjen në fytyrën tënde,

E turbullon nata që fsheh në shpirtin vashëz/...

“Bukuria”, fq.58.

Vemë re se për poetin natyra është tepër e ndjeshme dhe
mban qëndrimin e vet kur te njeriu nuk respektohet harmonia e ve-
tive të tij. Në rastin konkret harmonizimi i bukurisë me dashurinë.

VIII.5. Natyra e dyzimit poetik te P. Çuka

Po ashtu, poezia në fjalë është nga të paktat që rrëfimi poetik ndërtohet mbi një kontradiktë dhe dyzim të poetit me veprim pozitiv (bukuria) dhe funksion negativ nëpërkëmbje të dashurisë.

Ky dyzim në raste të tjera, ka një raport të kundërt. Tek poezia “Një dëshmori”, fq.19, kemi vargjet:

*“Plumb i armikut të hodhi, tribun i trimërisë.
Para se gëzimin final të Fitores të shijosh,
por vdekja jote u bë për ne yll ndriçues
dhe gjithë rrugën na tregon për të arritur Lirinë.”*

Pra siç shihet kemi një veprim negativ, siç është vdekja, por me një funksion pozitiv, siç është ndriçimi i rrugës për qëllimin e përbashkët me dëshmorin që ishte fitorja. Me të njëjtën skemë dhe logjikë është ndërtuar edhe poezia për Heroin e Popullit Thodhori Mastora, si dhe i gjithë cikli i poezive heroike. Është rast të theksojmë këtu se ky lloj dyzimi, do të thoshnim pozitiv i poetit lidhet me botëkuptimin e tij se individi në mënyrë të vullnetshme dhe pa u imponuar kush arrin në ekstrem, sakrifikon jetën, në emër të shoqërisë apo idealit të saj. Nga ana tjetër është kjo sakrificë që i garanton atij pavdekësinë.

Një trajtim i tillë na parashtrojnë edhe një herë qëndrimin e heroit popullor tradicional, i cili ishte i gatshëm të mohonte vetën, të përballej me sistemin (kulturën) që cënonte ekulibrat e tij me mjedisin (natyrën) deri në sakrifikim të vetës për të jetuar të tjerët. Madje edhe raportet janë po ato. Armiku përfaqëson një sistemin shoqëror-luftën-kulturën që i imponohet individit-heroit. Ndryshimi qëndron tek fakti se, dëshmori nuk vepron vetëm, por në kuadrin e komunitetit. Edhe fati që është personal është në funksion të fatit, ose aspiratës kolektive.

VIII.6. Komunikimi me traditën popullore

Ky është edhe këndvështrimi i raportit të poetit me traditën. E mbart traditën në përshtatje dhe në funksion të plotë me botëkuptimin e tij, ose brënda modelit të tij poetik. Shembull domethënës poezia “Rrapi i moshuar” (*Ο Γερο-πλάτανος*), fq. 13.

*“I lashtë, shumëdegësh, rrënjëthellë, hijerëndë,
qëndron një rrap i lashtë në mes të fshatit tim...”*

*“Πολύχρονος, πολύκλαδος, βαθύριζος, βαθύισκιος
στεκει ένας γέρο-πλάτανος στη μέση του χωριού μου...”*

Nuk duhet shumë mund që të orientohemi. Dihet që rrapit apo në përgjithësi pema në qëndër të fshatit, apo në arë, përbën për strukturën tradicionale të shoqërisë në trevën më të gjërë se ajo e minoritetit, Epirit, një objekt natyror bazë për organizimin e strukturës tradicionale shoqërore të një komuniteti. Brënda këtij koncepti, rrapit na jipet i *“lashtë”* dhe në *“mes të fshatit”*. Si i tillë fiton vlera të një monumenti kulture natyrore. Poeti e merr këtë element, aq të përdorur në traditën popullore që nga lashtësia, për ta vënë në funksion të organizimit të ri shoqëror edhe në minoritet, atë të shoqërizimit socialist.

*...”Dhe atje në sheshin pllakështraur dhe në hije
gëzim shokësh shpesh udhën merr...”*

ose

*“... Freskon fytyrat e bujqëve të zotë
që në pezule rrinë të rrapit rreth e rreth...”*

Kjo rimarrje nuk i humbet vlerat artistike *“të mitit”* të ri. Përkundrazi, ngarkesa emocionale që shkakton prania e elementit të traditës, pasurohet nga lëvizja e natyrës dhe e njerëzve të rinj të vizatuar nga gjuha e poetit.

E ndërsa kemi një rast klasik, për funksionin e një monumenti natyror në organizimin shoqëror të një fshati-komuniteti në kohën e poetit, ai nuk mjaftohet me kaq. Brënda së njëjtës poezi trajton edhe një dimesion tjetër të karakterit antropologjik të funksionit tradicional të pemës. Atë të lidhjes së njeriut me tokën, natyrën, vendlindjen e tij si një shprehje të vet identitetit të tij etnokulturor. Nuk zgjidhet shkëmbi, (ashtu siç do të shohim te N. Kacalidha) por pema, e cila, veçse ka lidhjen e njohur me Orakullin e Dodonës, është një organizëm i gjallë dhe vetitë e tij të gjalla, shtrihën aq sa thellë në tokë aq edhe në qiell. Njëkohësisht i shërbejnë jetës edhe drejtpërdrejtë edhe si funksion.

Thotë poeti në mënyrë filozofike:

*“Kushdo në tokën që e lind,
rrënjët thellë i hedh.
Lë të ulërijnë stuhi sa të duan,
atë s’e shkul dot askush”*

*“Όποιος στη γη που τον γεννά
Βαθιά τις ρίζες ρίχνει
Όσο αν μουγκρίζουν θύελλες
Δεν τονε ξεριζώνουν!”*

Poeti P. Çukas, ashtu siç e thamë, komunikimin me traditën e pa brënda modelit të vet mitik të poezisë së tij. Marrëdhëniet etike

midis brezave, në familje e në shoqëri, qëndrimi ndaj punës, jetës, raporti i individit me kolektivin janë elementë tradicional, të cilat edhe pse nuk kanë një referim të drejtpërdrejtë, rimirren për t'u vendosur në një realitet të ri, atë të parimeve marksiste.

Çukas në stilin krijues mbetet një poet i vargut tradicional, shumë të thjeshtë, pa ngarkesa të tepruara figurative e gjuhësore, por duke aplikuar një gjuhë burimore. Vargu i përdorur prej tij është 11,13 dhe 15- rrokëshi klasik i traditës popullore. Atë e gjejmë dhe të thyer duke përdorur, madje, dhe rimën. Përpyekjet e tij për të shkruar varg të lirë nuk ishin të suksesshme.

Mund të themi pa frikë se përbën një rast, që poezia e tij ngrihet më shumë mbi struktura të brëndshme gjuhësore të kombinuara me një ritëm analog me mesazhin poetik. Duke u mbështetur fuqishëm në traditën e poezisë popullore, gjuha amtare në poezinë e Çukës bëhet më plastike dhe më shprehëse.

KREU I NENTË

NIKOS KACALIDHAS

IX.1. *Jetëshkrimi, vepra*

Është një nga përfaqësuesit me në zë të fazës së dytë të letërsisë në minoritetin grek, por edhe atë shqiptare në përgjithësi.

U lind në Leshinicën e Sipërme të rrethit të Sarandës më 1949. U diplomua për letërsi në Universitetin e Tiranës. Në fushën e letrave u shfaq shumë shpejt. Vazhdon të jetë poet, megjithëse, kohët e fundit ai i kushton rendësi më të madhe prozës, madje asaj të gjatë, romanit, si edhe tregimeve dhe novelave. Që me 2004 kur botoi romanin e tij të parë “Parmenda e Hënës” «*To άροτρο του Φεγγαριού*», deri me 2021, Kacalidhas botoi reciprokisht 6 vëllime me poezi dhe pesë me prozë. (shih, kreu i gjashtë, fazat kryesore të letërsisë së pas luftës, tiparet dalluese, përfaqësuesit, faza e dytë).

Kacalidhas shquhet për numrin e madhë të esseve (spravave) për autorë e probleme të ndryshme të letërsisë në Minoritetin Grek, si dhe për përkthimet e shumta, sidomos, poezi nga greqishtja në shqip. Shkruan vargje me të njëjtën lehtësi si në shqip edhe në greqisht.

Nisi krijimtarinë e vet poetike si një përfaqësues i brezit të ri të poetëve në Shqipëri. Shumica e vëllimeve poetike të dhjetëvjeçarit të parë krijues, vitet 70'-80', janë të shkruara në shqip. Madje, është nga të paktët poetë minoritarë grekë që vazhdon të ketë një komunikim shumë të mirë me publikun shqiptar. Ai edhe tani shkruan me të njëjtën lehtësi e ngrohtësi poezi në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhën amtare. (“*Profecia e drurëve*” 1998, “*Pagëzimi i zogjve*” 2006.)

Është njëkohësisht poeti më produktiv i Minoritetit Grek dhe një nga me produktivet në letërsinë shqiptare. Ka shkruar mbi 30 vëllime poetike të ndara në dy kategori, vjersha dhe poema.

Përmendim disa prej tyre, ato nga fillimi deri më 2004: “*Fjalët e thëna në pranverë*”, 1971: “*Fluger*”, 1975: “*Shtëpitë tona në Jug*”, 1982: “*Shtrati i lumit tim*” («*Η κοίτη του ποταμού μου*»), 1982: “*Lirikë Diellore*” («*Λιόφωτο λιανοτράγουδο*»), 1985: “*Anedet*”, 1989: “*Refleksione*” («*Ανταύγες*»), 1998: “*Pagëzimi i zogjve*” 2004.

Prodhimtaria e tij letrare u rrit së tepërmi në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar. Në këtë periudhë, poeti bën hapa të qëndrueshme në lëvrimin e poezisë në gjuhën amtare, pa harruar edhe lexuesin shqiptar. Ka shkruar nëntë poema të gjata. Për mëndim: “Zërat e vendlindjes sime” («Οι φωνές της γενέτειρας μου»), 1990· “Kori tragjik i përgjakur” (“Ματομενη τραγική χοροδία»), 1990· “Bibla e të vrarëve”, («Η βίβλος των σκοτωμένων»), 1991· “Shtëpia e erërave” («Το σπίτι των ανέμων»), 1991· “Rrënjët e pemëve” («Οι ρίζες των δέντρων»), 1992· “Baladë e fundme, e përzishme” («Στερνή μπαλάντα, πένθιμη»), 1993 etj.

Kësaj periudhe i përkasin dhe disa vëllime poetike “Vaji i malit të vrenjtur”, («Το μοιρολόι του βουρκωμένου βουνού»), 1994· “Anija e Qipros dhe limonat e hidhura” («Το καράβι της Κύπρου και τα πικρολέμονα»), 1995· “Dhe sfinks i foli”, («Και η σφίγγα μίλησε»), 1995· “Ambrozia e gurit”, («Η αμβροσιά των βράχων»), 1997· “Këtë dikton gjaku im” («Αυτό εστί το αίμα μου»), 1997; “Njëqind, 100 fletëshat e Plejadës” («Εκατό εκατόφυλλα της Πούλιας»), 1997· “Loti i ciklaminit” («Το δάκρυ του κυκλάμινου»), 1998· “Porta e erërave të veriut” («Η πύλη των βοριάδων»), 1998· “Profecia e drurëve”, 1998· “Një mijë guacka deti”, («Χίλια κοχύλια»), 1999· “Bashi i yjeve”, («Η πρόρα των άστρων»), 2001· “Fati i Amarandos”, («Η Μοίρα του αμάραντου»), 2003 etj.

Vëllimi i tij i parë poetik, kur ende ishte student, u prit mirë në publik dhe ai u evidentua si një poet premtues. Gjithsesi, që në hapat e tij të para dallohet, se brënda poetit të ri ishte fshehur bota e të atit dhe e rrethit familjar e gatuar me kulturën greke dhe traditën folklorike të trevës së tij. Kjo origjinë duket se përcakton edhe individualitetin ndryshe të poetit në kuadrin e poetëve të tjerë shqiptarë të kohës. Ndoshta, nuk e dallon shumë skrupuloziteti dhe ritmi i vargut të lirë që përdor, se sa e dallon lirizmi që buron nga ky realitet dhe guximi për të shtrirë kufijtë e metaforës, metonimisë dhe simbolit tutje së zakonshmës deri te areali i surrealistes.

*“Të rikurdisim përsëri zembrekun e diellit
për fosforeshëncën e eshtrave”*

(poezia “Ekehrira”, vëllimi “Pagëzimi i zogjve” fq.176·

ose

*“Në qerpikët e saj kishte varur emblemën e hënës.
Në buzët e saj një zog pickon hënën dhe i çelej gjiri.
Brofi deti dhe u prushëruan kufijtë e mandarinave.
Hëna rrëshqiti në kumin e detit duke numëruar gjurmët
e perëndive...”*

(Poezia “Epifania e hënës” po aty fq. 62)·

ose

*“Nuk e di se ç’ka brënda mitologjisë së gurit.
Nuk e di se ç’ka pas frengjisë së korbit.
jashtë mureve ka mbirë një fik fluturues
shpirti i një luftëtari/ duke nderur duart si përbindesh i erërave.
Pikon pikë-pikë qumeshti i përgjakur i fikut
prej këputjes së gjethit nga damari i gurit.
pas kullave hyn edhe del fantazma e gjakut.*

“Kështjella e vjetër”. Po aty, fq. 89

ose

*“...Nën rrasat e varura të reve thera korbin me tehun
e vetëtimës”.*

Po aty, fq.130

Mirëpo, këtë gjenezë e brum Kacalidha i lidhi atëherë me angazhimin ndaj parimeve të realizmit socialist. Tregoi se dinte që talenti nuk kish shumë vlerë përballë qëndrimit që do të mbannte makina shtet ndaj këtij talenti. Ai e pranoi përkohësisht sfidën. Sipas rregullave të imponuara të kohës, bëri kompromis me makinën propagandistike të shtetit, shpesh në dëm të së vërtetës poetike, por për të fituar atë që dëshirojnë gjithmonë njerëzit e artit,-publikun. Pezmi lirik i gërshetuar me nota dramatike lidhën me një tematikë të përcaktuar nga patosi ideologjik i kohës. “Egoja” e tij poetike, ushqehet përherë e më shumë me “shqetësimet e mëdha” që duhet të zgjidh “udhëheqës” e “partia”, sidomos, në arënnën ndërkombëtare. E kompromentoi veten kur identifikon aty këtu poezinë, me qëndrimin zyrtar ndaj fesë.

Ngrohtësia e publikut dhe laurimi i vëllimit të tij të parë poetik, vënë në pah edhe egocentrizmin e tij, një veçori poetike që do të kultivohet në kushte të tjera dhe do të evidentohet më shumë në të ardhmen si veti e “kozmosit të Kacalidhës”.

Vepra poetike e Niko Kacalidhës njohu disa çmime e vlerësime. Që me vëllimin e parë “Fjalët e thëna në pranverë” 1971 merr “Çmimin e Republikës”. Me vëllimin e tretë “Shtëpitë tona në Jug”, merr “Çmimin e dytë kombëtar” në poezi. Pasojnë disa çmime të dhëna nga gazetata “Drita” e “Zëri i rinisë” si dhe revista “Nëntori”. Më 1989 dekorohet nga Presidenti i Republikës me titullin “Naim Frashëri” për shërbime të shquara në letërsi. Në 2003 merr çmimin “Pena e argjendë”, për përkthimin e vitit, të akorduar nga Ministria e Kulturës, për përkthimin në shqip të nobelistit grek Odhiseas Elitis.

Një numër nderimesh, çmimesh e dekorimesh i janë akorduar edhe në Greqi. Vlen të përmendet “Çmimi i Parë Panhelenik”, për poezinë “Asqitis”, 2003 dhe po këtë vit “Çmimi i Parë Ballkanik” “AIMOS” dhënë nga Komisioni Ballkanik i Sofies për vëllimin “Një qind, 100 fleteshat e Plejades”.

Nikos Kacalidhas nuk është se mjaftohet vetëm duke shkruar poezi. Është në lëvizje dhe bën vazhdimisht përpjekje që poezia e tij të njihet e të fitojë popullaritet. Është poeti, për të cilin janë organizuar veprimtari të ndryshme promovuese, kritike, njohëse e jubilare, më shumë se për çdo krijues tjetër të Minoritetit Grek: në Shqipëri, në Greqi, në Qipro, Gjermani, Bullgari e gjetkë.

Gjithashtu, është poeti që arriti njohje me shumë personalitete të njohura si me nobelistin Odhisea Elitis, me Melina Merkurin, me poetin kombëtar të Qipros, Kosta Montin. Gëzonte simpatinë e veçantë të Dritëro Agollit. Simpati të njëjtë shfaq edhe Ismail Kadarese dhe shumë personalitete të tjera të letërsisë në Shqipëri.

E gjithë kjo, do të thoshim se ndikoi ndjeshëm në egocentrimin e tij, që në procesin krijues shfaqet me një individualitet aq sa të lexueshëm, aq dhe të koklavitur, por që në përgjithësi është parë si vlerë.

“Krijues me dy identitete, -shprehet për të I. Kadare në parathënien e vëllimit “Pagëzimi i zogjve”. Ai është poet po aq i talentuar në të dyja, duke përbërë për studiuesit një rast të veçantë, kur i njëjti shpirt poetik shfaqet në gjuhë kaq të ndryshme siç janë shqipja dhe greqishtja.... poet me një poezi metaforike surrealiste brilante, përqsasur herë me zymtësinë e Seferis dhe me dritësinë e Elitis, dhe herë me dataje shqiptare të gurit, të malit, të dritës, të detit, të pranishme këto në pjesën me të rëndësishme të krijimtarisë së tij, gjë që e bën poezinë e tij ballkanike me ngjyra mesdhetare”.

Dritëro Agolli do të shprehet për të: *“...Është jo vetëm poeti më i plotë i Minoritetit Grek, por nder poetet e shquar në Shqipëri”.*

Moikom Zeqo: *“Poezia e Niko Kacalidhës është një brishtësi e ndritur në ekuinoksin e stinëve. Në vargjet e tij gjen tragjicitetin e kohrave. Lirizmi është në simbiozë me dimensionet e ashpra epike”.*

“Bashkëudhëtari i shtegtimeve poetike” do ta cilësojë Ndoc Gjetja. *“...një nga poetet më të shquar, që lexohet dhe nderohet në vendin tonë”* do të shprehet Ndoc Papeleka.

Llambros Mallamas: *“Arti i tij dallohet për një stil imediat dhe madhështor”.*

Dhimitris Iatropoulos: *“Poezia e tij mban aromën e traditës akrite, format e tij janë të kultivuara, thesari gjuhësor i shkëlqyer.*

I peshuar midis dramatikes dhe tragjikës, pa rënë kurrë në melo, kurse shpërthimi i tij ekzistencial takon dendur majat dhe kulmet e agonisë aktuale të botës. Originaliteti i tij është theksuar te stili që herë duket se Rigas Velestinlis tërheq një perde, herë Sollo-mos çel një dritare të befasishme dhe herë aedi anonim bizantin shkon shaluar mbi kalin e tij para teje”.

Pano Çuka: “*Niko Kacalidhës, ne poetët më të moshuar duhet t’i heqim kapelen.*” Dhe Andrea Zarballa: “*Niko Kacalidha është poet*”.

IX.2. Elementi biografik dhe miti poetik

Përshkrimi i deritanishëm i krijimtarisë së Kacalidhës bind lexuesin se ai e kishte të parathënë rrugën e ngjitjes dhe të suksesit. Në këtë rrugë ngjitjeje është me vend të vihet re konstatimi i studuesve dhe bashkëkohësve të tij në lidhje me të dhënat biografike të tërheqjes, nga qendrat e mëdha urbane dhe të kulturës së kohës dhe të mbylljes e të izolimit në ngushtësinë e vendlindjes së tij. Ishte një veprim që binte ndesh edhe me mentalitetin e kohës, por edhe me përvojën e ndjekur nga njerëzit e kulturës dhe artit në të gjitha kohërat. Përvojë, që lidh shkëlqimin e tyre me metropolet, qendrat e mëdha urbane e civile.

Problemi pas kësaj shtrohet nëse kjo tërheqje ndikoi pozitivisht apo negativisht në veprën e tij. Për të marrë një përgjigje, mendoj se është momenti i një përjasjeje psikoanalitike të të dhënave biografike të Kacalidhës. Siç vë re Sadik Bejko në parathënien e librit “*Eliksiri i Gurit*”, Tiranë 2004, Niko Kacalidha qysh i ri, u shfaq në botën e letrave shqipe si një shpresë dhe zë premtues. Ndërkohë, ai e pa talentin e tij nën flatrat e shkrimtarëve të mëdhënj të kohës siç ishte I. Kadareja dhe nën përkëdheljen e medaljeve dhe titujve. Nga ana tjetër, provoi se audienca e lexuesve nuk donte të dinte dhe aq shumë për lirikën e tij. Auerola e lavdisë që shpresei se i përkiste, as e provonte e as njerëzit e vinin re. Me një fjalë, nuk kuptoi se evidentimi dhe konfirmimi poetik ishin dy gjëra të ndryshme. Këtë fakt me sa duket dhe me sa tregojnë shokët edhe miqtë e tij, ai e përballoi si mohim të talentit të vet. Psikoanalitikisht e përjetoi nga pozitat e kompleksit të inferioritetit dhe si privim që çoi në mohimin e realitetit dhe izolimin e tij në vendlindje. “*Shoqëria*” si pamundësi për ta arritur e zotëruar plotësisht, fitoi në ndërgjegjen e tij cilësinë e ndjekësit persekutor. Kjo ndjenjë ripërsëritet tek Kacalidha kur synon krijimin dhe përballjen e kozmosit dhe e fantazisë së vet që

siç deklaroi, “*është rrënjosur (brënda tij) dhe vazhdon të më ndjek me maninë e persekutimit.*”

Ndoshta ndikoi në këtë qëndrim edhe lidhja e tij e ngushtë me vendlindjen. Këtë na e pohon vet Kacalidha në vëllimin poetik “Lirikë diellore” («*Λιόφωτο λιανοτράγουδο*») botuar me 1985. E vërtetë është gjithashtu, se rreth 15 vjet nga 1975 deri më 1990, do të endet në një gjeografi të ngushtë, nga Leshinica në Sarandë, jo me ndjenjen e harakirit, por të kërkimeve për t’ju “*imponuar*” realitetit. Rasti përbën një shembull klasik për ekzistencialistët.

Në këto kërkime ai tregoi se nuk ishte i përmalluar për plaçkurina. Ai ruajti dhe administroi në krijimtarinë e tij me dinjitet atë çka pa, dëgjoi dhe mësoi atje: Ngjyrën e qiellit, pëshpëritjet e detit, përrallat e gjyshes me dragonj, mitologjinë klasike të lidhur me vendlindjen dhe trojet përreth, natyrën, perënditë. Filloi të flasë e të bisedojë me ta, brënda një logjike universale personifikuese dhe t’i detyrojë të pranojnë se ai ishte zoti dhe perëndia e tyre. Përballë botës reale të qëndrave urbane, të cilën duket se nuk e përballoi dot dhe as u përpoq t’i përshtatet, por u largua prej saj dhe e përjetoi këtë si privim, ai ngriti kozmosin e vet. Ndërkohë, ndjenja e privimit po e orientonte në rrugën e hipertrofizimit të subjektit poetik dhe në ekstremizimin e egocentrizmit të tij.

Në vëllimin poetik “Lirikë diellore” («*Λιόφωτο λιανοτράγουδο*») botuar me 1985, i largohet shumë angazhimeve ndaj problemeve politike e ideologjike të kohës, të hasura me intensitet aq të madh në vëllimet paraardhëse “Shtrati i lumit tim”, («*Η κοίτη του ποταμού μου*»), 1982 dhe po atë vit “Shtëpitë tona në Jug”, vëllim që fitoi çmimin e dytë kombëtar në poezi. Ndoshta edhe këtë eveniment për një 25-vjeçar, poeti e përjetoi si privim dhe njëkohësisht si sfidë. Vetëm kështu mund të kuptohet fakti i ndërrimit të kursit poetik në vëllimin “Lirikë diellore” («*Λιόφωτο λιανοτράγουδο*»).

I qëmtuar me kujdes dhe nga niveli i sotëm i rrugës poetike të Kacalidhës, do të vemë re se ky vëllim përbën një minjaturë empirike të profilit të ardhshëm të poezisë së tij. Subjekti poetik zhvendoset ndalëngadalë në qëndër të mitit poetik. Vet ky mit ngjizet me elementë natyrorë të trevës së tij, me rimarrjen e traditës popullore dhe tendencën e hapur, për të krijuar mite të reja me hero vet subjektin poetik.

Karakteristikë është fakti që natyra, njerëzit, traditat janë në një harmoni të admirueshme. “...*Larë në dritë para meje shtrihën bregu e deti...*” na thotë poeti i cili i drejtohet të dashurës së tij:

“... *Vetëm në do malet që lartësohën në qiell*

atëherë më shumë do të më ndjesh, më shumë do të dua...”

Kapërcimi i antinomisë në raportet midis, individit-shoqërisë, natyrës-kulturës etj të vëna re edhe kur trajtuam traditën popullore, lidhën me faktin e parimeve të letërsisë së angazhuar të imponuara nga shteti socialist. Kjo me siguri përbën një arsye më shumë, që poeti ta ndjejë edhe më zhgënjimin. E vërteton më së miri fakti, që në vëllimet poetike që do të pasojnë dhe veçanërisht ato që kemi marrë përsipër për të analizuar, do të evidentohet me një tendencë rritjeje përpjekja për të mos lejuar integrimin e vetës në një mjedis historiko-shoqëror, (veç atij të Leshinicës), për arsye se bie ndesh me mitin e vet, krijuar nga subjekti poetik për “*botën*” (kozmosin), bazuar në cilësi që ngjasojnë ireale.

Shprehje e këtij egocentrizmi poetik është shpjegimi i tij për “*kozmosin*” e vet poetik. Kjo botë nisët nga ai vetë, familja dhe vendlindja e tij. Brënda këtij trekëndëshi Kacalidhas përpiket të kultivojë e të zgjojë gjithë yjësini e botës poetike greke që nga Homeri e mitologjia e deri tek Elitis. Ndaj dhe ai thotë “*Besova te bukuria tragjike, homerike e ëndërrore të botës*”¹³² dhe vazhdon: “*Gjithnjë brënda vetes është rrënjësor dhe vazhdon të më ndjek me maninë e persekutimit dhe një tjetër trini mitike dhe e çuditshme, kozmosi im, i fantazisë sime.*” Sipas poetit kjo trini e botës së tij përbëhet.

E para nga Bota Qiellore, Bota e Perëndive. “*Të gjithë qiejt janë mbjellë me perënditë e stërgjyshërve të mi*”.

E dyta është Bota e të Gjallëve, “*e bashkëkohësve të mi, të mençurit, përrallëtreguesit, punëtorët, çobanët, kallajxinjtë, mullixhinjtë, gëlqerbërsit*”.

E treta është Bota e Nëndheshme: “*Të vdekurit. Të ngulitur brez pas brezi, aty poshtë... dhe trinia bëhej me mish e me kocka dhe quhej Leshinicë e Sipërme. Leshinicë e Poshtme...*”¹³³, - sqaron poeti. Në këtë kuadër poeti përpiket të krijojë filozofinë e vet, arketipat e tij, që ngrihën në lirizmin dhe epizmin e njëkohshëm të poezisë së tij. Përpiket të arrijë vetëndërgjegjësimin në bazë të kritereve të tij, që nuk burojnë nga mjedisi bashkëkohor shoqëror, por i mbart me vete si një ngrehinë ideologjike ardhur nga një klimë tjetër kulturore.

Cilat janë elementët përbërëse të saj:

- Kozmosi i botës mitologjike.

¹³² Kacalidhas N., fjala e mbajtur në takimin e organizuar nga Universiteti i Janinës për të diskutuar rreth krijimtarisë së tij poetike, 19.2.2000.

¹³³ Kacalidhas N., fjala e mbajtur në takimin e organizuar nga Universiteti i Janinës për të diskutuar rreth krijimtarisë së poetit, 19.2.2000.

- Letërsia antike si mishërim i kësaj mitologjie në formën e arketipeve.
- Tradita e pasur popullore si mbartëse edhe aktualizuese të kësaj mitologjie.
- Natyra si ndërveprim i hapësirës, i kohës dhe i metafizikës.
- Mjedisi familjar dhe i komunitetit të mbyllur tradicional të Leshinicës së izoluar, që në aspektin e jetës civile vazhdonet linjën e traditës së vet, pothuaj të pacënuar nga ndikimi i regjimit komunist. Në këtë mjedis ishin gërshetuar dy elementë me rëndësi: tradita e gjallë popullore pasqyruar në këngët, tregimet, fabulat, mitet, legjendat, ngjarjet historike të lidhura me gjyshën dhe reflektimi i kulturës greke, reflektuar tek babai i tij.
- Brënda këtyre elementeve shtohet edhe ndikimi i arritjeve letrare të kohës në të dy vendet.

IX.3. Kronotoposi i mitologjisë poetike të Kacalidhës

Hapësira reale e veprimit poetik të Kacalidhës, siç e thotë edhe vet, është vendlindja e tij. **Hapësira e mitit poetik** (topos-i) është tjetër gjë. Përbëhet nga gjeografia e mitologjisë së lashtë greke, nga hapësira e kozmosit të yjeve, Diellit, Hënës, planetëve, nga relievi i maleve, i deteve, i lumenjeve, i pyjeve, i atmosferës, biologjia e bimëve, e lulëve, e kafshëve, metafizika e shpirtit dhe e perëndive. E gjithë kjo hapësirë nuk ka shpesh lidhje me etnotoposin, siç do ta vëmë re tek Zarballa. Në këtë pikë Kacalidha ngjan me Çukën.

Në dimensionin e kësaj hapësire, është integruar koncepti i **kohës së mitit poetik (Hronos)**. Fizionomia e hapësirës së përshkruar ka të përfshirë brënda vetës edhe elementin kohë si një diakroni e aktualizuar, ose sinkronike. Këtë marrëdhënie e ndihmon më shumë, fakti që si hapësira edhe koha në mitin poetik të Kacalidhës janë vendosur në hapësirën reale të vendlindjes së tij dhe veprimi i tyre lidhet me kohën e vet subjektit poetik, që në rastin konkret përcaktohet në mënyrë egocentrike nga UNI i vet poetit.

*“Tani e gdhënda barkën në magjinë espere
me dërrasë druri rrebesh nga filigrami i djepave
... thirra Odisenë:Kërce i pari.
Thirra argonautin bashkë me profecitë e veta...”*

*Qënin molos ngula statujë, totem në bash për të përgjakur detet
....Dhe së fundi korbin dhe një ovull.*

Të zbutja Karontin në të hyrë të Akerontit...


(Poezia “Barka e Noes”, vëllimi poetik,
“Pagëzimi i zogjve”, fq. 98.)

Grafikisht hapësirën e mitit poetik të Kacalidhës mund ta paraqesim me një trekendesh ku në bazë janë vendosur: Kozmosi i botës mitologjike dhe arketipet e krijuara mbi bazën e saj dhe tradita e pasur popullore si mbartese edhe aktualizuese të kësaj mitologjie. Në njerën brinjë anësore mund të vendosim hapësirën e natyrës dhe në brinjën tjetër mjedisin metafizik.

Koha e mitit poetik të Kacalidhës, grafikisht do të mund të paraqitej në mëyrë drejtvizore si kohë tashme, ose si bashkohësi e unit poetik, që lidhet me veprimin e subjektit poetik.

Në një bosht të tillë subjekti poetik vendos të gjitha elementët e tij poetikë që lidhën me një hapësirë dhe kohë që i takon së shkuarës, një të shkuare që kapërcën kufijtë historikë, për t’u takuar me mitologjinë, me qëllim që nga ky ndërveprim të përcaktojë të ardhmen.

Kjo është edhe natyra e gjithëkohshmërisë së hronos-it të Kacalidhës. Ai, si Kadareja është shndërruar në zotërues dhe krijues absolut të tyre. Kjo i jep atij të drejtën, ta thërmojë kohën, t’i ndryshojë kahun, ta bejë që të kthehet prapa, apo të qëndrojë në vend, të ketë vetëm shi dhe vjeshtë, mjegull dhe një hapësirë homerike, apo abstrakte.



Kozmosi i botës mitologjike tradita e pasur popullore

Pas këtyre përjasjeve ne mund të paraqesim skematikisht edhe strukturën e mitit poetik të Kacalidhës.

“MITI”	“REALITETI”
Natyre- vendlindje	Shoqëri – emigrim (izolim)
Siguri-besim	Dyshim – pabesi (kërkim ekzistence)
Kthim (vendlindje)- modesti	Mohimi i kthimit-(në shoqëri) egoizëm
Dritë –agim (agullim)	Errësirë - natë
Momente kalimtare (optimizëm)	Momente kalimtare (pesimizëm)
Buzëqeshje-bukuri	Dhimbje – shëmtyrë
Aspiratë-shpresë (duke u mbështetur te e shkuara)	Zhgënjim – pashpresë
Aspirim i së ardhmës	Mungesë perspektive
Natyre –dashuri	Shoqëri – vdekje
Plotmëri- ekzistencë	Privim- inekzistencë
Adhurim i njeriut	Adhurim i “ego-s”
Jetë	Vdekje
Poet (poezi)–perëndia e njeriut	Njeri-tradhëtia e shpirtit
↙	↘
<u>Shkruaj poezi- kultivoj dhe zhvilloj mitin poetik-ekzistoj</u>	

Paraqitja dhe analiza e mitologjisë poetike të Niko Kacalidhës, përbën vështirësi objektive si në raport me përpjekjen për të periodizuar veprën e tij, ashtu edhe me morinë tematike të trajtuar në të, me krijimtarië në dy gjuhë dhe me kontradiktat që paraqet ndërgjegjja e tij poetike. Këtu nuk bëhet fjalë për periudhën para viteve 90^{ie}, por edhe pas kësaj periudhe, madje edhe në veprën e përzgjedhur nga ai vet. Siç e thamë kjo ishte një nga arsyet, që për të minimizuar këto vështirësi, u përqëndruam në poezi-në e përzgjedhur nga ai dhe që sigurisht i përket viteve post diktatoriale.

Duke u mbështetur te raportet e përcaktuara më lart do të mundohemi të analizojmë problematikën e veprës së tij, duke u nisur nga dy pole që hasen në të dhe që përcaktojnë unitetin e vet kësaj mitologjie. Poli i përcaktuar nga gjendja “e *privimit*”, e cila lokalizohet dhe shprehet në një koncept hapësire “*këtu-po-shtë*” dhe kohe “e *tashmja-tan*”.

Poli i dytë i përcaktuar nga gjendja “e *plotmërisë*”, e cila hartograhohet në një hapësirë “*lart*”-qielli, kozmosi, por edhe atdheu i

tij i veçantë i subjektit poetik dhe në kohë tek e shkuara “atëherë” dhe që lidhet historinë e kësaj vendlindjeje.

IX.4. Gjëndja e privimit. Kategoria Natyrë

Natyra tek Kacalidha, ndryshe nga sa ndodh si në traditën popullore edhe në përgjithësi tek poetët e mëdhënj grek, Seferis, Elitis, Ricos, na paraqitet e dyzuar sipas “poleve” që përmendem më lartë. Ky dyzim, për shkak të natyrës së ndërgjegjes poetike, -kontradiktore, na shfaqet edhe brënda së njëjtës poezi, realitet që haset sidomos tek poemat e gjata.

Në poezitë e shkruara në gjuhën amtare natyra, ndryshe nga ato të shkruara në shqip, është më në harmoni me realitetin dhe duket se funksionon vetëm poli i plotmërisë. E rëndësishme është të theksojmë këtu faktin se kur poeti mediton në ide përgjithëse të karakterit diakronik-filozofik dhe kur i përshtatet logjikës së krijimtarisë popullore, natyra është “aleate” e tij. (Tek vëllimi “Profecia e Drurëve”, poezitë “Shpirtrat e poetëve”, fq. 11, “Këngë Ballkanase”, fq. 12, “Imitazione”, fq. 17, “Malet e Ballkanit”, fq. 20, “Në tre kasete magnetofoni”, fq. 30 etj).

Në polin e gjëndjes së privimit natyra shfaqet kërcënuese, e errët dhe e frikshme. Errësira, akulli, retë, rrufetë, vetëtimat japin me denduri praninë e tyre për të treguar epërsinë dhe sovranitetin e “forcave” kundërshtarë. Njëkohësisht na japin edhe pozicionin e subjektit poetik, i cili edhe pse deklaron se ishte dëshira e tij, për të qenë larg shoqërisë, ndjehet i vetmuar, pavarësisht nga përpjekjet e tij për të kundërtën. Kacalidha nuk nguron ta nënvizojë këtë situatë që në faqet e para të vëllimit “Pagëzimi i zogjve”. Në prozën poetike, “Unë thirra zogjtë e virgjërisë”, na njofton:

“...Kishin humbur gjurmët e mia të gjakut në dëborë lëpirë nga lukunia e tërbuar me ulërima netësh apokaliptike. Atëherë ishte kur unë thirra zogjtë e virgjërisë të më shpëtonin nga vdekja e harrimit me spirancën e hënës anëdetëve dhe perin e Arianës pyjeve. Dhe gjeten pikë-pikë gjurmët e gjakut tim të derdhur në dëborë, në palimpsestin e udhëve të asterisit të veriut. Larg amiantit, oksidimit të gjethit dhe acetilenit...”.

Vëllimi, “Pagëzimi i zogjve” fq. 9.

Subjekti poetik është i kërcënuar me “vdekje harrim” nga natyra e egërsuar. Ai nuk e vë në dyshim vendimin për të qëndruar “larg amiantit, oksidimit të gjethit dhe acetilenit...”, por në rrugën

e zgjedhur vetmia ishte kërcënuese. Denduria e vetmisë, e shfaqur edhe si plotfuqishmëri të unit poetik, dyert e mbyllura, motivi aq i shpeshtë i dritares, qoftë të mbyllur, apo të hapur, të dhënë me perspektivë me drejtim nga jashtë dhe larg, pranë të cilit është vazhdimisht subjekti poetik në pritje, shënojnë botën e periferisë në të cilën lëviz ky subjekt. Karakteristikë mbetet fakti, që brenda logjikës ekzistencialiste të subjektit poetik, ky i fundit synon t'u imponohet atyre e të triumfojë mbi ta. Aq e vërtetë është kjo, saqë shpesh rritja sasiore dhe cilësore e përmasave të së "keqes" – natyra e egërsuar, bëhet që të evidentohet forca e unit poetik. Ky është edhe thelbi i dramatikës dhe tragjikes në veprën e Kacalidhës.

"Dëborë bie në oborr, gjurmë yjet e zogjve.

*Fletën e mbrëmjes hap në dritare me degët e gështenjave.
me zogj flas në mbretërinë e drurit.*

*Gracka e bardhë dhe heshta e vetëtimave dhe bri i
bubullimave*

*....Pëllumbi i shpellave pikturon aureolat e absurdit dhe
thërrimet e asketit.*

... Qukapiku ruan statusin në statujat e drurëve.

Në të gdhirë gjithë drurët qenë kthyer në statuja...

Po aty, fq.19.

Dhe poeti:

"...Dhe një dërrasë më mbeti.

Dhe kaq mjafton, të kthehem mbi një dërrasë në Itakën time.

Po aty, fq.100.

Ose:

*"Dhe do të jepja shpirt ndanë brigjeve e busteve të drurëve,
qëlluar nga cimbalet e rufeve, i verbuar vetëtimave..."*

Po aty, fq.9.

Ndërkohë është po aq i ndërgjegjshëm se shpëtimin duhet ta kërkojë te natyra.

"Në pasqyrat e mia dimërore, boron pikëllimi i borës.

Pikë-pikë pikon pikëllimi nga hardhitë dhe nuseboret.

*Me një flutur bore të popullova shkretëtirën e shpirtit
dhe gjethëroi puthja.*

Po aty fq 122. Mua, thotë poeti, më shpëtuan "zogjtë",
(fq.24), "druri" (fq. 28), "guri" etj.

Dhe është po ai që në këtë natyrë tragjike, merr përsipër të shpëtojë jetën nëpërmjet pemës së paqes

"...Në breshërinë e bubullimave martirologjia e barit

Kam dalë në brigje të shpëtoj ullinj të ..."

Hëna ndaloi në viset e mia dhe piu gjithë puset e gjakut...
po aty fq.123.

Rrufeja e vetëtima na dalin 35 herë në poezi të ndryshme të vëllimit *"Pagëzimi i zogjve"*. Konkretisht:

- "Cimablet e rrufeveverbuar vetëtimave", fq. 9·*
- "Stralli i rrufeve, fq.14·*
- "Drurët pas bubullimave janë kryqet e vetëtimave zogjtë ngjyejnë vezët e tyre me të kuqen e vetimave", fq. 19·*
- "Rrufeja është në varrimin e dheut", fq. 23·*
- "Zogjtë e vetëtimave", fq. 26·*
- "Rënden në trandafilat e gjakut të vetëtimave", fq. 31·*
- "Majat e qipariseve përplaseshin me jataganet e rrufeve", fq. 33·*
- "amfora e rrufeve", fq. 34·*
- "Në guvat e pshurrura nga perçroi i rrufeve mbi gunat e vetëtimave", fq. 34·*
- "Një tatuazh vetëtime", fq. 51·*
- "Froni i vetëtimës në kockën e gurit", fq. 56·*
- "Nga krisja e hënës kërcisnin gjarpërinjtë e rrufeve gjarpërinjtë e hardhive", fq. 61·*
- Në kavalërinë e vjeshtës, mamuzat i mbajnë vetëtimat", fq. 66·*
- "Gjthë natën era këput mëgojëzat e bubullimave Pinela të përmbysura ngjyer me gjakun e rrufeve", fq 76·*
- "Ka puthje-sa shkrepja e një rrufeje", fq. 79·*
- "Fotografitë e djeguara të blicave të rrufeve", fq. 92·*
- "Rrufetë kafshonin bishtukun e yjeve", fq. 112·*
- "Rrufe prej filigrami", fq. 113·*
- "Shkrepëtinë thikat e vetëtimave", fq. 117·*
- "Vjeshta e vonë e vetëtimave", fq. 122·*
- "Tutje qiparisi ngulur një vetëtim", fq. 122·*
- "Gjaku pikoi në kryqin e rrufeve", fq. 123·*
- "Nën rasat e varura të reve therra korbin me thikën e vetëtimës", fq. 130·*
- "Re të therura me thika vetëtimash", fq. 131·*
- "Therisni elektronet e rrufeve të më bëjnë hi në vatra vetëtimash", fq. 141·*
- "Kalëruar murtaja në murgjarin e reve shtyn me flagrat e bubullimave, thërmon me thumbat e thëmbreve të vetëtimave ploçat e çatisë", fq. 154·*
- "Rrufetë e kreshpëruara luanë kërcenin nëpër kreshta", fq. 155·*

“S’qenë gjarpërinj, rrufetë thereshin me kamat e vetëtimave”, fq. 160.

“Gjaku pikoi mbi gurët e calcifikuar të rrufeve, busulla të bubullimave”, fq. 169.

“Gjarpërinj të vetëtimave”, fq. 187.

“Rrufetë na ngulën heshtat thellë në palcë”, fq. 195.

“Një shalë në qafë në kthesë të një rrufeje”, fq. 201.

“...në pritje të haxharit të rrufeve”, fq. 199.

Nata dhe hëna, përkrah rrufeve dhe rrebesheve, janë karakteristikat e kësaj gjëndjeje privimi. Në vëllimin *“Pagëzimi i zogjve”*, fjala *“hënë”* është përdorur 190 herë pa numëruar përsëritjet. I pasqyrojmë rastet e përdorimit, ashtu si për rastin e fjalëve *“rrufe”* dhe *“vetëtimë”*, për të provuar, shkallën e madhe të përsëritjes të së njëjtes fjalë, për të evidentuar, vendin që zënë disa elementë dhe detaje në krijimtarinë e N. Kacalidhës, si dhe për të parë gamën e gjërë të përdorimit të metaforës, personifikimit e metonimisë nga ana e tij, si një përpjekje për t’i kthyer ato në simbole të subjektit dhe mitologjisë së tij poetike. Të tilla fjalë janë akoma fjalët: *“druri”*, *“guri”*, *“deti”*, emrat e disa lulëve etj.

“Spiranca e hënës”, fq. 9.

“suicidin e hënës”, fq. 10.

“shën Meria e hënës”, fq. 15.

“gëmushën e hënës”, “pyjeve hënore”, “faltoren e hënës”, “mëkataret e hënës”, “kllonkat e hënës”, “zogjtë e hënës” fq. 16.

“vezët e hënës”, fq. 17.

“guri i hënës”, “baptisterin e hënës”, “futen e hënës”, “pëllëmbën e hënës”, “Bishtukun e hënës”, fq. 18.

“feneri i hënës”, fq. 20.

“globi i hënës”, “bërryli i hënës”, fq. 21.

“baseni i hënës”, fq. 22.

“Çarçafi i hënës”, fq. 25.

“misërniken e hënës” fq. 26.

“survejimin e hënës”, fq. 27.

“(mbulova) me një cipë hënësire”, fq. 28.

“dritaren e hënës”, fq. 29.

“(polifoninë) në kasetën e hënës”, “Orakulli i përthënur”, fq. 33.

“kaden e hënës”, fq. 34.

“(Asparagusi) shtegun e hënës”, fq. 39.

“spirancën e hënës”, “gjirin e hënës”, fq. 47.

“folenë e hënës”, “epifania e hënës”, “çatia e hënës”, “tjegullat e hënës”, “altari i hënës”, “i përthënur”, “shtëpia e hënës”, “nëtëve hënore”, “qumështin e hënës”, “qerpiku i hënës”, krisja e hënës”,

“oshënar i hënës”, “emblema e hënës”, “çelësi i hënës”, “leopardet ehënës”, “lugina ehënës”, “heshtja e hënës”, “kali ker i hënës”, “shënjtërinë e hënës”, “shtegu i hënës”, “fytyrë hënore”, “monedha e hënës”, “djepi i hënës”, “vezët e hënës”, “spiranca e hënës”, “hëna e urritur”, fq. 86·

“stalagmiti i hënës”, fq. 96·

“eklipsi i hënës”, fq. 97·

“briri i hënës”, fq. 98·

“kosore e hënës”, fq. 102·

“tempulli i hënës”, “ballkoni i hënës”, fq. 135·

“misërnikja e hënës”, fq. 117·

“disku i hënës”, “sinia e hënës”, “oshilacionet e hënës”, “opinga e hënës”, “arkivoli i hënës”, fq. 141·

“timbani i hënës”, fq.147·

“hëna përkrenare”, “hëna faltore”, “shkallet e hënës”, fq. 156·

“hëna dash përçor”, fq. 157·

“shezlongu i hënës”, “kokallat e hënës”, fq.158·

“bibilushi i hënës”, fq. 159·

“Supën e hënës”, fq. 162·

“hënavënë kapele”, fq. 165·

“hënë e vesuar”, fq. 172·

“napa e hënës”, fq.175·

“kupa e hënës”, fq. 182·

“Farfurinat e hënës”, fq.186·

“metafizika e hënës”. fq 187·

“bukëfiqtë e hënës”, “bishti i hënës”, fq.188·

“rropullitë e hënës”, fq.190;

“hënë njëzetvjeçare”, “hënë mitare”, fq. 191·

“hënë e ngrënë”, fq. 192·

“biçaku i hënës”, “koka e hënës”, fq. 203·

“drapri i hënës”, fq. 209·

“qefini i hënës”, fq. 215·

“monokli i hënës”, fq. 216·

“abordi i hënës”, fq. 229·

“mitra e hënës”, fq. 229.

Në raport me hënën, dielli është *“periferik”* dhe i *“pamundur”* për të ndërhyrë në aksionin e mitit poetik. Prania e diellit ndodh për të bërë krahasime të trajtës së traditës popullore, *“fytyrë diellore”, “i bukur si dielli”* etj, ose të përdoret thjesht si sistem referimi, *“Të më vendosni ndanë detit, përballë diellit”, “Pagëzimi i zogjve”, fq.141, “Foleja e diellit në strehë me gonxhe prilli”, po*

aty, fq. 28. Edhe kur ndodh që dielli të këtë një pozicion më aktiv, ky nuk buron nga natyra e diellit, por nga vullneti, apo raporti i subjektit poetik me diellin, që kuptohet qëndron mbi të. Përjashtim bëjnë rastet kur mitologjia e tij poetike lidhet me Qipron.

Karakteristikë është gjithashtu, fakti që “*hëna*” si element mitformues në poezinë shkruar në gjuhën greke është tej mase e kufizuar. Përkundrazi “*dielli*” e “*rrit pjesëmarrjen*” e tij si element aktiv dhe veprues në rrëfimin poetik të Kacalidhës.

Të njëjtin fat, si hëna kanë edhe detajet e tjerë si “*druri*” e “*guri*”. Guri ka marrë në poezitë në gjuhën greke trajtën e “*shkëmbit*”, se në greqisht ana fonetike e fjalës është më fine. Enigmatike mbetet arsyeja që detyroi Kacalidhën të tërheqë nga fondi aktiv i fjalorit të mitit të tij poetik elementin “*pemë*”, e përdorur në shqip me termin “*dru-ri*”.

IX.5. Kategoria: Shoqëri-njeri

Kacalidhas, duke u nisur nga fakti i vendosjes së unit të tij poetik në qëndër të kozmosit të vet e përmbys modelin e Elitis-it, Livadhitis-it, Ricos, por edhe të Çukës mbi rolin dhe përgjegjësitë e njeriut në raport me botën. Uniteti dhe ekzistenca e kozmosit të Elitis psh, strukturohet në bazë të varësisë reciproke të natyrës me njeriun dhe shoqërinë. Përcakton moralin dhe aktivitetin njerëzor sipas modelit të vlerave të natyrës dhe e lidh këtë, përsa u përket pasojave, me të ardhmen e këtij kozmosi.

Pikërisht, kjo përmbysje nuk e lenë Kacalidhën të zgjidhë drejt kapërcimin e kontradiktës *individ-shoqëri*, që presupozon mënyrën se si do të arrihet harmonizimi i dëshirueshëm midis parimit që kërkon përparësinë e interesit të përgjithshëm dhe eudemonizmit kolektiv (lumturia si qëllim i fundit i çdo veprimi njerëzor) dhe kërkesës për vetpërsosje dhe eudemonizëm individual. Ndryshe, nga poetët që sapo përmendëm, por edhe nga P. Çuka dhe A. Zarballa, Kacalidha nuk e zgjidh atë, qoftë edhe si një proces i dhimbshëm dramatik ndërjegjëzimi që çon nga përplasja te uniteti dhe te harmonizimi i vlerave individuale e shoqërore, në një kalim nga pervoja biomatike individuale tek ajo kolektive-shoqërore. Ai e zgjidh atë si vullnet individual që vjen si pasojë e sundimit të institutit të sovranitetit individual.

*..E shkreta shtëpia, zjarri i fikur
mohimi nga bekimi i hirit.
Borsi i ngrirë në dritare.*

*pjergullës në oborr i krisnin eshtrat.
Shtëpisë varur në brinjë i krisnin traret.
Gjyshës pranë vatrës i therrnin kokallat
Drurit të nxirrë në oxhak i kriste palca e zjarrit
Vdekja që zinte pragun në oborr, ngrinte nga bora
Mjekroshe mjegullat në brigjet e lumenjve,
varrin gështenjave napën e të vdekurve.
Retë e therrura me thika vetëtimash ...*

“Pagëzimi i zogjve”, fq.130

Mund të vihet re lehtësisht se nëse natyra është e egër, kërcënuese dhe e errët, njeriu në mitologjinë e subjektit poetik, është periferik, fatkeq, i privuar. “Ca pleq”

*“...Flenë paqeve të Gushtovjeshtës me barin në mes të
gishtrinjve
...Gjumi i tyre hyn në rropullitë e dheut për të ringjallur gjakun
Në gropat e urisë s’ka vend për varre.
Korbat u klithin telegramëve të kobshme të gjetheve fletë
nevrologjish të vjeshtës.
(Po aty, fq.91.)*

Përmasa të tjera krijon kjo marrëdhënie kur poeti ndërjegjësohet se “kozmosi” i tij po braktiset dhe ai e di shumë mirë se pa njerëz edhe ky “kozmos” s’ka asnjë vlerë.

*“...Shkopinj të gjetluan mbirë nëpër varre
s’arrijnë as orët t’i varrosin bokërrimave.
Më 11 do të përcjellin Janin dhe më 12 Andrënë...
më 12, dhjetë pleq me barelë ulokun xha Vasil
me 3 do të transportojmë barba Markon
(i biri s’pati vizë u tha në celularë).
... Dhe vonë do t’i vijë radha papa Theodhoriut,
po kush ka për të varrosur të tjerë?...*

(Po aty, fq.163.)

Kjo është një nga poezitë e një stili të veçantë. I ngjan një reportazhi, a një raporti. Ai u mjaftua me përthyerjen e kohës, -brënda një dite. Dhe mjaftoi aq që “raporti” të përcjellë me një emocion gërryes dramën deri në tragjedi të privimit të një komuniteti nga jeta.

Kuptohet poeti nuk identifikon vetën me këtë kategori njerëzish. Përkundrazi, ai nënvizon edhe kështu “egon” e vet autarkik dhe karizmatik, që synon me përshkrimin e gjëndjes privuese të ngjallë nxitjen për mos braktisje. Këtij motivi poeti do t’i rikthehet shpesh për të arritur një kulm me “baladën e malit të vrenjtur”.

“Do të ngjallen të vdekurit. Do të marrin rrugën e kthimit për në shtëpitë e tyre/ po ku do t'i gjejnë të gjallët?”, -Pyet poeti për të kërkuar shpresën tek e pashpresa. Më poshtë vet ai pohon se gota e shpresës nuk është as gjysëmplotë, as gjysëm bosh:

*“Me tre qirinj të ndezur e tre të fikur në ulërimat e erës...
Do të ringjallen të vdekurit se tymosnin mërzinë malet e mia”.*

(Po aty, fq. 94.)

Braktisja i jep ngjyra edhe më të errëta privimit te poezia *“Hieroret e gurit”*, fq. 105. Edhe perënditë i kthejnë krahët e braktisin dhe shoqëria tinzare , *“bënin të paditurin”*.

IX.6. Kategoria, forcat metafizike

Vështrimi i deritanishëm na dha mundësinë për të përqasur kategorinë e forcave metafizike që veprojnë apo bashkëveprojnë me subjektin poetik, apo janë *“nën pushtetin”* e tij. Kjo do të thotë se tek Kacalidha veprimi metafizik nuk lidhet vetëm me qiellin, me parajsën, apo me një botë tjetër. Faktorët metafizikë dhe veprimi i tyre janë pjesë përbërëse e kozmosit të tij. Ai u njuh rol in e *“krijuesit”* të këtij kozmosi dhe vet subjektit poetik. Në këtë kategori përfshihen si faktorë të tillë që veprojnë në qiell: Zoti, shënjtoret etj; në tokë: zogjtë, druri, guri, shpirti etj. Janë faktorë që veprojnë në hapësirë, sipas raportit lart-poshtë dhe në kohë sipas marrëdhënies, e *kaluar- e tashmë*. Në këtë hapësirë do të vendosim edhe perënditë, ose metafizikën e mitologjisë që si kohë veprimi i takon së kaluarës.

Nga përcaktimet e deritanishme na rezultojnë dy momente të rëndësishme: Së pari, subjekti poetik zgjeron gamën e faktorëve të veprimit metafizik. Së dyti, veprimi i tyre nuk është i pavarur nga vullneti i këtij subjekti. Në lidhje me këtë shtojmë akoma se individualiteti, apo veprimet e tyre nuk janë të dhëna, konstante dhe konseguente. Ato ndryshojnë deri në kondradiktore. Rëndësi ka këtu fakti që ato brënda logjikës së mitologjisë së kozmosit të Kacalidhës çmitizohen. Kjo, menduam, është ana më interesante e kësaj kategorie dhe do ta shqyrtojmë me hollësi. Bëhet interesante se të njëjtën linjë ndjek poeti edhe në qëndrimin e tij në lidhje me mitologjinë klasike greke dhe traditën popullore.

1. Kacalidha nuk mbështet as linjën biblike të gjesit të botës e as atë të materialistëve. Ndjek linjën e tij, atë të elementëve të veçantë natyrorë, por të ndryshme, të cilat në këtë mision animizohen. Ai na thotë se:

“Në fillim qenë zogjtë dhe shpirti i zogjve”, “Pagëzimi i zogjve”, fq. 22.

“Në fillim qenë zogjtë dhe amarandusi i shpirtit ecnin mbi lumin e Lithisë”, Po aty, fq. 35.

“Në fillim ishte guri dhe froni i vetëtimës në kockën e gurit”, po aty, fq. 56.

“Në fillim duhet të kenë qenë drurët.

Në fillim duhet të ketë qenë vjeshta”, po aty, fq. 67.

“I pari është dielli në tempull kryeëngjëll.” Po aty, fq. 48 etj.

“Në fillim qe puthja, më the ti, në fillim ishte puthja”, “Profecitë e drurëve”, fq. 96.

Në poezitë në gjuhën greke si fillesë e krijimit të gjithësisë qenë, shkëmbinjët dhe rrënjët e tyre, mali, deti.

“Në fillim ishin shkëmbinjët dhe rrënjët tyre në të çarat e tokës dhe detit”

(vëllimi, “Fati i Amarandos”, fq. 165.)

Interesant e bën konceptin e tij mbi “*gjenesis*” fakti që, edhe pse nuk e gjen burimin e “*gjenesis*” te fryma e shënjtë (“*fjala*”, thotë Kadareja), prap se prapë ai nisët nga “*njëshi*” një njësi, por që i takon botës materiale. Gjthashtu, pas çdo njësie materiale siç vumë re më lart, pason një radhë faktorësh të tjerë, të ndryshëm, por materialë dhe shpirtërorë. Kështu në linjën e zogut pasojnë guri, amarandusi, konstelacionet e yjeve, dita, nata etj. Në linjën e Diellit, pasojnë, kryeëngjëlli, shën Nikolla, gjyshi i deteve dhe pas tij gjyshja, Olga, pëllumbi që fle me engjëjt. Në linjën e gurit pasojnë druri, gjaku i pëllumbit, grushti i poetit, kodi i besimit.

Por, na pohon poeti, në shpirtin e cilitdo nga këta faktorë është i pranishëm shpirti i poetit.

*“...në shpirtin e gurit e në shpirtin e drurit,
në shpirtin e erës e në shpirtin e zogjve,
shpirti i poetëve do të jetë futur, patjetër...”*

(vëllimi “Eliksiri i gurit”, fq. 22.)

Ky qëndrim kondradiktor, ose i shumëfishtë për “*gjenesis*” e tij fiton një profil tjetër kur e kërkon në një djalektikë midis ujit dhe shpirtit:

*“... Rrufeja është në varrimin e dheut.
Erërat rrojnë në varrimin e zjarrit,
Ujërat rrojnë në varrimin e erërave
Dheu është në vdekjen e ujërave
Shtegtimi i shpirtrave kthehet në ujëra
Pavdekësia e ujrave është në rrënjët e dheut*

*Prej rrënjës së dheut gurgullojnë ujërat jetëdhënës
Prej ujërave gurgulluese lindin shpirtrat.
Prej metempsikozës së shpirtrave metafora e zogjve.
Dhe bashkë këmbëjmë shpirtrat tanë
Dhe prej hirit tonë është ringjallja e gurit dhe ringjallja e barit.
Prej shpirtit tonë lëvrin rrënja e gurit
Prej shpirtit tonë lëvrin rrënja e drurit.
“Dhe e kundërta:“prej zjarrit, prej zjarrit, prej zjarrit...
prej lumit, prej lumit, prej lumit...
Prej zogut, prej zogut, prej zogut...”*

(“Pagëz. i zogjve”, fq. 23.)

2. Subjekti poetik çmitizon rolin e perëndisë/ve dhe për t'i vënë në shërbim të kozmosit të tij i trajton si bashkëpunëtor/ë të vet, i qëndrimeve dhe i qëllimeve të tij. Ky çmitizim ka dy veçori.

Së pari në lindjen e tyre vë primare natyrën.

*“...Kryqëzuar drurët në Golgotën e gurit.
Zogjtë u lagin buzët me pika vesë.
Pikthi sqepon gozhdën për çlirimin e drurëve.
Ringjallet Jisusi nga kryqet e drurit...”*

(vëllimi “Pagëzimi i zogjve”, fq. 15.)

Në poezinë “Krishti u ngjall” i kundërvihet formulës fetare të ngjalljes së Krishtit, si përcaktuese edhe për ngjalljen e natyrës – pranverën.

*“Pashë biskun e blirit dhe gjethin e qershisë.
Dhe zogun që dilte nga një guaskë deti
dhe gatitej për ligjërimet dhe pagëzimet e zogjve.
Në spiritualizmin e gjethit vesa lante glasat e zogjve.
Gurrave zbriste mullizeza murg i murmë për psallmat
e lumenjve...”*

(po aty, fq.42.)

Poeti na kumton me këtë paralelizëm të pa shprehur deri në fund, por të nënkuptuar nga titulli se është feja ajo që vuri ngjalljen e krishtit në zemër të pranverës dhe jo e kundërta.

Poeti ironizon mitin biblik sipas të cilit Krishti arriti të shumëfishojë bukën dhe verën dhe si pasojë mjaftoi për dhjetëfishin e njerëzve të pranishëm. Në traditën popullore gjeti vend në shprehjet dhe proverbat, “bukë e krip e zemër”, “atje ku nuk arrin tepron”, “mjafton fjala e mirë” etj. Në poezinë “Një bukë e Krishtit” tek vëllimi “Fati i amarandos”, fq.70, ai thotë:

*“...Një bukë të Krishtit ndanë në vetullën e malit
Dhe hëngrën. Dhe ikën.*

Dhe të gjithë u ngopën duke rokanisur hënën. Dhe të gjithë të pangrënë në udhëkryqe...

Së dyti: Subjekti poetik e konsideron të drejtë morale të vëjë në funksion të kozmosit të vet edhe trininë e shënjtë, “*në emër të atit, të birit dhe të shpirtit të shënjtë*”. Ai e ndryshon atë sipas situatave që krijohen në pjesë të veçanta të mitologjisë së tij poetike.

“*Në emër të ujit, të baltës e të zjarrit*”, “Pagëzimi i zogjve”, fq. 24: “*Në emër të atit, të birit, të zogut të shtrenjtë...*” (po aty, fq. 21) “*Në emër të gurit, në emër të drurit, në emër të atit.*”, (po aty fq. 124), ose formulën e lutjes fetare “*Ati ynë që je në qiell*” e perifrazon duke shtuar “*dhe tani zbritë në brigje*”, (po aty, fq. 199), duke lenë edhe një herë të kuptohet me gjithëfarë mënyrash se funksioni qiellor i perëndisë nuk ka kuptim pa lidhjen me tokën dhe kozmosin e tij, i cili është unik. Të njëjtën qëndrim mbajnë edhe shpirtrat e të vdekurve. (poezia “Fise Eliziane” fq. 172.)

Së treti. Perënditë, qofshin këta paganë ose jo, kanë sjellje të rëndomtë njerëzore.

*“Pyjeve zjarret përvëlojnë mistikën e gjethërimit.
sheshit ka nxjerrë Zeusi bolet dhe i kruan zjarreve.
Panit i digjet mjekra mbi kurrizin e Hermesit.
Dhe Artemida me drerin vvarë, hedhur supeve,
si t’i shpëtonte zjarrit?”...*
(“Pagëzimi i zogjve”, fq.192.)

“*...në sqetullat e tua që mbajnë erë cjapi burrërie*” (Zotit). (Po aty, fq. 205.)

“*Brigjeve gërhiste Poseideonil... Kruante mjekrën brigjeve sikur diçka kërkonte/...*” (Po aty fq. 150.)

“*Tani pas gjurmëve të borsit në dëborë ecte Isusi. Shën Mëria në kërkim të birit./ Krishtit të bardhë me nusebore do t’i lante sklepat e mëkatit/...*” (Po aty , fq. 175.)

“*Në oden e madhe dëgjoja perënditë/ që bisedonin mbrëmjeve me perëndeshën, Ollgën,/gjyshen time./ Dëgjova çoç i thanë në vesh Nikollës, gjyshit tim, hyjnisë së detit...*” (Po aty, fq.158.)

Së katërti: Perënditë janë të barabarta, “*marrin urdhëra*” nga subjekti poetik dhe gjithmonë në shërbim të komunitetit ose janë “*nën*” mbrojtjen e tij.

“*Satum, mua mos më gllabëro se jam vëlla kromozonesh me Zeusin*”, (“Pagëzimi i zogjve” fq. 178)

“*Si t’i shpëtoja vallë perënditë, si t’i shpëtoja pyjet?*” (Po aty, fq. 192)

“Do të marrë urgjentisht “Zeusin” olimpik të vijë, për transplant të zëmrës time/... Do të marrë urgjentisht “Zeusin” olimpik të vijë për transplantim të brinjëve të mia./... Vetëm të rrini ju në këmbë, të gurgullojë gurra juaj”... (Po aty, fq.178.)

“I vetmi, unë, luani, lindur në korrik, i ulërrij Zeusit...” (“Zodiaku i Zeusit”, po aty, fq.190)

“...Nuk jam naiv, Zeus, i thashë. Unë vet i di të gjitha. Ti me ke mua, tha Zeusi hyjnori. Po të ngacmoi Saturni që fle tej, në brinjë, futu te hierorja e gurit. Mashtroje...” (Po aty, fq. 105.)

IX.7. Gjendja e plotmërisë

Marrëdhënia me metafizikën përbën edhe një tregues të plotmërisë së subjektit poetik ndaj mitit. (Ndërkohë që nuk përjashton gjëndjen e privimit, pasi plotmëria që synon të arrijë me këtë tip marrëdhëniesh uni poetik, është në fakt e paarritshme, mbetet në kuadrin e dëshirës dhe vetëm sa ushqën egocentrizmin e tij, pasi në fund të fundit do të shoqërohet me zhgënjim).

Plotmëria, siç e thamë, mishërohet tek mungesa e dyzimit të unitetit të unit poetik dhe paralelisht tek prezenca e natyrës në harmoni pozitive me të. Një rast domëthënës është poezia “Ostracizmi”, (“Pagëzimi i zogjve”, fq. 210). Poeti pohon se e zbuar *“nga brigjet”* se ishte *“çamarok i marrë pas diellit dhe gocave të detit”*. Ai iku dhe u la brigjeve emrin e tij *“të shkruar me goca deti”* dhe gjeti prehje i pasaportizuar tek yjet si banor i tyre, duke mbretëruar malet.

Tek Kacalidha plotmëria shfaqet edhe si shprehje e vullnetit të tij për të qenë kudo, të kontrollojë dhe të drejtojë akoma edhe diellin në misionin e tij:

*“Me çelësin sekret kopil të diellit,
çela me gishtërinjtë e përgjakur zëmrën e trandafililit.
Dhe e ruaj çelësin sekret kopil të diellit.
Sepse vetëm unë e paskam çelsin sekret, kopil, të diellit!
Gjërsa kam kyçur lesën e mbrëmjes
dha asnjë luledede s’më kanë ngrënë ujqërit.”*

(“Pagëzimi i zogjve”, fq.204)

Plotmëria është domëthënëse kur subjekti poetik arrin të vendos një harmoni midis natyrës dhe individit apo shoqërisë. Psh.

*“Gjiri me pushin e virgjërisë dhe shega e bigëzuar në
birësimin e brinjës.*

*Cimbalit i bie brigjeve zogthi i shkalluar.
Shtëpitë e përhumbura në gjetherimin e blirit.
Brigjet e mbështetura në gjirin e jargavanit.
Ndanë shtëpive tona shtiza e ëndrrave duke pëshpëritur në
veshin e yjeve.
Prilli çap pas çapi i pushton brigjet e barit.
Nuancat e klorofirit derdhur nëpër rrasat e oborrit.”
(Po aty, fq.142.)*

Duke patur parasysh traditën popullore të dhëniës së tiparëve njerëzore nëpërmjet elementëve natyrorë, Kacalidha arrin te poezia “*Imitazione*”, Vëllimi, “Profecia e drurëve”, fq. 17, t’i marrë natyrës gjithçka që është e bukur dhe t’ia përshtatë tipareve të njeriut (unit poetik) në bazë, kuptohet, të një ngjashmërie qoftë edhe të jashtme, (metaforë).

*“U harkua ylberi dhe m’u bë vetull. Dhe më pikoi në qerpik
qelibari i vesës.
Brofën shkëmbinjë... dhe m’u bënë ballë. Dhe m’u bënë krye.
Doli Dielli dhe më tha: “Do të të bëhem sy”
... Po shpirtin dhe zemrën m’i fali nëna.”...*

Shpalosja prej tij e vlerave të heroit tradicional që është gati të sakrifikojë veten për të tjerët, ose në emër të bindjeve dhe idealeve, të kozmosit që vet subjekti poetik krijoi, janë tregues të plotmërisë së unit poetik, pasojë e harmonizimit të qenësishëm të interesave të tij me natyrën, shoqërinë, kundër faktorëve që synojnë të kundërtën.

*“Thanë për prag nate Shën Bartolemeu.
...Thanë të hiqnim emrat tanë, të shkullnim tabelat e dyerve.
... Me shkronja më të dukshme në derë rishkrova emrin tim.
Le të më vinin kryq. Le të më shënonin te kjo natë e ulërimës.
Dhe le të thoshnin për prag nate Shën Bartolemeu.”
(“Pagëzimi i zogjve”, fq.211.)*

Motivi i vdekjes së tij si sakrificë sublime në emër të kësaj harmonie dhe të kozmosit të vet, është i dendur dhe shumplanesh në poezinë e Kacalidhës. Të njëjtit qëllim i shërben edhe “*mos-vdekja*”, ose ngjallja e subjektit poetik. Në emër të kësaj logjike, poeti në poezinë “Ekehiria”, u kërkon perëndive të sakrifikohet edhe “*dielli*” për “*hir të paqes*”. (“Pagëzimi i zogjve”, fq. 176.)

E megjithatë, gjendja e plotmërisë nuk përbën për poetin veçori dalluese. Nuk është konstante dhe zhvillohet brënda gjëndjes së privimit, që promovohet si zhgënjim, por edhe si pamu-

ndësi që realiteti i kozmosit të tij të përbëjë një sfidë ndaj realitetit, ashtu siç ia arrin me shpalosjen e mitologjisë poetike të këtij kozmosi.

IX.8. Çmitizimi i mitologjisë

Thamë që, në fillim tradita popullore–folklori dhe pastaj letërsia e kultivuar, ashtu si letërsia klasike greko-romake, gjetën te mitologjia e lashtë greke një strukturë arketipesh me vlerë estetike të gjithëkohshme të afta për t'u referuar dhe rimarrë në çdo kohë si mundësi për rritjen e cilësisë së vlerave estetike. Po aq e vërtetë është se vetëm me përjashtime të ralla janë bërë përpjekje çmitizuese të kësaj mitologjie. Pavarësisht se nisen nga qëllime pozitive, për të evidentuar se përseritjet në kushtet e sotme të tragjizmit dhe epizmit të kësaj mitologjie kanë vlerën e një komedie bajate, këto përpjekje ishin të pafata.

Kacalidhas, mësa duket i bindur se kozmosi i tij është i denjë për një ngjashmëri krahasuese me këtë mitologji dhe subjekti i tij poetik po aq i aftë ta përthyejë atë deri në çmitizim ose destrukturizim, guxon edhe në këtë drejtim, si një sfidë më vete. Zgjedhi tre mënyra:

Së pari. Heronjtë dhe arketipat e mitologjisë së lashtë kthehen në personazhë të mitologjisë së tij poetike. Kacalidhas nuk interesohet shumë për mesazhin që mbartin dhe transmetojnë heronjtë dhe arketipat mitologjikë. I intereson thjesht një, apo disa elementë, bile dhe vetëm emri. Si të tillë “*ngarkohën*” me aksion në kohën dhe hapësirën e Kozmosit të Kacalidhës dhe në shërbim të mesazheve shpesh të pakodifikuara, të zakonshme, ose si qëllim në vetvete.

“Atëherë ishte kur unë thirra zogjtë e virgjërisë të më shpëtonin nga vdekja e harrimit me spirancën e hënës anëdetëve dhe perin e Arianës pyjeve”. “Pagëzimi i zogjve”, fq. 9.

“Një bors në krifë të kalit çmendur pas Afërditës”, “Pagëzimi i zogjve”, fq. 21.

“Në breg të detit do të vdes, si Heraklidi në vetminë e kumit me guaskat”, po aty, fq. 24.

“Të mbaja në grushtet e mia Ikarin e Dedalin” (se me llastika gjuante zogj, që binin në tokë), po aty, fq. 45.

Shpesh duket se gjithë poezia ndërtohet që të vihet re kjo lidhje e unit poetik me elementë mitologjikë, ose “*u kërkohet*” aty-

re të rreshtohën në poezi pa asnjë shkak, ose lidhje kuptimore, madje as ngjashmëri formale.

*“Ditët e mia numëroja që janë sa shkrepja e një rrufeje,
...Poshtë barkut të deles dal nga shpella e Odiseut.
...Ngrita gurin qiklopik të turbulloja detet për inat të Poseidonit.”*
“Pagëzimi i zogjve”, fq 79.

E tillë është akoma poezia “Qëni i Itakës”, fq.162. Poeti shfrytëzon pikërisht këtë element mitik për të përshkruar një qën pa asnjë dallim nga qëntë e të gjitha kohrave.

Së dyti. Poeti e ndryshon thelbin e mitit, apo vet mitin, ose e çvlerëson atë: *“Unë isha një nga të Odiseut dhe me shpëtuan sirenat”,* (!!)

“Pagëzimi i zogjve”, fq. 116.
Në poezinë *“Dyshimet e Odiseut”*, fq. 138, poeti lidh kthimin e Odiseut në Itakë me numrin e bimëve. Dyshimi se ato mund të ishin vetëm njëmijë e bën atë të pyes vetën:

*“Dje ndeshesha në dete me stuhitë për në Itakë me vet
Poseidonin,
vetëm për njëmijë drurët e Itakës?”.*

Shihet qartë që çmitizimi nuk lidhet thjesht me ndryshimin e përmbajtjes, por më shumë me thelbin e heroit mitologjik që ishte zgjuarsia dhe qartësia e mendimit, vendosmëria për qëllimin fisnik të kthimit në atdhe me çdo lloj sakrifice. Po ashtu, elementi i zgjedhur për të deheroizuar Odisenë, *“druri”*, luan rolin e kyçit në mitogji dhe në vijimësinë e kulturës popullore. Druri-ulliri i vjetër i Odiseut, përbën mjetin e njohjës së tij me Penelopën. I njëjti detaj është përdorur nga balada popullore e rinjohjes për të realizuar ribashkimin e të porsamartuarve, të ndarë për shumë vite, sipas disa varianteve, për shkak të një lufte, të një shërbimi ndaj mbretit, apo të kurbetit.

Të tilla poezi mund të përmendim akoma, *“Odiseu”*, *“Pagëzimi i zogjve”*, fq. 100. Edhe në këtë poezi, Kacalidhas le menjanë vetinë karakteristike të Odiseut të mitologjisë, që ishte aksioni, peripecitë dhe rreziqet, si pjesë e pasurisë dhe e vlerave të tij pas kthimit në Itakë. Kacalidhas përpiket të justifikojë pasivitetin e Odisesë së tij duke evidentuar vetëm një element,- atë të kthimit në Itakë qoftë *“edhe me një dërrasë”*.

I njëjti arsyetim ka vlerë edhe për poezinë *“Muret e Trojës”*, *“Pagëzimi i zogjve”*, fq. 136, në të cilën poeti, në emër të evidentimit të bukurisë së Helenës, sakrifikon jo thjesht arsyet e vërta të kësaj lufte, por edhe shkallën e intelektit të atyre që projektuan si sulmin edhe mbrojtjen dhe për pasojë epizmin e kësaj lufte. Çmitizimi i thelbit të kësaj lufte mitologjike që ngërthen në

fakt logjiken e të gjitha luftrave shekullore, ndodh brënda logjikës së egocentrizmit të unit poetik të Kacalidhës, i shprehur në keqardhjen e tij se nuk ishte ndërtuesi i mureve të Trojës.

Tek poezia “Tundimi i Odiseut”, “Pagëzimi i zogjve”, fq. 74, çmitizimi është shprehje e dyzimit të ngahershëm të vet subjektit poetik. Kjo bie më shumë në sy po të kemi parasysh faktin se heronjtë mitologjikë (dhe në krijimtarinë e mëvonshme popullore), aq më shumë Odiseu, marrin mbi vete pa ekuivoke gjithë veprimin dhe japin vazhdimisht një zgjidhje pozitive për kolektivin që përfaqësojnë.

Së treti: Nëpërmjet rimarrjes së motiveve apo miteve poetike të poetëve të tjerë mbi këtë mitologji, për të arritur në mite të veta, të cilat, mendojmë se asnjëherë nuk arrijnë te nivelet e paraardhësve.

Tek poezia “Leopardi”, “Pagëzimi i zogjve”, fq. 74, deviza e poetit është: *“Sa herë më ke zgjuar me klithmat e tua./ Egërsirë roje që fle brënda meje.”* Në aspektin e filozofisë së unitetit si pasojë e të kundërtave kjo është një e vërtetë. Por, po të kemi parasysh poezinë e poetit grek K. Kavafis për Itakën, ai e çkodifikon mesazhin e udhëtimit të Odiseut për në Itakë, për t’i rritur vlerat duke e kodifikuar këtë udhëtim në funksion të një mesazhi filozofik. Duke e sintetizuar elementë mitologjikë pjesëmarrës në udhëtimin e Odiseut për në Itakë Kavafis na thotë se na thotë se ... në rrugën tende nuk do të takosh magjistrica dhe najada, po s’i pate brënda vetes. Kacalidhas me të njëjtin kod të Kavafit, na thotë se e keqja bashkëjeton me njeriun si diçka e domosdoshme. Për Kavafin e keqja që të bëhet pjesë e njeriut varet nga ai vetë dhe vullneti i tij. Për të është produkt shoqëror, ndërsa për Kacalidhën veti biologjike e individit.

Çmitizimi i mitit mitologjik tek poezia “Kali i drunjtë”, “Pagëzimi i zogjve” fq. 137 lidhet me raportin e vendosur midis njerëzve brënda mureve (të një qyteti) dhe pritjes së tyre deri në padurim që të hynte kali i drunjtë edhe duke prishur muret. Kjo poezi është një paralele me poezinë po të K. Kavafis, “Duke pritur barbarët”. Filozofia e Kavafis e shikon ardhjen e barbarëve si *“një farë zgjidhjeje”* për një shoqëri në degradim të plotë. Sipas Kavafit, është kjo arsyeja që barbarët i presin të gjitha strukturat e shtetit. Pritja e kalit të drunjtë tek mbrojtësit e Trojës në poezinë e Kacalidhës, nuk ka asnjë lidhje me realitetin mitologjik. Nga ana tjetër, poeti nuk parashton asnjë arsye për të justifikuar veprimin. *“A do të hynte ndonjëherë duke rrezuar muret, sepse u tretim duke pritur nëpër tempuj”*... Në rastin konkret çmitizimi

është shumë i pafat se raportet e mbrojtësve të Trojës me kalin e drunj të bëjnë të papërfillshëm mitin e ri poetik të Kacalidhës.

Duke përfunduar këtë përjasje duam të theksojmë se kjo mënyrë krijimi mitesh poetikë, duke u nisur nga fabulat, ose filozofia e krijimeve të poetëve të tjerë, traditës popullore etj është një normë tek Kacalidha. Prandaj konsiderohet e drejtë ajo që thuhet se kur lexon poezi në gjuhën shqipe të N. Kacalidhës, të kujtohën poetët grek si Seferis, Elitis, Ricos etj dhe anasjelltas. Kur lexon poezi në gjuhën greke të kujtohet Kadareja, Agolli, Podrimja etj. Ai justifikon "*originalitetin*" ose individualitetin e tij krijues me tri mënyra. Së pari ia përshtat unit të vet poetik duke vendosur marrëdhënie të vetës së parë. Së dyti e çvendos mitin tek gjeografia e Kozmosit të tij. Së treti e vesh me figuracionin e vet karakteristik animizues e surrealist.

IX.9. Marrëdhëniet me traditën popullore

Po të përjashtojmë krijimin e mitit të lules, apo të barit të "Amarandos"¹³⁴ tek vëllimi poetik në gjuhën greke "Fati i Amarandos", vihet re një indiferencë e theksuar e unin poetik në raport me këtë traditë. Ose më saktë, Kacalidhas mban një qëndrim "*përvetësues*" të këtyre vlerave në funksion të kozmosit të tij. Këto elementë me një status të qëndrueshëm dhe të provuar vlerash estetike në area lin e traditës popullore nuk shërbejnë në vijimësi dhe në mënyrë të natyrshme si struktura koherente edhe për mitologjinë e kozmosit të Kacalidhës. "*Krishti u kryqëzua në Leshinicë dhe gjithë e përpjeta gjër në buzë të muzgjeve/ të nxirte në Golgotën time/... thotë poeti, ("Profecia e drurëve") fq. 136, ose, "Andej niste rrënja e diellit dhe e vetëtimës. Andej niste rrënja e barit", (po aty, fq. 99).*

Marrëdhëniet e mësipërme nënvizojnë faktin se kozmosi i Kacalidhës ka fituar një shkëlqim të mbipopulluar duke përvetësuar të gjitha arritjet e kulturës njerëzore të njohuara nga poeti, por si qëllim në vetvete.

Fjalë, shprehje, vargje, motive etj, të traditës letrare popullore bëhen pjesë e artikulimit të ligjërimit në mitin poetik të këtij kozmosi. Kjo ndodh më shumë, siç e thamë, kur poeti shprehet në gjuhën greke dhe më konkretisht kur përdor vargun karakteristik popullor, me apo pa rimë. Botëkuptimi i traditës popullore,

¹³⁴ Amarandos nga greqishtja, që nuk vishket. Sipas traditës popullore bari ka të theksuar vetinë e hareshës për atë që e ha, qofshin njerëz apo kafshë.

ose është i rallë në mitologjinë poetike të Kacalidhës, ose trajtohet sipas modeleve të veta poetike dhe qëllimeve të unit poetik, ose duke i deformuar, çmimizuar, apo trajtuar në mënyrë të njëanshme ato.

Nga elementët a natyrës sqaruam, psh rolin e pemës, zogut, diellit etj në organizimin e botkuptimit popullor, në trajtimin dhe në zgjidhjen drejt të raporteve *individ-natyrë-kulturë-shoqëri*, në përcaktimin e *gjëndjes së plotmërisë dhe të privimit, të metafizikës* etj.

E vërtetë është nga ana tjetër, se pema dhe zogu (si dhe gu-ri) kanë një vend nderi në poezinë e Kacalidhës. Tituj vëllimesh poetik si “Profecia e drurëve”, apo “Pagëzimi i zogjve”, flasin qartë për këtë. Druri dhe zogu fitojnë vetinë e krijuesit të botës, të marrjes dhe të dhënies së profecive, të komunikimit me qiellin e tokën, me perëndinë edhe shpirtin, bëhën shpëtimtarë të unit poetik, por nuk vendosin dot raportet që këto dy elementë kanë në kozmosin e traditës popullore. “*Sytë e tu të zinj. Mrekullisht të zinj. Mrekullisht të magjishëm. Tempulli qiellor, (unë në to rënë përmbys si prej një profecie të lashtë pagane/ të gjuhëzuarish përpara Dodonës.)*”, (“Eliksiri i gurit”, fq. 40.)

Thamë që pema në traditën popullore, por edhe në letërsinë e kultivuar (Rrapi, tek Kadareja) nuk lidhet më me vetinë e profecisë, por të lidhjes me tokën dhe qëndresën. Tek Kacalidha vetia e qenësishme e pemës (drurit) është profecia.

Simboli i lidhjes me tokën dhe qëndresën i është deleguar gurit. “*Këtu u pizicionuam./Guri i pllajës sime ka formën e fytyrës sime./ Këtu fjetëm. Mbi gurë. Dhe blici i hënës ma fiksoi fytyrën në negativin e gurit/...*”. (vëllimi “Profecia e drurëve”, fq. 118.) (Ismail Kadareja tek parathënia e vëllimit “Pagëzimi i zogjve”, e konsideron gurin një element të kosmogonisë shqiptare, ashtu si dhe malin.)

Këtu është monenti të theksojmë gjithashtu një fenomen interesant që ndodh me unin poetik të Kacalidhës. Thamë më lartë se elementë të tillë si pema apo zogu zënë një vend nderi në poezinë e Kacalidhës. Këto dy elementë i veçuem si nga më të qenësishëm në traditën popullore greke me lidhje të drejtpërdrejta me Orakullin e Dodonës. Vendin e nderit për to Kacalidhas ua lë në poezinë e shkruar në gjuhën shqipe (!!). Aktivizimi i tyre në korpusin poetik në gjuhën amtare është pothuaj i paqenë. Kjo përbën një ndërmjetësim të poetit për t’i përcjell poezisë në gjuhën shqipe jo thjesht dy elementë poetikë aq të rëndësishëm në traditën popullore greke, por dhe një mitologji poetike të ngri-

tur në bazë të tyre. “Përcjellja” në poezinë shqipe të traditës gjetike të poetit (nga pikëpamja etnike) na jep argumentin për të nënvizuar suksesin e tij në poezinë shqipe.

Nga kritika në gjuhën shqipe është thënë se nuk dihet se cila është gjuha primare e poetit, por duke krahasuar rreth 53 poezi që gjenden njëkohësisht në të dy gjuhët (vëllimet “Fati i amarnados” dhe “Pagëzimi i zogjve”) vihet lehtë re, lirshmëria e poetit në përdorimin e gjuhës greke. Poezia në gjuhën amtare manifeston dukshëm rrjedhshmëri dhe origjinalitet. Megjithatë kur poeti shkruan shqip me të drejtë ai konsiderohet si lëvruar i denjë i gjuhës shqipe.

Për të parë më mirë mekanizmin e përthyerjes së traditës popullore në poezinë e tij po analizojmë dy shembuj.

1. Marrim në fillim poezinë “Monogjirja”, (vëllimi “Pagëzimi i Zogjve”, fq. 83.) Titulli është përkthim nga greqishtja *μονοβίζα*, që do të thotë grua me një gji. Monoviza, sipas legjendës në traditën popullore në Minoritetin Grek, identifikohet me gruan që doli nga deti, dogji Finiqin dhe shkatërroi gjithçka rreth e qark. Tradita popullore mitizoi kështu aktin shkatërrimtar të mbreterëshës ilire, Teuta që identifikohet me shkatërrimin më të madh të ndodhur ndonjëherë. Aftësitë shkatërruese lidhën me gjirin e saj të vetëm të mbushur, në vend të qumështit me helm dhe çdo gjë që spërkatej me këtë helm shkatërrohej që nga themelet. Në mitin e legjendës popullore nuk na jipet asnjë shpjegim pse gruaja shkatërrimtare mbeti me një gji.

Poeti, duke u mbështetur te semantika e fjalës greke, -një gji-, krijon rreth kësaj fjale një poezi me ngarkesa thellësisht pozitive dhe pa asnjë lidhje me mitin e legjendës. Thotë poeti:

Ati ynë që je në qiell...

pse ngacmon bukurinë e gjinjve?

Tani një gji mbeti për mua.

Tjetrin ia prënë thikat e dhimbjes.

Tjetrin ia marrën erinitë

Nga pija unë qumeshtin e shpirtit.

Dhe mbeti mëma monogjirja me njerin gji të shënjtëruar.

Po tjetrin gji ua hodhën qënve në një pavion kancerozësh

apo në morg e ruajnë mjekët për ekspeditat studentore?

Tani një gji mbeti për mua, ku rri mbështetem natën vonë

përgjoj, a do të rritet vallë edhe një herë gjiri i prerë?

Ati ynë që je në qiell...,

Pse ma le mëmën monogjire,

pse ngacmon bukurinë e gjinjve?

Në variantin greqisht të kësaj poezie, (vëllimi “Fati i amaranos”, fq. 83,) poeti ruan linjën e mitit të legjendës. Biles, zgjedh për varg atë tradicional 15-rrokësh në strofa dyshe, me rimë të puthur. Kjo i jep poezisë një afinitet më të madh me legjendën.

Në variantin shqip, mjaftoi origjinaliteti në përkthim nga greqishtja i fjalës “*monoviza*” duke ruajtur në shqip të njëjtin mënyrë fjalëformimi si në greqisht (i vetëm- mono+gji-vizi), për të krijuar një poezi. Impresioni mbështetet tek “*orgjia*” e unit poetik ndaj zotit si shkaktar i këtij fati, si dhe te vajtimi për gjinë e prerë, herë për qumështin e nënës e herë për erotikën e gjinjve. I ballafaquar me të dy variantet poeti na zbulon mungesën e egzigjencës së tij ndaj krijimtarisë popullore.

2. “*Τα λιόκλαδα του Κλήδωνα*», (Degët e ullirit të Klidhonës) është titulli i një poezie në gjuhën greke, në vëllimin “Fati i Amaranos” (fq. 125) që lidhet drejtpërdrejt me një nga traditat popullore nga më interesantet në stinën e verës. Vendoset në ditën e Ekuinoksit Veror. Është dita që Dielli arrin kulmin e nxehjes dhe zgjat në maksimum orët e ditës në krahasim me natën. Sipas traditës në këtë ditë kaq të nxehtë që përkon me festën e shën loanit, ndizen zjarre të mëdhënj për të djegur të gjitha gjërat e thata. Në aspektin praktik besohet se kjo ndihmon në pastrimin e tokës bujqësore nga barërat e këqia dhe rrjedhimisht në rritjen e pjellorisë së tokës.

Në aspektin metafizik, tradita popullore shpreh një shqetësim të madh për arsye se pikërisht në këtë ditë kulmore të veprimtarisë diellore mbi tokë, vihen re njollat e Diellit,- ana e dobët e tij, që besohet se po të rriten këto njolla, Dielli do të humbasë aftësinë e tij ngrohëse dhe jetëdhënëse. Pikërisht në kulmin e veprimtarisë ngrohëse të Diellit, populli mendonte për dimrin. Zjarret e ndezura, sipas traditës, do ta ndihmonin Diellin në këtë pikë kritike dhe kalimtare të mos humbiste energjitë e tij. Në këtë ditë vajzat dhe djemtë djegin në këto zjarre byzylikët (bimorrë) të vëna në një mars për t’u mbrojtur nga mbreteria djegëse dhe plot sëmundje e diellit të marsit. Aq të mëdha bëheshin këto zjarre sa që populli kur shikon ndonjë zjarr të madh thotë: “U bë e shën Janit”

Kjo ditë, në aspektin kohor, është një moment kalimtar. Sipas traditës në çdo moment të tillë kohor, (Viti i Ri, Pashkët, ndërrimi i muajve, i stinëve) duhet patur kujdes dhe duhet provuar fati. Vajzat e reja çohën që herët në mëngjes dhe shkojnë të marrin ujë “*të pafolur*” në burimet malore, pa i zënë drita e agimit dhe e sjellin në shtëpi si fat bashkë me degë ulliri apo dafine.

Tradita fatndjellëse e verës vjen nga lashtësia. Fjala, *Κλήδο-va*, në greqishten e vjetër ka kuptimin e shansit, shënjë parandjenje, që haset në veshjen tingëllore të fjalës. Si folje ka kuptimin e hedhjes së provës, apo provokimit të fatit.

Në poezinë e Kacalidhës janë të pranishëm këto elemente, por nuk arrijnë të kthejnë në vlera estetike këtë metafizikë të traditës popullore dhe që buron nga dialektika e natyrës. Mjaftohet thjesht me karakterin përshkrues për të evidentuar fabulën e mitit të tij poetik që fshihet te leximi i fatit nga vajzat sipas dëshirave të tyre, ose, idenë se fati gjëndet tek vullneti i njeriut dhe nuk është i dhënë as i panjohur.

Si konkluzion të kësaj analize mund të themi se modelet e Kacalidhës për një raport sa më të drejtë me krijimtarinë popullore nuk kanë lidhje me modelet e zgjedhura nga Sollomos, Pallas, Seferis, Ricos, Kalvos, Siqelianos, (përmendim emra poetësh grekë me të cilët ai ka një kontakt e një komunikim shpirtëror, si dhe ndikim në poezinë e tij). Ata janë mbështetur tek modelet e krijimtarisë tradicionale popullore që në qëndër kanë raportin *natyrë-kulturë* si një raport kosmogonik edhe për kulturën e re greke. Në elementët e natyrës, Dielli dhe drita, brënda kondradiksionit të tyre, konsiderohen: Elitis "Kreu i kozmosit poetik është Dielli", Seferis, "*Drita greke besoj se ka një funksion mishërimi vlerash hyjnore te njeriu*" (sprova v. 2. fq. 55 Athinë 1974). Pallas, Drita eidenton si kategori sunduese të natyrës qartësinë dhe dliresinë etj.

Kacalidhas, krahasimisht me elementë të tjerë natyrorë, u rri larg si dritës ashtu edhe Diellit. "*Në pëllëmbët e amarandos/ u ul në gjunjë dielli/ të thithte ushqimin e pavdekësisë/...* (vëllimi "Fati i Amarandos", fq. 73.) Në poezinë e tij vendin kryesor e zë hëna e yjtë pastaj, errësira-agullimi e më pas rrufetë. Në veprën e përndisë për çdo ditë të javës, sipas Kacalidhës, drita vjen e gjashta. Në ditën e parë e kishin radhën shkëmbinjtë, në të dytën etja, në të tretën uria, në të katërtën rrënjët, në të pestën dhimbja, në të gjashtë drita dhe në të shtatën ishte e tija, e subjektit poetik.

Kondradikta

Poezia e Kacalidhës karakterizohet nga dy pole bazë. Njeri është natyra, tjetri ndërgjegja e subjektit poetik.

Përshtypja e parë që krijohet nga kontakti me poezinë e tij është një botë e vogël e natyrës, hartografuar në vendlindjen e tij Leshinicë. Ndjeshmëria poetike përqëndrohet tek detajet e pa-

fundme nga “*jeta e natyrës*”, në mënyrë të tillë që intimizon anën dhe shfaqjen e saj sipërfaqësore për të lejuar lexuesin të shikojë subjektin e tij poetik me syrin e krijuesit fillestar. Në këtë këndvështrim poezia e tij karakterizohet nga një kontradiksion shumplanesh, që buron tek mungesa e një sistemi organik të elementeve të saj përbërëse si dhe tek kumtimet e larmishme “*ideologjike*” të poezive.

Këtu edhe një herë duam të vemë re se të njëjtë elementë natyrorë vendosin në mënyrë të vazhdueshme në hapësirë dhe kohë raporte të ndryshueshme metaforike dhe metonimike, herë përjashtuese, herë harmonie, herë kundërshtuese e herë mohuese. Pra, marrin përsipër herë funksione pozitive-aprovuese e herë negative mohuese. Dhe kjo situatë kuptohet nuk buron nga kontradikta e brëndshme e çdo elementi si pjesë e kontradiktave, që sigurojnë unitetin e gjithësisë dhe të mishëruar me aq natyrshmëri në krijimtarinë popullore. E kanë burimin te justifikimi i qëllimit imedjat i unit poetik dhe te kontradikta midis këtij qëllimi të çastit i ardhur si ndikim, si frymëzim, si ide, apo si imazh, i qëllimit të deklaruar për kozmosin e tij poetik dhe “*kozmosit tjetër*”.

Ne jemi munduar të bëjmë një klasifikim të natyrës kontradiktore të “*universit*” poetik të N. Kacalidhës. Klasifikimi detyrimisht shoqërohet me pohimin se kjo natyrë kontradiktore nuk duhet marrë as vetëm si e metë, ose antivlerë e as vetëm si vlerë.

Kontradikta brënda vargut:

«*Ακαμπτos ο Σίσιυφος, / κυρτός στην ακαμψιά του*»

“*I papërkulur Sifizi, / i kërrusur në papërkulshmërinë e tij...*”

(“*Fati i amarandos*”, fq. 65.).

Kjo bëhet shkas për një kontradiktë logjike dhe burim për kontradiktat e tjera

“*...Kodrat e amarandos*

dinosaurë që brirët kruajnë tek yjet..”

(Po aty, fq. 73)

Kontradiktë midis vargjeve:

«*...Αρχαίο πένθος των κυπαρισσιών...*

χρησμούς ανθών και νυκτωδίες και λιβανίσματα...»

“*Zi e lashtë e qipariseve...*

profeci lulesh dhe netësira dhe temjanisje?...

(Po aty, fq. 89.)

Kontradiktë brënda një poezie: Eshtë dy llojesh, me efekte pozitive (e tipit –*rrijedhin ujrat dhe burimet, / vrapojnë fëmijët për të parë nusen*) dhe me efekte negative (e tipit – *pa shih kohë që*

zgjodhe, vdekja të të marrë / tani që lulëzon natyra dhe toka mbin bar). Fija e barit, na thotë poeti, tek poezia me të njëjtin titull, (vëllimi, “Profecia e Drurëve”, fq. 54,) mbin

“*në faqën e femrës që fle pas puthjes së parë...*

... *në elipsoidin e gurit të kështjellës*

... *mbi kambanën e bronxtë...*

... *mbi bishtin e dallëndyshes...*

... *përmes ulërimës së brinjës...*

... *midis buzëve të puthjes...*

... *në pasqyrimet e ujrave...*”.

Por “*Fija e barit nuk mbin (o, vetëm nuk mbin) mbi varrin e nënës së mërgimtarit.*”. Në poezinë “Zogjtë, të dashurat”, vëllimi “Fati i amarandos”, një kondradiktë e ngjashme përsëritet katër herë.

Në këtë pikë duam të theksojmë se Kacalidha përdor në mënyrë të regullt tekniken e baladave popullore në ndërtimin e kondradikës së brëndshme. Ai rrit së tepërmi, deri në hiperbolë njerën anë të kondradiktës, (në rastin e mësipërm mbirjen e barit) për të nënvizuar më mirë anën tjetër, (marazin e nënës që vdiq pa parë djalin).

Kondradikta midis poezive. E ndamë në tri kategori të tjera.

a. Në lidhje me botëkuptimin e mitologjisë së tij poetike, (Për këtë pikë kemi folur shumë në pjesët e tjera të kësaj analize)

b. Në lidhje me funksionin e mjeteve poetike nga një poezi në tjetrën. (Dielli, psh, një herë i duhet poetit të jetë i ngrirë, një herë të përcaktojë ngjyrën e syve të tij, një herë tjetër të jetë në krye të tempullit, një herë të ulet në gjunjë para amarandusit, një herë të sakrifkohet bashkë me detin për hir të paqes etj. Deti- në një poezi, (vëllimi “Fati i amarandos”, fq. 212) na thotë se për të zgjëruar detin ia vlen edhe sakrifica e gjakut. Në një poezi tjetër na thotë se do ta pi detin në kupën e hënës, lë të thahet deti etj). Këtë kondradiktë mund ta shohim gjithashtu në krijimin e fushave leksikore dhe të fushave semantike gjatë përdorimit të tyre për krijimin e figurave, sidomos të metaforave (përfshirë personifikimet) dhe të simboleve.

c. Në lidhje me parimet dhe qëndrimet e subjektit poetik mbi të njëjtin fenomen, objekt apo ngjarje. (Marrim si shembull qëndrimin në lidhje me Odiseun, Itakën, Penelopën, Perënditë, zogjtë, gurët, pemët etj. Konkretisht: Në poezinë “Jemi treqind”, (vëllimi poetik “Fati i Amarandos”, fq. 231) kemi një rrëfim poetik qëndrese heroike në kohët aktuale realizuar nëpërmjet një paralelizmi me treqind luftëtarët e Leonidhës në Thermopile. (intertekst konfiguracional) Një faqe më pas, në fq. 232, vjen poezia

me titull "Thermopile". Deheroizmi është provokues. Uni poetik i të treqindëve të Leonidhës është i dyzuar. Nuk e trembin Perset, por të tijtë nga prapa dhe ekzistenca "e *dhelprave të fushës*". (Intertekst si përtëritje arketipi)

IX.10. Ndërtimi i poezive- fenomeni i ndikimit

Kjo mënyrë është shpesh edhe shkak për një kontradiktë logjike, që çënon në vijimësi logjikën e rrëfimit. Megjithatë, logjika e rrëfimit çënohet më shumë për arsye subjektive. Për poetin bërtamë e fabulave të mitit poetik bëhet shpesh një impresion i ardhur nga burime nga më të ndryshme. Këtë impresion, në formën e fjalës, shprehjes mbresëlënëse, idesë etj, ai kërkon ta përdorë si fabul dhe të ndërtojë mitin e tij. (Nëpërmjet intertekstit konfiguracional+Intertekstit si përtëritje arketipi). Veprimi të rrëfimi i mitit shtyhet përpara nëpërmjet fjalive që tregojnë kryerjen e një veprimi pasi është kryer më përpara një veprim tjetër. Kur në qëndër të poezisë vendos unin e tij poetik (ndodh shumë shpesh në poezinë e shkruar në gjuhën shqipe) rrëfimi përfundon zakonisht me një pyetje retorike.

Në përpjekjen që të bëhet origjinal mundohet të krijojë diçka ndryshe duke shfrytëzuar gjithë arsenalin e mundshëm të kalibruar dhe justifikuar me figuracionin e tij. Arsenalin e figuracionit i aktivizuar sado i gjërë që të jetë është po ai. Kjo do të thotë se stërgjatjet e vëna re çojnë në hiperbolizime pa funksione estetike dhe në kontradiksione pa vlera. Me këtë mekanizëm mund të shpjegojmë edhe përpjekjet e Kacalidhës për të kthyer në vlera personale ndikimet nga krijues të tjerë.

Marrim si shembull vargun, "*Netëve dalin nga guva shënjtoret dhe luajnë kukafshehti...*" (vëllimi "Pagëzimi i zogjve", fq. 61). Automatikisht të kujton vargun e famshëm, karakterizuar si surreal, të J. Ricos, "Çdo natë dalin nga pusi statujat dhe hipin tek pemët", (poezia "Vendi imi" përfshirë në vëllimin poetik "Pasqyrat", shkruar në kohën e diktaturës kur Ricos ishte i internuar në një ishull). Tek Ricosi ky varg vjen pas një rrëfimi poetik lidhur me shkretimin e vendit për shkak të diktaturës. Pas kësaj, Ricos shtron pyetjen në vetën e parë shumë: "*Si ndodhi që lejuan rregullimin e shtëpisë me një dorë të ngurtë?!*" Dhe si zgjidhje gjeti daljen e statujave nga pusi. Statujat simbolizojnë kështu shkëlqimin e Greqisë së historisë (e lashtë apo revolucioni grek, apo lufta e 1940). Këtë kohë diakronike e shënon nëpërmjet një elementi hapësinor, simbolit

të pusit. Statujat nuk rrinë në sipërfaqe ku rrinë sehirxhinj njerëzit që e lanë Greqinë të administrohet me dorën e ngurtë të diktaturës. Ngjiten në pemë ngrihën mbi ta si simbole frymëzimi. Ricos realizon në një plan vertikal hapësinor veprimin në kohën historike. Po te Kacalidha. “*Shënjtoret*” e tij nuk kanë asnjë ngjashmëri me një funksion të tillë. Përkundrazi, duket se e gjithë poezia “Epifania e hënës” dhe mesazhet që ajo mbart, nisen nga ky varg dhe zhvillohen për të justifikuar këtë varg.

Kacalidha të njëjtin varg e rimerr edhe në dy raste të tjera. Në poezinë “*Ruani çelësin*”, vëllimi, “Fati i amarandos”, fq. 147, thotë:

*“Dhe të lajnë qerpikët me ujë shege statujat e varrosura
Të ripërtëritet kopshti i trandafilave dhe të mbulojë bustet
Dhe dafina të zgjedhim, të thurrim kurrora?...”.*

Duke kuptuar ndoshta pamjaftushmërinë etij për të arritur fuqinë estetike të Ricos Kacalidhas i rikthehet motivit edhe një herë duke vënë në qëndër të motivit vet unin e tij poetik. Thotë konkretisht te poezia “Duke kërkuar pusët”, (po aty, fq. 120.)

*“Duke kërkuar pusët rashë brënda në puse.
Dhe nga nën dheu ngjitem të dalë nga pusët.
Në më kërkoni do më gjeni patjetër në puse
Jam palma që rritet nga thellësitë.
Dhe nëse lart presin degët e mia.
Do të ripërteriten degët.”*

Me këtë logjikë Kacalidha rimerr vargun tjetër të njohur të Ricos që përngjason tre retë pranë hënës me tre viça që pinë ujë në të, poezia “Romiosini”, varg i përdorur nga Kadare në formën “*tre viça re pinë ujë në postafin e hënës*”. Kacalidha i krahason retë me deshtë, (po aty, fq. 179) dhe “*Nga instiktet e zogjve shpërndahën leopardet e reve*”, “Pagëzimi i zogjve”, fq. 19.

Për këtë na bind edhe fakti se poeti për çdo vend që viziton shkruan poezi duke u mbështetur tek ajo që është përfaqësuese për atë vend. Duke ndjekur këtë linjë te vëllimi poetik “Profecia e drurëve” vemë re se, kur poeti viziton Pogradecin, në poezinë që i dedikon qytetit i drejtohet Lasgushit, (fq. 163), kur shkon në Berat i referohet kalasë, Onufrit, (fq. 162), kur është në Gjirokastër, “*fle me Argjiron*”, (fq.185-6).

Ky është mekanizmi me të cilin Kacalidha ndërka në poezinë e tij fjalë të urta popullore, frazeologji, vargje këngësh popullore.

Greqishtja, si gjuhë, ka një ndikim dhe prani të dukshme në arsenalin poetik në gjuhën shqipe. Vihet re një liri e shqipes poetike të Kacalidhës për të pranuar struktura gjuhësore të rafshit leksikor dhe sintaksor nga greqishtja. Nuk vihet re e kundërta, gjë që flet se gjuha shqipe është më e hapur për poetin për të pranuar ofertat e tij gjuhësore të “*huazura*” nga një gjuhë tjetër.

Po ashtu, në krijimin e mitit poetik në gjuhën shqipe ka shumë elemente të ardhura nga bota greke dhe këtu nuk kemi parasysh vetëm mitologjinë. Dhe prapë do të themi se e kundërta nuk është e vlerësueshme, gjë që do të thotë se integriteti poetik i Kacalidhës përcaktohet nga identiteti i tij etnik.

Kjo nuk përjashton nga ana tjetër ndikimin nga autorë shqiptarë, veçanërisht nga I. Kadare. Tek Kadareja, klima, relievi, shiu, ngjyra e qiellit, mjegulla, balta, përbëjnë një identitet dialektik me “*hronon*” dhe veprimin si akt rrëfimi, që na kujtojnë shpesh skena homerike të përshkrimit të natyrës. Kjo është e vlefshme edhe për Kacalidhën.

Për t’u shënuar është fakti se etnotopos-i i letërsisë dhe i kulturës greke merr trajta të tjera në periudha të mëpastajme. Lidhet me detin, hapësirën, kaltërsinë, bardhësinë e diellin. Kadareja në krijimtarinë e tij ruan lidhje adekuate me natyrën e topos-it homerik (male shkëmborë, male të larta e të ftohta, re të sërtë, sfond i një dekori tragjik, fillon I. Kadare, “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”).

Në këtë pikë Kacalidha, ashtu si edhe gjatë u theksua, i përmbahet linjës së Kadaresë dhe jo zhvillimeve që ndoqi etnotoposi letrar grek.

Preferimet në kohë

Në këtë kendvështrim, kur është pranverë, ai nuk shkruan poezi për verën apo vjeshtën dhe e kundërta. Koha më e preferuar për mitin e tij poetik janë momentet kalimtare, kufiri ndarës midis dy situatave: Në harkun kohor të ditës preferon agimin-agullimin, midis muajve preferon prillin, majin, shtatorin dhe dhjetorin. Po të vemë re bëhet fjalë përsëri për muaj që shënojnë kalimin nga një moment stinor në tjetrin. Midis stinëve zgjedh pranverën dhe vjeshtën.

IX.11. *Subjekti poetik, miti dhe surealizmi*

Brënda mitologjisë poetike të N. Kacalidhës sprova e heroit - poet nuk ka një definicion të dukshëm. Gjendet vazhdimisht në zhvillim pa na dhënë modelin e një zgjidhjeje brënda një kuadri, qoftë edhe të “kozmogonisë” së tij të deklaruar. Kjo bëhet me evidente kur shkruan në vetën e parë. Karakteristikë dalluese mbetet fakti se rrëfimi poetik definton në një pyetje retorike si shprehje e pamundësisë së tij për të dhënë një zgjidhje edhe pse çeshtjen e parashton vet. Ose, ashtu siç e pamë, uni e tij është në qëndër të gjithçkaje. Pas kësaj i rikthehet linjës së rrëfimit poetik me një radhë shpjegimesh. “...Kur do të ulen ujërat vallë, të nis pëllumbin ndan rruzullimit ?...”.

Pyet poeti te poezia “Barka e Noes”, vëllimi poetik “Pagëzimi i zogjve”, fq. 99. Pyetja vjen pasi barka është bërë gati nga ai vet për udhëtim. Pas pyetjes retorike vazhdon shpjegimin e radhes paksa të fragmentarizuar dhe pa lidhje logjike: “Në s’gjetë degë ulliri, doemos një gjeth ka për t’u gjetur.” Po aty, fq. 99.

Poezia e tij nisat nga një parim i vetëm. Çdo gjë në botën e gjallë, në natyrë dhe metafizikë përbën një vlerë dhe mund të shndërrohet në poezi sipas risisë që çdo vlerë e prekshme nga ndjenjat duhet të ketë një ndikim të shpirti njerëzor, duhet të gjejë aty homologen e vet. Tjetër gjë është se poeti harmoninë e përfutuar në natyrë mbi bazën e të kundërtave dhe në një sistem unik, reflektohet si imponim apo vullnet deri dhe arbitrar i subjektit poetik të unit të tij në funksion të momentit i ardhur si ide e shkëputur, apo si imazh. Kjo, si dhe kundërvenia shpesh me sistemin kosmogonik të traditës popullore dhe mitologjisë klasike përcakton edhe diferencimin e tij me poetë të cilëve tenton t’u përngjajë, Elitis, Seferis apo edhe Kadares.

Në një masë të madhe kjo ka fragmentarizuar dhe dyzuar edhe surrealizmin e pretenduar të tij. Surrelizmin dihet se është përbërje e dy komponentëve:

I pari pretendon se pas botës së ndjenjave ekziston edhe një parajsë e dytë plotmërie, si zgjërime (dhe jo e kundërta) i botës së ndjenjave. Përsosja e njeriut varet nga mundësia e zbulimit të këtij dimesioni, (që është edhe i vërteti pasi të afron me subkoshiencën duke iu larguar çdo sistemi logjik dhe lidhjeje me realitetin).

I dyti pretendon se për arritjen e këtij qëllimi duhet mohuar çdo kufizim dhe pranuar çdo liri në përdorimin e fjalës, vargut, befasinë në kombinimin e fjalëve dhe krijimin e figurave impresionuese duke tejkaluar edhe mundësitë reale të metaforës dhe metonimisë. Në

këtë këndvështrim surrealist i Kacalidhës mjaftohet me komponendin e dytë. I pari mund të trajohet thjeshtë si pasojë dhe jo si qëllim, apo si përpjekje e autorit.

“Ishte hëna apo kryet e tua mbështetur në supet e mia?

Sidoqoftë kishte marrë zjarr jasemini i gjirit.

Kishte marrë zjarr gjysmëhëna e buzës.

Dhe endesha brigjeve për në shtëpinë e hënës,

për ta gjetur netëve duke i rënë ziles së yjeve.

Me qefinin e hënës lidhur në krye ulërija në guvat e heshtjes...

(vëllimi “Pagëzimi i zogjve”, fq. 62).

Kacalidha në përzgjedhjen e “shënjes” në kuptimin semasiologjik nisat nga kriteret strukturaliste të dy boshteve, paradigmatic dhe sintagmatic me prirje të pafundme, për të gjetur fjalë sa më të vështira, krijime të veta, fjalë të huazuara nga greqishtja, apo të fjalëformuara me rregullat e gjuhëve analoge. Jep rëndësi të veçantë shënuesit, pa menduar për të shënuarin. Këtu e ka burimin edhe të shkuarit aq larg në përngjasimet midis dy shënjave për ndërtimin e metaforës, metonimisë apo personifikimit dhe simbolit. Në ndërtimin e këtij lloji metafore, të cilën e përdorë me një denduri shumë të madhe, Kacalidhas ka përzgjedhur përngjasimet sipas raportit frymor–jo frymorrë. E kundërta është tepër e rallë, madje, më e rrallë se raporti send-send.

Në ndërtimin e metaforës sipas raporteve të ngjashmërisë frymor-send, huazon rregullin e traditës popullore, por tejkalimi i masës shpesh nuk e ndihmon, ose çon në një surrealizëm që nuk synon thelbin e fenomeneve me anë të ndjenjave.

IX.12. Fenomeni i përsëritjes

Përsëritja është arma tjetër e Kacalidhës në arsenalin e tij poetik. Përsëritja luan rolin e mjetit estetik kur, si çdo gjë, nuk ka masën. Në rastin tonë është më shumë shprehje e lidhjeve të shumëfishta të një kontigjenti të caktuar fjalësh në përpjekjen, për të krijuar metafora të goditura me definicion simbolin. Të tilla janë, hëna, zogu, pema–(ulliri), gjethi, guri, bregu, deti, mali, dhe në greqisht bari i “Amarandos”.

Nga lulet më të preferuara janë jargavani, ciklamini, jasemini. (Në vijim do të japin të dhëna më të plota për raste dhe mënyrat e përdorimit të tyre.

- ▶ Përsëritja vihet re:
- ▶ Përsëritje si mjet stilistik-shkallëzimi, aliteracioni, tautologjie.

► Përsëritje si fjalë më vete në togfjalësha të lira apo të ngurtësuar.

► Përsëritja nga fragment i një poezie në një poezi me vete.

► Përsëritje si ide.

► Përsëritje për krijimin e motiveve (jetë–vdekje, rrufetë, zogu, guri, pagëzimi).

► Nga përdorimi në një poezi si varg, në përdorimin si titull në një poezi tjetër. Nga titull në një poezi në titull të një cikli apo vëllimi poetik.

► Përsëritjen e titullit në vargun e parë të poezisë. (Tek vëllimi “Profecia e drurëve” nga 151 poezi në 34 titulli përsëritet në vargun e parë në mënyrë të plotë dhe në 25 poezi në mënyrë indirekte).

Kjo bën që Kacalidha të mos bëj përjashtim nga brezat e sotëm të poetëve, madje përbën një shëmbull tipik. Fjala është për mungesën tek këto breza të sistemeve botëkuptimore poetike referimi, që mundësojnë kërkimin, rikompozimin dhe promovimin e të vërtetës universale. Në vend të tyre haset vizioni personal i cili çon në larminë e të vërtetave individuale, si shprehje moderne e copëzimit të unitetit të njeriut me Botën.

Në vijim po sjellim disa tabela në lidhje me dendurinë e përdorimit të fjalëve-shënjave të preferuara të poetit, lidhja e tyre në togfjalësha të lira dhe të ngurtësuar, krijimi i fushave leksikore dhe semantike etj, në vëllimin, “**Pagëzimi i zogjve**”. Në këtë vëllim 53 poezi janë të përkhyera nga greqishtja dhe gjenden paralelisht edhe të vëllimi “Fati i Amarandos”

Druri

Faqe	shprehja	Faqe	shprehja
9.	Busteve të drurit	25.	abëcënë e drurëve
9.	altari i drurit	25.	profecitë e drurëve
10.	tempujve e busteve të drurit	26.	çuditë e drurëve
15.	altari i drurit	31.	drithërimi i drurit
15.	çlirimet e drurit	32.	kokat e drurëve
15.	kryqet e drurit	32.	ideogramet e drurit
17.	vertebrat e drurëve	32.	sarkofagu i drurit
19.	mbretërine e drurit	32.	kryeroje e drurëve
19.	statujat e druve	33.	lugë druri
19.	majat e drurëve	34.	lakuriq drurët
23.	rrënjët e drurit	34.	kapilarët e drurit
24.	shpirti i drurëve	34.	dallgëzimi i drurëve

- | | |
|--|--|
| <p>36. profecitë e druve (13-prof. gjethit)
 48. profetikja e drurëve
 51. shtylla vertebrale e drurëve
 52. u gdhinë drurët
 53. kafshonte era drurët
 56. druri në shtatoren e erës
 64. kokëposhtë drurin
 68. dinastitë e drurëve
 70. permanentin e drurëve
 76. lotojne drurët
 94. damaret e druve
 97. lakuriqësia e druve
 97. statujat e zhveshura te drurëve
 97. rropullitë e drurëve
 105. (altaret ne pergjim) te rratheve te drurit
 106. furkave (fatale)të drurit
 114. drurët e zisë
 114. fustaneve të drurit</p> | <p>114. drurët qindrakrahësh
 114. rrënjët e drurëve
 116. arkipelagu i druve
 117. drurët e kryqëzuara
 117. (kërciten) kockat e druve.
 121. gjethëzonin drurët
 125. labirinthi i drurit
 129. <i>lëpij hirin e drurit</i>
 137. <i>kali i drunjtë +1</i>
 137. drurët varur greminave
 149. profecitë e drurëve
 164. dinastinë e drurëve
 164. bigave të drurëve
 164. gdhënd drurin e qivurit
 168. (mbin) kryqet e drurëve +1(169)
 169. gravurë për drurët
 175. në lëkurën e drurëve
 188. drurit të kryqëzimit
 227. minifundi i drurëve</p> |
|--|--|

Guri

- | Faqja | shprehja | Faqe | shprehja |
|-------|-------------------------|------|------------------------------------|
| 9. | Tempujt e gurit | 56. | kockën e gurit |
| 15. | Golgotën e gurit +1(35) | 79. | guri qiklopik |
| 15. | Altari i gurit | 80. | guri i hidhërimit |
| 21. | të çarën e gurit | 80. | guri i bubullimës |
| 22. | grishjen e gurit | 80. | gur metaforik |
| 23. | ringjallja e gurit | 80. | vallen treshe te gurit |
| 23. | rrënja e gurit | 89. | mitologjise se gurit |
| 24. | gurë të egër | 89. | damari i gurit |
| 28. | memecëria e gurit | 97. | guret e ngrirë |
| 29. | rrebeshi i gurit | 98. | gurë memec |
| 30. | mitra e gurit | 102. | eliksiri i gurit |
| 30. | lakuriqësia e gurit | 103. | hierore e gurit +2(106)
+3(107) |
| 31. | pragjet e gurit | 105. | lakuriqësisë së gurit |
| 32. | guri filozofal +1(111) | 105. | amarandusi i gurit |
| 33. | arkitraret e gurit | 109. | eliksiri i gurit+1,+1(119) |
| 34. | ne kuarcin e gurit | 107. | hierorëve të gurit+1 |
| 34. | shpërthimin e gurit | 111. | rimartuar gurin |
| 35. | zemra e gurit | 111. | guri i Lëshinicës |
| 35. | gjytoninë e gurit | 112. | bokërrimat e gurit |
| 35. | ngushëllimi i gurit | 114. | guri i pragut |
| 54. | gurët e pritjes | | |

- | | |
|--------------------------------------|-------------------------------|
| 114. guri i vatrës | 149. gjeneza e gurit |
| 114. guri i varrit +1(134) | 149. kokallat e gurit |
| 114. virgjërisë së gurit | 154. në rezidencën e gurit |
| 114. eliksiri I gurit | 155. guri u rrudhos |
| 114. Kërthizën time prerë me gurë... | 156. gur filozofal |
| 115. gjarpëri i gurit | 156.guri i gjyshes |
| 115. rrënjët e gurit | 158. kockat e gurit |
| 118. gurë varri | 162. Rrëqethja e gurit+1(209) |
| 120. demografisë së gurit | 164. gurin pagan+1(165) |
| 121. amfora e gurit | 164. kuajt e zinj të gurit |
| 121. ndryshkeshin guret | 166. gurët ngrinë |
| 121. gurë mbolla | 169. mbi varre mbi gurët |
| 122. gjeografia e gurit+1(157) | 169. gravurë për gurët |
| 122. gurin e brigjeve | 174. guret e brigjeve |
| 124, klepsidhra e gurit | 187. kuarci i gurit |
| 126. borsi i gurit | 188. diagonalja e gurit |
| 127. Tri gjëra mbërthyer prej gurit | 188. gjenealogjia e gurit |
| 128. sinagoga e gurit +3 | 189. menopauza e gurit+1 |
| 129. gjiri i gurtë | 190. zodiaku i gurit |
| 130. hirin e gurit | 196. gurin e vetmisë |
| 130. rrudhjen e gurit | 197. gjenetika e gurit |
| 132. Në krisjen e gurit | 197. pickojnë gurin |
| 132. Mitologjisë së gurit | 199. ambrozinë e gurit |
| 133. <i>Meduza</i> që ngurosi gurin | 200. në grushtin e gurit |
| 133. dhimbjen e gurit | 205. kalorësitë e gurit |
| 134. krisin gurët+1(146) | 205. të bulëzojë guri |
| 134. Gurët mbirë varrëve+3 | 205. gjuha e gurit+1 |
| 187. gurëve ovalë të statujave | 217. vetminë e gurit |
| | 227. do ta therr gurin |

J a s e m i n i

- | Faqja | shprehja | Faqe | shprehja |
|-------|-------------------------|------|-------------------------------|
| 10. | litarin e Jaseminit | 95. | zjarr mori jasemini |
| 15. | Jasemini i gjirit | 95. | venitet jasemini |
| 35. | spiralja e jaseminit | 95. | pak orë roka jaseminit |
| 35. | rrënjë jasemini | 106. | fëfërin jasemini |
| 37. | enigmës së jaseminit | 113. | enigma e jaseminit |
| 50. | dialekti i jaseminit | 117. | Pas derës kacaviret jasemini |
| 62. | jasemini i gjirit | 124. | jaseminitin e mbrëmjes |
| 90. | të dehte jasemini + 2 | 129. | aromë jasemini |
| 90. | kam punë me jaseminitin | 130. | kryqet e jaseminit |
| 90. | syte e jaseminit | 155. | pagëzonin jaseminitin |
| 90. | era e jaseminit | 157. | frymën e shënjtë të jaseminit |
| 90. | mbjelljen e jaseminit | 181. | marose jaseminitin |

Ciklamini

Faqja	shprehja	Faqe	shprehja
14.	peshqiri i ciklaminit	80.	vëllazëria vjollcë e ciklaminit
26.	drithërimin e ciklaminit	81.	cikli i ciklaminit
34.	cikloni i ciklaminit	111.	syri i ciklaminit
63.	ciklamini i yjeve	119.	loti i ciklaminit
73.	erinitë e ciklaminit	119.	kam ca punë me ciklaminit
74.	në shtëpinë e ciklaminit	125.	dinastinë e ciklamineve
79.	ciklamini i rrugës	131.	bulboret e ciklaminit
79.	veshin e ciklaminit	132.	dridhej ciklamini

Brigjet

Faqja	shprehja	Faqe	shprehja
14.	ravgimet e brigjeve	126.	(borën duke shkundur) në brigje
14.	kandilet e brigjeve	127.	duke përgjuar brigjet
19.	herbariumi i brigjeve	129.	në sqetullat e brigjeve
25.	leoperdta e brigjeve	130.	brigjet gjenealogjike
66.	vjeshta brigjeve	131.	mjegulla në brigje
69.	eshtrat e brigjeve	134.	do të digjen brigjet
71.	lmonishtet e brigjeve	137.	u drodhën brigjet
76.	lakoren brigjeve	137.	... që t'i blatonin brigjet
79.	brigjet e karafilta	141.	ballkonëve të brigjeve
80.	të ngurosja brigjet	143.	brigjet e mbështetura në <i>gjirin e jargavanit</i>
80.	kërcimeve pirike brigjeve	143.	<i>Prilli pushton...</i> brigjet e barit
80.	ngurosja e brigjeve	145.	<i>Fax urgjent</i> brigjeve
86.	brigjeve të mia	150.	brigjeve gërhiste Poseidoni
86.	tre diej kullosnin ne brigje	150.	Rrëqethte brigjet
88.	brigjet e Leshinicës	150.	kruante mjekrën brigjeve
92.	gjarpërimi i brigjeve	160.	meduzat blasfemojnë brigjet
102.	yjet kercejne ne brigje	165.	humbellave të brigjeve
111.	alabastri i brigjeve	174.	picirruket e brigjeve
114.	brigjeve te Akeronit	174.	gurët e brigjeve
114.	ciklopi pshurte brigjet	175.	brigjet bordhëllore
117.	(kerusja ime) urë për brigjet	176.	brigjeve të hënës
117.	Babelin e brigjeve	176.	brigjeve të borzilokut
119.	si shënjtore në brigje	177.	në bardhësinë e brigjeve
121.	përshpirtjes së brigjeve	178.	do të shkretohën brigjet
121.	gjëmojnë brigjet	180.	Marina e brigjeve+7, +5(181)
122.	brigjeve te Akeronit	180.	bregun e vetmisë
123.	gurë tëbardhë brigjeve	185.	brigjeve paleolitike
124.	ngrihën brigjeve shtatore		
124.	në sekuestrimin e brigjeve		

188. u zgjuan brigjet
191. duke eremuar brigjet
197. brigjeve paganë

197. brigjeve diellorë
197. klorofilin e brigjeve

H ë n a

Shprehja	faqja	Shprehja	faqja
"Spiranca e hënës", fq. 9,		"krisja e hënës",	
"Suicidin e hënës", fq. 10,		"oshënari i hënës",	
"Shën Mëria e hënës", fq. 15,		"emblema e hënës",	
"gëmushën e hënës", fq. 15,		"çelësi i hënës",	
"pyjeve hënore", fq. 15,		"leopardët e hënës",	
"faltoren e hënës", fq. 15,		"lugina e hënës",	
"mëkataret e hënës", fq. 15,		"heshtja e hënës",	
"kloçkat e hënës", fq. 15,		"kali kër i hënës",	
"zogjtë e hënës", fq. 16,		"shënjtërinë e hënës",	
"vezët e hënës", fq. 17,		"shtegu i hënës",	
"guri i hënës", fq. 17,		"fytyrë hënore",	
"baptisterin e hënës", fq. 17,		"monedha e hënës",	
"futen e hënës", fq. 17,		"djepi i hënës",	
"pëllebën e hënës", fq. 17,		"vezët e hënës",	
"Bishtukun e hënës", fq. 18,		"spiranca e hënës",	
"feneri i hënës", fq. 20,		"hëna e urritur", fq. 86,	
"globi i hënës", fq. 20,		"stalagmiti i hënës", fq. 96,	
"bërryli i hënës", fq. 21,		"Eklipsi i hënës", fq. 97,	
"baseni i hënës", fq. 22,		"briri i hënës", fq. 98,	
"Çarçafi i hënës", fq. 25,		"kosore e hënës", fq. 102,	
"misërniken e hënës", fq. 26,		"Tempulli i hënës", fq. 102,	
"survejimin e hënës", fq. 27,		"Ballkoni i hënës", fq. 135,	
"me nje cipë hënësire", fq. 28,		"misërnikja e hënës", fq. 117,	
"dritaren e hënës", fq. 29,		"disku i hënës", fq. 117,	
"në kasetën e hënës",		"sinia e hënës", fq. 117,	
"Orakulli i përhënur", fq. 33,		"oshilacionet e hënës", fq. 117,	
"kaden e hënës", fq. 34,		"opinga e hënës", fq. 117,	
"shtegun e hënës", fq. 39,		"arkivoli i hënës", fq. 141,	
"spirancën e hënës",		"timbani i hënës", fq. 147,	
"gjirin e hënës", fq. 47,		"hëna përkrenare", fq. 147,	
"folenë e hënës",		"hëna faltore", fq. 147,	
"epifania e hënës",		"shkallet e hënës", fq. 156,	
"çatia e hënës",		"hëna dash përçor", fq. 157,	
"tjegullat e hënës",		"Shezlongu i hënës",	
"shtëpia e hënës",		"kokallat e hënës", fq. 158,	
"nëtëve hënore",		"bibilushi i hënës", fq. 159,	
"qumështin e hënës",		"Supën e hënës", fq. 162,	
"qerpiku i hënës",		"hënavënë kapele", fq. 165,	

“hënë e vesuar”, fq. 172,
 “napa e hënës”, fq. 175,
 “kupa e hënës”, fq. 182,
 “Farfurinat e hënës”, fq. 186,
 “metafizika e hënës”, fq. 187,
 “bukëfiqtë e hënës”,
 “bishti i hënës”, fq. 188,
 “rropullitë e hënës”, fq. 190,
 “hënë njëzetvjeçare”, fq. 190,

“hënë mitare”, fq. 191,
 “hënë e ngrënë”, fq. 192,
 “biçaku i hënës”, fq. 192,
 “abordi i hënës”, fq. 229,
 “koka e hënës, fq. 203,
 “drapri i hënës”, fq. 209,
 “qefini i hënës”, fq. 215,
 “monokli I hënës”, fq. 216,
 “mitra e hënës”, fq. 229.

Z o g u

Faqja shprehja

9. Zogu i vrigjirise
 11. Pagezimi i zogjve
 12. Gravura e zogjve
 13. Zanafilla e zogjve
 13. Imitimi i zogjve
 13. sqepitjet e zogjve
 13. pickimi i zogjve
 13. Bebëzën e zogjve
 13. Bëbezën e zogjve
 14. Zogjtë e urrisë
 14. Konkili i zogjve
 14. rojet e zogjve
 15. dashuritë e zogjve
 15. kori i zogjve
 15. flatrat e zogjve
 15. zogun e ligjërim
 16. Bishtukun e zogut
 16. tufat e zogjve
 17. Gjaku i zogjve
 15. Pagëzimi i zogjve +4. (22, 26,
 37,43),
 17. Inventarin e zogjve
 18. rrathët e zogjve
 18. zogjtë e drurëve
 19. Yjet e zogjve
 19. udha e zogjve
 19. golgota e zogjve
 19. psallmat e zogjve
 19. instiktet e zogjve
 20. folete e zogjve +1(36) +1(76)
 20. eshtrat e zogjve
 21. zogu i shënjte.

Faqe shprehja

21. varret e zogjve
 22. kosheret e zogjve
 22. zogjte e puthjeve
 22. korde zogu
 22. racioni i zogjve
 22. shtrojet e zogjve
 22. shpirti i zogjve
 22. syrin e zogjve
 22. bëbezën e zogjve
 23. metaforat e zogjve
 23. zogjtë e pagëzuar.
 23. rrokjet e zogjve
 24. shpirtin e zogjve
 25. sozia e zogjve
 26. zogjtëe vetëtimave
 26. virgjërine e zogjve +1 (30)
 26. zogj siamezë
 27. puthjet e zogjve
 27. vreshta e zogjve
 27. zogjte e yjeve
 27. flete e zogjve
 27. kolonizimin e zogjve
 27. gjaku i zogjve+2(51)
 29. flugeri i zogjve +1
 29. dritareve te zogjve
 29. gjumin e zogjve
 29. Orfeu i zogjve
 29. belbëzimet e zogjve
 29. kopetë e zogjve
 29. shtigjet e zogjve
 29. gjirin e zogjve
 29. rrënjët e zogjve

29. Babilonia e zogjve
30. ungjillin e zogjve + ungjillizimin (30)
30. Shën Mëria e zogjve
30. stacione kërcimi të zogjve
31. gjunjët e zogjve
31. ëndrrat e zogjve
32. qimiteret e zogjve
32. rekuieimi i zogjve
33. adrenalina e zogjve
33. zogjtë pagane
33. zogu i shpresës
33. kadifene e zogjve
33. zogu i dëborës
33. Zogjtë e Fatamorganes
34. Shpirtit të zogjve
34. pickimi i zogjve
34. saksofoninë e zogjve
35. sytë e zogjve +1 (35)
35. kryqëzimi i zogjve
35. antikuari i zogjve
35. zogjte e përdëllyer
35. shtëpinë e zogjve+2(35)
35. kokat e zogjve +2(35)
36. pikëllimi i zogjve
36. zgavrat e zogjve
- 36, korin e zogjve+1(37)
36. kortezhin e zogjve
38. shugurimi i zogjve
39. asparagusi i zogjve
40. zogjtë e vjeshtës
- 43, Dedali i zogjve
43. imitacioni i zogjve
44. celulari i zogjve +1(44)
44. zonës së mbulimit të zogjve
45. guvat e zogjve
46. zogu i agullimit+1(105)
46. zogu i buzëmbremjes

47. porcelani zogjsh
47. gjurmeve te zogjve
48. magjistaria e zogjve
50. zhargoni i zogjve
52. pupat e zogjve
52. pickimi i zogjve
53. flatra zogjsh
55. kaltërsia e zogjve
57. blatimi i zogjve
60. zogu i urrise
60. zogjtë fantastikë
60. zogjtë e mrekuillisë
63. amforën e zogjve
79. pagëzohën zogjte
88. sythat e zogjve
97. kërcimet e zogjve
97. fole zogjsh
106. zogj t. dashuruar
106. të kremtën e zogjve
114. shtëpinë e zogjve
130. hirin e zogjve
130. spirancën e zogjve
132. sistemimin e zogjve
132. kardiogramin e zogjve
132. zemra e zogjve
153. zogjtë e zotit
154. imitacionet e zogjve
158. shtegu torzot i zogjve
173. zogjtë e puthjeve
176. liturgjisë së zogjve
181. zogjtë e detit
185. pagëzoja zogjtë
187. zog bore
188. m'i zgjoi zogjtë
191. gjuhësinë e zogjve
199. abecenë e zogjve
219. zogjtë e vjeshtës

Fjale dhe shprehje greke

9. asterisit te (veriu),
10. +1(47) +1(86)+2(172) +1(79)
+1(86) +1(124) +2(128) +1(132)
+1(153) +1(172) +1(173)
15. dodekafonise

15. ksillofonave
27. arkeopterikseve +5(119, 130, 156,187,207) 27.
27. amarandusit +1(34), +2(35)
+7(93, 95,105,115,125,197)

- | | |
|---|---|
| <p>31. protoplastit (ne kuptim. zotit)
 32. qimiteret (e zogjve)+1(111)
 33. ajasmës
 36. litanine
 43. Dedali (arktekt i shquar i mitologjise, bëri labirintin e Kretes)
 61. epifania e hënës
 98. eremimit +3+(128,173,188), <u>nuk është fjalë greke, por krijim i autorit nga era ose aroma</u>
 105. apokalips +1(106)
 106. perikope –(apokalipsi)
 106. Koqinolithari+1(178)
 109. ostracizmi (i yjeve) eksostrakismos+1(210)
 111. kataklizmës
 115. radhiqet (lakra)
 123. martirologjia (e barit)
 128. kafkulla
 129. heraldiket e erës +1(133) +1(156) +1(197)</p> | <p>129. (viset) kimerike
 129. monoklin+1(216)
 135. tramundanat+2, +1(166)
 141. lepitkën (lepidhi)
 153. gufallat +1(160)
 153. ikonat-ikonostaset
 153. terratoren (ne kuptimin e teras)
 153. nafore +1(157)+1(197)
 158. ambrozine –amvrosia
 160. palindromisë
 170. klepsidhrat
 174. picirruket
 176. ekehiria
 179. epifaninë e jugës
 181. viset e Jallisë – gr. Jiallo
 182. onirike –oneiriki
 182. fallosi
 188. kallamidhet
 197. heliotropizëm+1(198)
 197. kimerike
 197. anakrezat
 197. erinike
 221. efemëre</p> |
|---|---|

Fjalë të vështira

- | | |
|--|--|
| <p>9. Palimpsestin (e udhëve), +3 (21, 22, 84) +3 (72)
 10. suicidi (i hënës) +3 (27,119,121)
 21. shermasheku
 33. esperandoja e shpirtit+1(128)
 33. Fatamorganes
 34. Asparagusit +3 (39)
 35. diadema
 64. gujave +1(64)+1(69)
 66. (une) aelekini (I vjeshtes)
 69. akupuktura
 72. krizantema + 2(87,) +3(92, 119, 170) +2(118)
 97. koleopteret
 98. magjinë espere
 98. luleshtridhe endemike
 103. hierore e gurit +2 +4(105, 182, 184)+5(106,107)
 112. hedonizmi +1(128)<i>hedonike</i></p> | <p>125. diademen time,+1(188)
 129. (pushi)edik / <i>Aferditës</i> +1(131)
 129. verbërinë terrishte
 130. <i>petlat</i> e asfondelit
 130. krillave+1(153)
 130. navigacionin (<i>diellor</i>)+1(197)
 141. agavie+2(230)
 147. <i>petalet</i> e aposperitit
 153. krezmuar
 153. absidat abrashe
 153. angrat
 153. asfondilit+2(172)+1(181)
 160. kerubinet+1(176)
 180. <i>era</i> e buthtimit
 182. hermaphrodite
 188. arlikenit
 197. esperidet
 197. trishtilet
 224. aedeve</p> |
|--|--|

Fjalëformim me ndikim nga greqishtja







Mbremësore - εσπερινός
Anëdet - ακρογιαλιά
Monogjirja - μονοβίζα
Frankofiqve - φραγκοσυκιά
Buzëperëndimit - ηλιοβασίλεμα
Barblet - μελισσοβότανο
Ditnet – μέρα - νύκτα
Monoditë - μονοήμερο
Nusebore - χιονονιφάδα
Gjithësimanisë – απειρομανία


Fjalë të krijuara nga poeti

86. Fatthënë (12 herë)
132. gushfarfuri
147. yllthet
184. gjethësimanisë
121. gjethëzonin drurët
122. gjethëroi (puthja)
129. endërmiku
131. gjethnaja (sipas Kadaresë thashethemnaja)
140. gjethërrenja
163. gjethuan
223. gjethërua
167. hënëzim, hënëzuar

Fusha leksikore







KREU I DHJETË

ANDREAS ZARBALLAS

X.1. Jetëshkrimi dhe veçoritë e poezisë së tij

“Asnjë revolucion, as në arte, as në jetë nuk ka më shumë shpresa suksesi nga ai që përdor si pikëmbështetje traditën”. Risia është e nobelistit grek Odise Elitis, por, duke respektuar masën dhe raportet, mund të huazohet për të karakterizuar Andrea Zarballanë dhe poezinë e tij.

Për ta argumentuar këtë risi në poezinë e A. Zarballas, do të ndjekim edhe për të, madje veçanërisht për të, metodologjinë e mbështetjes në tekstin poetik nga njera anë (të vëllimit “101 poezi për një grusht dhe” 1970-1991), dhe nga ana tjetër në qasjen dhe njohjen e kuadrit historik dhe fenomenëve social-politike, që përcaktojnë mitologjinë poetike të veprës së Zarballas. Mund të përcaktojmë pra, dy linja: Atë të poezisë si të tillë dhe të atdheut të tij të veçantë,- “*vendit*”- topos-it-etnotoposit të subjektit poetik të përshkuara nga dyzimi i unit poetik midis mitit dhe realitetit. Duhet vënë re se faktorë të jashtëm politiko-shoqëror (kultura në raport me natyrën), detyrojnë poetin të lëviz në mënyrë alternative midis mitit dhe realitetit dhe këto dy pole ushqejnë reciprocisht ndjenjën e optimizmit (gjëndje plotmërie), ose të pesimizimit (gjëndje privimi). Në rastet kur poeti arrin të shmang kondradiktën midis mitit dhe realitetit, atëherë karakterizohet nga gjendja e plotmërisë dhe e kundërta.

A. Zarballa, u lind më 1942 në fshatin Llazat të Sarandës. Pas studimeve punoi për pak kohë si mësues dhe pastaj gazetar në gazetën “Llaiko Vima”. Më 1981 botoi vëllimin e parë poetik, «*Επιμένουμε*» (“Këmbëngulim”) dhe më 1986 vëllimin e dytë «*Τα παιδιά του Ήλιου*» (“Djemtë e Diellit”). Në periudhën midis botimit të dy vëllimeve poetike, botoi një përmbledhje publicitare me titullin «*Ταξίδι στον τόπο μου*» (“Udhëtim në vendlindjen time”) Më 1992 botoi vëllimin e tretë poetik, «*101 ποιήματα για μια χούφτα γη*» (“101 poezi për një grusht tokë”).

Me 2004 studimin «*Ο άλλος χάρτης*» (“Harta tjetër”). Më 2006 është përkthyes i poezisë greke në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, i poezisë shqipe në gjuhën greke, në antologjinë e poetëve ballka-

nikë, AIMOS. Më 2006 dhe 2007, përgatiti dy antologji, e para me poezi të poetëve minoritarë grek e përkthyer dhe shqip dhe e dyta me tregimin e zgjedhur të prozatorëve nga Minoriteti Grek. Me 2008 botoi vëllimin me tregimet e tij më të mira «*Η μοίρα του Αλκίνοου*» (“Fati i Alkinos”) dhe po këtë vit një vëllim me esse rreth këngëve popullore me titull, «*Το αίμα της αγάπης*» (“Gjaku i së dashurës”). Më 2009 botoi vëllimin e ri me poezi “*Ραβδομάντης*” (“*Fallhedhësi me shkop*”), që ai e konsideron si pjesën e tretë të trilogjisë së vëllimeve të tij poetike dhe më 2016 vëllimin poetik “*Η μπαλάντα της στάμνας*” (“*Balada e shtamnës*”).

A. Zarballas është i njohur për letrat në gjuhën greke dhe shqipe edhe për përkthimet e tij të shumta dhe serioze në gjuhët analoge, greke dhe shqipe. Po ashtu, është pothuaj i vetmi që nuk shkruan letërsi në ndonjë gjuhë tjetër veçse asaj greke.¹³⁵

Pavarësisht nga prodhimtaria jo e shumtë poetike, konsiderohet një nga poetët me në zë dhe një nga penat më të fuqishme, në letërsinë e Minoritetin Grek në Shqipëri.

Zarballas në veprën e tij poetike, mishëron dukshëm parimin se elitat etnike (në formën akademike apo edhe të pushtetëve politike), duke u nisur nga qëllimi i kontrollit (orientimit historik përspektiv) të popullit, në kuptimin e komunitetit, krijojnë dhe mbështesin një mekanizëm shoqëror krijues, që i paraprin mënjanimit të rastit të kundërt, kaosit. Kupton drejt se ky komunitet për çdo moment të së tashmës historike kërkon një të kaluar të “*dobishme*”. Në këtë kontekst ai nisat nga koha e tij për ta ballafaquar atë me “*periudhat e arta*” në të shkuarën. Në shërbim të këtij misioni, vendin kryesor e zënë mitet, apo legjendat, të cilat, konsiderohen si kritere objektive përcaktuese të identitetit etnik.

Zarballas përbën në vetvete një shkollë poetike. I ndërgjegjshëm për misionin e tij si poet e gazetar ka meritën se është nga të parët, që në fillim të viteve 80^{te}, thyen kornizat e brezit të vjetër të shkrimtarëve dhe poetëve minoritarë, madje në disa drejtime.

Së pari, orienton totalisht mitin poetik për nga tradita si botëkuptim dhe ideologji. Në aspektin e formës, apo të shprehjës poetike, e bën këtë duke zëvendësuar me sukses vargun tradicional me ritëm dhe rimë me vargun e lirë e të thyer.

Së dyti e angazhon subjektin dhe mitin poetik me fatet e atdheut të tij të veçantë, “*vendit tim/tonë*”, (*ο τόπος μου/μας*) duke i dhënë fuqi simboli.

¹³⁵ Shih për më shumë, kreu i gjashtë, faza e dytë e letërsisë së pas luftës.

Së treti, bëhet faktor determinant, që poetët minoritarë mund të shkruajnë me sukses edhe poezi në gjuhën amtare. Ndikimi në këto drejtime ishte i drejtpërdrejtë. Ndhmoi shumë edhe pozicioni i tij në gazetën “Llaiko Vima”, si i vetmi mjet periodik që botoonte letërsi në gjuhën greke, si dhe autoriteti dhe rreptësia që ai manifestonte në kërkesat për cilësi në letërsi.

Andreas Zarballas është kaq i lidhur me fatet e vendit që i përket, sa që poezia e tij edhe kur botohej nën “*inspektimin*” rigoroz të diktaturës, gjente mjete komunikimi me pulsën e përkatësisë etnike dhe këtë ndjesi e përçon me guximin që e pajis arti i metaforave, alegorisë, paralelizmave dhe i simbolikës së tij të veçantë.

Kur shkruante poezi që do t’i fuste diku nën dhe, evidentohet më qartë pezmi i fatit të të qenit dyfish i përbuzur dhe i harruar. Është poeti i krijimit të simbolikës së tij të veçantë, që i shërben misionit të poezisë së tij, por i shërbejnë dhe komunitetit të tij për t’u vetorientuar.

Filologu dhe tregimtari i njohur grek Hristoforos Milonis, shkruan për Zarballan: “*Në poezinë e tij, gjuha arrin të realizojë funksionin e saj më fin dhe të shprehë jo thjesht fatin e keq në sipërfaqën e tij të së përditshmes, por dhe “lëvizjet më të thella të shpirtit”, ëndrrat, dinjitetin e plagosur dhe marrazin e një populli që e kanë harruar. Bota e tij është një botë e mbyllur, por në unitet me fatin dhe kujtesën historike, me kohezionin gjeografik dhe veçoritë dalluese të identitetit kulturor dhe jetës së brëndshme të komunitetit të vet. Tek ai është i shkrirë organikisht poeti që, përfundimisht bëhet ndërgjegjja dhe zëri i tij...*”¹³⁶.

Vargu i tij është i kursyer dhe i thjeshtë. Përmes një sintaksi të goditur arrin të përcjellë pa vështirësi emocion te lexuesi i tij. Di dhe përdor me saktësi fjalën kur do të krijojë ngjyime poetike, apo të përcjellë meditime filozofike.

Është poet me shumë i arsyes se i ndjenjës. Natyra, ngjyrat, tingujt kanë vlerë për Zarballan kur e ndihmojnë të depërtojë më mirë te shpirti i popullit.

“*Zarballas, -thotë për të Fotos Qiriazatis,- është poet i kursyer dhe i thjeshtë, me vargje që kanë si epiqëndër më shumë arsyen se zemrën, por lirik dhe i dashur, i dhembshur dhe i hidhëruar, me mërzitje të dukshme për braktisjen e madhe në mëshirën e njerëzngrenësve, gjithë stres dhe ankth, por edhe besim e shpresë shtrënguar mes dhëmbëve*”¹³⁷.

¹³⁶ Μιλίωνης Χρ., gaz. Καθημερινή, f. 30, dt. 6 mars, 1994.

¹³⁷ Qiriazatis F., Gaz. «Νέα εστία», 25.12.1994.

Motivet e traditës popullore, ashtu si dhe vargu klasik popullor trembëdhjetë apo pesëmbëdhjetërokësh, marrin një vlerë të re artistike, gjithmonë, duke u aktualizuar në përmbajtje. Zarballas kërkon të “fshihet” pas këtyre formave për të qenë sa më alegorik në kumtimet e tij të ndaluara për kohën.

Andreas Zarballas nuk kujdeset vetëm për vargun. Kujdesi i tij më i madh është te mesazhi që do të transmetojë. Do që të jetë sa më i saktë, më i plotë dhe më i thellë e i gjerë.

Krijimi i uniteteve poetike me një tematikë të caktuar, por dhe me një mesazh sa më të gjërë, jo me poema të gjata, por me poezi sa më të shkurtra (krejt ndryshe nga Kacalidha) mbetet një karakteristikë tjetër e poetit.

Brënda këtij kuadri ai krijon simbolikën e vet, e cila jo në pak raste është shndërruar në simbolikën e poezisë së krijuesve të tjerë minoritarë grekë. Marrim këtu si shembull ngarkesën emocionale dhe simbolike që fitoi në krijimtarinë e tij togëfjalëshi “*vendi ynë*”, i cili kthehet në sinonim të kategorisë estetike të hapësirës, topos-it, njëkohësisht, e pashkëputur nga kategoria tjetër, koha - hronos.

Ngarkesa emocionale shtohet edhe më po të kemi parasysh kushtet kur përdorimi i fjalës Greqi dhe emrat apo mbiemrat e prodhuara prej këtij emri “*ishin të ndaluara*”. Për pasojë duhej krijuar një nocion i ri për të përcaktuar përkatësinë etnike. Dhe u gjet nocioni «*ο τόπος μας*», (“*vendi ynë*”), për të përcaktuar, si atdheun e veçantë të poetit dhe në vijim të të gjithë të tjerëve, ashtu edhe marrëdhëniet me Greqinë, por edhe dallimin nga atdheu i përbashkët “*socialist*”.

Po ashtu përmendin simbolet e shamive dropullite, të pemës dhe të rrënjëve etj, gjë për të cilën ia vlen t’i kushtohet vëmendje më e gjërë.

Të gjitha së bashku përbëjnë të veçantën për Zarballan, - etnotipin e tij për Minoritetin Etnik Grek.

X.2. Kronotoposi i mitologjisë së tij poetike

Zarballas nuk nguron të afirmojë, se e tashmja dhe ardhmja e ka zanafillën te një moment substancial të së shkuarës dhe zhvillohën si përjetim riciklues i këtij realiteti, si gjithëkohshmëri e etnotipit. Bëhet fjalë për një dinamikë të brëndshme të kësaj kohe, si shëmbëlltirë të përjetësisë, siç e përckaton Barthes, e cila identifikohet në një hapësirë mbartëse të simboleve, metaforave,

arketipave, heronjve, miteve të çmitizuar apo dhe të krijuar rish-tazi si mitizim të historisë, apo dhe si rimitizim i miteve për të udhërrëfyer historinë. Lidhet me një antropomorfozim të natyrës dhe të historisë në funksion të kumtit letrar dhe etnotopos-it.

Gjithçka duket se merr shkas nga një konstatim i subjektit poetik. Evidenton me dhimbje një të çarë, një krisje midis hro-notoposit të bashkëkohësisë së tij dhe atij të së kaluarës dhe kjo, sipas tij, vë në rrezik të ardhmen.

“...Vrasin gjyshërit tanë që vdiqën në shekuj / vrasin fëmijët ta-në që nuk kanë lindur akoma...”, thotë poeti tek poezia “Pemë di-mri”, vëllimi “101 poezi për një grusht dhe”, fq. 31 dhe shton: “Si na vrasin kështu? / Dhe ne bëjmë sikur nuk dëgjojmë armë...” Për këtë angazhohet në rikrijimin e një realitet të ri marrëdhëniesh diakronike e sinkronike të topos-it të vet si udhërrëfyes të së ardhmës.

Gjithçka tek Zarballai ndodh dhe lëviz në një hapësirë -topos që nga ky këndvështrim përbën etnotopos-in edhe që serish është i gjithëkohshëm. Realizohet me sinkronizimin e të kaluarës me mjete estetike.

E kaluara në rastin e Zarballas, ndryshe nga Kadareja, është e identifikuar, e sigurt, e konsoliduar dhe e dobishme për të sotmen. (Kadareja e kërkon këtë të kaluar të lavdishme për identi-fikim sa më të shquar të së tashmës dhe të ardhmës së etnotipit të vet). Lidhet me kthimin tek një truall po aq të identifikuar sa dhe të lavdishëm siç është Atdheu.

Tek Zarballai, ndryshe nga Çuka dhe Kacalidha, kjo e kaluar e dobishme funksionon në varësi komplementare me truallin e tij (topos-in), duke treguar që e shkuara bashkohet nëpërmjet ha-pësirës etnike (truallit, topos-it) me të ardhmen.

Në këtë pikë Zarballas u afrohet shumë poetëve grekë si Sollomos, Ricos, Elitis etj dhe ashtu si ata përpiqet të krijojë atë që thotë Elitis, mitin e ri të helenëve. Ka veçse një ndryshim.

Elitisi beson se miti aktual i bashkëkombasve ekziston dhe mjafton “pak zemër të mirë dhe të çlirë” që të të evidentohet. Zarballai kërkon ta krijojë atë dhe lëkundet midis pesimizmit dhe optimizmit, shpresës dhe zhgënimit. “Mos flisni! Heshtje, mos bërtisni! Vurgu ëndërron një tjetër Lefter¹³⁸.” - thotë Zarballas

¹³⁸ Fjala është për heroin e popullit Lefter Talio i cili konsiderohet njeriu vizionar i Minoritetit Etnik Grek në kohën e Luftës së Dytë Botërore.

X.3. Topos-i

Thamë se subjekti poetik i Zarballait lëviz në një plan hapësinor të identifikuar, përshkruar si «ο τόπος μας», (“vendi ynë”). Në këtë aspekt Zarballas dhe Kacalidhas nisen nga i njëjti koncept i ngushtë gjeografik i veprimit të subjektit poetik. I pari e barazon me fshatin e lindjes, Leshinicën. I dyti është pak më i gjërë. Gjeografia e lëvizijes së unit të tij janë “*pesë male*”, “*dy fusha*”, “*tre lumenj*”. (“101 poezi për një grusht dhe”, fq. 78).

Në poezinë e Zarballas, interesante dhe njëkohësisht domethënëse mbeten marrëdhëniet e subjektit poetik me “*topos-in*” e tij realizuar nëpërmjet një metafore, të përsëritur e të qëndrueshme deri në simbol. Metafora në fjalë realizohet nëpërmjet pëmës. Në mitin e tij poetik ajo përfaqëson vet subjektin poetik ose njeriun në përgjithësi. Thotë poeti: “...*Në malet e tij (topos-it) jam shkëmb, në pyje jam pemë...*”(po aty, fq.100) dhe vazhdon “...*Në më zëntë në rrugë stuhi a rerebesh/ më ngre përpara një pemë për çadër...*” (po aty fq.101).

Në poezinë “Erë”, (po aty, fq.44) në përpjekje për të na treguar raportet metaforike midis njeriut dhe elementëve natyrorë na bën një klasifikim interesant të këtyre marrëdhënieve. Pema mund të shkulet si njeriu, por njeriu mund të tkuret por nuk shkulet (!!):

*“Sonte, dhe malet do të përkulen si pemet.
Pemët do të shkulen si njerëzit.
Njerëzit mblidhën në heshtjen e tyre si kërmij...”*

Në poezinë “Pllatovuni nën dëborë”, Zarballai rimerr elementin e pemës/ve nga legjenda-miti i plakut që vret kuçedrën e ujit për të krijuar mitin e tij të ri, të raportit të brezit të poetit që nuk po kryen ende detyrimin ndaj topos-it atdheut të vet:

*“Sot Pllatovuni
i ngjan si një fije e pafund letre të bardhë
me të dy rreshtat e pemëve si vargje pesëmbëdhjetërokëshe
dy vargje të zvargura si klithma e kuçedrës
në çastin e djegjes.
Letër e bardhë e pashkruar Historia e brezit tim
dhe ne akoma asgjë!
Nuk shkrojtëm akoma dy vargjet për kuçedrën e re
si dy rreshta me pemë
në faqën tjetër të historisë tonë të hidhur.”*

(po aty fq 41).

Funksionet poetike e estetike të pemës tek mitologjia poetike e Zarballait lidhën me funksionet e saj si monument kulturor natyror në jetën tradicionale popullore dhe që në analizë të fundit na çon tek raportet e këtij monumenti natyror me civilizimin e Orakullit të Dodonës. Pra, siç e thamë kemi kalimin nga realiteti (funksionet e pemës në jetën primitive) tek miti, (orakullit i Dodonës), nga miti te realiteti, (funksioni i pemës në organizimin e strukturës tradicionale të jetesës, duke ruajtur ose duke fituar elemente dhe përmbytje kulturore) dhe nga ky realitet tek materia poetike (miti letrar). Personifikimi i pemës në aspektin e lidhjes me tokën sjell në mënyrë organike dhe të pazgjidhshme antropomorfizimin e tokës - toposit në kuptimin e atdheut.

“Ullinjtë tanë nuk janë pemë.

Janë gjyshërit tanë.

Të rudhosur.

Shekullor.

Nuk kanë ndërmend të ikin nga kjo jetë.

Rrënjët janë duart e tyre.

Duar të ashpra dhe të gjata

që futen thellë në tokë

të mbajnë dheun....”

(po aty, fq.19.)

“...Dhe durimi ynë bëhet rrap i ngulur thellë bri brigjeve të lumënjve/ krenaria qiparis dhe bredh në pllajë...” nënvizon tek poezia, “Dhe ne këmbëngulim”, po aty fq.28.

Funksionin e shumëfishtë në realitet të rrënjës së pemës në raport me tokën, e takojmë edhe në poezinë e Zarballait. (Dihet se nëpërmjet rrënjës pema merr ushqim nga toka dhe rritet. Në raport të drejtë me thellësinë e rrënjëve pema siguron qëndresën lart mbi tokë. Po ashtu rrënjët mbajnë tokën, e mbrojnë nga erozioni dhe rreshqitjet.) Në këtë aspekt, miti poetik i Zarballas na shpalos dy motive kryesore kundërshtuese. Shkuljen dhe rrënjosjen (në konceptin e të mbajturit të tokës rreth rrënjës). Le t'i trajtojmë këto motive tek poezia “Një pemë” marrë nga vëllimi poetik “Djemtë e Diellit”¹³⁹ fq. 64.

“Perreth kasollës, arat janë të huaja,

përreth arave të huaja kopetë

¹³⁹ Duhet theksuar se në vëllimin poetik “101 poezi për një grusht dhe”, poeti ka përfshirë një numër shumë të madhë poezish të marra nga vëllimi “Djemtë e Diellit”, kuptohet pasi i ka ripunuar. Nuk kuptuam arsyet që pse kjo poezi nuk u përzgjedh nga poeti si një nga poezitë e tij më të mira.

*Një pemë, që mbillnin në oborrin tonë,
ishte që të mbeshteste bujku parmendën
të varrte drapërin
të ngjitej atje lartë në verë
të hidhte një frut të pjekur
në duart e femijës së vet.
Një pemë që mbillnim ishte që të mbroheshim të mos na
mirrte era.*

*E shkullnin edhe atë
dhe mbeste një grop e zbrazët në oborrin tonë,
dhe mbeste një një grop e zbrazët në shpirtin tonë
ku shkonte dhe mbinte marazi....”*

Poezia i referohet realitetit të para Luftës së Dytë Botërore, por ka fituar vlera gjithkohshmërie. Gjithëkohshmëria buron nga fakti se komuniteti që poeti përfaqëson, përjeton identitetin e vet etnik me dyshimin që buron nga dy faktorë.

Faktori i parë ka të bëjë me ndjenjën e shkëputjes forcërisht nga kombi am dhe me izolimin e dhunshëm nga kontaktet me të.

Faktori i dytë lidhet me reagimet për mbrojtjen e identitetit të vet etnik të (atdheut të tij të veçantë-topos-it) nga forcat asimiluese të politikave shtetërore apo dhe të faktorëve të tjerë të lidhur ngushtësisht me identitetin etnik të shumicës. Në këtë drejtim lidhja e njerëzve me tokën e atdheut të veçantë lidhet pazgjithshmërisht me çështjen e identitetit etnik.


Veshja estetike e këtyre raporteve realizohet nëpërmjet metaforës (simbolit) të pemës. Kjo ndodh kryesisht për shkaqe të përmendura më lart. Po të marrim pjesën e parë të poezisë së cituar, funksionet reale të pemës, lidhet me veçoritë e antropologjisë shoqërore të këtij komuniteti, në raport me të. Për këtë arsye, kur poeti na thotë se “*një pemë që mbillnim ishte që të mbroheshim të mos na mirrte era*”, duhet të kuptojmë domosdoshmërinë e lidhjes me tokën si mënyrë për të mbrojtur identitetin e veçantë etnik. Veprimi i kundërt shkulja dhe pamundësia për të rezistuar tregon pikërisht dyshimin deri në bindje se sheshimi dhe asimilimi i këtij identiteti përbën një qëllim të arritur nga ana e shumicës. Pra, kemi evidentimin e një force horizontale që vepron nga jashtë (një forcë shoqërore-shteti) me drejtim nga brënda (natyral-identiteti etnik është i natyrshëm) dhe një rezistencë vertikale nga poshtë (rrënjët) me drejtim nga lart (pema).

Këtu është momenti të theksojmë se edhe Kadareja e përdori me sukses metaforën e pemës për të strukturuar poemën

“Shqiponjat fluturojnë lartë”. Në të gjejmë kahje të njëjta forcash si tek Zarballai. Po ashtu me sukses dhe brënda logjikës së Zarballait e përdori metaforën e pemës edhe P. Çukas. Bile, në të njëjtin poezi (analizuar kur qe rasti), Çuka gërsheton dy motivet, lidhjen me tokën dhe funksionin e organizimit tradicional shoqëror. Kjo vërejtje nuk është e vlefshme për Niko Kacalidhën.

Po ashtu, A. Zarballas na tregon se elementët estetike natyrore në poezinë e tij kanë një qëndrushmëri dmth përdoren me vlera të pandryshueshme dhe që burojnë nga vet natyra e elementeve të natyrës, (Dielli, hëna, pema etj). Kjo e afron Zarballan me poetët grekë si Sollomos, Seferis, Siqelianos, Elitis, Riccos, por jo me Kacalidhën.

Këto raporte, ose këtë konceptim të subjektit poetik me topos-in e tij do të mund ta paraqisim grafiksht si më posht:



T'i analizojmë me radhë këto raporte.

E kaluara. Përbën paradigmën e shndritshme në diakroninë historike. Bëhet fjalë për një strukturë arketipesh të konsoliduara, të krijuara gjatë një hronotoposi që i kapërshen kufinj të kohorë të historisë, që udhërrëfente bartësit e tyre në çdo perspektivë historike. Kjo hapësirë diakronike përfshin si kozmosin panhelenik, ashtu edhe botën lokale «ο τόπος μου», vendin e veçantë të subjektit poetik. Na vjen nëpërmjet metafizikës së perëndive mitologjike dhe perëndisë dhe shënjtoreve kristianë, heronjve mitikë, të legjendave dhe të këngëve popullore si dhe arketipeve që ata krijojnë në marrëdhënie me hapësirën dhe kohën në gjithëkohshmërinë e hronotoposit të atdheut. Gjeografia në kohë e këtyre faktorëve është tepër e gjërë dhe rimirret si kumt për aspekte të ndryshme të bashkëkohësisë së subjektit poetik.

Në poezinë “Jemi edhe ne”, fq. 7, mjafton vetëm vargu “Atëherë ishte që u pre akoma edhe një kordë në lirën e Homerit”,

për të na dhënë gjithë ndjesinë e subjektit poetik për padrejtësinë e vendosjes së kufijve.

Në poezinë “Automjeti me nr 11”, po aty, fq.10, vargjet, “*Nga koha e Minotavros na ngarkojnë një nga një/ dhe na çojnë të ushqejnë Vdekjen.*” na çojnë tek kultura antike e Kretës. Miti i Minotavros, jeta e të cilit ishte lidhur me vdekjen periodike të të rinjve, që i duheshin për ushqim, na sjell përmasat e sakrificave të anëtarëve të komunitetit që përfaqëson subjekti poetik në kohën e diktaturës.

Në poezinë “Limani”, fq. 12, Prometeu i bashkëkohësisë së subjektit poetik nënvizon shkallën e shpërftyryrimit të dinjitetit njerëzor nga diktatura. Në poezinë “Tezgjahu” miti poetik krijohet mbi arketipin e durimit të Penelopës, por edhe të baladës popullore.

Në poezinë “Korfuzi”, fq. 15, dërrasa e dëshiruar nga barka e Odiseut mjafton për të na kumtuar këmbënguljen për të arritur te atdheu mëmë.

Poezia “Butrinti”, fq. 17, ka brënda arkitekturën e një qyteti antik me “*heronj*” – statuja që po humbasin në kohën e subjektit poetik lavdinë e tyre të lashtë në betejën me vdekjen e kohës së tij. Në poezinë “Jashtë në oborre” prania e sfinksit, mjafton për të kuptuar heshtjen e prindërve të brezit të subjektit poetik.

Emri Thermopiles tek poezia “Deti”, fq. 20 mjafton për të kumtuar mesazhin se fitoren e percakton e drejta dhe trimëria dhe jo madhësia e forcës.

Në poezinë “Mbledh gjakun”, fq. 22, na shfaqet Dhimo i baladës popullore që mbledh gjakun e së dashurës për t’u treguar pesë vilajeteve fajin e tyre në lidhje me fundin tragjik të kësaj dashurie. (Paralelisht subjekti poetik kërkon të çojë gjakun e mbledhur të vendit të tij dhjetë vendeve në Evropë.).

Në poezinë tjetër, “Dhe gjaku nuk duket”, fq. 23, shtëpitë e topos-it të tij janë ndërtuar në “*luginën e Frikës*”, (sipas mitologjisë Perëndia e Frikës).

Në poezinë “Presin pyjet tanë”, fq. 25, e vërteta absolute e mitit lidhur me qimen e Samsonit, i jep mundësinë poetit të krijojë mitin e tij te bindjes tek shpresa. Emri i djalit të vet tek poezia “Paridi”, fq. 30 na çon te arketipi i rembimit të gruas së bukur.

Dhe kështu me radhë do të gjejmë mitologjinë e lashtë greke, baladat dhe legjendat e topos-it të subjektit poetik, shën Kozman, shën Merinë, kalorësin e vrarë në fushën e Dropullit, pemët që rrinë kaçaku i revolucionit grek Thanasis Dhjakos me ka-

pedanin e Vurgut i dy luftrave botërore Thimjo Loli, etj. (Do t'i rikthehem këtij fenomeni edhe kur do të flasim për hronos-in)

Atdheu. Përbën privimin e madh të subjektit poetik. Subjekti poetik vë në përpjestim të zhdrejtë shkëputjen nga atdheu mëmë me mungesën e ndjenjës oqeanike të harmonisë me përmasa kozmike tek pjesëtarët e komunitetit të tij. Megjithatë aspirimi i atdheut nga subjekti poetik përbën thelbin e mitologjisë poetike të A. Zarballas në raport me të (atdheun mëmë).

Poeti është e vërtetë se konstaton problemin tek vendosja e kufijve, por, për të, privimi absolut vjen nga mbyllja hermetike e këtyre kufijve dhe humbja e çdo kontakti me atdheun mëmë. Këto raporte të kundërtash përcaktojnë dhe tragjedinë e topos-it të subjektit poetik.

Zarballas në konturimin estetik të këtyre raporteve aktivizon me një dinamikë dhe filozofi të re mesazhet nga e kaluara të përmendura më lart. Niset nga momenti i realitetit, “*këshillohet*” me ndërgjegjen e koduar të identitetit kolektiv të dhënë përmes simbolikës, miteve dhe metaforave të veta, aq të njohura dhe rikthehet te realiteti i tij me mesazhet poetike të siguruara nga kjo trashëgimi kolektive, por duke shtuar elemente poetike të veta. Në këtë terren artistik poeti krijon simbolikën e topos-it të tij, që herë mes sakrificash, e herë në mënyrë pasive, aspiron atdheun mëmë. Kështu poeti duke parë shamite e bardha të dropulliteve që bëjnë një përjashtim në të gjithë veshjen e Jugut, i kthën ato së bashku me topos-in –Dropullin në një anije simbol që pranon sfidën e vdekjes së diktaturës komuniste dhe shkon drejt atdheut:

“Shamite dropullite janë vela të bardha.

Dhe Dropulli lundron. Merr zvar spirancën. Zvar kavot që e lidhin në limanin e huaj.

I vështirë udhëtimi.

Valët që ngrë Perëndia e Tmerit janë male.

Çdo ditë rrezohën udhëtarë

Por velat mbesin të bardha. Nuk u nxinë

as në detin e kurbetit,

as në ngushticat e vdekjes,

as në mesin e detit të rrobërisë. Asnjë Thisea

nuk udhëton me këtë anije.

Dhe Dropulli lundron

me velat plot bardhësi të hapura përballë erërave.

Shkon drej Atdheut.”

“Τα δροπολίτικα μαντίλια είναι άσπρα Πανιά

*Και η Δρόπολη αρμενίζει. Παίρνει σβάρα την άγκυρα.
Παίρνει σβάρα τους κάβους
που τη δένουν εδώ στο ξένο λιμάνι.
Δύσκολα το ταξίδι
Τα κύματα που σηκώνει ο Θεός Τρόμος είναι βουνά.
Κάθε μέρα πέφτουν επιβάτες.
Μα τα πανιά μένουν άσπρα. Δεν μαύρισαν
ούτε στο πέλαγος της ξενιτιάς,
ούτε στα στενά του χάρου,
ούτε καταμεσής στη θάλασσα της σκλαβιάς. Κανένας Θησέας
δεν ταξιδεύει με τούτο καράβι.
Και η Δρόπολη αρμενίζει
με όλα τα κάτασπρα πανιά της ανοιχτά στους ανέμους.
Πάει για την πατρίδα.”*

(Po aty, fq.51.)

Tek poezia “Gjithë natën”, po aty, fq. 21, atdheut qaset tek subjekti poetik në endrrën e tij. Poeti nënvizon këtu idenë se atdheu nuk është thjeshtë një gjeografi, por kozmos i vendosur midis hapësirës dhe kohës; ekziston si një “komunitet produkt i fantazisë”, siç e përcakton Andersoni, individët e të cilit nuk njihën midis tyre por janë të bindur për ekzistencën e karakteristikave që i bashkojnë. Autori nënvizon gjithashtu se as në endërr aspirata nuk ka fat.

“Gjithë natën

atdheu ishte kaq pranë meje sonte!

Fillon poezia dhe mbaron:

“Gjithë natën

hëna mbeti e gozhduar në qiell.

Dhe kishte një rreth të verdh përçark

si syri që nuk fle gjumë.”

Ndjenja e privimit merr një përmasë tjetër kur poeti pohon se “Nuk e dinim atëherë, djem të rinj, se përjetësia fillon tek atdheu./ Nuk dinim akoma se ne nuk kishim atdhe.” (Po aty, fq. 59.)

Raporti i marrëdhënies së subjektit poetik me atdheun rrit amplitudën e dramacitetit në poezinë “Limani”. (Po aty, fq.12.) Subjekti poetik ankohet për indiferentizmin e atdheut ndaj tyre.

Në detin, që në një rast të tillë i ngjan një fushe ku mbin “vetëm lulja e shkretëtirës”, vjen më të rrallë ndonjë anije dhe ikën pa përshëndetur, thotë poeti. Mungesa e kësaj përshëndetjeje bëhet më e rëndë kur harron “neve, të gozhduar në shkëmbinj/ pa qenë askush nga ne Prometeu.” Pra kur në topos-in e tij shteti

diktatorial i do njerëzit të lidhur edhe kur nuk paraqesin asnjë rrezik për të.

Të njëjta raporte na shpalos edhe poezia “Korfuzi”, po aty, fq. 15. “Lutja” e subjektit poetik që “Kurfuzi” të afrohet bëhet se ai nuk mundet pasi, “...*Vite me radhë një grykë pushke na merr shënjë jetën drejt e në ballë/ dhe ne nuk mund të lëvizim/...*”. Poeti në asnjë rast nuk mohon dashurinë dhe aspiratën për atdheun, ashtu siç është i sigurt se kjo nuk do të ndodhë kurrë. “*Ç’më mbete mor i shkretë Korfuz/ Anije e prraruar në det të hapur?*”, do të konkludojë poeti në fund të përgjërimeve ndaj Korfuzit që “s’afrohet”.

Të tjerët. Subjekti poetik nuk niset thjesht nga parimi i lashtë se që të njohësh më mirë vetën duhet ta ballafaqosh me të tjerët, më ata që s’të duan, kundërshtarët, armiqtë. Madje duket se nuk i duhet kjo risi. Nuk ka kohë për të dhe nuk është se nuk e njeh topos-in e tij. E njeh ashtu siç njeh edhe të tjerët dhe i numëron: *Historia që kaloi në topos-in e tij si egërsirë dhe preu një kordë tjetër nga lira e Homerit.* (fq. 7) *Ata që vijnë të mbolasin (shartojnë) gjuhën tonë.* (fq. 80) *Ata që i morrën barba Thodhorit tokën dhe ai u çmend.* (fq. 35)

Por mbi të gjitha është diktatura komuniste. Numri “101” në titullin e vëllimit që po analizojmë, lidhet me shprehjen aq shpesh të dëgjuar në minoritet për dënimet e rënda, deri kapitale, të gjykatave komuniste në dëm të minoritarëve grekë. Atëherë doli nevoja e një tabuje. Tabuja ishte “U dënua më 101”, dmth, u dënua me 101 vjet burg. Pra, nuk kishte më shpëtim për të dhe liri për familjen e tij. Kjo skenë vizatohet drithëruese në poezinë me titull “Automjeti me Nr.11”. Fjala është për numrin (targën) e “gazit të degës së punëve të brëndshme” të rrethit të Sarandës. Në atë kohë të gjithë e dinin se kudo që kjo makinë shfaqej do të ndodhte arrestimi i radhës. Poeti për ta bërë më të frikshme këtë gjëmë e vlerëson atë nga këndvështrimi i fëmijëve, të cilët në vend që të gëzoheshin se shikonin një makinë, siç do të qe e natyrshme për atë kohë, shprehën në emër të subjektit poetik.

“Makina me Nr. 11 lëron fshatrat tona

Nga pas

Lë dy vragë paralele

Plot hieroglifë

Këtë shkrim e njohim.

Eshtë i vdekjes”

“Το αυτοκίνητο Αριθ.11 αλωνίζει τα χωριά μας

Πίσω του

*αφήνει δύο παράλληλες γραμμές
γεμάτες ιερογλυφικά
Αυτή τη γραφή τη γνωρίζουμε
Είναι του θανάτου...*

(Po aty, fq. 10.)

Kjo skenë e përsëritur solli pasojën deformuese të njeriut. Nga njera anë “Shtettrrethimin”, po aty, fq. 70, ku subjekti poetik pranon se vlerat e tyre nuk janë të sigurta as kur janë të mbyllura thellë në zëmër.

*“Të gjitha i mbyllem në zëmrat tona...
Siguruam mirë portat.
Por, këmbëngulin t’i shpërthejnë si kështjellat e vjetra
Në vend të shkallëve dhe topave
kanë veshin e spiunit.
Bile dhe të mikut/ bile dhe të vëllait...”*

Solli nga ana tjetër,

*“Kur na thanë se i vranë
ne shpërthyem në duartrokitje të stuhishme.
Qëndruam shumë kohë
në këmbë
duke duratrokatur për vdekjen...”*

(Po aty, fq. 34.)

Solli madje edhe vetizolimimin dhe fatalitetin e subjektit poetik.

*“Mbyll frikshëm portën
dhe le jashtë botën si një qën të zi
botën që më ndoqi gjithë ditën
që më ndjek gjithë jetën
... Por nuk mund të rri i mbyllur përgjithmonë
Dikur do të dalë
dhe një ditë, e di, do t’më hajë.”*

(Po aty, fq.11.)

Ose,

*“Nuk dal tek dera e lavdisë
... Vetëm tek pragu i shtëpisë së vjetër dal
Ku të shkoj?
Asnjë derë nuk më pret.
Përpara pragjeve frika hapi kanale të thella
si atëherë
rreth kullave mesjetare*

*...Në portën e shtëpisë sime mbështetem.
Prapa meje është një zë. Që ngjitet nga themelet..."
(Po aty, fq.52.)*

Dhe të gjitha këto pasoja nënvizojnë faktin se faktori i tretë kundër topos-it të subjektit poetik ishin vet njerëzit e tij.

Në rafshin e kësaj mitologjie poetike subjekti poetik përjeton dramën e tij që buron nga fakti i njohjes së thellë të topos-it të tij dhe pamundësisë për të vepruar, aq më keq për ta ndryshuar. Kjo dramë e thellë shpaloset si një privim i gjërë. "*Jeta këtu është e hidhur, -thotë poeti,- por dhe vdekja akoma më e hidhur*", (po aty, fq. 7). Përmasat e kësaj drame jipen në poezinë "*Natë dimërore*" (po aty, fq. 46). Paradigma përbëhet nga detaje home-rike që vendosen në një sintagmë surrealistike.

*"Nata sterë e zezë,
e goditur nga rrufeja
shtrirë në arkivol.
Veshur në të zeza retë
qajnë mbi të.
Një yll që u skërmit tutje horizontit
i ngjan qiririt te koka e arkivolit.
Një pikë shiu jashtë në llamarinë
mban ritmin e një melodie mortore
Çfarë shtyn era me duart gjigante
arkivolin e natës
apo të vendit tim?"*

Poeti përshkruan duke numëruar elementët natyrorë që marrin pjesë në një ceremoni mortore e përmasave gjigante. Natyra kurrë nuk mund të jetë më e zezë dhe më e kobshme se aq. Komenti i ardhur në fund të poezisë me një paralelizëm midis arkivolit mortor të natës dhe të vendit të tij, nuk lë vend për analiza të tjera pesimizmi dhe privimi.

Vjeshta, shiu, nata kanë rol absolut në dhënien e gjëndjes së privimit të subjektit poetik. Agim dhe ..."*Ikën nata nga supet e natyrës/ strehë gjen në zëmër/...*" (Po aty, fq. 48). Karakteristikë e tyre mbetet statizmi i cili mbërthën edhe jetën.

*"U thashë mirëmbërëma mbrëmë varreve
ishite natë dhe gjethet binin.
Nuk ka më jeta jonë dy kuptime
...Ndënë dhe edhe përmbi
të njëjtin puls do të kemi
...Mban mend nga mëngjesi ynë i parë*


vëlla kishim vdekjen...".

(po aty, fq. 29.)

Kulmin e vet ky privim e arrin tek poezia "E diel", (po aty, fq. 55.) Poeti fikson një moment përshpirtjeje për të vdekurit. Kontrastet që krijon pamja venë në pikëpyetje kuptimin e vet jetës.

*"Midis varreve tejet të bardha
të nxirra siluetat e zeza të grave vajtuçe
O zot
cila është më e bukur vdekja apo jeta?"*

Kaq është poezia. E vendosur në katrorin simiotik të Graimas vemë re se vetëm në boshtet diagonale çiftet vendosin marrëdhënie pohuese, ndërsa në ato vertikale dhe horizontale vendosin marrëdhënie kundërshtuese, që do të thotë se situata i largohet shumë logjikës së zakonshme normale.



Sipas kësaj analize simiotike për subjektin poetik e zeza nënkupton jetën dhe e bardha vdekjen. Kjo bën të mundur që e zeza të identifikohet tek e bardha dhe jeta tek vdekja.

Ky është në përgjithësi relievi i mitologjisë poetike të Zarballas lidhur me topos-in, apo me etnotoposin e tij. Karakterizohet, siç e pamë nga gjendja e privimit, pavarësisht se poeti bën aty këtu përpjekje për të venë një ekulibër midis pesimizmit dhe optimizmit. Fare lehtë mund të vihet re se përpjekja në fjalë është e mjaftë vetëm për të pohuar se shpresa nuk ka thënë akoma fjalën fatale.

Po ashtu duhet pohuar se gjendja e privimit është më shumë rezultat i gjëndjes së topos-it të tij, krijuar nga ballafaqimi i tre faktorëve përcaktues të thelbit të tij. E kaluara, atdheu mëmë, të tjerët. Jashtë këtij realiteti marrëdhëniesh poeti manifeston vullshëm një gjëndje plotmërie të admirueshme dhe njëkohësisht befasuese.

*"Dita ia shoqti kandilin edhe yllit të fundit.
Një zog kurdis kitaren përmbi pemë.
Dielli lahet në lumë.
Një lule than këmishën e vesuar*

tek teli i një rreze drite.

Mirëmëngjes, o botë, mërëmëngjese!

Sa mirëmëngjes do të të nis akoma”

(Po aty fq. 87.)

Ose,

“Burim, burim i Bistricës,

syri i vendit tim i kalter, ah i kalter!

Vetull jeshil të ri përmbi kurrora e pemëve

dhe bari përreth qerpiktë e jeshiltë.

Gjthmonë me dritë nga agimet, me dritë nga mesdita

gjithmonë i thellë dhe i kthjellët syri i vendit tim.”

(Po aty, fq. 94.)

Sollëm këto dy shembuj për të vërtetuar se kur subjekti poetik komunikon drejtpërdrejt me topos-in – vendin e tij, atëherë largon si me magji pesimizmin dhe natyra i jep mjetet e veta për të vizatuar e krijuar mitin e optimizmit e të plotmërisë.

Harmonia e natyrës dhe e mitit me realitetin krijojnë një simfoni të gëzueshme të poezitë “Lambri”, (Pashkët), “Djemtë e Diellit”, “Klarinet” dhe veçanërisht tek poemthat në fund të vëllimit poetik: “Hyj në vresht”, fq. 96 dhe “Udhëtoj në vendin tim”, fq. 100. Deviza e poetit është:

“Jam unë brënda vendit tim

apo ai brënda meje?

Dhe të dy jemi një.”

(Po aty fq. 100.)

Natyra dhe historia, natyra dhe traditat në një harmoni perfekte midis tyre krijojnë për subjektin poetik paraqsën mbitokësore.

X.4. Hronos-i

Hronos-koha e mitit të poetik të Zarballas është organisht e shkrirë me topos-in-hapësirën. Ashtu si nuk mund t'i ndash kohën dhe hapësirën në konceptin e atdheut, ashtu nuk mund të ndash hronotopos-in tek mitologjia poetike e Zarballas. Çdo ndarje bëhet thjesht për arsye metodike.

Në hronosin e Zarballas përfshihën, si bashkëkohësi, ngjarje, data, emra që kanë vepruar në kohë dhe periudha të ndryshme, para kohës së rrëfimit poetik. Kjo, thamë, e ndihmon poetin t'i japë mitit tij vërtetësi dhe substancialitet sa dhe mitet apo le-

gjendat. Të krijojë gjithashtu, ndjenjën e vazhdimësisë së natyrshme, e cila për shkak të krisjes të së tashmes me të kaluarën, mund të pengohet në të ardhmen.

Nga ana tjetër miti i tij nuk vendos me të shkuarën raporte shkak pasojë, pasi ai është i ndërgjegjshëm që shkak është vet aktualiteti i mjedisit të tij politik, shoqëror e kulturor. Referimi tek e shkuara kërkohet të funksionojë si kod sjelljeje për bashkëkohësinë poetike dhe për të ardhmen, të ketë aftësi komunikuese dhe marrëdhënieje harmonike me hronos-in e gjithëkohshëm.

Zarballas, si Kadareja arrin te ajo që Andersoni e quan "*Mbi-kohësi sinkronike*" ose "*parashikim profetik*". Kjo veti tek Zarballas, ashtu si tek Kadareja sigurohet duke evidentuar estetikisht atë që përbën vetinë e "*pushpjegueshme*" të letërsisë,- mbikohësinë (extemporality) e saj.

Në këtë këndvështrim Zarballas, ashtu si Kacalidha rimerr materien e shndritshme kumtuese të botës së miteve, sidomos të botës helene dhe atë lokale, (veçanërisht Zarballas) duke e sendërtuar atë në përshtatje të idesë së përbashkësisë integrale dhe të gjithëkohshme, me identitetin etnik. (Kacalidha e evidenton pjesën e dytë të pohimit tonë vetëm kur shkruan greqisht).

Ndryshe nga Kacalidhas që identifikon kohën e veprimit të mitit poetik me kohën e vet, pra një bosht horizontal, veprimi poetik tek Zarballai zakonisht, vetëm sa nisët nga koha e tij, një kohë e tashme-bashkëkohësi. Ky moment kohor rrëfen një moment të caktuar të gjëndjes së mitit poetik, që në përgjithësi i përshtatet gjëndjes së «*topos-it*» tonë, (vendit tonë).

Pavarësisht nga format kohore gramatikore të foljeve të përdorura, subjekti poetik e shtrin veprimin në të kaluarën historike dhe mitologjike, ose në infinit, me qëllim përcaktimin e së ardhmës. Bëhet fjalë për një kohë në hapësirën e identitetit diakronik të mitologjisë poetike të A. Zarballas. Në këtë kuptim e tashmja e subjektit poetik shërbën si pikënisje për të tashmen e gjithëkohshme të Zarballas. Kjo bashkëkohësi e gjithëkohshme ka dy dimensione të tjera. Njera ka kahje nga e kaluara (*tani-këtu vs poshtë-atëherë*). Tjetra nisët nga pika e skajshme e së shkuarës për të pikësnyuar të ardhmen. (*Poshtë-atëherë vs tani-këtu vs lart-pastaj*).

Hallkë ndërlidhëse midis tyre mbetet ndërgjegja, botëkuptimi ose ideologjia e subjektit poetik, e cila gjendet vazhdimisht midis dy kategorive përcaktuese të gjëndjes së tij: *Realitetit* dhe *Mitit*. Subjekti poetik lëviz dhe vepron vazhdimisht për të arritur harmonizimin e këtyre dy kategorive. Kur ia arrin dhe kjo konstatohet kur i drejtohet të shkuarës (*poshtë-atëherë*), subjekti poetik kara-

kterizohet nga plotmëria. (Siç e treguam kur folëm për topos-in, as kjo nuk ndodh gjithmonë). Dhe e kundërta, kur niset nga e tashmja për të parë të ardhmen subjekti poetik paraqitet i dyzuar, shfaq hapur mosbesim dhe dyshim dhe karakterizohet në përgjithësi nga gjendja e privimit ekstrem.

E konkretizojmë skemën e përshkruar me dy shembuj nga vëllimi poetik që po analizojmë:

“Sot Pllatovuni

*i ngjan si një fije e pafund letre të bardhë
me të dy rreshtat e pemëve si vargje pesëmbëdhjetërokëshe
dy vargje të zvargura si klithma e kuçedrës
në çastin e djegjes.*

*Letër e bardhë e pashkruar Historia e brezit tim
dhe ne akoma asgjë!*

*Nuk shkrojtëm akoma dy vargjet për kuçedrën e re
si dy rreshta me pemë
në faqën tjetër të historisë tonë të hidhur.
Akoma asgjë!*

(Σήμερα το Πλατοβούνι

*είναι σαν μια απέραντι, κάτασπρη κόλλα χαρτί
με τις δυο σειρές τα δέντρα σαν στίχοι δεκαπεντασύλλαβοι
δυο στίχοι μακρόσυρτοι σαν η κραυγή του στοιχειού
την ώρα που καιγόταν.*

*Αγραφή κόλλα χαρτί | Ιστορία της γενιάς μου
κι εμείς ακόμα τίποτα!*

*Δεν γράψαμε ακόμα τους δυο στίχους για το νέο στοιχειό
σα δυο σειρές με δέντρα
στην άλλη σελίδα της πικρής ιστορίας μας.
Ακόμα τίποτα!)*

“Njëqind poezi për një grusht tokë” fq. 41

Dhe

“Rufisin shiun pllajat, pemët dhe ullinjtë

pinë fshatrat edhe varret


....Pi vendi im verën e vjeshtës

dhe brënda tij u zgjuan, lëvizën rrënjët.

...Do të rezistojmë them!”,

po aty, fq. 47

Grafikisht këtë mënyrë funksionimi të mitit poetik të A. Zarballas do të mund ta paraqisim:



Çfarë është e **tashmja ose bashkëkohësia e gjithëkohshme** e Zarballas. Është një e tashme tridimensionale e realizuar përmes së tashmës. Nuk ka shumë vlerë gramatika e gjuhës. Për subjektin poetik ka rëndësi të theksojë se në çdo të tashme dhe të ardhme ka rol dhe funksion e shkuara, një e shkuar që ka të mishëruar në një, hapësirën dhe kohën dhe vjen në të tashmen si mesazh i çkodifikuar për të orientuar të ardhmen.

Poeti e realizon këtë duke gërshetuar mjetet gjuhësore me intertekstin si ripërtëritje arketipi dhe intertekstin konfiguracional. E konkretizojmë me dy shembuj. Titulli i poezisë së parës është: “Tezgjahu”, (αργαλειός) fq. 13.

*“Herë-herë,
sa shikojmë që soset durimi në shtambën e shpirtit
si uji në behar
një nga një
e shumta dy nga dy
zbrësim deri poshtë te bregu i detit.
Pak më poshtë se deti ynë
pak më tutje se deti ynë
është Itaka.
Rimë mbi shkëmbinj të bregut
dhe kudrojmë valët
dhe dëgjojmë valët
që sjellin mbi kurriz atë të thjeshtin tak-tak*

*atë të thjeshtin tuk-tuk
të tezgjahut të Penellopës.
Rimë mbi shkëmbinjtë e bregut
derisa shtamba e shpirtit/ të mbushet sërish me durim?"*

Nga pikëpamja gramatikore (gjuhësore), asnjë folje nuk është në kohën e shkuar. As në të ardhmen. Mjaftuan tri elementë nga mitologjia, (Itaka, Penelopa dhe tezgjahu, që në një farë mënyre formësojnë arketipin e durimit) për të vendosur një marrëdhënie intertekstuale midis së tashmës së subjektit poetik dhe të kaluarës mitologjike. Kjo marrëdhënie nisët nga nevoja e subjektit poetik për të vendosur një lidhje me një mesazh të caktuar-pritjen, durimin, rezistencën, mesazh për të cilin ka nevojë subjektit poetik ta përdorë si ushqim shpirtëror në të tashmen dhe në të ardhmen si vijimësi dhe në mënyrë të përsëritur. Kjo nevojë përcaktohet nga trysnia që ushtrohet nga një forcë e padeklaruar, por e nënkuptuar, shteti-monist (kultura), kundër unit poetik. Ajo prish ekuilibrin midis unit poetik dhe identitetit të tij të dhënë në mënyrë të natyrshme, (natyra). Uni poetik nuk ka mundësi të reagojë në mënyrë aktive, (si në traditën popullore) dhe kjo gjë ndje prodhon tek ai një dramë që e deheroizon duke shkaktuar gjëndjen e privimit.

Poezia e dytë mban titullin "Ullinjtë tanë", po aty , fq.19.

Ullinjtë tanë nuk janë pemë. Janë gjyshërit tanë.

Të rrudhosur.

Shekullor.

Nuk kanë ndërmend të ikin nga kjo jetë

Rrënjët janë duart e tyre.

Duar të ashpra dhe të gjata

që futen thellë në tokë

të mbajnë dheun

Shtrengojnë rreth e qark fshatrat. Si atëherë

....si dhe tani

se mos rëntë të fryjnë erërat e marrin gjuhën tonë

se mos rëntë të flasin fshatrat gjuhë tjetër

që nuk e kuptojnë ullinjtë.

Ullinjtë tanë nuk janë pemë. Kur ikim

dhe kur kthehemi

kalojmë midis gjyshërve...

... Rruga jonë kalon midis ullinjve."

Në këtë poezi e "shkuara", miti ka një natyrë tjetër. Identifikohet te binomi gjysh-ulli. Gjyshi-njeri (i moshuar) që në traditën

dhe praktikën popullore mbart përvojën dhe mençurinë. Ulliri – natyra, krahas cilësive të tjera që e fisnikërojnë në marrëdhëniet me njeriun, identifikohet me gjyshin, faktorin njeri dhe në kuptimin metaforik i shton atij jetëgjatësinë e vet. (Ulliri vjen nga shekuj dhe nuk dihet destinacioni në të ardhmen - gjyshërit nuk kanë ndërmend të ikin nga kjo jetë). I jep rezistencën dhe lidhjen me tokën.

Gjyshi-shoqëria njehsohet me ullirin dhe i jep pemës-natyrë, ndërgjegjen-kulturën e duhur për të fituar rolin e mbrojtësit. Raporti *poshtë-atëherë* këtu ka trajta reale. (poshtë, toka ku shtrihen rrënjët - duart e gjyshërve; atëherë jetëgjatësia e ullirit dhe e gjyshit, për të cilët poeti gjen kohën të përvijojë edhe detaje të tjera unifikuese, siç janë rrudhat, shënjë vjetërsie për të dy elementët e binomit).

Ulliri i jep mundësi poetit, që bashkë me linearitetin vertikal të saj, që lidh nëntokën, tokën dhe mbitokën, të jap edhe aspektin tridimensional të kohës, (e shkuara, e tashmja, e ardhmja). Pra, vëmë re që gjithkohëshmëria e së tashmës në këtë rast realizohet nëpërmjet intertekstit konfiguracional. Kjo, për arsye se edhe në këtë poezi asnjë formë foljore gramatikore nuk i përket kohëve të së shkuarës. As të së ardhmës. Haset vetëm e tashmja, madje në kuptimin e parmë të saj. Ndihejmojnë procesin përdorimi i elementeve gramatikore kohorë (*si atëherë....si edhe tani*).

Në këtë poezi, ndryshe nga e para, kemi një harmonizim midis natyrës dhe njeriut. Kjo i jep subjektit poetik siguri (*Rruga jonë kalon midis ullinjve*) dhe mundësi për të kumtuar optimizëm, pra, një gjëndje plotmërie.

Eshtë momenti këtu të theksojmë se subjekti poetik, përse i përket gjëndjes së plotmërisë, apo të privimit në lidhje me atë që përbën themelin e mitologjisë së tij- Vendi ynë, «ο τόπος μας»- është i dyzuar. Dyzimi lidhet me aspektin e së ardhmës së fatit të tij ku optimizimi i subjektit poetik altermohet në pesimizëm, ndërsa e kundërta (siç e thamë kur folëm për topos-in) ose ndodh rrallë ose nuk ndodh fare. Gjithashtu kjo e ardhme përcaktohet nga e tashmja.

“Loja” me kohën bëhet për Zarballan instrumenti kryesor për të zgjidhur sipas ideologjisë së unit poetik marrëdhëniet midis mitit dhe realitetit, hronos-it dhe topos-it. Nëpërmjet një interteksti të dyfishtë sjell në bashkëkohësinë e tij (në funksion të gjithëkohshmërisë si ballafaqim dhe si nevojë për një shkrirje organike të së shkuarës me të tashmen, ose si harmonizim të mitit me

realitetin) arketipin mitologjik dhe arketipin e legjendave lokale si dhe traditën e këngës popullore.

*“Qyteti i Butrintit e kaloi pragun e vdekjes,
por u muar peng...”*

(Me kuptimin se trashëgimia e saj arkeologjike përdoret për të evidentuar identitete të tjera. shën. i yni).

*Luftëtarët e Butrintit janë invalidë
Dikush këmbën, dikush dorën, dikush kokën e la në betejën
me vdekjen.*

*Apoloni ka sytë e ulura
dhe Zeusi rri mbërthyer në mur, pa rrufetë e tij.
Në shkallët e amfiteatrit një grup të rinjsh
ndjekin tragjedinë moderne të rrëmbimit.
E ndjejmë.*

Duhet të durojmë vetëm hidhërimin e qytetit pengëmarrë.”
(Po aty. Fq 17.)

Analizojmë momentet: Vargu i parë na kumton se qyteti hyri në pavdekësi, por, (vargu i dytë) ai është marrë peng. Në fragmentin e dytë të cituar referimi metonimik tek luftëtarët bëhet nëpërmjet statujave, të cilët kështu siç janë, bëhen bashkëkohëse me unin poetik. Marrëdhënia metonimike e mësipërme, fiton më shumë natyrë metaforike, kur poeti na thotë se këta “luftëtarë” janë invalidë, jo për shkak të fitimit të lavdisë së tyre reale (*fituar atëherë-përjetuar si mit*). Por, në luftë “me vdekjen”- kohën, kushtet natyrore dhe shoqërore që duan t’u rrëmbejnë, apo t’u zhdukjin, apo t’u dedikojnë tjetërkujt lavdinë e tyre. (*tani- realiteti*). Pra miti dhe realiteti në këtë rast nuk kanë harmoni. Subjekti poetik ndjehet i privuar dhe e shpreh privimin me ndjenjën e hidhërimit dhe të braktisjes që e detyron të përballojë i vetëm këtë situatë.

Koha e veprimit është bashkëkohësia e subjektit poetik. Edhe në këtë rast foljet gramatikore janë të gjitha në të tashmen. Edhe foljet e dy vargjeve të para, që janë në të kryerën e thjeshtë ka kuptimin e kohës së vazhdueshme që vjen nga e kaluara në të tashmen me synim të ardhmen, gjë që i jep subjektit poetik të drejtën të kumtojë se kjo gjëndje do të vijojë të jetë dhe në të ardhmen pavarësisht nga rezistenca e tij pasive.

Tek poezia “Dhe ne këmbëngulim”, (po aty fq. 28), subjekti poetik ndërkaq në tekstin e poezisë një varg nga një këngë historike, për të evidentuar shpresën zhgënjyese në lidhje me fatet e topos-it të tij. Edhe këtu, nga pikëpamja gramatikore rrëfimi ndodh në kohën e tashme lidhja me të kaluarën bëhet nëpërmjet

një vargu këngeje popullore krijuar në një moment të caktuar historik si shprehëse e një situatë po të caktuar.

“...*Akoma këtë pranverë, akoma këtë behar...*”, është vargu popullor i ndërkallur në poezinë e këmbënguljes dhe të shpresës prej shtatë vargjesh. Historia e vargut është e thjeshtë. Në periudhën e formëzimit të shtetit-komb grek, banorët e këtushëm kultivuan shpresën se duhet të bënin pak durim (akoma këtë pranverë, akoma këtë behar), se “*moskovi*”–rusia, do të vendoste përfundimisht për bashkimin e tyre me kombin am. Nuk ndodhi.

Dhe në këtë mënyrë çvlerësohën vargjet e tjera “*optimiste*” edhe në këtë poezi.

“Dhe ne këmbëngulim

Dhe durimi ynë bëhet rrap i ngulur thellë bri brigjeve të lumënjve

krenaria qiparis dhe bredh në pllajë,

aspiratat trumze e mbirë gerxheve

shpresat tona, fshehur nën gurin e durimit

këngë e zvargur

“Akoma këtë pranverë, akoma këtë behar....”.

Folëm pak më lart për dinamikën e brëndshme të kohës-hronosit tek Zarballas përmes së cilës ai realizon gjithëkohshmërinë dhe thamë se ajo identifikohet në një hapësirë mbartëse të simboleve, metaforave, arketipave, heronjve, miteve të çmitizuar apo dhe të krijuar rishtazi si mitizim të historisë, apo dhe si rimitizim i miteve për të udhërrëfyer historinë.

Në këtë këndvështrim, poeti që t’i jap vërtetësi mitit të tij, por edhe vazhdimësinë e pretenduar, krijon subjekte mitike të përmasave mitologjike apo sipas traditës popullore. Këto na shfaqën herë si dëshirë (kur bëhet fjalë për të ndryshuar të tashmen).

“... Çdo ditë mendojmë për fshatarin e zgjuar.

Shumë vonon të duket me kafshën ngarkuar

në rrugën e brezit tonë...¹⁴⁰.”

(Po aty fq. 10.).

Dhe herë si realitet i kryer (kur bëhet fjalë për të stigmatizuar, ose përshkruar realitetin e tij të jetuar.) “...*Dridhën shtëpitë tona në luginën e Frikës...*”, thotë poeti tek poezia “Dhe gjaku nuk duket” fq. 23. Sipas logjikës së krijimit të faktorëve mitologjik në lashtësi, ai krijon elementët e tij poetik

“... Dhe Dropulli noton...

Valet që ngrë Perëndia e Tmerrit janë male

¹⁴⁰ Fjala është për legjendën e plakut me kuçedrën, analizuar në kapitullin e dytë.

*çdo ditë bien në det udhëtaret
... Asnjë Thisea nuk udhëton me këtë anije...*
(po aty fq.51.)

Në shëmbullin e dytë kemi krijimin e një perëndie, atë të Tmerrit, që bashkëvepron estetikisht me një hero real mitologjik, Thisean.

Poezia “Llambri” (Pashket), fq. 84, përbën një rast të veçantë që rrëfimi poetik është vendosur në të shkuarën. Miti i përket të ardhmës në formën e shpresës. Kjo arrihet nëpërmjet përdorimit të foljeve në kohën e ardhme nga ana e subjektit poetik që rrëfen në një moment të së shkuarës. Subjekti poetik shpalos shpresën se pas ndalimit të fesë, Pashkët do të rifestohen një ditë në vendin e tij. Poeti nuk është i interesuar të na thotë se kur do të ndodhë kjo gjë. Më shumë i intereson të na tregojë besimin se do të ndodhë. Për të realizuar këtë përdor kohën. Nëpërmjet saj afron momentin e festimit të Pashkëve. Paralelisht, ndihmohet nga afrimi i kendit të vështrimit mbi ngjarjen. Këtë e realizon duke përdorur sa më shumë folje dhe duke sjellë detaje të shumta nga këto festime. Poezia fillon: *“Dikur do të vijne Pashkët dhe në fshatrat tona...”*. Na njofton momentin e pritjes. Koha se kur do të vijne Pashkët është ende e papërcaktuar. Atëherë, vazhdon poeti në vargun e dytë, *“Dallandyshtet do të trohisin gërshërat për të prerë shiritin/ lidhur në dy ullinj të vjetër në qendrën e fshatit/...”*. Dha pas pak na njofton *“Pashkët sot!...”*. Rrëfimi pas kësaj vërtet pason veprime në kohën e ardhme, por ato kanë një denduri të jashtëzakonshme dhe keni i vështrimit afrohet shumë mbi to. Siguria e subjektit poetik se Pashkët do të vijne shprehet me vargjet *“... do të vemi nga varret/ t’u themi haberet e mira gjyshërve/...”* dhe nga *“dikur”* që kemi njoftimin e parë për ardhjen e Pashkëve, e mbyll poezinë duke na thënë se kjo *“dikur”* është afruar shumë, është bërë *“nesër”*.

Si fjalë e fundit për këtë shënim për A. Zarballan do të përmendim atë kërkesë të vazhdueshme ndaj tij për më shumë prodhimtari. Por me sa duket poeti i zhgënjyer nga zhvillimet që pasuan pas viteve 90’ po i lë gjithnjë e më pak vend letërsisë dhe merret me evidentimin ndryshe, të paktën, të historisë së “vendit të tij” në të gjitha drejtimet.

KONKLUZIONE

Në përfundim të monopgrafisë ndjesia që mbetet pas rishikimit të vazhdueshëm është se edhe pse the shumë gjëra, prapë je borxhli ndaj objektit dhe qëllimeve të përcaktuara. Megjithatë, midis gjërave që thamë mund të nënvizojmë si më kryesoret:

Tradicionalisht dhe në aspektin teorik është i vërtetë fakti se Letërsia në Minoritetin Grek në Shqipëri, përbën një realitet të pranuar nga të gjithë. Po ashtu, i vërtetë është dhe fakti që ky realitet është pranuar, herë si një fenomen i njohur që nuk meriton vëmendje e herë si “*tabu*”, vëmendja mbi të cilën shkakton kokëçarje. Kjo situatë bëri që faktorët e ndryshëm që kanë lidhje me të të kenë qëndrime të ndryshme për të njëjtin objekt.

Më e keqja është se këto qëndrime nuk kanë të bëjnë me thelbin e kësaj letërsie, natyrën dhe funksionin e saj. Pra, nuk ka përgjigje për veçoritë e saj si një letërsi kontakti i një treve. Nuk ka vlerësime për faktin se sa dhe si ajo ka krijuar individualitetin e vet, ose sa ka mundur ajo të luajë rolin e ndërmjetësit midis dy letërsive në kontakt dhe sa ka përfituar ajo vetë etj.

Këto shqetësime përcaktuan objektin tonë, për të arritur në konkluzionin se kjo letërsi lidhet me një trevë kulturore me veçoritë e veta. Krijuesit dhe bartësit e kësaj letërsie etnikisht i përkasin kombit grek si vazhdim territorial dhe politikisht shtetit shqiptar. Produkti letrar i tij u zhvillua në varësi të ngushtë me faktorët socialë, politikë e historikë, që vepruan në identitetin e vet kulturor në periudhën e të qenit minoritet brënda shtetit shqiptar si dhe para këtij momenti gjeopolitik.

Për të arritur qëllimin tonë në përcaktimin e veçorive dalluese të kësaj letërsie, ndoqëm dy rrugë:

Së pari, e pamë të domosdoshme të vëmë përballë këtë letërsi me faktorët që ndikojnë në veçoritë e saj të karakterit të përgjithshëm. Bëhet fjalë për kategorinë e parimeve të përgjithshme të historiografisë krahasuese të letërsisë.

Në kushtet e mungesës totale të një baze teorike mbi historiografinë e kësaj letërsie dhe të veçorive të saj, një nga problemet e para të punës tonë ishte ai i periodizimit dhe emërtimit.

Për periodizimin e kësaj letërsie parapëlqyem parimin e mbartjes së periodizimeve historiko-politike, të gërshetuar me parimin e Mukarovskyt, sipas të cilit, trajtimi historik i letërsisë bëhet në një ndërthurje të dyfishtë: si “*zhvillim*” i “*strukturave*” të brëndshme të saj dhe si “*krijim*”, në raport me realitetin shoqëror

“*të jashtëm*”. Ndjekja e kësaj rruge lidhet me faktin që letërsia e Minoritetit Grek në Shqipëri u zhvillua si një letërsi e ndikuar nga zhvillimet historike e politike. Nga ana tjetër historiografitë e letërsive shqiptare edhe greke ndoqën pak a shumë të njëjtat parime. Si rezultat dalluam këto periudha:

Periudha e parë përfshin etapën e kontaktit të drejtpërdrejtë me krijimtarinë letrare të traditës popullore.

Periudha e dytë përkon me pushtimin e gjatë otoman deri në lindjen e shtetit të pavarur shqiptar. Karakteristikë dalluese është se ajo zhvillohet si pjesë e pandarë e lëvizjes së përgjithshme letrare greke. U zhvillua si veprimtari filologjike dhe u priu lëvizjes iluministe e romantike të rajonit. Ajo, edhe pse përfshihet në fushën e letrave kishte si synim përfshimin dhe kultivimin në ndërgjegjen e kohës të një vizioni perëndimor-antiosman

Periudha deri në Luftën e Dytë Botërore. Karakteristikë e kësaj periudhe është zhvillimi i letërsisë me statusin e të qenit minoritet etnik brënda shtetit shqiptar. Kjo letërsi vazhdon të ruajë kontaktet me letërsinë e kombit am. Ndërsa kontaktet me letërsinë shqiptare janë të vakëta, aq sa nuk mund të merren parasysht.

Periudha e realizmit socialist. Komunikimet me letërsinë kombëtare greke janë pothuaj inekzistente. Ndikimet e shumta nga letërsia shqiptare janë më shumë pasojë e metodës krijuese. Letërsia e kësaj periudhe zhvillohet kryesisht si poezi. Nga një letërsi e shkruar në gjuhën greke në fillimet e saj, kthehet në një letërsi bilinge ku elementi shqip, sidomos në fund të viteve 70', fillim të viteve 80', bëhet mbisundues.

Letërsinë e kësaj periudhe e klasifikuam si Letërsi “*të burgosur*” ose “*të ndaluar*” (përmbledh krijimtarinë letrare të njerëzve, të cilët, për shkak të kundërshtimit të regjimit komunist, ose fizikisht, ose moralisht ishin të burgosur, të internuar, me biografi të prishur) dhe letërsi “*të lirë*”. Këtë të dytën e ndamë në dy grupe. Në grupin e parë përfshimë letërsinë që ka si karakteristikë krijimtarinë me autocensurë dhe në grupin e dytë krijimtarinë thellësisht të angazhuar.

Periudha në zhvillim. Konsiderojmë atë pas viteve 90'. Karakterizohet nga një zhvillim i vullshëm dhe nga lëvrimi, pothuaj, i të gjitha gjinive e llojeve letrare. Kontaktet me letërsinë panhele- ne janë të lira, ndërsa rrallohen gjithnjë e më shumë kontaktet me letërsinë shqiptare.

Si fazë e ndërmjetme është ajo e periudhës së Luftës së Dytë Botërore.

Një rëndësi të veçantë iu kushtua autorëve kryesorë të kësaj letërsie në të gjitha periudhat.

Përsa i përket emërimit parapëlqyem termin “*Letërsia në lidhje me Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri*”, për të përcaktuar gjithë trashëgiminë letrare të këtij minoriteti edhe para vendosjes së kufijve, dhe termin “*Letërsi e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri*” për trashëgiminë letrare pas këtij momenti historik.

Duke u nisur nga veçoritë e kësaj letërsie, **metoda e përdorur është ajo e një historiografie krahasuese e mbështetur fuqimisht në sociologjinë e letërsisë, si dhe metoda e një analize krahasuese për veprat përfaqësuese të poetëve me në zë në Minoritetin Grek të periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore, konkretisht të P. Çukës, N. Kacalidhës, A. Zarballasë. Krahasimi bëhet në disa plane mbi bazën e raporteve të krijimtarisë popullore me natyrën, kulturën, shoqërinë, me prodhimin letrar të autorëve të tjerë.**

Si kënd vështrimi u parapëlqye mënyra biomatike e vlerësimit të fenomeneve letrare të kësaj treve.

Së dyti, u ndoq ruga e studimit të fenomeneve të brëndshme letrare. Veçuam kategorinë e rrafshëve krahasuese të strukturës apo të shtresimit të brëndshëm letrar: shtresën fonetike me kuptimin e eufonisë e të stilistikës: semantike me bazë fjalën dhe produktin kuptimor që buron nga përdorimi i saj sipas rregullave të gjuhës poetike: shtresën e fabulave, e motiveve e sidomos e miteve etj. Në këtë përpjekje u operua me disa kategori marrëdhëniesh të letërsisë me natyrën, njeriun, metafizikën, sipas raporteve *individ-shoqëri*, *natyrë-kulturë*, *liri-roberi*, *jetë-vdekje* si kriterë tipologjike të traditës popullore të mbartura në letërsinë e kultivuar. Planet krahasuese përfshijnë krahasimin me traditën popullore, me poezinë e kultivuar greke, me poetë të letërsisë shqiptare dhe krahasim midis tyre. Edhe në këto plane krahasuese vihen re disa nivele.

Qëllimi, ishte që, duke u mbështetur në ligjësitë estetike të funksionit dhe natyrës së letërsisë, të japim një ide sa më të plotë për çeshtje që lidhën me historiografinë e zhvillimit të letërsisë së Minoritetit Grek. Këtë çeshtje e trajtuam brënda sistemit të referimit të hapësirës e të kohës, si elemente të qenësishëm e përcaktues të ecurisë së kësaj letërsie.

Po ashtu, përqasem: përkatësinë etnike të bartësve dhe krijuesve të saj në raport me letërsinë e prodhuar; raportet e marrëdhënieve me letërsinë panhelene dhe me letërsinë shqiptare dhe popullin shqiptar në përgjithësi etj. Të para brënda sistemit referues të kohës, karakteristikë e shumë prej këtyre faktorëve mbetet ndryshueshmeria në varësi të ndryshimeve gjeopolitike të trevës, në të cilën kjo letërsi u lind dhe u zhvillua.

Ky realitet është parë si një proces diferencimi nga identiteti kulturor e letrar i kombit am i cili, në periudhën e diktaturës, bëri që pothuaj vetëm gjuha të ishte elementi i përbashkët midis letërsisë së këtij komuniteti dhe letërsisë greke. Ndërsa, në rastin e marrëdhënieve me letërsinë shqiptare, bëri që gjuha të mbetet elementi pothuaj i vetëm dallues midis kësaj letërsie dhe asaj të Minoritetit Grek.

Një faktor që ndikoi së tepërmi në ruajtjen e identitetit të veçantë të kësaj letërsie është folklori i kësaj treve dhe marrëdhëniet e letërsisë me të. Në lidhje me këtë konkluzion është me vend të theksojmë se punimi, si në aspektin e përpjekjes për të ndërtuar historinë e kësaj letërsie, ashtu edhe në studimin e veprave përfaqësuese të poetëve me në zë në Minoritetin Grek nisët dhe argumenton idenë se kjo letërsi ka një komunikim të vazhdueshëm me jetën tradicionale dhe folklorin letrar. Në këtë komunikim mbarten arketipat e krijuara nga kozmosi mitologjik panhelen dhe letërsia klasike greke, si dhe përthyerjet që këto arketipe pësuan në traditën e mëvonshme popullore, në eposin e mëvonshëm, baladat, mitet, legjendat me karakter panhelen dhe lokal. Mendojmë se interesante mbeten në punim, përpjekjet për të studiuar Letërsinë e Minoritetit Grek nga ky këndvështrim.

Si e tillë kjo letërsi vlerësohet se përbën një kontribut dhe një vlerë përbërëse, për të gjithë letërsinë dhe kulturën shqiptare. (Vetëm në aspektin e kornizës ideologjike ajo mund të konsiderohet e barasvlefshme me mbarë letërsinë e angazhuar shqiptare me tipar dallues vetëm gjuhën.) Njëkohësisht, ajo përbën edhe një vlerë e veçori ndryshe për letërsinë greke.

Këto veçori burojnë nga fakti se kjo është një letërsi kontakti. Në rrjedhat historike kontaktet e saj janë herë të dyanshme e herë të njëanshme.

Në punim theksohet që raportet e letërsisë së kësaj treve me letërsinë e kombit am kaluan nga stadi i një letërsie të njehsuar, para vendosjes së kufijve në një letërsi pa asnjë kontakt, në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore për të kaluar në periudhën e pas viteve 90të të shekullit të kaluar, në stadin e rifitimit të plotë

të kontakteve me letërsinë e kombit am, deri në përpjekje për njehsim me të.

Në raport me letërsinë shqiptare këto kontakte kaluan nga ato natyrore në periudhën para vendosjes së kufijve, në humbjen pothuaj fare të këtyre kontaktëve në periudhën deri në Luftën e Dytë Botërore. Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitet 90të kemi një komunikim intensiv me tendenca njehsuese (pavarësisht nga gjuha) me letërsinë shqiptare, për të kaluar sërisht në një ekstrem të kundërt, të ngjashëm me atë të periudhës 1912-1939.

Kjo situatë solli një fenomen që rrallë mund të haset në historinë e zhvillimit të fenomeneve kulturore e artistike, veçanërisht, në kushtet e zhvillimeve integruese e globalizuese të shekullit të kaluar dhe në vijim. Ajo çoi zvogëlimin e mundësive të letërsisë së Minoritetit Grek, për të fituar rolin e transmetuesit të dyfishtë midis dy letërsive, asaj greke dhe shqiptare.

Lënda e studimit është organizuar mbi këtë strukturë. Është ndarë në tri pjesë dhe në dhjetë kapituj. Dy pjesët e para lidhën me historiografinë sipas periodizimit. Vija kohore ndarëse e pjesëve është periudha e Luftës së Dytë Botërore si ngjarje që përcakton ndryshimin e metodës krijuese të letërsisë dhe raportet e marrëdhënieve të saj me letërsitë analoge në kontakt.

Pjesa e tretë angazhohet me studimin e poezisë së përzgjedhur të P. Çukës, N. Kacalidhës dhe A. Zarballasë. Përzgjedhja e poezisë është bërë nga vet poetet të konsideruar si me në zë në Letërsinë e Minoritetit Grek të periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore.

Në fund të monografisë ka një bibliografi thujse shtëruese të autorëve të Letërsisë së Minoritetit Etnik, të përfshirë ose jo në monografia. Përpjekja na dha arkivin e parë të titujve të veprave të kësaj letërsie dhe autorët e tyre.

Së fundi besojmë se në kuadrin e qëllimit që i vumë vetës, për një studim të letërsisë në lidhje me Minoritetin Grek në Shqipëri, arritëm objektivin. Studimi jo vetëm e organizon historinë e kësaj letërsie, por e shikon atë në kuadrin krahasues në disa plane - në atë të trashëgimisë dhe të aktualitetit të marrëdhënieve me letërsinë e kombit am dhe atë shqiptare, në realitetin e vet të brëndshëm dhe në atë shqiptar. Kuptohet se do të qe një ndër-marrje e pamundur nëse ne do të vinim si objektiv studimin, në të gjitha nivelet të të gjithë letërsisë, apo të një gjinie të caktuar, apo të një periudhe të vetme.

Ishte një ndërmarrje e vështirë që rrjedh kryesisht nga fakti se është i pari studim i këtij lloji me objekt letërsinë e minoritetit grek. Kjo lë shumë vend për kritika, sugjerime e debate. Të gjitha janë të mirëprituara. Por më shumë është e mirëpritur dëshira për të hapur një dritare të re jo vetëm në studimin, sistemimin dhe promovimin krahasues të kësaj letërsie, por edhe për të parë ndryshe nga ç'ka ajo është trajtuar nga të gjithë faktorët përgjegjës për realitetin letrar e kulturor të trevës në fjalë.

Duke pretenduar se bëmë vetëm diçka modeste, përfundojmë duke thënë se edhe kjo monografi provoi se oreksi u hap.

Gjirokastër,
2003-2022

FUND

BIBLIOGRAFI

Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë, 1984

Adem Jakllari, Historia e mendimit etnologjik dhe mitologjik (përshatje), Tiranë, 2003

A. J. Graimas, Dysens. Essais semiologiques, Paris, 1970

Brunel Pierre, Qu' est-ce que la littérature comparée, Paris, 1983

B. Anderson, Imagined communities, London, 1983

Cl. Pichois & A. Rousseau, La littérature comparée, Paris, 1983

Douwe Fokkema-Elrond Ibsch, Theories of Literature in the Twenty Century, Athinë, 1998

Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë, 1994

Luçiano Boçi, Koha në poetikën e romanit, Elbasan, 2005

Gennette G., Τα όρια της διήγησης, Athinë, 1987

Gjovalin Shkurtaç, Sociolinguistika, Shblu, Tiranë, 1999

Milivoj Solar, Hyrje në teorinë e letërsisë, Tiranë, 2001

Monroe G. Beardsley, Aesthetics from Classical Greece to the Present, Athinë 1989

R. Wellek – A. Warren, Theory of Literature, Athinë, 1976

Rene Wellek – Austin Warren, Theory of literature, Athinë 1980,

Renè Wellek, Concepts of Criticism, New Haven, London, 1963

Robert Elsie, Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë – Pejë 1977

Roman Ingarden, Das literarische Kunstwerk, Halle, 1931

R. Barthes, Eléments de sémiologie, Paris, 1964

Shaban Sinani, Një dosje për Kadarënë, bot. II, Tetovë, 2005

Shezai Rrokaj, Çështje të gjuhës shqipe, Tiranë, 2007

Universiteti Shtetëror i Tiranës, Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë, 1959

Universiteti i Gjirokastrës, Kërkime universitare, 5, Gjirok. 2001

Kërkime Universitare, 9, Gjirok. 2005

Van Tieghem, La littérature comparée, Paris, 1931.

Y. Chevrel, La littérature comparée, Paris, 1989

Yves Chevrel , Letërsia e krahasuar, Tiranë, 2002

Αθανάσιος Σπ. Πασχάλης, Τα μεταπολεμικά αναγνωστικά της ελληνικής μειονότητας της Αλβανίας, Athinë, 1998

Αθηνά Βουγιούκα, Η ποίηση της πραγματικότητας & η πραγματικότητα της ποίησης: Η αναφορά στον Γκρέκο του Νικο Καζαντζακη, Athinë, 1999

Βασ. Κ. Μάργαρη, Συγγραφείς και λογοτέχνες των Ιωαννίνων (1206-1990) (Shkrimtarë dhe Injërëz të letrave të Janinës (1206-1990), Janinë, 1991

Γιώργος Βελούδης, Γραμματολογία θεωρία της λογοτεχνίας, (Gramatologjia –teoria e letërsisë), Athinë 1994

Εκδοτική Αθηνών Α.Ε, Ήπειρος, (Epiri, botuar nga Shtëria Bot. Athinës Α.Ε), Athinë, 1997

Ερατοσθένης Γ. Καψωμενος, Αναζητώντας το χαμένο ευρωπαϊκό πολιτισμο, Α', Athinë, 2002

Λίνου Πολίτη, Ιστορία της Νεοελληνικής Λογοτεχνίας, Athinë 1993

Μαρία Χατζηγιακουμή, Η «υπέρβαση» της ιστορίας στο έργο του Ο. Ελύτη, Athinë, 2004

Μιχαλης Περάνθης, Ελληνική Πεζογραφία, 1453 μέχρι σήμερα, Vel. IV, Athinë.1982

Νικολας Βερνίκος & Σοφία Δασκαλοπούλου, Στις απαρχές της νεοελληνικής ιδεολογίας, Athinë, 1999

Παναγιώτη Ν. Μπάρκα, Τα λαογραφικά, Tiranë, 2003.

Π. Μπάρκας, Τα ταξίδια της φηγού, τομ. I.II.III, Ελίκρανον Αθήνα 2016

Υπ. Εθ. Άμ. της Ελλάδας, Ήπειρος – θεων, ανθρώπων και ηρώων, (Epiri i perëndive, njerëzve dhe heronjve – botim i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë), Athinë, 2001

FJALORË

Apostol Pango, Enciklopedia e Delvinës dhe e Sarandës, Tiranë, 2002

Γερ. Μαρκαντωνάτου & Γ. Σακελαριδη, Λεξικό λογοτεχνικών όρων (J. Markontonatu & J. Sakelaridhi, Fjalor i termave letrare), Athinë, 1984

Σωκράτη Γκίκα, Φιλοσοφικό λεξικό, (Sokr. Gjika, fjalor filozofik), Athinë 1988.

Υπ. Εθν.Παιδ. Θρ., Λεξικό λογοτεχνικών όρων, Fjalor i termave letrare, Botuar Min. Ars & Fesë, Athinë, 1999

GAZETA & REVISTA

Gaz. "Drita" edicioni 1960-1990

Gaz. "Zëri i popullit"

Gaz. "Καθημερινή",

Gaz. "Νέα εστία",

Gaz. "Ελευθεροτυπία"

Gaz. "Τα νέα της ΟΜΟΝΟΙΑΣ"

Gaz. "2000"

Gaz. "Λαϊκό Βήμα"

Gaz. "Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα"

Rev. "Nëntori", edicioni 1953-1990

Rev. "Alternative", Nr. 80 (Oktober 1971), Përkth. Greqisht

BIBLIOGRAFI NDIHMËSE (VEPRAT E AUTORËVE)

Agamemnon Ath. Kommatas.

«Χασάν Οδυσσέας ο Αργυροκαστριτης»,
(“Hasan Odhisea Gjirokastriti”), roman, Athinë, 1972

Alekos Papas

“Το σύγχρονο ταξίδι του Οδυσσέα”
(“Udhëtimi modern i Odiseut”).

Aleksandros Mamopullos.

“Epiri: Folkloristikë, doke e etnografi”

«*Ηπειρος: Λαογραφικά – Ηθογραφικά - Εθνογραφικά*» me dy
vëllime (1961, 1964)

“Miti i kontributit shqiptar në pavarësinë e Greqisë”

«*Ο μύθος της Αλβανικής συμβολής εις την ανεξαρτησίαν της
Ελλάδος*» 1963

“Hristos Hristovasilis, tregimtari, folkloristi, patrioti”

«*Χρ. Χρηστοβασίλης, ο διηγηματογράφος, ο λαογράφος, ο
πατριώτης*» 1965

“Kurbeti dhe kënga popullore”

«*Η ξενιτιά και το δημοτικό τραγούδι*» 1966

“Angjeliqi Hatzimihali dhe arti popullor epirotas”

«*Αγγελική Χατζημιχάλη και η Ηπειρωτική Λαϊκή Τέχνη*» 1967

“Qeraxhintë”

«*Αγωγιάτες και Κιρατζήδες*»,

“*Kryepiqesia, institucion vetëvendosjeje përgjatë pushtimit
Otoman*”

«*Δημογεροντία, θεσμός αυτοδιοικήσεως επί Τουρκοκρατίας*»

“Bamirësia epirotase dhe rilindja e re greke”

«*Ηπειρωτική Ευεργεσία και νεοελληνική αναγέννηση*»)

Alqis Papas

“Γεφύρια”

(“Urat”).

Andreas Zarballas

«*Επιμένουμε*» (“*Këmbëngulim*”), poezi, Tiranë, 1981

«*Ταξίδι στον τόπο μου*»

(“*Udhëtim në vendin tim*”) publicistikë, Tiranë, 1985

«*Τα παιδιά του Ήλιου*»

(“Djemtë e Diellit”), poezi, Tiranë, 1989
«101 ποιήματα για μια χούφτα γη»
 (“101 poezi për një grusht tokë”), poezi, Athinë, 1992
 «Ο άλλος χάρτης» (“Harta tjetër”), studim, Athinë, 2004
 «Η μοίρα του Αλκίνου»
 (“Fati i Alkinos”), tregime, Athinë, 2008
 «Το αιμα της αγάπης»
 (“Gjaku i së dashurës”), esse, Athinë, 2008
 “Ραβδομάντης”
 (“Fallhedhësi me shkop”), poezi, Gjirokastër, 2009
 “Η μπαλάντα της στάμνας”
 (“Balada e shtamnës”) poezi, Athinë, 2016

Athanasios Ikonomidhis

“Οι δύο οι φίλοι»
 (“Dy miqtë”), dramë
 «Αρκευθίδες»
 (“Arkefthides”), dramë
 «Μιχαήλ Άγγελος Κομνηνός»
 (“Mihail Angjellos Komninos”), dramë
 «Ηπειρωτικές εικόνες»
 (“Imazhe epirotase” ose “Kujtimet e moshës femnore”).
 tregime
 «Η καστανιά της νύφης»
 (“Gështenja e nusës”), tregim,
 «Ο Βρικόλακας»,
 (“Vrikollaku”), tregim,

Athina Papa

«Αμάραντα ταξίδια»
 (“Udhetime të pa fishkura”) Athinë 2020
 Άβυσσος ψυχής»
 (Pafundësi shpirti) Athinë 2021

Dhimitris Kokaveshis

“Stalakmitet” 2004,
 “Fati i dritës”, 2009,
 “Meteoritet”

Dhimitrios A. Panajotidhis -Meksis

“Fotikia në Paramithi”
 «Η Φωτική εν Παραμυθιά»
 “Fotikia në Paramithi dhe mbishkrimet në të”

«Η Φωτική παρά την Παραμυθιάν και επιγραφαί τίνες αυτής»
“Folkloristika. Doke dhe zakone të rajonit të Paramithisë në Thesproti”

«Λαογραφικά. Ήθη και Έθιμα του Τμήματος Παραμυθιάς, εν Θεσπρωτία» “Arkeologji. Kërkime arkeologjike në thesproti”

«Αρχαιολογικά. Θεσπρωτικά Αρχαιολογήματα»

“Shënime kronologjike për monastiret dhe kishat e Thesprotisë”

«Χρονικά σημειώματα εν Μοναίς και Εκκλησίες της Θεσπρωτίας»

“Katalog kronologjik të episkopatave të Thesprotisë me më të vjetrat ato të Evrias, Fotikës dhe Butrintit”

«Χρονολογικός Κατάλογος των επισκόπων Παραμυθιάς μετά των αρχαιοτέρων της Ευροίας, Φωτικής και Βουθρωτού»

Elsa Tzumba

“Όσο κρατάει ένα όνειρο»

(“Sa mban një ëndër”) Gjirokastër 2016

Evangjellos Fotiadhis

“Mendime rreth studimit të Thanas Vajës”

«Συμβολή εις την περί του Θανάση Βάγια έρευνα»

“Greqisht”

«Ελληνικά» 1950,

“Uniteti i heleneve”

«Η Ενότης των Ελλήνων» 1950,

“Hyrje në historinë e Greqisë”

«Εισαγωγή εις την Ελληνική Ιστορία» 1949-1951,

“Tradita e dijes si faktor e 1821”

«Η Λογία παράδοσις ως παράγων του Εικοσιένα» 1953,

“Mësimet hyrëse në historinë politike të helenizmit më të ri dhe modern”

«Εισαγωγικά μαθήματα εις την πολιτική Ιστορίαν του νεωτέρου και συγχρόνου ελληνισμού» 1958,

“Mësimet udhëheqjeje”

«Μαθήματα Ηγεσίας») 1955

Fotos Qiriazatis.

“Fluturimet e para”, poezi, Tiranë, 1961

”Hapat”, poezi, Tiranë, 1971

“Rruga drejt burimeve”, poezi, Tiranë, 1979

“Bërtitje në mesnatë”

(«Κραυγή στη νύχτα»), tregime, Athinë, 1991

«Φωτολούλουδα »

(“Luledrite”), poezi, Athinë, 2004

«Άκου τι σου σφυρίζει ο άνεμος»,
("Dëgjo ç'të thotë era"), roman, Athinë, 1998
«Κυνηγώντας την ομορφιά»
("Duke ndjekur bukurinë"), roman, Athinë, 2001
«Η κόρη του ποιητή»
("Vajza e poetit"), roman. Athinë 2001
«Το μυθικό ανάκτορο»
("Pallati mitik"), roman, Athinë 2018
«Όταν βούιζε η Μπίστρισα»
("Kur buçiste Bistrica"). Poezi, Athinë
«Ποίηση-1966-1991»
("Poezi-1966-1991"), Athinë 2007
«Φύλλο ζωής»
("Gjethe jete") poezi, Athinë 2017.

Grigor Jovani

"Botë pa dashuri", poezi, Tiranë, 1977
"Punishtja e ëndrrave", poezi, Athinë 2004
"Udhëtojt brenda vetes", poezi, Athinë, 2008
"Blu e thellë", poezi, Athinë, 2012,
"Vreshtat e Dionisit" - gjashtë libra në një", poezi Athinë 2015
"Taverna e të marrëve", poezi, Athinë 2022.
"Ura e mbretit", roman në botim
"Klinika", proza të shkurtëra, në botim.

Janis Lilis

«Πνιγμένοι Καϋμοί»
(Brenga të mbytura) poezi, Athinë, 1945.
«Η Λιούντζη του Αργυροκάστρου, Ιστορία-Λαογραφία»
("Lunxhëria e Gjirokastrës, histori-folklor"). Esse, Athinë 1945
«Μεθυσμένα Βαλκάνια»
(Ballkan i dehur), Athinë, 1946
«Περιγραφικές εντυπώσεις»
(Përshytyrje përshkruese), Athinë, 1947
«Βορειοηπειρωτικές σελίδες»
(Faqe nga Epiri i Veriut). Athinë, 1947
«Το καλαμπόκι του αγά»
(Misri i agait), Australi, 1953
«Ξεριζωμένη γενιά»
("Brezi i çrrenjosur"), roman, Athinë, 1955
"SS Partizanka – Ξεριζωμένη γενιά»
(SS Partizanka- Brezi i shkullur), pabotuar

Jorgos Çatis

- “Zëra nga sketerra”, poezi, 1995
“Përralla me mbret”, fabula, 1995
“Mes dashurisë e dhimjes”, lirika, 1996
“Mimozat e zemrës”, vjersha, 1997
“ Në skaj të ëdrrës pret një vajzë”, lirika, 1998
“Mbjell mes jush një sekuó”, poezi, 1999
“Mërmërimë mes gurgullimash”, poezi, 2000
“Ëndërrvasësit”, poemë, 2000
“Alter ego”, roman, 2001
“Kalorës ëndrrash”, poezi, 2002
“Puhë pas duhisë”, poezi, 2003
“Kumti i vonuar”, tregime, 2006
“Toreadorët”, poezi, 2007
“Enigma e asaj stine”, poezi, 2008

Jeorjos V. Papadhopullos.

- «Θλιμμένα τραγούδια»
 (“Këngë të trishtuara”), poezi, Bukuresht, 1930
«Αύρες και θύελλες»
 (“Fillade e stuhi”), poezi, Bukuresht, 1936
«Τραγούδια της Σιωπής»
 (“Këngë të heshtura”) poezi, Bukuresht, 1937
«Το Παράξενο παιδί»
 (“Djali i çuditshëm”) roman, Bukuresht, 1943
«Η Θύελλα»
 (“Stuhia”) roman për fëmijë. Bukuresht, 1946

Jorgos Shukuris

- «Η θλιμμένη νεράιδα»
 (“Neraidha e trishtuar”) tregime

Katerina Karaxha

- «Νήματα και αισθήματα»
 (“Fije dhe ndjenja”), Athinë 2018;
«Το βάλς της πέννας»
 (“Valsi i penës”), Athinë 2021

Katina Papa

- «Στη συκαμιά από κάτω»
 (“Poshtë manit dhe tregime të tjera”), Athinë, 1935,
«Αν άλλαζαν όλα»
 (“Po të ndryshonin të gjitha”) Athinë 1948.

- «Σ' ένα Γυμνάσιο Θηλέων»
(“Në një gjimnaz femrash”) Athinë 1960,
«Ποιήματα» (“Poezi”), Athinë 1963
«Ο Ξένος» (“I huaji”) Dramë, Athinë 1967
«Η ηθική των αρχαίων Ελλήνων»
(“Morali i grekëve të lashtë”) Studimi
«Τα προς εαυτούς καθήκοντα»
(“Detyra për vetën”) Studimi
«Κριτικές και αισθητικές μελέτες γύρω από το έργο του Κων-
σταντίνου Θεοτόκη, του Γρηγορίου Ξενοπούλου, του Αντώνη
Τραυλαντώνη και του Αλέξανδρου Δελμούζου»
(“Kritika dhe studime estetike mbi vëpren e K. Theotokit, të
Gr. Ksenopullos”)
«Ο Γρηγόριος Ξενόπουλος ως παιδαγωγός»
(“Grigoris Ksenopullos si pedagog”) Monografi
«Η αλληλογραφία της με τον Γρηγόρη Ξενόπουλο και τον
Δημήτριο Καμπούρογλου»
(“Letërkëmbimi me Gr. Ksenopullon dhe Dhimitrio Kaburogllu”)
«Ο γάμος στο Δέλβινο και τα χωριά του», μελέτη για τα γα-
μήλια έθιμα του Βορείου Τμήματος της Ηπείρου
(“Traditat e dasmës në Delvinë dhe fshtatrat për rreth”) studim
«Η ηθική και το Θέατρο»
(“Etika dhe Teatri”) studim
«Η φιλοσοφία της Τέχνης στην 'Ελλάδα»
“Filozofia e Artit në Greqi”

Konstandinos Kondos

- “Κομντε πέρ λετρήν τιμε”
«Σχόλια εις την εμήν επιστολήν»,
“Vërrejtje rreth polisit e Athinjtëve të Aristotelit”
«Παρατηρήσεις εις Αριστοτέλους Αθηναίων Πολιτείαν»,
“Vërrejtje gjuhësore”
«Γλωσσικές Παρατηρήσεις»

Kostas Nushas

- «Θρυλική συμφωνία»
(“Simfoni legjendare”)

Kristo Armando Gjezos

- «Ανεκπλήρωτοι φόβοι»,
“Frikë e porealizuar”, 2012
«Η λάσπη»,
“Balta” roman

«Τραμπάλα»

“Traballa” tregime

«Το δέντρο που είχε μια μπάλα για κεφάλι»

“Pema që kishte për kokë një top” libër për femijë

Manolis Vitos

«Στα δίχτυα του έρωτα»

(“Në rrjetën e dashurisë”), tregime, 1946

«Ο γαμος του φτωχου»

(“Dasma e fukarait”, tregime, 1951

«Ο πόλεμος»

(“Lufta”), tregime, 1953

«Ο αρωστημένος»

(“I semuri”), tregime, 1957

«Εφήμερη ευτυχία»

(“Dasuri e përkohshme”), tregime, 1961

«Ματιες στη ζωή μου»

(“vështrime në jetën time”), tregime, 1965

«Το σπίτι»

(“Shtëpia”), tregime, 1973

«Διηγήματα»

(“Tregime”), 1975

«Ο Βιοπαλεστής»

(“Në luftë për jetën”), tregime, 1978

Margaritis Papas Hristos,

“Gramatika e muzikës dhe përmbledhje muzikore”

«Γραμματική Μουσικής και Συλλογή Μουσικών»

Mihalis Papadhopullos (Botis)

“Μερόπη”

(“Meropi”), poezi,

«Το πουγκί του Φιλάργουρου»,

(“Qeska e kopracit”) komedi,

«Ο ψευτογιατρός»

(“Mjeku i rremë”), komedi,

«Ο κομήτης»

(“Kaçaku”), komedi.

Miltiadhīs Ikonomidhis,

«Εικονογραφημένο Ηπειρωτικό Ημερολόγιο»

(“Ditari i ilustruar epirotas”), revistë, Konstandinopojë, 1911

«Εικονογραφημένο Ηπειρωτικό Ημερολόγιο» 1914

(“Ditari i ilustruar epirotas”), revistë, Athinë, 1915
«Ηπειρωτικά» (“Hpeirotika”), Αθήνα 1938
«Άνθρωποι από τη Βόρειο Ήπειρο»
 (“Njerëz nga Epiri i Veriut”), tregime, Athinë, 1924
«Ιστορίες από την Ήπειρο μου»
 (“Histori nga Epiri im), tregime e pabotuar
 «Αυτά που σας μολογώ γινίκανε στην Ήπειρό μου»
 “Kto që po ju tregoj ndodhën në Epirin tim”

Minas Lekkas vëllime poetike

«Φυλακισμένα τραγούδια»
 (“Këngë të burgosura”),
 «Της Αθήνας τα παράξενα»
 (“Gjërat e çuditshme të Athinës”),
 «Μαργαριτάρια»
 (“Margaritarët”),
 «Γέφυρες»
 (“Urat”),

Mirela Kallaxhi

«Ίχνη και περάσματα»
 (“Gjurmë dhe shtigje”), Athinë 2020

Nikos Kacalidas

“Fjalët e thëna në pranverë”, poezi, Tiranë, 1971
“Flugeri”, poezi, Tiranë, 1975
“Shtëpitë tona në Jug”, poezi, Tiranë, 1982
«Η κοίτη του ποταμού μου»,
 “Shtrati i lumit tim” , poezi, Tiranë, 1982
“Anedet”, poezi, Tiranë, 1989
«Ανταύγεσ», (“Refleksione”), poezi, Tiranë, 1989
«Οι φωνές της γενέτειρας μου»
 (“Zërat e vendlindjes sime”), poezi, Tiranë, 1989
«Λιόφωτο λιανοτράγουδο»
 (“Lirikë Diellore”), poezi, Tiranë, 1985
“Anedet”, poezi, Tiranë, 1989
«Ανταύγεσ» (“Refleksione”), poezi, Tiranë 1998
«Οι φωνές της γενέτειρας μου» poezi,
 (“Zërat e vendlindjes sime”), poezi, Tiranë, 1990
“Ματομενη τραγική χοροδία»
 (“Kor tragjik i përgjakur”), poezi, Tiranë, 1990
«Η βίβλος των σκοτωμένων»
 (“Bibla e të vrarëve”), poezi, Tiranë, 1991

- «Το σπίτι των ανέμων»
 (“Shtëpia e erërave”), poezi, Tiranë, 1991
- «Οι ρίζες των δέντρων»
 (“Rrënjët e pemëve”), poezi, Tiranë, 1992
- «Στερνή μπαλάντα, πένθιμη»
 (“Baladë e fundme e përzishme”, poezi, Tiranë, 1993
- “Το μοιρολόι του βουρκωμένου βουνού»
 (“Vaji i malit të vrenjtur”), poezi, Selanik, 1994
- «Το καράβι της Κύπρου και τα πικρολέμονα»
 (“Anija e Qipros dhe limonat e hidhura”), poezi, Nikozia, 1995
- «Και η σφίγγα μίλησε»
 (“Dhe sfinks i foli”), poezi, Selanik, 1995
- “Η αμβροσιά των βράχων»
 (“Ambrozia e gurit”, poezi, Korfuz, 1997
- «Αυτό εστί το αίμα μου»
 (“Këtë dikton gjaku im”), poezi, Tiranë, 1997
- «Εκατό εκατόφυλλα της Πούλιας»
 (“Njëqind, 100-gjetheshet e Plejadeve”), poezi, Selanik, 1997
- «Το δάκρυ του κυκλάμινου»
 (“Loti i ciklaminit”), poezi, Athinë, 1998
- «Η πύλη των βοριάδων»
 (“Porta e erreve të veriut”), poezi, Selanik, 1998
- “Profecia e drurëve”, poezi, Tiranë, 1998
- «Χίλια κοχύλια»
 (“Një mijë guacka deti”), poezi, Janinë, 1999
- «Η πλώρα των άστρων»
 (“Bashi i yjeve”), poezi, Selanik, 2001
- “Η Μοίρα του αμάραντου»
 (“Fati i Amarandos”, poezi, Selanik, 2003
- «Η σέλα του Φεγγαριού»
 (“Shala e hënës»), poezi, Athinë, 2008
- «Το άροτρο του φεγγαριού»
 (“Parmenda e hënës”), roman, Athinë, 2004
- “Τα εραλδικά της Κίχλης”
 (“Heraldikët e Kihlit”) poezi, 2008,
- “Όφισ οικουρός”
 (“Gjarpër i shtëpisë”) poezi, 2013
- “Ο παρακλητικός του ηλιοβασιλέματος”
 (“Lutja e perendimit të diellit”) poezi, 2014
- “Δαφνοπόταμο”
 (“Lumë prej dafine”) poezi, 2015
- “Το ξύπνημα των κοιμωμένων οφθαλμών”

- (“Zgjimi i syve të fjetur”) poezi, 2020
“Νύχτας ανομήματα”
 (“Mekate nate”) tregime e novela, 2006
“Περί Ομονοίας και άλλων δαιμονίων”
 (“Rreth Omonias dhe demonëve të tjerë”) roman, 2018
“Ο Νυχτοπαρωρίτης”
 (“Niktorparoriti”) roman, 2019
“Η επέλαση των χιονιάδων”
 (“Marshimi i borës”) prozë 2021

Nikollaos Kerameos Shek XVII

“Kundërpërgjigje në emër të të cilesuarve padrejtësisht kundërshtarë të njëres dhe të vetmës Kishë apostolike dhe unike Nimfë të Perëndishme e Krishtit”

«Αντέγκλημα κατά των εγκαλούντων αδίκως κατά της μιας και μόνης αγίας καθολικής και αποστολικής Θεοσύμφου του Χριστού Εκκλησίας».

- “Reagime ndaj autoritetit të Papës së Romës”
«Αντιρρητικά κατά της αρχής του Πάπα της Ρώμης»,
“Rreth parimeve teologjike”
«Περί αρχών Θεολογικών»
”Rreth miqësisë dhe erosit”
«Περί φιλίας και έρωτος»

Panajotis Barkas

- «Χειμωνισμένη αγάπη»
 (“Dashuri e dimerërizuar”), 1981
«Κόντρα στο ρεύμα»
 (“Kundër rymës”), 2009
«Ήπειρος ο Μύθος στην πραγματικότητα»
 (“Epiri, miti në realitet”), dokumentar, 2010
«Οι ήρωες πολεμούν σαν Έλληνες»
 (“Heronjtë luftojnë si helenët”), dokumentar, 2015
«Ο Τόπος μας και η Επανάσταση του 1821»
 (“Vendi ynë dhe Revolucioni i 1821”), dokumentar, 2021
«Λυρικοί στοχασμοί»
 (“Meditime lirike”), poezi, 2022
«300 αποφθέγματα»
 (“300 sentenca”), 2022

Panajotis Bolis

- «Θλιμένα Μάτια»,
 (“Sy të trishtuar”) prozë e shkurtër, 2016

“Nostalgjia çapitet në rrugët me kalldrem”, poezi, 2019
“Sonte Hëna” prozë e shkurtër, 2022

Panos Çukas

«Λεύθερη ζωή» (“Jetë e lirë”), poezi, Tiranë, 1953
«Ποιήματα» (“Poezi”), Tiranë, 1955
«Η Τρακτερίστια» (“Traktoristja”), poezi, Tiranë, 1957
«Το φως του Οχτώβρη»
 (“Drita e tetorit”), poezi, Tiranë, 1959
«Ανατολές και δύσεις»
 (“Lindje Perëndime”), poezi, Tiranë, 1964
«Το νέο τέλος ενός παλιού θρύλου»
 «Σαλπίσματα» (“Kushtrime”), poezi, Tiranë, 1969
«Το Νέο Τέλος ενός Παλιού Θρύλου»
 (“Fundit i ri i një legjende të vjetër”), poezi, Tiranë, 1984
«Κορυφές και ορίζοντες»
 (“Lartësi dhe orizonte”), poezi, Tiranë, 1977
«Τα ξαραβωνιάσματα»
 (“Prishja e fejesës”), prozë, Tiranë, 1970
«Λύκοι με ράσα», prozë, përkthim, Tiranë, 1973
“Ujq me rasa”, (në shqip), prozë, Tiranë, 1970
 (Θοδωρής Μάστορας», monografi, Tiranë, 1977
 “Thodhoris Mastoras”, (shqip), Tiranë, 1976
 “Çelësat e lumturisë”, poezi, Tiranë, 1967
 “Urdhëroni në vendlindjen time”, poezi, Tiranë, 1972
 “Koka e gjarpërit”, prozë, Tiranë, 1973
 “Kështu nisën të vinin pranvera të reja”, poezi, Tiranë, 1981
 “Soditje nga bedenat”, poezi, Tiranë, 1982
 “Në lulëzim të përbashkët”, prozë, Tiranë, 1985

Pavillos Shutis

«Η φλογέρα μου»
 (“Fyelli im”). Poezi, Tiranë, 1955
 «Με τη λύρα και το κεντρι»
 (“Me lirën dhe thumbin”), poezi, Tiranë, 1965
 «Προσφορά»
 (“Kontribute”), pezi, Tiranë, 1983

Persefoni Gjini

«Ραψώδικοι σίχοι»
 (“Vargje rapsodike”)
 «Πατρίδα μου Πολύτσιανη»
 (“Atdheu im Poliçani”)

Petros Çerkezis

- “Në tokën e stërgjyshërve”, poezi, Tiranë, 1977;
“Duarshtrengimesh”, Tiranë, poezi, Tiranë, 1984;
“Dridhet pala e fustanellës”, Tiranë, 1987.
«Οι ληστές του Ήλιου»
(“Grabitesit e Diellit”), poezi, Nikozia, 1998
«Στην όχθη του σκοτωμένου χρόνου»
(“Në bregun e kohës së vrarë”), poezi, Nikozia, 1999
«Η έκτρωση»
(“Abordi”), roman, Nikozia, 2005
“Panteoni i dashurive të flijuara”. Prozë poetike 2003
“Τα δέντρα και ο θάνατος”
(“Pemët dhe vdekja”), prozë 2017
“Η μεγάλη έξοδος”
(“Dalja e madhe”) roman 2018
“Πύρινος αρραβώνας”
(“Fejesë e zjarrtë”).roman 2019

Petros Kurtis

- «Η Μαιανδρία»
(“Meandhria”)
«Η Λουίζα, το κορίτσι που δεν ξέρει να γελά»
(“Luiza, vajza qe s’di të qesh”) roman 2009
«Η μούσα του χωριού μου»
(“Muza e fshatit tim”) roman
«Το εισιτήριο της κόλασης»
(“Bileta nga sketëra”) roman
«Ο Μαύρος Καβαλάρης»
(“Kalorës i zi”)
«Μάρθα μη φύγεις»
(“Martha mos ik!”)
«Στα φτερά του Πήγασου»
(“Në krahët e Pegasos”) Poezi
«Θα είναι αργά»
(“Do të jetë vonë”)
«Το ματωμένο δαχτυλίδι»,
(“Unaza e gjakosur”) roman, 2011
«Αγάπη και δάκρυα»,
(“Dashuri dhe lot”) roman, 2012
«Κραυγές μέσα από το φίμωτρο»
(“Klithma pas gojës së mbyllur”)

«Ωμότητες»,
("Brutalitate")
«Μια πένα φωνάζει»,
("Një penë bërtet")
«Μετρώντας τα κύματα»
("Duke numëruar valet") poezi
«Εγώ με την κομμένη γλώσσα»
("Unë me gjuhë të prerë")
«Σφυριές»
("Goditje çekiçi") poezi 2019

Polizois Spiros Shek XVIII

"Përmbledhje mbi logjikën sipas Aristotelit dhe artit të retorikës"
«Επιτομήν Λογικής κατ' Αριστοτέλη και Τέχνην Ρητορικήν»

Rodhavi Gogoni

«Ερωτικές φεγγοβολές»
("Dashuri dritëhene"), Athinë 2019

Spiros Hristu

"Ο άλλος άνθρωπος"
("Njeriu tjetër") *tregime*, 2001,
"Ο Γλάρος ήταν στην ώρα"
("Pulëbardha ishte në kohë") *tregime*, 2009,
"Στην άλλη στροφή"
("Në kthesën tjetër") *tregime*, 2015,
"Τα σημεία των καιρών"
("Gjëmat e kohrave") *tregime*, 2016,
"Δεν έχω λόγια μόνο λουλούδια"
("Nuk kam fjalë veç lule") *tregime*, 2018.
"Με θέα τη λίμνη"
("Me pamje nga deti") *roman*, 2019.
"Βρεθήκαμε να μη χαθούμε"
("U gjetem për të mos humbur") *roman*, 2020.

Spiros Xhas

«Το τραγούδι της ειρήνης», novelë, 1949
"Kënga e lirisë", 949
"Përkundruell Murganës" novelë, Tiranë, 1953
«Μπροστά στα μάτια της Μουργκάνας», novelë, Tiranë, 1953
«Οι φρουροί της Δημοκρατίας»
("Rojet e demokracisë") *tregime*, Tiranë, 1954

«Πέντε γράμματα- μια πραγματική ιστορία», novelë, Tiranë, 1956

“Pesë letra – një histori e vërtetë”, novelë, Tiranë, 1956

«Τσιγγάνικη αγάπη» novelë, Tiranë, 1962

“Dashuri cingane”, novelë, Tiranë, 1962

“Spitali partizan”, roman, Tiranë, 1966

«Το παρτιζάνικο νοσοκομείο», roman, Tiranë, 1967

“Qyteti i ri” («Η νέα πόλη»), roman, Tiranë, 1966

“Kur ndërtonim hidrocentralin”, novelë, Tiranë, 1966

«Όταν οικοδομούσαμε τον υδροηλεκτρικό σταθμό», novelë, Tiranë, 1966

“Llampa e minatorit ndrit”, novelë, Tiranë, 1966

«Η λάμπα του μιναδόρου φωτίζει», novelë, Tiranë, 1966

“Lefter Talo”, monografi, (shqip-greqisht), Tiranë, 1970

Thanas Zikon.monografi, (shqip-greqisht), Tiranë, 1970

“Akti i fundit”, dramë, “Nëntori”, nr. 1, 1958

“Kronikë Dropullite”, roman, Tiranë, 1989

Stavrinos Dhelviniotis-Vestiaris

“Tregim i bukur për Mihail voibodën, si sundoi në Vllahi, si preu turqit që u gjenden aty, si bëri dhe shumë heroizma, dhe pastaj si e vranë pa luftuar”. 1602

Stavros Paputsis

“Εναγωνίες προσδοκίες”

(“Prishmeri në ankth”) tregime

“Στη χωρισμένη γη της Ηπείρου”

(“Në tokën e ndarë të Epirit”)

“Το κομπολόι της ελπίδας”

(“Tespihët e shpresë”)

“Να κλαις και να γελάς”

(“të qash e të qeshësh”) 2020

roezi «Αναπόφευκτη μέθεξη»

(“Dehje e pashmangshme”)

«Πάνω από έναν αιώνα»

(“Përmbi një shekull”).

«Το πρόπον του Ανδρέα Μαρτίνου»

(Ajo që i shkon Andrea Martinut”) biografi 2015

“Δημήτρης Στέφος, ο άνθρωπος, ο επιστήμονας, ο καταδιωκόμενος, ο Έλληνας”

(“Dhimitris Stefanos, njeriu, shkencëtari, i përndjekuri heleni”) biografi 2018

Tasos Vidhuris

“Ηλύσια”

(“Ilisia”) poezi

“Διηγήματα”

(“Tregime”), Patra, 1938

Tilemahos Koças.

«Συμβάν στη νύχτα»

(“Ngjarje në mesnatë”), tregime, Athinë, 1991

«Το τελευταίο καναρίνι»,

(“Kanarini i fundit”), novelë, Athinë, 1995

«Το τραγούδι εκείνης της νύχτας»

“Kënga e asaj nate”, tregime, Athinë, 1998

«Βροχή στον τάφο»

(“Shiu mbi varr”), tregime, Athinë, 1998

«Τα εφτά παραθύρια»

(“Të shtatë dritarët”), roman, Athinë, 2003

“Τρεις γενιές Αμερικάνοι”

Tri breza amerikanë. Athinë 2004

“Τεκμήριο Αθωότητας”

(“Argument pafajësie”), 2007

“Στην απέναντι όχθη”

(“Në bregun matanë”), 2011

“Ο χορός της νύφης”

(“Vallja e nusës”), 2012

“Κώδικας τιμής”

(“Kodi i nderit”), 2013,

“Οι δεινόσαυροι των Αθηνών, ταξίδι σε λάθος χώρα”

(“Disaurët e Athinës, udhëtim në vend të gabuar”, 2015,

“Σινική μελάνη”

“Bojë Kine”, 1918.

“Στη δίνη του ψυχρού πολέμου”

Në merinë e luftës së ftohtë), 2022.

Thomas Sterjopullos

“Η άγνωστη Ρωμιοσύνη”

(“Helenizmi i panjohur”) esse, 1997.

“Ανθρωποι στα σύνορα”

(Njerëz në kufi”) tregime, 2004.

“Ο θάνατος του Κώστα Ταμπάνη”

(“Vdekja e Kosta Tabanit”) tregime, 2010.

“Γραμμένα στο χρώμα”

- (“Të shkruara në tokë”) tregime, 2012.
“Νυχτερινή επίσκεψη και άλλα διηγήματα”
(“Vizitë nate dhe tregime të tjera”), 2014.
“Ενθύμιον Χίου”
(“Kujtime nga Hio”) poezi,
2017. “Ανθρωποι”
(“Njerëz”) portrete, 2019.
“Στις Δερόπολης τον κάμπο”
(“Në fushën e Dropullit”) Përmbledhje artikujsh dhe komente,
2021.
“Η αντιπολεμική και κοινωνική σάτιρα του Βασίλη Μανή –
Καζινιέρη”
(“Satira kundër luftës së Vasil Mani-Kazinieri, shënime
biografike, 2022.

Vangjelis Zafiratis

- “Ποιήματα”
(“Poezi”),
“Εμένα οι κάμποι με γνωρίζουν”,
(“Mua fushat më njohin”),
“Δάκρυ της πέτρας”
(“Loti i gurit”), 2002,
“Πέτρες και θάλασσα”
(“Gurë dhe det”),
“Σγουρός βασιλικός”
(“Borzilok gjethedredhur”),
“Qyteti i larë në diell”,
“E zeza është e bardhë”.
“Η μοναξιά της πέτρας”
(“Vetmia e gurit”) Sprovë.

Vasilis Dilos

- “Ο παράδεισος είναι δίπλα”
(“Parajsa është në krah”). roman

Vasilis Hristu

- “Μάνα... καημένη μάνα”
(“Nënë ... e shkreta nenë”) tregime
«Τα τραγούδια της Ελένης»
(“Këngët e Elenit”) romanin 2020

Vasilis Koças,

- «Γεια χαρά» (“Pershëndetje”), poezi, Tirana, 1961

«Σατυρικοί στίχοι»
("Vargje satirike"), Tiranë, 1961
«Τραγούδια του καιρού»
("Këngët e stinës"), poezi, Tiranë, 1965
«Λιανείστε τους , στουμπίστες τους»
("Bjeruni dhe stypini"), poezi, Tiranë, 1968
«Κομμουνιστικά φώτα»
("Drita komuniste"), poezi, Tiranë, 1969
«Η αητοφωλιά»
("Foleja e shqironjës"), poezi, Tiranë, 1970
«Απρίλη καλωσόρισες»
("Mirë se erdhe prill"), poezi, Tiranë, 1973
«Συζήτηση με τη γυναίκα μου»
("Bisedë me gruan time"), poezi, Tiranë, 1973
«Ταξιδιαρικά μοτιβα»
("Motive shtegtuese"), poezi, Tiranë, 1974
«Ήσουν ποτέ στη Δρόπολη»,
("Ishe ndonjëherë në Dropull"), poezi, Tiranë, 1977
«Ποιήματα» ("Poezi"), Tiranë, 1986

Vasilis Gjizelis.

«Δύσκολη πορεία»
("Rrugë e vështirë"), poezi, Athinë, 1991
«Ελευθεριάδα», ("Iliriada") poezi, Athinë, 1993
"Puthja Blu" poezi, Elbasan, 1993
«Υπάρχω» ("Ekzistoj"), poezi, Athinë, 1994
«Πάψε να μου το λες»
("Pusho se thëni"), poezi, Athinë, 1994
«Σε ματωμένο κύκλο»
("Në rreth të gjakosur"), poezi, Athinë, 1997
«Βαλκανιάδα» ("Balkaniada"), poezi, Athinë, 1997

INDEKSI I EMRAVE

- Agamemnon Ath. Kommatas: 7, 77, 259
Alekos Papas: 8, 134, 143, 256
Aleksandros Mamopullos: 68, 69, 259
Alqis Papas: 8, 134, 147, 259
Andreas Zarballas: 8, 9, 106, 109, 118, 134, 137, 138, 139,
134, 225, 226, 259
Athanasios Oikonomidhis: 66, 259
Athina Papa: 8, 143, 148, 260
Dhimitris Kokaveshis: 260
Dhimitrios A. Panajotidhis – Meksis: 50, 260
Elsa Tzumba: 8, 147, 261
Evangjellos Fotiadhis: 67, 68, 261
Fotos Qiriazatis: 8, 106, 116, 116, 117, 127, 134, 139, 225, 261
Grigor Jovani: 120, 149, 262
Janis Lilis: 7, 69, 70, 262
Jorgos Çatis: 109, 263
Jeorjos V. Papadhopollos: 78, 263,
Jorgos Shukuris: 8, 145, 263
Katerina Karaxha: 148, 263
Katina Papa: 7, 56, 57, 59, 60, 61, 62, 64, 65, 123, 263
Konstandinos Kondos: 49, 264
Kostas Nushas: 8, 134, 143, 144, 146, 264
Kristo Armando Gjezos: 147, 264
Manolis Vitos: 7, 79, 265
Margaritis Papa-Hristos: 50, 80, 265
Mihalis Papadhopollos (Botis): 7, 66, 265
Miltiadhis Ikonomidhis: 67, 265
Minas Lekkas: 8, 134, 146, 266
Mirela Kallaxhi: 8, 134, 143, 147, 266
Nikos Kacalidhas: 8, 9, 106, 107, 109, 123, 134, 135, 136,
137, 173, 176, 179, 188, 196, 198, 199,
200, 203, 207, 210, 228, 240, 266
Nikollaos Kerameos: 48, 268
Panajotis Barkas: 14, 16, 107, 134, 143, 144, 266,
Panajotis Bolis: 148, 149, 268
Panos Çukas: 8, 9, 11, 24, 91, 97, 100, 102, 106, 125, 126,
127, 128, 129, 153, 159, 160, 161, 162, 167,
177, 269,

Pavlos Shutis: 125, 127, 131, 269
Persefoni Gjini: 132, 269
Petros Çerkezis: 8, 134, 140, 141, 270
Petros Kurtis: 8, 144, 270
Polizois Spiros: 48, 271
Rodhavji Gogoni: 8, 147, 271
Spiros Hristu: 8, 145, 271
Spiros Xhas: 8, 24, 31, 91, 97, 98, 102, 104, 105, 106, 108,
109, 110, 127, 129, 130, 271
Stavrinis Dhelviniotis-Vestiaris: 53, 272
Stavros Paputsis: 8, 146, 272
Tasos Vidhuris: 7, 65, 123, 273
Tilemahos Koças: 8, 120, 121, 122, 134, 143, 271
Thomas Sterjopullos: 8, 106, 109, 134, 141, 143, 273
Vangjelis Zafiratis: 8, 134, 143, 146, 274
Vasilis Dilos: 8, 81, 145, 274
Vasilis Hristu: 8, 145, 274
Vasilis Koças: 8, 127, 131, 244
Vasilis Gjizelis: 8, 120, 121, 148, 275

